

DORACAK PËR ARSIM PËR SHKATHTËSI JETËSORE

**Prej klasës VII-IX
të shkollës fillore**



BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Botues:

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Për botuesin:

Drejtor, Vesna Horvatoviq,

Redaktor:

Mitko Çeshllarov

Zhaneta Çonteva

Përkthim:

Zekirija Ibrahim

Botoi:

Teknokart, Shkup

Tirazhi:

2000 ekzemplarë në gjuhën shqipe

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

373.3.016:316.61 (035)=163.1

ПРИРАЧНИК за Образование за животни вештини за VII-IX одделение /
(уредници Митко Чешларов, Жанета Чонтева). – Скопје : Биро за развој на
образованието, 2009. – 302 стр. : илустр. : 28 см

ISBN 978-608-206-017-0

1. Митко Чешларов и Жанета Чонтева [уредници]
а) Основно образование – Наставни методи – Прирачници

COBISS.MK-ID 80474634



Doracaku është përpiluar me përkrahje profesionale dhe
finansiare nga Zyra e UNICEF- it, Shkup

Doracakun e përgatitën:

- Filipina Negrievska
- Safet Ballazhi
- Sasho Nikollovski-Alushevski
- Renata Dedova

nën mbikëqyrje të Prof. Dr. Violeta Petroska-Beshka

Në doracak janë përdorë materiale që janë përgatitur për nevojat e programeve të ndryshme arsimore që janë krijuar nga ekipi i ekspertëve të Qendrës së të Drejtave të Njeriut dhe Zgjidhjes së Konfliktëve:

- Најчевска, М. (раководител на проектот) (2000). *Имам право: Проект за имплементација за правата на детето во IV одделение од основното образование* (прирачник за наставници). (*Кам të drejtë: Projekt për implementimin e të drejtave të fëmijës në klasën IV të shkollës fillore*) (doracak për arsimtarë). Qendra e të Drejtave të Njeriut – Instituti i Studimeve Sociologjike dhe Gjurmimeve Politike-Juridike dhe UNICEF.
- Најчевска, М. (уредник) (2006). *Во право си. (Ke të drejtë Komiteti i Helsinkit dhe Qendra e të Drejtave të Njeriut dhe Zgjidhjes së Konfliktëve)*
- Петроска-Бешка, В. (2002). *Абра-мир-добра, Образование за мир - 1. и 2. дел (Абра-раче-добра, Arsimi për раче – pjesa 1 dhe 2)* (doracak për përdorim intern). Qendra e të Drejtave të Njeriut dhe Zgjidhjes së Konfliktëve dhe UNICEF.
- Петроска-Бешка, В. (2005). *Едукација за разрешување конфликти за VII одделение (Edukimi për zgjidhjen e konfliktëve për klasën VII)* (doracak për arsimtarë). Qendra e të Drejtave të Njeriut dhe Zgjidhjes së Konfliktëve dhe UNICEF.
- Петроска-Бешка, В., Најчевска, М. и Поповски, М. (1999). *Почитување на разликите.* (прирачник за обучувачи). (*Respektimi i dallimeve* – doracak për trajnues) Projekt për zgjidhjen e konfliktëve etnike – Fakulteti Filozofik, Shkup.
- Петроска-Бешка, В., Поповски, М. и Абдулаи, Ј. (1997). *Разбирање на конfliktите (Kuptimi i konfliktëve* – doracak për trajnues) Projekt për zgjidhjen e konfliktëve etnike – Fakulteti Filozofik, Shkup.

PËRMBAJTJA

HYRJE	7
-------------	---

TEMA I: UNË – ZHVILLIMI PERSONAL

Përmbajtja I-1: KRIJIMI I VETËBESIMIT	15
Përmbajtja I-2: KRIJIMI I PASQYRËS PËR VETVETEN SI ANËTAR I FAMILJES DHE SI NXËNËS	23
Përmbajtja I-3: NJOHJA DHE SHPREHJA E EMOCIONEVE PERSONALE	31
Përmbajtja I-4: BALLAFAQIMI ME HUMBJEN DHE KEQARDHJEN	37
Përmbajtja I-5: BALLAFAQIMI ME SUKSESIN/MOSSUKSESIN	45
Përmbajtja I-6: SHPREHJA E MENDIMIT	51
Përmbajtja I-7: MENAXHIMI I KOHËS SË LIRË	57

TEMA II: UNË DHE TI – RAPORTET NDËRPERSONALE

Përmbajtja II-1: FORMIMI, MBAJTJA DHE NDËRPRERJA E LIDHJEVE	63
Përmbajtja II-2: RUAJTJA E FSHEHTËSISË	67
Përmbajtja II-3: DHËNIA DHE PRANIMI I NDIHMËS	71
Përmbajtja II-4: PRANIMI DHE MIRATIMI I GABIMEVE	77
Përmbajtja II-5: BALLAFAQIMI ME EMOCIONET	81
Përmbajtja II-6: BALLAFAQIMI ME SJELLJEN E DHUNSHME	87
Përmbajtja II-7: ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE	95

TEMA III: UNË DHE TË TJERËT – MARRËDHËNIET SHOQËRORE

Përmbajtja III-1: NJOHJA E TË DREJTAVE THEMELORE TË NJERIUT	105
Përmbajtja III-2: RESPEKTIMI I TË TJERËVE (MOSDISKRIMINIMI)	119
Përmbajtja III-3: PËRKRAHJA DHE BASHKËPUNIMI I NDËRSJELLË	131
Përmbajtja III-4: NJOHJA E STRUKTURËS SË GRUPIT	139
Përmbajtja III-5: MARRJA E VENDIMEVE NË GRUP DHE KUPTIMI I DEMOKRACISË	147
Përmbajtja III-6: BALLAFAQIMI ME TRYSNINË SOCIALE	153
Përmbajtja III-7: NDËRMARRJA E PËRGJEGJËSISË PËR VEPRIMET	163

Përmbajtja III-8: NDËRTIMI I RAPORTIT POZITIV NDAJ VENDIT TË VET.....	169
Përmbajtja III-9: KRIJIMI I NDJENJËS PËR PËRKATËSINË E GJITHMBARSHME QYTETËRUESE	175
Përmbajtja III-10: PERCEPTIMI I MODELEVE POZITIVE TË IDENTIFIKIMIT	191
Përmbajtja III-11: ZHVILLIMI I QASJES KRITIKE NDAJ MEDIAVE.....	197
Përmbajtja III-12: SHFRYTËZIMI I INSTITUCIONEVE PËR MBROJTJE DHE SIGURI.....	203

TEMA IV: UNË DHE SHËNDETI – JETA E SHËNDETSHME

Përmbajtja IV-1: PËRVETËSIMI I SHPREHIVE PËR USHQIM TË SHËNDETSHËM.....	209
Përmbajtja IV-2: KUJDESI PËR HIGJIENËN PERSONALE.....	223
Përmbajtja IV-3: PARANDALIMI I SËMUNDJEVE DHE SËMURJEVE	229
Përmbajtja IV-4: ZHVILLIMI I VETËDIJES PËR SHËNDETI SEKSUAL.....	237
Përmbajtja IV-5: PREVENTIVA E KEQPËRDORIMIT TË SUBSTANCIVE PSIKOTROPIKE.....	253

TEMA V: UNË DHE MJEDISI – RAPORTI ME MJEDISIN E JASHTËM

Përmbajtja V-1: SJELLJA E SIGURT NË MJEDIS.....	261
Përmbajtja V-2: KUJDESI PËR HIGJIENËN E MJEDISIT.....	269
Përmbajtja V-3: KRIJIMI I RAPORTIT POZITIV NDAJ BIMËVE DHE KAFSHËVE.....	277
Përmbajtja V-4: MBROJTJA E PLANETIT TOKË	295

HYRJE

ÇKA ËSHTE ARSIMIMI PËR SHKATHTËSITË JETËSORE?

Të gjithë fëmijët, pavarësisht nga prejardhja dhe aftësitë, kanë nevojë për shkathtësi të cilat do t'u mundësojnë t'i shfrytëzojnë dituritë e tyre që të praktikojnë forma të shëndosha të sjelljes dhe t'u shmangen atyre formave që paraqesin kanosje ndaj shëndetit të tyre personal, emocional dhe social. Ato shkathtësi do të ndihmojnë që ata të jenë të pjekur, aktivë dhe persona të përgjegjshëm në një shoqëri qytetare dhe multikulturore.

Me çka dallohet arsimimi për shkathtësi jetësore nga qasjet e tjera të cilat orvaten të ndikojnë në sjelljen e fëmijëve?

- Arsimimi për shkathtësi jetësore është i orientuar drejt futjes së **ndryshimeve të sjelljes** përmes përvetësimit të diturive, qëndrimeve dhe shkathtësive të caktuara, të cilat u ndihmojnë fëmijëve **të zgjedhin dhe praktikojnë** sjellje të shëndoshë në vend të mësimit të thatë me shpjegimin se çka do të thotë ajo sjellje në teori.
- Detyra themelore e arsimimit për shkathtësi jetësore është **ta transformojë diturinë në sjellje**; andaj secili program për shkathtësi jetësore duhet të ofrojë raport të balancuar ndërmjet: (1) diturive dhe informacioneve; (2) qëndrimeve dhe vlerave dhe (3) shkathtësive.
- Arsimimi për shkathtësi jetësore bazohet në **metodat participuese të mësimit dhe mësimdhënies**, që i bën fëmijët pjesëmarrës aktivë në procesin e mësimit, në vend që t'i trajtojnë ata si pranues pasiv të informacioneve.

Arsimimi për shkathtësi jetësore nis nga premisa themelore se përvetësimi i shkathtësive jetësore është e drejtë e secilit fëmijë. Kjo e bën të jetë relevant për **nevojat e fëmijëve** të secilës moshë dhe në mënyrë fleksibile t'u përgjigjet sfidave reale të **jetës së përditshme** të fëmijëve.

Arsimimi për shkathtësi jetësore e merr parasysh faktin se sjellja e individit varet nga faktorë të ndryshëm, të cilët burojnë nga familja, shkolla dhe bashkësia më e gjerë, po edhe nga faktorët individualë në të cilët bëjnë pjesë dituritë, qëndrimet, shkathtësitë dhe veçoritë e individit. Prandaj, arsimimi për shkathtësi jetësore nuk zbatohet në mënyrë të izoluar nga burimet e tjera të ndikimit, por përkundrazi, synon që ta fuqizojë individin si pjesë të bashkësisë që ai të mund të ballafaqohet me sfidat të cilat burojnë nga ndikimet e mjedisit në të cilin ai ekziston.

ÇKA JANË SHKATHTËSITË JETËSORE?

Termi *shkathtësi jetësore* i referohet një grupi të madh të shkathtësive psiko-sociale, qëllimi i të cilave është të kontribuojnë për zhvillimin personal, emocional dhe social të fëmijëve, si dhe të sigurojnë mirëqenie fizike, mendore dhe sociale për fëmijët.

Është vështirë të bëhet një listë e të gjitha shkathtësive të mundshme jetësore, por zakonisht si më të rëndësishëm mund të konsiderohen ato që janë dhënë në tabelën që vijon (Tabela 1). Se cilat shkathtësi jetësore do të theksohen dhe cilave do t'u kushtohet vëmendje më e madhe në procesin e arsimimit, kjo varet nga tema dhe përmbajtja që përcillet, nga situata reale

jetësore në shkollë dhe në mjedisin më të gjerë dhe, më e rëndësishmja, nga nevojat e vetë nxënësve. Pa e marrë në konsideratë kontekstin në të cilin është vënë, arsimimi për shkathtësi jetësore duhet të promovojë vlera pozitive dhe t'i zbatojë shkathtësitë e përbushjes së nevojave konkrete të fëmijëve.

*Tabela 1. Shkathtësitë më të rëndësishme jetësore.
(sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë)*

<p>Vetëdija për veten</p> <ul style="list-style-type: none"> • vetëdija për vlerat personale (vetëbesimi, imazhi pozitiv për veten) • vetëdija për dobësitë personale (të priturat reale, imazhi real për veten) • vetëdija për të drejtat dhe përgjegjësitë • pasqyra e qartë për vlerat • motivimi dhe kujdesi për vetveten 	<p>Empatia</p> <ul style="list-style-type: none"> • kujdesi për të tjerët • toleranca ndaj dallimeve • respektimi i të tjerëve • të qenët i shoqërueshëm
<p>Shkathtësitë e komunikimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • komunikimi efektiv dhe adekuat verbal dhe joverbal • aftësia për t'u shprehur • asertiviteti • dëgjimi aktiv • aftësia për bisedime 	<p>Shkathtësitë interpersonale</p> <ul style="list-style-type: none"> • bashkëpunimi • përgatitja për punë ekipore • formimi dhe ndërprerja e miqësive • njohja e kufijve të sjelljes adekuate interpersonale
<p>Shkathtësitë e marrjes së vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> • marrja e vendimeve me vetëdije të plotë për faktorët që ndikojnë në mendimin dhe zgjedhjen • marrja e vendimeve që janë të bazuara në vlerësim të saktë të situatës • parashtrimi i qëllimeve reale • planifikimi i procedurave personale duke marrë parasysh pasojat e mundshme • marrja e përgjegjësisë për procedurat personale • përgatitja për ndryshimin e vendimeve me qëllim të përshtatjes ndaj situatave të reja 	<p>Shkathtësitë për zgjidhjen e problemeve</p> <ul style="list-style-type: none"> • identifikimi i problemeve dhe shkaqeve të paraqitjes së tyre • vlerësimi i saktë i aktiviteteve që mund të ndërmerren për zgjidhjen e problemeve • identifikimi se ku mund të kërkohe ndihmë kur ka ndonjë problem dhe kërkimi i ndihmës. • përgatitja për kompromis • përgatitja për pjesëmarrje në zgjidhjen grupore të problemeve
<p>Të menduarit kreativ</p> <ul style="list-style-type: none"> • të menduarit pozitiv • mësimi aktiv (nevoja për të kërkuar njohuri të reja) • aftësia për ta shprehur vetveten • identifikimi i mundësive alternative • zbulimi i zgjidhjeve origjinale të problemeve 	<p>Të menduarit kritik</p> <ul style="list-style-type: none"> • njohja e ndikimeve sociale dhe kulturore ndaj qëndrimeve, vlerave dhe sjelljes (përfshirë edhe presionin e moshatarëve dhe ndikimin e mediave) • vetëdija për pabarazinë, padrejtësinë dhe paragjykimet • vetëdija për rolin e qytetarit të përgjegjshëm
<p>Ballafaqimi me emocionet</p> <ul style="list-style-type: none"> • njohja e emocioneve personale dhe e emocioneve të të tjerëve • ndërlidhja e emocioneve me përjetimet, të menduarit dhe sjelljen • ballafaqimi me frustracione, hidhërim, pikëllim, frikë dhe ankth • ballafaqimi me emocione të fuqishme të të tjerët 	<p>Ballafaqimi me stresin</p> <ul style="list-style-type: none"> • ballafaqimi me situata në të cilat nuk mund të ndikohet • zhvillimi i strategjive për t'u ballafaquar me humbjen, refuzimin dhe kritikën • ballafaqimi me përdorimin e substancave psikotropike • rezistenca ndaj trysnive • ballafaqimi me situata të stresit • menaxhimi i kohës

SI TË JEPET MËSIM PËR SHKATHTËSITË JETËSORE

Kur bëhet fjalë për arsimimin e shkathtësive jetësore, nuk mjafton vetëm të përcaktohet se cilat janë shkathtësitë që duhet t'i përvetësojnë fëmijët, por edhe se cilat metoda mësimore do të përdoren në atë rast. Si do të jepet ai mësim është njësoj me rëndësi me atë se *çka do të mësohet*. Kjo do të thotë se mësimi që është i orientuar drejt përvetësimit të shkathtësive jetësore duhet të bazohet në metodat dhe qasjet aktive që u mundësojnë fëmijëve të mësojnë përmes përvojës, duke i zbatuar këto shkathtësi. Në këtë mësim rolin më themelor e ka arsimtari – nga ai varet se a do të thjeshtësohet arsimimi për shkathtësi jetësore vetëm në përcjelljen e diturive për atë se si duhet të vepohet në situata të caktuara ose do të përfshihet edhe përvetësimi i shkathtësive që do t'u mundësojnë fëmijëve të veprojnë në mënyrë adekuate kur gjendet në një situatë konkrete.

Në tabelën që vijon (Tabela 2) janë dhënë metodat më shpesh të përdorura të mësimin aktiv që përdoren në mësimdhënien e shkathtësive jetësore. Përveç se janë përcaktuar dobite kryesore nga zbatimi i secilës metodë, në këtë tabelë janë dhënë edhe këshilla konkrete për zbatim të suksesshëm të secilës metodë.

Tabela 2. Metodatat më shpesh të përdorura në arsimimin për shkathtësi jetësore

Metoda	Dobitë	Këshilla për arsimtarin / arsimtaren
Diskutimi me tërë grupin	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Nxit këmbimin e mendimeve</i> 2. <i>Ndihmon në arritjen e përbashkët të përfundimeve dhe nxjerrjen e porosit nga aktivitetet</i> 3. <i>Ndihmon në përvetësimin e komunikimit dhe respektit të ndërsjellë</i> 	<ul style="list-style-type: none"> o Arsimtari duhet t'u mundësojë nxënësve që ta nxjerrin porosinë dhe të arrijnë në përfundim o Arsimtari duhet të sigurojë respektimin e rregullave të sjelljes për të cilat janë marrë vesh më parë – në rast të thyerjes së rregullave, identifikohet dhe jepet rregulla e thyerjes, pa i përmendur fëmijët që e kanë thyer atë. o Arsimtari duhet t'i respektojë denjësisht rregullat për të cilat janë marrë vesh dhe me sjelljen e tij të bëhet model i nxënësve o Secili fëmijë duhet të nxitet të marrë pjesë në diskutim – përparësi u jepet përgjigjeve të pyetjeve në të cilat nxënësit më rrallë paraqiten për fjalë. o Asnjë fëmijë nuk detyrohet të përgjigjet në pyetje gjatë diskutimit – duhet të gjendet mënyra që të gjithë fëmijët të nxitin të marrin pjesë në mënyrë vullnetare o Asnjë përgjigje e nxënësve nuk duhet të trajtohet si e gabuar, e as të reagohe në të (verbalisht ose joverbalisht) sikur është e gabuar

Grupet punuese (grupet e vogla)	<ol style="list-style-type: none"> <i>Ndihmojnë në aktivizimin e secilit fëmijë, përmes këmbimit të përvojës personale dhe shprehjes së mendimit të tyre</i> <i>U ndihmojnë fëmijëve që të mësojnë të komunikojnë me njëri-tjetrin, të bashkëpunojnë dhe të respektohen me njëri-tjetrin.</i> 	<ul style="list-style-type: none"> o Më së miri është që grupet të numërojnë 4-5 fëmijë, pos nëse nuk është caktuar më shumë o Nuk lejohet që fëmijët e njëjtë vazhdimisht ta paraqesin punën e tyre në grup – kujdes që në këtë të ndërrohen rolet mes djemve dhe vajzave o Më së miri është që grupet të formohen me zgjedhje të rastësishme (me përdorimin e kartelave të lojës, numërimit etj.) që kështu të pamundësohet formimi i klikave o Udhëzimet për punën në grup duhet të jenë të qarta dhe të kuptueshme nga të gjithë o Arsimitarja duhet të sigurojë që të gjithë anëtarët e grupit të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në punë
Analiza e përrallave	<ol style="list-style-type: none"> <i>I prezantojnë informacionet në mënyrë interesante që kështu t'u ndihmojnë fëmijëve që më lehtë të kuptojnë dhe të mbajnë mend</i> <i>Mundësojnë të inkuadrohen edhe tema më të ndjeshme dhe më të vështira</i> <i>Kontribuojnë për zhvillimin e fantazisë së fëmijës</i> <i>Kontribuojnë për zhvillimin e shkathtësive komunikuese (dëgjim, ligjërim, shkrim)</i> 	<ul style="list-style-type: none"> o Përrallat duhet të jenë interesante dhe të lexohen ose rrëfohen në mënyrë dramatike o Përrallat duhet të jenë të kuptueshme për fëmijët – që fëmijët të mund ta zbulojnë dhe kuptojnë mesazhin e përrallës dhe t'i identifikojnë ndjenjat e personazheve kryesorë. o Përrallat duhet të përdoren si nxitje për vizatim, aktrim ose ndonjë aktivitet tjetër. o Përrallat duhet të nxisin ndërlidhje me jetën e përditshme të fëmijëve
Vizatimi, modelimi, kolazh dhe teknika të vizatimit	<ol style="list-style-type: none"> <i>Paraqet mjet për ta shprehur mendimin e fëmijëve</i> <i>Nxit të menduarit kreativ</i> <i>Ndihmon që të përcillen dhe mbahen mend informacionet</i> 	<ul style="list-style-type: none"> o Nuk është me rëndësi të jetë shumë artistike – më e rëndësishme është përmbajtja e asaj që është vizatuar. o Mund të përdoret si zëvendësim për shkrim të fëmijët më të vegjël, të cilët akoma nuk i kanë përvetësuar shkathtësitë e shkrim-leximit o Duhet të jetë e kufizuar në kohë dhe e njohur për nxënësit o Mund të vizatohet në mënyrë individuale ose grupore
Analiza e situatave / rasteve	<ol style="list-style-type: none"> <i>Mundëson që, përmes analizës së sjelljes së dhënë, të nxitet sjellja alternative</i> <i>Nxit të menduarin kritik dhe kreativ</i> 	<ul style="list-style-type: none"> o Situatat duhet të jenë më të shkurtra, më të thjeshta dhe më të kuptueshme o Situatat duhet të burojnë nga realiteti dhe ta shprehin atë realitet

Demonstrime dhe simulime	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Ndihmojnë që të ndërlihet dituria abstrakte me situatat konkrete të realitetit</i> 2. <i>Kontribuojnë për zhvillimin e shkathtësive praktike dhe të shkathtësive të vëzhgimit</i> 3. <i>E stimulojnë të menduarit logjik</i> 	<ul style="list-style-type: none"> o Më së miri është të përdoren sende të vërteta (ushqim, top ose gjëra të tjera) në vend të fotografive të tyre o Fëmijët duhet të inkurajohen që në mënyrë të pavarur të inkuadrohen në demonstrimet dhe simulimet praktike, me ndihmë minimale nga arsimtari
Akrimi dhe luajtja e roleve	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Kontribuojnë që të zhvillohen të gjitha llojet e shkathtësive komunikuese</i> 2. <i>U mundësojnë fëmijëve që t'i analizojnë qëndrimet dhe emocionet, madje edhe atëherë kur bëhet fjalë për tema të ndjeshme, siç është seksualiteti ose pengesat në zhvillim</i> 3. <i>Kontribuojnë për zhvillimin e vetëbesimit te fëmijët</i> 4. <i>Nxisin aktivitete që kërkojnë nga fëmijët të mendojnë dhe të vendosin.</i> 	<ul style="list-style-type: none"> o Fëmijët duhet që vetë t'i mendojnë dramatizimet në të cilat do të aktrojnë dhe rolet që do t'i kenë ata. o Si rekuizita mund të përdoren kukullat e vërteta, por edhe gjërat e thjeshta të bëra nga çorape, qese të letrës ose sende të ngjashme që mund të përshtaten për këtë qëllim o Secili dramatizim duhet të jetë ilustrim i ndonjë mesazhi të caktuar ose të shpijë drejt një mesazhi të caktuar o Dramatizimet mund të përdoren çdoherë kur paraqitet sjellje “problemore” jashtë orës së mësimi të shkathtësive jetësore.
Aktivitete loje	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Ndihmojnë që tema të realizohet përmes argëtimit</i> 2. <i>Kontribuojnë që më lehtë të mbahet mend porosia</i> 3. <i>Mundësojnë që të gjithë fëmijët të marrin pjesë dhe të kontribuojnë për zhvillimin e vetëbesimit te fëmijët</i> 	<ul style="list-style-type: none"> o Për luajtjet e lojërave më shpesh duhet një hapësirë e zbrazët (më rrallë edhe ndonjë organizim i veçantë i hapësirës), e cila mund të sigurohet me zhvendosjen e bankave dhe karrigeve nga nxënësit (njësoj edhe djemtë edhe vajzat) o Në lojëra duhet të marrë pjesë edhe arsimtari – në fillim, kur përmes shembullit të tij do të ndihmojë në kuptimin e udhëzimeve dhe/ose përmes pjesëmarrjes në aktivitete ashtu si kërkon nga nxënësit

SI PËRDORET DORACAKU

Në doracak janë dhënë të gjitha pesë temat e përfshira në programin e shkathtësive jetësore:

1. UNË: Identiteti personal
2. UNË dhe TI: Raportet ndërpersonale
3. UNË dhe TË TJERËT: Raportet shoqërore
4. UNË dhe SHËNDETI: Jeta e shëndoshë
5. UNË dhe MJEDISI: Raporti me mjedisin e jashtëm

Për secilën temë programi mësimor i parashikon nga disa përmbajtje që përpunohen nëpër aktivitete të ndryshme. Në doracak janë dhënë përmbajtjet e secilës temë bashkë, ndërsa pritet nxënësi që t'i përvetësojë ato si dituri, shkathtësi dhe qëndrime/vlera pas përvetësimit të secilës përmbajtje veçmas. Rezultatet e pritura për secilën përmbajtje burojnë drejtpërdrejt nga qëllimet mësimore të vizatuara në program. Nga arsimtari/arsimtarja pritet që derisa e udhëheqë punëtorinë të udhëhiqet nga qëllimet drejt të cilave synon tema dhe përmbajtja konkrete.

Doracaku përmban numër të ndryshëm të punëtorive për secilën temë të programit mësimor, gjegjësisht për secilën përmbajtje në kuadër të temës. Numri i punëtorive luhet varësisht nga përmbajtja e temës, por edhe nga ndërlikueshmëria e qëllimeve të parashtruara mësimore, gjegjësisht nga rezultatet e mësimimit të inkuadruar në vetë temën/përmbajtjen. Me realizimin e secilës përmbajtje veçmas, arrihen disa qëllime mësimore njëherazi, që nuk do të thotë se një punëtori mund të zëvendësojë më shumë të tilla, as se punëtoritë e ofruara konkrete mund të kombinohen, të modifikohen dhe të ridedikohen.

Secila punëtori është e strukturuar ashtu që të përfshijë disa komponentë që realizohen njëri pas tjetrit dhe shpesh burojnë nga njëri-tjetri. Qëllimi i secilit komponent dhe i karakteristikave të tij kryesore është përshkruar në Tabelën 3

Tabela 3. Përshkrimi i komponentëve që e përbëjnë strukturën e punëtorive

<i>Komponenti</i>	<i>Dedikimi</i>	<i>Karakteristikat</i>
Aktiviteti hyrës	- <i>I inkuadron nxënësit në temën e punëtorisë dhe/ose i jep punëtorisë ton argëtues</i>	- Paraqet aktivitet lojë - Duhet të zgjasë 5-10 minuta - Mundet, por nuk është patjetër, të ketë lidhje të dukshme me temën - Mund të kryhet me pyetje që e sigurojnë lidhjen me aktivitetin kryesor
Aktiviteti kryesor	- <i>siguron arritjen e qëllimeve të parashtruara dhe të rezultateve të pritura (nxënësit t'i përvetësojnë dituritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e kërkuara) përmes mësimimit nga përvoja</i>	- i përmbajnë aktivitetet bartëse të punëtorisë të organizuara në formë të aktrimit/roleve, vizatimit, analizës së përrallave, analizës së situatave/rasteve ose të llojeve të ndryshme të aktiviteteve të lojës - shumica e punëtorive kanë një aktivitet kryesor, por disa kanë mund të kenë edhe nga dy, që burojnë nga njëri-tjetri - aktiviteti (ose aktivitetet) kryesor/e duhet të zgjat/zgjasin 20-30 minuta

Diskutimi	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Nxit këmbimin e përshtypjeve dhe mendimeve nga aktiviteti kryesor</i> - <i>Siguron arritjen e përfundimeve drejt të cilave synon punëtorja (deri në arritjen e qëllimeve dhe rezultateve)</i> 	<ul style="list-style-type: none"> - Vijon pas aktivitetit kryesor (ose pas secilit aktivitet kryesor, nëse ka më shumë) - Mbahen në bazë të serisë së pyetjeve të strukturuar që lidhen me përvojat e aktivitetit kryesor - E udhëheq arsimtari në rolin e facilituesit – nuk i ofron përfundimet, por i udhëheq nxënësit që ata vetë të arrijnë në përgjithësimin e përvojave dhe njohurive paraprake.
Përfundimi	<ul style="list-style-type: none"> - <i>u jep arsimtarëve orientime për atë që duhet të bëjë nga diskutimi me nxënësit</i> 	<ul style="list-style-type: none"> - i rezymon dituritë, shkathtësitë dhe qëndrimet që duhet t'i arrijnë nxënësit në kontekst të punëtorisë konkrete - nuk u tregohen nxënësve – arsimtari i ka në mendje përgjigjet kur parashtron pyetje (dhe nënpyetje) për diskutim
Aktiviteti përfundimtar	<ul style="list-style-type: none"> - <i>i lëviz nxënësit nëpër diskutime dhe/ose siguron përfundim të punëtorisë me ndjenja pozitive</i> 	<ul style="list-style-type: none"> - paraqet aktivitetet loje - mund të zgjasë më së shumti 5 minuta - nuk është i patjetërsueshëm kur aktiviteti kryesor është më i vëllimshëm dhe përmban metoda të ndryshme të punës - mund të zbatohet para ose pas reflektimit – nëse del nga aktiviteti kryesor ose ka pikëtakime me të, rekomandohet t'i paraprijë reflektimit, por nëse është i pavarur nga aktiviteti kryesor mund ta ndjekë reflektimin
Reflektim	<ul style="list-style-type: none"> - <i>e rezymon atë që e ka mësuar dhe e ndërlikohet me jetën e përditshme – i nxit nxënësit të mendojnë për atë që e kanë përjetuar, që e kanë kuptuar dhe si mund ta zbatojnë atë që e kanë mësuar</i> 	<ul style="list-style-type: none"> - vijon pas aktivitetit përfundimtar ose pas aktivitetit kryesor, varësisht nga lidhja ndërmjet aktivitetit përfundimtar dhe aktivitetit kryesor - çdoherë zhvillohet në bazë të katër pyetjeve të njëjta - e udhëheq arsimtari në rol të facilituesit – nuk imponon pikëpamje dhe përjetim të tij, por vetëm siguron atmosferë që nxënësit t'i shprehin përjetimet e tyre dhe të ofrojnë zbatim të asaj që e kanë mësuar në jetën e përditshme.

Doracakun përmban punëtorë që janë të dedikuara për fëmijë të moshës 12-14 vjeçare, gjegjësisht për fëmijë të klasave 7-9. Me këtë rast duhet të thuhet se punëtoritë nuk janë të grupuara sipas moshës, me qëllim që të kështu t'i jepet mjaft liri realizuesit të programit që vetë ai **të zgjedhë se cilat punëtori i konsideron për më themelore dhe/ose më adekuate** për moshën, pjekurinë dhe nevojat e nxënësve të tij. Kjo do të thotë edhe se realizuesi mund **t'i përshtatë punëtoritë e paraqitura të moshës, pjekurisë dhe nevojave të nxënësve**, nëse gjatë kësaj i përmbahet strukturës së përgjithshme të punëtorisë.

Punëtoritë e ofruara në doracak mund edhe të mos i mbulojnë të gjitha orët e parashikuara për përmbajtjet që i kushtohen arsimimit për shkathtësi jetësore të klasave IV-VI. Nga arsimtari/ arsimtarja që e realizon programin për shkathtësi jetësore pritet që ai të jetë kreatori i punëtorive me të cilat do të përmbushet numri i mbetur i orëve të parashikuara me programin mësimor. Realizuesit të programit i jepet liri **që të krijojnë punëtori të reja**, që nga njëra anë do të burojnë nga qëllimet e programit, ndërsa nga ana tjetër do t'i respektojnë nevojat e grupit të nxënësve të tij/të saj ose nevojat që i imponon një situatë e caktuar në paralele, në shkollë ose në komunitetin

më të gjerë. Në atë rast pritet që modeli i punëtorive të paraqitura në doracak dhe përvoja e arritur përmes zbatimit të tyre të përdoret si bazë e krijimit të punëtorive plotësuese.

Punëtoritë e dhëna në doracak janë grupuar rreth pesë temave të përfaqësuara në programin e arsimimit për shkathtësi jetësore. Gjatë realizimit të punëtorisë në punën me nxënës nuk pritet të respektohet rendi i paraqitjes së tyre si në doracak, por përkundrazi, realizuesit të programit i jepet liri e plotë **që ta lëvizë rendin e punëtorive**, duke e ndryshuar temën nga njëra orë në tjetrën, por duke i respektuar edhe nevojat e nxënësve dhe të vetë rrethanave.

Disa nga punëtoritë për nga vetë përmbajtja e tyre ose për nga qëllimet e tyre mund të duken të afërta për përmbajtjet/qëllimet mësimore të përfaqësuara në lëndët e tjera. Kjo nuk do të thotë se ato punëtori duhet të shmangen, por përkundrazi, mund **të përdoren si nxitje, e ndonjëherë edhe si zëvendësim për orët e parashikuara në përmbajtje të tilla më akademike**. Ndonjëherë duhet të kihet parasysh qasja që e imponojnë punëtoritë, e cila shpie drejt rezultateve më të qëndrueshme të mësimit dhe, përveç që ofron dituri, nxit edhe përvetësimin e shkathtësive dhe pranimin e qëndrimeve dhe vlerave pozitive.

TEMA I:

UNË – ZHVILLIMI PERSONAL

Përmbajtja I-1:

KRIJIMI I VETËBESIMIT

Pritet që nxënësi/nxënësja:

Dituri	<ul style="list-style-type: none">• Ta dijë konceptin <i>për vetveten</i> dhe për veçantinë e tij• Të dijë mënyra të ndryshme të shprehjes së aftësive dhe kapaciteteve përmes punës dhe aktiviteteve të lira• Të dijë mënyra të ndryshme për të kontribuar në punën grupore
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none">• Të mund t'i zhvillojë potencialet, dituritë dhe interesat e tij në fusha të ndryshme• Të mund ballafaqohet me sfidat• Të mund t'i shprehë potencialet e tij dhe të bashkëpunojë me të tjerët në zgjidhjen e detyrave
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none">• Ta kuptojë se është i rëndësishëm besimi në <i>UNË mund të ndikoj për ndryshime</i>• Të pranojë se është me rëndësi të mbahet vetërespekti pozitiv i bazuar në vetënjohjen e qartë.

PUNËTORIA I-1.1: QËLLOJE KUSH JAM!

MATERIALET

- Pajisje për të shkruar
- Copëza të vogla të letrës 2x6 cm.
- Sellotej i gjëra
- Gërshërë
- Kuti



AKTIVITETI HYRËS

Nxënësit formojnë tresha dhe qëndrojnë ashtu në hapësirën ndërmjet karrigeve që janë të radhitura në rreth. Secilit nxënës i jepet nga një copë letre.

Arsimtari e jep këtë udhëzim: “Secili duhet të mendojë dhe të përkujtohet në diçka që e ka bërë ose që e ka arritur me çka dallohet nga moshatarët e tij – diçka që e bën atë unik në raport me të tjerët (p.sh.: rashë me sajë në gropë të thellë 3-4 metra).”

Në kuadër të treshit të formuar nxënësit duhet të merren vesh se cili do ta përfaqësojë grupin para të tjerëve, duke e vënë në pah uniken e tij/saj në një fjali të vetme. Uniken e atij/asaj që duhet ta përfaqësojnë e shkruajnë në një copë të vogël letre, të cilën pastaj do ta lexojnë para të gjithëve. Nxënësit kthehen në rreth, por kanë kujdes të ulen sa më larg atyre që duhet t'i përfaqësojnë.

Përfaqësimi fillon nga një vullnetar dhe bëhet në këtë mënyrë: Vullnetari e thotë së pari emrin e tij, e pastaj e lexon uniken e nxënësit që e përfaqëson: “Unë jam (emri i tij) dhe jam unik/e me atë (unikja e tjetrit).”

Nxënësit e tjerë e qëllojnë se kujt i referohet në të vërtetë ky tipar unik.

Kur t'ia qëllojnë (do ta thonë emrin e tij/saj), atëherë ndodhë qëllimi “i vërtetë”: nxënësi ngrihet, e thotë emrin e tij dhe e përsërit uniken e tij.

Nxënësit e tjerë në rreth, pas secilës paraqitje, i japin duartrokitje.

Procedura përsëritet me nxënësin që është i ulur majtas ose djathtas vullnetarit të parë, sipas radhitjes së uljes në rreth dhe kjo përsëritet derisa nuk prezantohen të gjithë.

AKTIVITETI KRYESOR

Secilit nxënës i jepet nga një fletë e vogël e letrës në të cilën duhet ta shkruajë emrin e ndonjë personi të famshëm me të cilin ai entuziazmohet, por gjatë kësaj askush nuk guxon ta shohë se çfarë emri ka shkruar. Mund të bëhet fjali për shkencëtar, shkrimtar, artist, personazh nga veprat letrare, ndonjë hero i filmave ose i TV-së...

Fletat e shkruara vendosen në një kuti të përbashkët.

Nxënësit ndahen në grupe të vogla (me nga 4-6 fëmijë). Secili grup ulet duke e formuar një rreth.

Secili anëtar i grupit me sy të mbyllur e tërheq një “person të njohur” nga kutia, duke pasur kujdes që të mos e shohë ai që është afër tij. Tash secili mund të vërejë se në çfarë personi të famshëm janë shndërruar të tjerët e grupit të tij, por këtë nuk mund ta shikojë se është shndërruar ai vetë.

Detyra e secilit është që ta zbulojë se në çfarë personi “është shndërruar”. Këtë mund ta bëjë përmes parashtrimit të pyetjeve në cilat jepet përgjigje me PO ose JO (për shembull: A jam mashkull?; A jam këngëtare? etj.) Ai që pyet ka të drejtë të vazhdojë të pyesë derisa i jepen përgjigje pohuese. Si të marrë përgjigje JO, e drejta e pyetjes i kalon nxënësit tjetër në rreth.



Nxënësit merren vesh vetë se cili do të fillojë i pari me zbulimin e identitetit të tij të ri, ndërsa të tjerët e grupit e presin radhën e tyre. Aktiviteti përfundon kur të gjithë do ta qëllojnë identitetin e ri.

DISKUTIM

1. A “ju ra” personi i famshëm të cilit ju i entuziazmoheni?
2. A ndjeheshit mirë ose keq kur e zbuluat se çfarë identiteti keni marrë në lojë? Pse?
3. A është mirë të jemi dikush të cilit të tjerë i entuziazmohen? Pse?
4. A është patjetër të jemi persona të famshëm që njerëzit që na vlejné diçka në jetë të entuziazmohen me ne? Si e sigurojmë entuziazmin e tyre?

PËRFUNDIM

Është mirë kur të tjerët, veçanërisht ata që për ne janë të rëndësishëm, entuziazmohen me ne. Që ta arrijmë këtë, s’është e thënë të jeni persona të famshëm – mjafton të jemi të dalluar në veprimet tona.

REFLEKTIM


1. Çka bëmë?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA I-1.2: EDHE TË NGJASHËM EDHE TË NDRYSHËM

MATERIALET

- Pajisje për të shkruar
- Fletë pune për nxënësit: Me çka jemi të njëjtë e me çka dallohemi - 1
- Fletë pune për nxënësit: Me çka jemi të njëjtë e me çka dallohemi - 2
- Tabelë dhe shkumës



AKTIVITETI KRYESOR 1

Nxënësit ndahen në grupe të vogla me nga tre vetë. Nëse në këtë mënyrë nuk mund të përfshihen të gjithë nxënësit, atëherë formohen grupe edhe me nga dy nxënës (çifte)

Secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënësit “Me çka jemi të njëjtë e me çka dallohemi (1 dhe 2)” me detyrë që bashkërisht të plotësohet në këtë mënyrë:

Secili e zgjedh nga një rreth për vete dhe mbi të e shkruan emrin e tij.

Pastaj paramendohet një listë e gjërave që dëshiron dhe/ose nuk dëshiron t'i bëjë (p.sh.: dëshiron të luajë futboll, të hajë tortë... nuk dëshiron të zgjohet herët, t'i bëjë detyrat e shtëpisë...).

Përmes diskutimit me fëmijët në grup secili nxënës duhet të zbulojë se cilat nga ato gjëra i referohen vetëm atij (dëshiron dhe/ose nuk dëshiron t'i bëjë vetëm ai), cilat gjëra janë të përbashkëta me secilin nga dy nxënësit e tjerë në grup (të dy dëshirojnë/nuk dëshirojnë t'i bëjnë) dhe cilat gjëra janë të përbashkëta për të tre nxënësit e tjerë në grup (nëse grupi punon në tresh).

Nëse nxënësit e zgjedhin bashkërisht se cilën nga ato gjëra do ta shkruajnë në rrethë, atë e bëjnë në këtë mënyrë:

- Në fushën e përhimë me ngjyrë më të çelur i shkruajnë 3 gjëra të vetme që vlejnë vetëm për atë të cilit i takon rrethi (shkruhen nga 5 nëse punojnë në dyshe)
- Në fushën e përhimë me ngjyrë pak më të errët, që është e përbashkët për dy fëmijë të grupit, shkruhet nga 3 gjëra të përbashkëta për të dy (shkruhen nga 5 nëse punojnë në dyshe)
- Në fushën e përhimë me ngjyrë më të errët, që është e përbashkët për tre nxënës të grupit, shkruhen tre gjëra të përbashkëta për të tre. (vetëm kur punojnë në tresha)

AKTIVITETI KRYESOR 2

Pas përfundimit të punës në fletët e punës, nxënësit ulen në rreth.

Arsimtarja i shënon gjërat e përbashkëta veçanërisht ato që janë të përbashkëta për të tre në grup), të cilat pastaj do t'i lexojnë 3-5 vullnetarë (edhe së paku 5 do të shkruhen në tabelë).

Pastaj arsimtarja kërkon dhe shkruan një pjesë të gjërave që janë dëshmuar si të vetmet të rëndësishme për disa nxënës. Ata konstatojnë bashkërisht se a janë këto gjëra ende të vetme nëse aty inkuadrohen të gjithë nxënësit e grupit të madh.

DISKUTIM

1. A e kishit më vështirë të gjeni gjëra me të cilat dalloheshit nga të tjerët apo gjëra me të cilat ishit të ngjashëm? Pse?
2. A është më lehtë të gjeni dallime/ngjashmëri me më pak apo më shumë persona? Pse?
3. Kur ndjehemi më mirë – kur mendojmë se jemi të ndryshëm nga të tjerët apo kur jemi të ngjashëm me të tjerët? Pse?



PËRFUNDIM

Kur është grupi homogjen (i përbërë nga moshatarë), është shumë lehtë të gjenden interesat e përbashkëta.

Gjërat për të cilat ne mendojmë se na dallojnë, sepse zakonisht krahasohemi me rreth më të vogël të moshatarëve, paraqiten si ngjashmëri çdoherë kur në krahasim të tillë inkuadrohen më shumë persona.

Dallimet janë shprehje e individualitetit. Të jesh personalitet me tiparet tuaja specifike çdoherë është më mirë se të jesh kopje e të tjerëve.

**AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR**

Të gjithë nxënësit duhet të radhiten në një vijë sipas një karakteristike të përcaktuar më parë, për shembull: sipas muajit dhe vitit të lindjes. Me këtë rast ata nuk guxojnë të flasin fare. Kështu duhet t'i gjejnë mënyrat e komunikimit ndërmjet vete, me qëllim që të radhiten si duhet.

Variacionet:

- Sipas gjatësisë së shputave
- Sipas ngjyrës së syve
- Sipas ngjyrës së flokëve
- Sipas ngrohtësisë së pëllëmbëve

REFLEKTIM

1. Çka bëmë?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA I-1.3: KUR TË RRITEM, DËSHIROJ TË BËHEM...

MATERIALET

- Copëza të vogla të letrës
- Pajisje për të shkruar
- Tabelë dhe shkumës



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë fëmijët qëndrojnë në një hapësirë të gjerë të zbrazët të klasës, ku duhet të radhiten në vijë sipas gjatësisë së pëllëmbës, duke filluar që nga pëllëmba më e vogël, Të gjithë fëmijët qëndrojnë në një hapësirë të gjerë të zbrazët të klasës, ku duhet të radhiten në vijë sipas gjatësisë së pëllëmbës, duke filluar që nga pëllëmba më e vogël, deri te pëllëmba më e madhe, por gjatë kësaj nuk guxojnë të flasin

AKTIVITETI KRYESOR

Fëmijët ndahen në çifte dhe në fletëza të përgatitura qysh më parë (nga katër për secilin fëmijë) secili fëmijë duhet t'i shkruajë për vete katër dëshira për ardhmërinë e tij (për pesë vitet e ardhshme) në katër fusha të ndryshme:

1. Pamjen fizike
2. Të arriturat praktike
3. Karakteri/sjellja
4. Mënyra e jetesës

Pastaj në çifte diskutojnë për atë që e kanë shkruar dhe e shpjegojnë atë.

Arsimtari nxit diskutim për atë se cilat gjëra mund të ndikojnë në realizimin e dëshirave dhe të priturve të tyre. Përmes një stuhie të trurit fëmijët japin ide, ndërsa arsimtari i shënon ato në tabelë. Pastaj arsimtari kërkon të përcaktojë se cilat gjëra varen nga ata vetë, e cilat varen nga të tjerët ose nga faktorë të tjerë të jashtëm

Pasi t'i kenë përkufizuar këto gjëra që burojnë nga vetë fëmijët dhe ndikojnë në realizimin e dëshirave të tyre, zhvillohet një diskutim.

DISKUTIM

1. Cilat gjëra ndikojnë në realizimin e dëshirave dhe të priturve tona?
2. Cilat gjëra burojnë nga vetë ne dhe mund të ndikojnë në realizimin e dëshirave tona?
3. Çka është vetëbesimi? Si mund të kontribuojë ai për realizimin e dëshirave tona?
4. Si krijohet vetëbesimi? A lindim me vetëbesim ose atë e përvetësojmë gjatë jetës?
5. Çka ndikon në zhvillimin e vetëbesimit te fëmijët (prindërit, arsimtarët, shokët dhe vetë fëmija)?
6. Si mund të ndikojmë vetë për vetëbesimin tonë?
7. Cilat komente ose fjali ndikojnë në krijimin e vetëbesimit?



PËRFUNDIM

Që të mund ta realizojmë atë që e dëshirojmë, ekzistojnë disa gjëra që varen nga vetë ne dhe me të cilat mund të ndikojmë ndaj të arriturave tona. Para së gjithash ne duhet ta njohim vetveten dhe të kemi pasqyrë reale për aftësitë, potencialet dhe dituritë tona në atë moment,

pastaj të dëshirojmë t'i pranojmë sfidat dhe të jemi të përkushtuar, të vazhdueshëm, të kemi organizim dhe planifikim të mirë aktiviteteve.

Është shumë me rëndësi të kemi vetëbesim, përkatësisht besim pozitiv në vetvete se ashtu mund ta bëjmë atë që e dëshirojmë. Ndaj vetëbesimit tonë ndikon shumë edhe raporti pozitiv dhe raporti motivues i prindërve, arsimtarëve dhe miqve.

Ne edhe vetë mund të ndikojmë ndaj vetëbesimit nëse përqipemi që në secilën situatë të japim gjithçka nga vetja jonë që të kemi sukses, duke e pranuar se megjithatë ka mundësi të na ndodhë edhe ndonjë mossaukses.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Arsimtari i vizaton në dysheme me shkumës dy vija të gjata paralele në largësi mes vete prej një metri. Fëmijët ndahen në dy grupe dhe njëri grup ndalet në gjatësinë e njëres vijë, ndërsa grupi tjetër në vijën tjetër, me ç'rast të dyja grupet janë të kthyer me fytyrë kah njëra-tjetra. Kështu ata i formojnë dy rreshta ku fëmijët kalojnë një nga një duke u mbajtur ngadalë, ndërsa fëmijët e tjerë u bëjnë “dush” me mesazhe të mira – përkatësisht secili fëmijë thotë diçka të mirë ose diçka që i pëlqen fëmijës që kalon mes rreshtave. Kur një fëmijë të kalojë mes rreshtave, ai pastaj ndalet në fund të rreshtave, e pastaj fëmija i parë i vijës së njëjtë do të duhet të kalojë aty. Kështu fëmijët kalojnë një pas një nga secili rresht derisa të radhiten të gjithë.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja I-2:**KRIJIMI I PASQYRËS PËR VETVETEN SI ANËTAR I FAMILJES DHE SI NXËNËS****Pritet që nxënësi/nxënësj:**

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • Të dijë për ndryshimet në marrëdhëniet me prindërit që shkaktohen në periudhën e adoleshencës • T'i dijë mënyrat e ndryshme të pjesëmarrjes aktive në jetën shkollore • Të dijë për nocionin “të arriturat në shkollë”
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të marrë pjesë në ndërmarrjen e aksioneve konkrete për përparimin e jetës shkollore • Të mund të vendos relacione pozitive me nxënësit e tjerë të klasës dhe me arsimtarët • Të mund ta përmirësojë suksesin e shkollës së tij.
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Ta kuptojë se mbështetja e prindërve, nxënësve të tjerë dhe e arsimtarëve është shumë e rëndësishme për krijimin e pasqyrës pozitive për vetveten • Të pranojë se nxënësit duhet të ndjehen pjesë e shkollës së tyre

PUNËTORIA I-2.1: SHKOLLA IME ËSHTË E IMJA!

MATERIALET

- Letër për të shkruar
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI KRYESOR 1

Të gjithë nxënësit janë të ulur në banka dhe secilit i jepet nga një fletë letre e ndarë në dy pjesë. Një njërën prej atyre gjysmave do të duhet ta vizatojnë një rreth të vogël në të cilin do të shkruajnë UNË. Pastaj në largësi të ndryshme nga ky rreth (varësisht nga ajo sa i ndjen afër në atë moment), duhet t'i vizatojë dy rrathë të vegjël që do t'i paraqesin:

- Prindërit/kujdestarët;
- Shokët;
- Shkollën;
- Muzikën;
- Sportin dhe
- Gjërat e tjera të rëndësishme.

Pastaj në gjysmën tjetër të fletës do të vizatohet se sa afër do të dëshironite t'i ndjejë gjërat e dhëna. Pasia të përfundojnë, nxënësit ndahen në çifte dhe bisedojnë ndërmjet vete për atë që e kanë vizatuar.

DISKUTIM 1

1. Cila ishte ajo që e vendosët më afër vetes?
2. E ajo që e vendosët më larg vetes?
3. Sa është larg/afër shkolla juaj prej jush? Pse?
4. Çka e bën atë të afërt?
5. E çka është ajo që e bën të largët?
6. A mund të afrohet shkolla më afër jush, të bëhet më e afërt?



AKTIVITETI KRYESOR 2

Arsimtarja i pyet nxënësit:

“Me çfarë mënyrash dhe procedurash secilit nga ju si nxënës ju është mundësuar të merrni pjesë në marrjen e vendimeve dhe të ndikoni në gjëra që janë të rëndësishme për ju?” dhe përgjigjet i shkruan në tabelë.

Nxënësit ndahen në grupe dhe secilit grup i jepet detyrë e veçantë:

1. **grupi 1** – Me çka mundet secili nga ju individualisht të kontribuojë në zbulimin e klasës?
2. **grupi 2** – Çka mund të bëjë secili nga ju në lidhje me organizimet dhe garat që t'i bëjë ato më joshëse për vete?
3. **grupi 3** – Çka mund të bëjë secili nga ju që oborri i shkollës të jetë më i pastër dhe vend i sigurt për qëndrimin e nxënësve?

Secili grup duhet mendojë dhe në fletë të madhe të letrës t'i shkruajë ose t'i vizatojë disa gjëra që do të mund t'i bënte secili anëtar i saj që shkolla t'u bëhet vend më i këndshëm për të qëndruar dhe për të mësuar.

Pastaj nga një nxënës i secilit grup e prezanton detyrën.

DISKUTIM 2

1. Në cilat fusha të jetës shkollore secili nga ju mund të marrë pjesë dhe ta japë kontributin e tij?
2. Pse është e nevojshme të merret pjesë me ide dhe iniciativa personale në jetën shkollore? A do ta bëjë pjesëmarrja personale më të këndshme jetën shkollore?
3. Çka nevojitet që dëshira dhe iniciativa e nxënësit të shndërrohet në aktivitet të realizuar?
4. Cilat gjëra varen nga nxënësi E cilat varen nga arsimtari dhe nga drejtuesit e shkollës?



PËRFUNDIM

Nxënësi e kalon një pjesë të madhe të jetës së tij në shkollë, andaj është me rëndësi që ai aty të ndjehet mirë. Secili nxënës mundet, madje është përgjegjës, të kontribuojë për ngritjen e cilësisë së jetesës në shkollë. Secili nxënës përmes sjelljes së tij konkrete të përditshme dhe përmes ndërmarrjes së iniciativave dhe aktiviteteve të ndryshme mund ta bëjë shkollën më të bukur dhe më tërheqëse për mësim dhe për shoqërim. Iniciativat e nxënësve duhet të përkrahen dhe të mundësohen nga drejtuesit e shkollës dhe nga arsimtarët.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Arsimtarja thotë se secili nxënës duhet të mendojë ndonjë pyetje e cila do t'i përmbajë dy alternativa (pyetje “ose-ose”) dhe e cila ka të bëjë me jetën shkollore. Pyetjen do të duhet t'ia parashtrijë fëmijës që është pranë tij; ai duhet të përgjigjet, e pastaj një pyetje tjetër t'ia parashtrijë fëmijës tjetër që është në anën e tij të djathtë e kështu me radhë. Pyetjet mund të jene edhe qesharake, por jo vulgare. Arsimtarja në fillim duhet t'i japë disa shembuj:

1. Gjatë pushimit të gjatë a do të dëshirojë më shumë muzikë rep OSE karioke shou?
2. Si dëshiron të ecësh më shumë në shkollë, me rolerka OSE me skejtboard?
3. Për mensë a dëshiron të kemi më shumë kërmij të zier OSE guaska të gjalla?

REFLEKTIM

1. Çka bëmë?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA I-2.2: DIÇKA U NDRYSHUA, E DIÇKA MBETI NJËSOJ

MATERIALET

- Pajisje për të shkruar
- Fletë pune për nxënësit: Aktivitete dhe marrëdhënie
- Fletë pune për nxënësit: Letër



AKTIVITETI KRYESOR 1

Fëmijët ndahen në grupe me nga katër vetë dhe secilit fëmijë i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënësit “Aktivitete dhe marrëdhënie” në të cilën duhet të shkruajë se cilat kanë qenë aktivitetet e tij të dëshiruara me secilin anëtar të familjes para tre viteve, e cilat janë tash. Ata duhet t’i zgjedhin tre anëtarë të familjes që mund të jenë farefis më i afërt ose më i largët.

DISKUTIM 1

1. A janë aktivitetet të njëjta? Pse?
2. A është marrëdhënia e njëjtë? Pse?
3. Çka ka ndryshuar?
4. Si do të dëshiroje t’ju trajtojnë prindërit/kujdestarët tuaj?
5. Ajo që fëmijët e kësaj moshe kanë nevojë për më shumë pavarësi, a do të thotë se edhe prindërit nuk na duhen? Pse?
6. Çka mendoni, si ndjehen prindërit tuaj? Pse? A ju duan ata ende?
7. A i keni pyetur?


PËRFUNDIM

Gjatë pubertetit te fëmijët zakonisht paraqitet nevoja për më shumë pavarësi dhe privatësi. Ndodhë që prindërit nga njëra anë t’i trajtojnë tinxherët e tyre si fëmijë akoma të vegjël, ndërsa nga ana tjetër të kërkojnë prej tyre të sillen si të rritur. Njësoj është edhe me tinxherët: edhe ata dëshirojnë të sillen ndaj tyre si të rritur, por, nga ana tjetër, e kanë vështirë ta bartin gjithë barrën për veprimet e tyre. Edhe prindërit edhe fëmijët duhet të mësohen dhe ta pranojnë këtë gjendje të re. Për këto ndryshime prindërit dhe fëmijët duhet të bisedojnë hapur.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Secilit fëmijë i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënësit “Letër”, në të cilën do të duhet të shkruajë letër për prindërit/kujdestarët e tij/saj në të cilën do ta prezantojë vetveten dhe do të tregojë se si do të dëshironte të sillen ata me të. Ai duhet të shpjegojë aty se cilat janë anët e tij/saj pozitive dhe si do t’u dëshmojë se duhet të kenë besim në të; për gjërat që kanë rëndësi për të dhe për gjërat që do të dëshironte t’i bëjë. Ai duhet të shkruajë edhe sa janë të rëndësishëm për të prindërit/kujdestarët dhe në çfarë mënyrë do të dëshironte të pranojë mbështetje prej tyre.

Pas përfundimit të aktivitetit secili nxënësi duhet ta marrë letrën me vete dhe, nëse dëshiron, t’ua japë ose t’ua lexojë letrën prindërve/kujdestarëve të tij. Kush dëshiron, atë letër mund ta lexojë edhe para të tjerëve.



DISKUTIM 2

1. Si ndjeheshit derisa e shkruanit letrën?
2. A e kishit lehtë apo vështirë? Pse?

PËRFUNDIM

Ndonjëherë është shumë vështirë të flitet hapur për vetveten dhe të kërkohet ndihmë ose mbështetje, madje edhe nëse është fjala për dikë që na njeh shumë mirë dhe që është shumë i rëndësishëm për ne, veçanërisht kur kjo ndodhë në periudhën e jetës kur nevoja për pavarësi dhe liri të zgjedhjes personale është e rritur. Të pranohet se kemi nevojë për mbështetje, kjo është virtyt, e jo mangësi. Ushtrimi i komunikimit të hapur në rrethana të paramenduara na përgatit që të mund të komunikojmë hapur edhe në situata reale.

**AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR**

Të gjithë fëmijët qëndrojnë në rreth. Secili prej tyre duhet të tregojë se çka ka të njëjtë ose të ngjashme me ndonjë nga anëtarët e familjes së tij. Ajo mund të jetë ndonjë tipar, ndonjë karakteristikë fizike, ndonjë shprehje e mirë ose e keqe, ndonjë interes, hobi etj.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA I-2.3: RESPEKTIMI OSE DËGJUESHMËRIA?

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Respektimi, mosrespektimi, dëgjueshmëria

AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth. Ata duhet të tregojnë se për çfarë arsye respektohen mes vete me të tjerët. Aktivitetin e fillon një nxënës, i cili kthehet në të djathtën e tij dhe thotë: “Respekt për (emrin e fëmijës), sepse (e thotë ndonjë tipar ose sjellje të fëmijës)”. Fëmija të cilit i shprehet respekti falënderohet dhe kthehet kah nxënësi djathtas tij dhe vazhdon po me atë fjali. Kështu vazhdohet në rreth derisa radha përsëri të kthehet te fëmija që e ka filluar lojën.

AKTIVITETI KRYESOR

Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i jepet nga një situatë të fletës së punës për nxënës “Respektimi, mosrespektimi, dëgjueshmëria”, të cilët duhet ta lexojnë dhe pastaj të diskutojnë për mënyrat e ofruara, si dhe që ta përcaktojnë mënyrën e respektimit. Pastaj nga një anëtar i secilit grup e lexon situatën dhe mënyrat e ofruara të reagimit dhe e tregon se cilën mënyrë të reagimit grupi e konsideron se është respektim, cilën e merr për dëgjueshmëri, e cilën e merr si mosrespektim.

DISKUTIM

Pas prezantimit të secilës situatë:

1. Pse mendoni se ky reagim është respektim?
2. Pse mendoni se ky reagim është dëgjueshmëri?
3. Pse mendoni se ky reagim është mosrespektim?



Pas prezantimit të të gjitha situatave:

1. Kur të rriturit kërkojnë nga fëmijët t'i respektojnë, çka do të thotë kjo?
2. Kur të rriturit kërkojnë nga fëmijët të jenë të dëgjueshëm, çka do të thotë kjo?
3. A është i njëjtë respektimi dhe dëgjueshmëria?
4. Kur dhe ku mësojmë të respektohemi?
5. A mësojmë për respektimin në familje? E në shkollë?
6. Si mësojmë të respektohemi?
7. A mjafton vetëm të flitet për respektimin që ai të mësohet?
8. Cila nga këto sjellje ju duket se është më e shpeshtë në klasën tonë?
9. Si ndjehemi kur jemi të dëgjueshëm? Çka ndodhë me problemin? A zgjidhet problemi apo injorohet?
10. Si ndjehemi kur sillemi me mosrespektim? Çka ndodhë me problemin? A zgjidhet problemi apo rritet?
11. Si ndjehemi kur sillemi me respektim? Çka ndodhë me problemin? A është ky pozicion fillestar i mirë për zgjidhjen e problemit?

PËRFUNDIM

Dëgjueshmëria para së gjithash do të thotë nënshtrim, përuarje ndaj dëshirave dhe kërkesave të dikujt tjetër pa ankesë, madje edhe kur kjo është në llogari të atij që e kërkon të kryhet kërkesa. Respektim kemi kur me kujdes dhe pa ndërprerje e dëgjojmë mendimin e tjetrit dhe mendimin tonë në lidhje me atë që është shprehur, madje edhe atëherë kur mendimi jonë është

i ndryshëm ose edhe i kundërt me mendimin e bashkëbiseduesit, por pa ofendim, pa nënçmim dhe kërcënim. Respektimi shfaqet me fjalë, me gjeste dhe me qëndrimin e trupit

Shumë shpesh ndodhë që të rriturit të thonë se kërkojnë nga fëmijët t'i respektojnë, ndërsa në fakt kërkojnë që fëmijët të jenë të dëgjueshëm. Fëmijët mësojnë për respektimin para së gjithash në familje dhe në shkollë, zakonisht jo nga ajo që e dëgjojnë si këshillë për respektin, por përmes shembullit personal të të rriturve përreth tyre. “Fëmijët asnjëherë nuk kanë qenë shumë të suksesshëm në “dëgjimin” e të rriturve, por asnjëherë nuk kanë ndodhur që ata të mos kenë sukses të sillen si ata!”



Kur sillemi me dëgjueshmëri, shumë shpesh ndjejmë se na bëhet padrejtësi, pa pasur mundësi të shprehim dhe të bëjmë diçka që vërtet e duam. Sjellja e tillë nuk e zgjidh problemin, por vetëm momentalisht e “ndrydh” dhe e shtyn zgjidhjen e tij për ndonjë kohë tjetër, kur ndoshta për shkak të pakënaqësisë së shtresuar, problemi në vend që të zgjidhet fryhet edhe më shumë.

Kur sillemi me respekt, ne e vlerësojmë bashkëbiseduesin, por edhe vetveten, natyrisht duke mos i dëmtuar marrëdhëniet pozitive me bashkëbiseduesin. Kur sillemi ndaj ndokujt me respekt, ne lëmë hapësirë që edhe të tjerët të sillen ndaj nesh me respekt

Vetëm nëse sillemi me respekt në situatat ku ka ndonjë problem, ne mund të sigurojmë pozicion të mirë fillestar për zgjidhjen e problemit – nëse sillemi me mosrespektim, atëherë problemi sigurisht edhe më shumë do të përkeqësohet në vend që të zgjidhet.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Përmbajtja I-3:**NJOHJA DHE SHPREHJA
E EMOCIONEVE PERSONALE****Pritet që nxënësi/nxënësja:**

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • Ta dije se puberteti sjell edhe ndryshime në emocione • T'i dijë shkaqet/burimet e stresit • T'i dijë disa mënyra të ballafaqimit me stresin
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mund ta identifikojë problemin/burimin e stresit dhe t'i ofrojë disa zgjidhje • Të mund të zgjedhë aktivitete në të cilat do të relaksohet/do të çlirohet nga ngarkesa psikologjike
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Ta kuptojë se problemet mund të shikohen edhe nga një perspektivë tjetër dhe se është shumë me rëndësi të flitet për atë që ndjehet në një moment të dhënë • Ta kuptojë se shprehja konstruktive e emocioneve është mënyrë e mirë e mbrojtjes nga stresi.

PUNËTORIA I-3.1: NDRYSHIME KËTU – NDRYSHIME ATJE

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Ndryshimet në pubertet
- Letër për të shkruar
- Pajisje për të shkruar
- Copëza të vogla të letrës
- Sellotej



AKTIVITETI HYRËS

Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup duhet ta prezantojë nga një emocione para të tjerëve, ndërsa ata do të duhet t'ia qëllojnë se përse është fjala. Emocioni nuk duhet të thuhet me gojë, por duhet të aktrohet situata në të cilën paraqitet ai emocion.

Secili grup e tërheq nga një fletëz në të cilën janë shkruar këto emocione:

- Dëshpërim
- Hidhërim
- Padrejtësi
- Dashuri
- Krenari
- Pikëllim

AKTIVITETI KRYESOR

Nxënësit ndahen në grupe të gjinive të njëjta (veçmas meshkuj dhe veçmas femra) dhe secilit grup i jepet për detyrë të shkruajë se për çfarë ndryshimesh bëhet fjalë në pubertet duke i marrë parasysh këto komponentë:

- Truporë (në trup)
- Psikologjikë (në të menduar dhe në ndjenja)
- Socialë (në raportet me të tjerët)

Pastaj arsimtari ua jep këtyre grupeve nga një kopje prej fletës së punës për nxënësit “Ndryshimet në pubertet” dhe kërkon nga nxënësit ta krahasojnë listën që ata vetë e kanë përgatitur.

Pasi t'i krahasojnë nxënësit listat e tyre me listën e ofruar, pastaj mund të diskutojnë për ato pika ku ka përputhje të plotë ose ndryshime të plota.

DISKUTIM

1. A u përputhën listat tuaja me listat ofruara? Ku kishte më shumë përputhje?
2. A kishte më shumë dallime? Në çka dalloheshin?
3. Si ndjeheni në lidhje me ato ndryshime?
4. A ndodhin ato ndryshime te të gjithë? E a ndodhin te të gjithë në të njëjtën kohë? A kemi kaluar edhe ne të rriturit – arsimtarët dhe prindërit tuaj – nëpër ato ndryshime?
5. A ka diçka që ju shqetëson apo që ju brengos në lidhje me ato ndryshime?



6. Për cilat gjëra do të dëshironit të dini më shumë?
7. Kujt i drejtoheni në lidhje me brengat tuaja?

Secilit fëmijë i jepet na një letë e vogël letrë në të cilin duhet ta shkruajë ndonjë pyetje, respektivisht ndonjë fushë për të cilën do të dëshironit të dini diçka më shumë. Pastaj të gjithë fëmijët i mbështjellin fletat që të mos mund të shihet ajo që është shkruar dhe i vënë në një kuti. Arsimtari i lexon fletët nja nga një dhe i ngjet në tabelë, e pastaj bashkë me nxënësit i përcakton grupet e pyetjeve që i referohen kësaj teme dhe e përcakton kohën dhe mënyrën në të cilën planifikon të përgjigjet bashkë me nxënësit në atë ose në ndonjë orë tjetër.

PËRFUNDIM

Të gjithë ndryshimet që ndodhin gjatë kohës së pubertetit janë natyrore dhe normale. Ato i përjetojnë secili prej nesh. Vajzat hynë në pubertet më herët se djemtë. Shumica e ndryshimeve që ndodhin te djemtë janë të ngjashme edhe te vajzat. Ndryshimet emocionale dhe psikike janë po ashtu pjesë normale e zhvillimi të njeriut, janë të pritshme dhe ndodhin në kohë të ndryshme te personat e ndryshëm. Emocionet janë të fuqishme, të stuhishme, ndryshojnë lehtë dhe ndonjëherë dalin nga kontrolli.

Është shumë me rëndësi që të bisedohet me të rriturit për të gjitha dilemat dhe brengat, sepse ato janë ndryshime normale.

REFLEKTIM


1. Çka bëmë?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA I-3.2: STRESI

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Niveli dhe cilësia e stresit
- Fletë pune për arsimtarin /arsimtaren: Diagrami i stresit
- Letër për të shkruar
- Pajisje për të shkruar
- Tabelë dhe shkumës



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth dhe një nga një duhet ta shprehin emrin e tyre sikur të jenë shumë të brengosur.

AKTIVITETI KRYESOR 1

Nxënësit janë renditur në rreth. Secili me një fjali duhet të tregojë se pse dhe/ose kur (në çfarë situatë) brengoset dikush që e njeh, duke filluar me fjalët: “E njoh një fëmijë/një grua/një burrë që brengoset...”

Së pari fillon arsimtarja përmes shembullit të saj: “E njoh një fëmijë që brengoset shumë që të mos marrë njësh në test.” Derisa nxënësit e tjerë i thonë fjalitë “e tyre”, duhet të kihet kujdes të mos ketë përsëritje të shembujve dhe çdoherë të shprehet një shembull i ri.

DISKUTIM 1

1. Brengosja e kujt u përmend më shumë – e fëmijës, e burrit dhe/ose e gruas?
2. Me çka dallohen fëmijët, burrat dhe gratë në brengat e tyre? Për çka brengosen më shumë fëmijë, për çka brengosen më shumë burrat e për çka gratë? Për çka brengosen prindërit, për çka arsimtarët e për çka nxënësit...?
3. Si ndjehen njerëzit kur brengosen për diçka?
4. Çka do të thotë fjala stres? Cila është lidhja ndërmjet brengosjes dhe stresit? (Çka mund të ndodhë nëse brengosja zgjat një kohë më të gjatë dhe ndjenjat që paraqiten në ato situata janë shumë negative?)

PËRFUNDIM

Brengosjet zakonisht janë të lidhura me ndjenja negative. Brengosja e vazhdueshme e lidhur me ndjenja të negative mund të shkaktojë stres. Për persona të ndryshëm gjëra të ndryshme mund të jenë gjendje stresi. Brengosjet e fëmijëve më shpesh janë për gjëra që kanë lidhje me përgjigjen në ndonjë lëndë, për marrëdhëniet me shokë, me arsimtarë, djalë/vajzë, ndërsa brengosjet e njerëzve në përgjithësi janë sëmundje, ngjarje botërore me pasoja negative, mungesë e kohës, mërzitje.



AKTIVITETI KRYESOR 2

Nxënësit të ndarë në grupe të vogla duhet ta përcaktojnë nivelin e stresit (lart ose ulët) dhe cilësinë e stresit (të dëshiruar – të padëshiruar) në situatat e dhëna në fletën e punës për nxënës “Niveli dhe cilësia e stresit”.

Pasi të përfundojnë, arsimtarja e vizaton në tabelë një diagram të thjeshtë dhe përgjigjet e nxënësve i shkruan në pjesën përkatëse të diagramit. (Përgjigjet e sakta në Fletën e punës për arsimtarin/arsimtaren „Diagrami i stresit“)

DISKUTIM 2

1. A është stresi çdoherë i padëshiruar? Kur është i dëshiruar?
2. Si do të dukej jeta pa aspak stres?
3. A janë të këndshme për ne edhe situatat me stres të madh të dëshiruar?
4. Si ndikon stresi i padëshiruar i tepërt ndaj nesh?



PËRFUNDIM

Stresi shkakton probleme kur është shumë pak ose kur është shumë tepër. Stresi i tepërt i padëshiruar shkakton reaksione të shumta psikologjike dhe fiziologjike.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Nxënësit qëndrojnë të ulur në rreth. Të gjithë ata marrin një dorën tjetër, herën një të tjetër, herën një të tjetër e herë këmbën tjetër. Ata shkulet nga 10 herë, në rrethin e jashtëm dhe në rrethin e brendshëm radhë. Aktivitetit i prin arsimtarët.

REFLEKTIM

1. Çka mësuam?
2. Çka mësuam të re?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA I-4.1: PIKËLLIMI NË ART

MATERIALET

- Letër për të vizatuar
- Pajisje për ngjyrosje
- Fletë pune për nxënësit: Vepra artistike të frymëzuara nga pikëllimi
- Ngjyra uji, temperë, copa të ndryshme të pëlhurës, ngjitës, sellotej, kokrra, materiale natyrore

AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth dhe një nga një duhet ta thonë emrin e tyre sikur të jenë të pikëlluar.

DISKUTIM

Arsimtarja u thotë nxënësve se do të flasim për pikëllimin dhe për atë se si mund të shprehet ai.

1. Cilat janë mënyrat e zakonshme të shprehjes së pikëllimit?
2. Çka bëjmë kur jemi të pikëlluar?
3. Si dhe me kë dëshirojmë ta ndajmë pikëllimin?
4. A mund të nxisin ndjenjat e pikëllimit edhe ndonjë aktivitet? Çfarë?
5. A mund të shprehet ndjenjat e pikëllimit edhe përmes artit? Si?
6. A dini ndonjë shembull të artit ku artistët e kanë marrë frymëzimin e veprave të tyre artistike nga ndonjë pikëllim personal?

AKTIVITETI KRYESOR 1

Nxënësve që janë të ndarë në grup u jepet nga një vepër artistike nga fleta e punës për nxënës “Veprat artistike të frymëzuara nga pikëllimi” dhe kërkon nga secili grup që shkurtimisht ta komentojë veprën. Pastaj nga një përfaqësues i secilit grup e prezanton veprën që e ka marrë dhe atë e shoqëron me koment të grupit.

PËRFUNDIM

Pikëllimi nuk është ndjenjë që mund të ndahet lehtë me dikë dhe që mund t'i shprehet lehtë dikujt. Ai është një emocion i thellë dhe i pakëndshëm. Shprehja e pikëllimit ndihmon që të pakësohet dhimbja dhe më lehtë të pranohet ajo. Shumë personalitete të famshme frymëzimin e tyre për veprat e tyre artistike e kanë marrë pikërisht nga pikëllimi. Shumë shpesh pikëllimi shërohet edhe përmes ekspresionit artistik. Kur ballafaqohemi me ndonjë ndjenjë të pikëllimit të shprehur përmes veprës artistike, atëherë kjo na ndihmon që ta njohim, ta pranojmë dhe më lehtë ta shprehim pikëllimin tonë.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA I-4.2: ÇKA BËJMË MË PIKËLLIMIN?

MATERIALET

- Letra për të vizatuar të prera në formë të shiritit të gjatë
- Pajisje për ngjyrosje



AKTIVITETI HYRËS

Arsimtarja u thotë nxënësve se tash do të fantazojnë pak dhe se secili prej tyre duhet ta mendojë dhe ta thotë ndonjë “superfuqi” që do të dëshironte ta ketë, duke shpjeguar edhe pse dëshiron ta ketë atë.

Shembuj të “superfuqisë”:

- Të më zgjaten duart pa fund që të mund t’i përqafoj miqtë e mi nga Franca
- Të mund të hajë nga një kilogram çokolatë në ditë dhe të mos trashem asnjë gram

AKTIVITETI KRYESOR

Ky aktivitet është i prirë nga fantazia dhe prandaj që të jetë i suksesshëm të gjithë nxënësit duhet të çlirohen, t’i mbyllin sytë, të krijojnë qetësi maksimale dhe askush të mos hyjë ose të dalë nga klasa. Nëse dikush shqetësohet dhe i hap sytë, arsimtarja nuk duhet ta ndërpresë aktivitetin, e as t’i thotë atij nxënësi që t’i mbyllë sytë – vetëm duhet t’i japë shenjë në mënyrë joverbale se gjithçka është në rregull dhe se vetëm duhet të heshtë dhe të mos u pengojë të tjerëve.

“Çlirohuni, uluni mirë dhe mbyllni sytë. Paramendoni se po hyni në një balon të madh, të fortë e të tejdukshëm dhe se ngadalë po përgatitemi për udhëtim të imagjinuar në të kaluarën... ndaheni nga karrigia dhe shkoni... Duke udhëtuar ju e ndeshni një ngjarje të gëzuar të së kaluarës suaj... shikoni kush është me ju... si janë të disponuar ata... si jeni të disponuar ju. Përpiquni t’i mbani ato ndjenja. Tash përsëri e vazhdoni udhëtimin... ktheheni edhe më prapa dhe ndeshni në një ngjarje të pikëlluar... ngjarje në të cilën ju keni qenë të lënduar... në të cilën keni humbur diçka... keni qenë të zemëruara ose të dëshpëruar... Si ndjeheshit atëherë?...A qanit?... Kush është përreth jush?... Si ndjehen ata?... Përpiquni që edhe këto ndjenja t’i mbani për një kohë në vete... Përsërituni me personat e ngjarjes dhe ngadalë përgatituni për kthim... Balona juaj ngadalë fillon të ngrihet... era ju bart lehtë dhe nëpër dritare përsëri ju vendos në këtë klasë... tash përsëri jeni në karriget tuaja... hapni sytë ngadalë dhe kthehuni në të tashmen.”

Secili fëmijë i jepet nga një shirit letre të cilin duhet ta ndajë në katër pjesë dhe në secilën prej tyre ta prezantojë ngjarjen e së kaluarës në të cilën është përkujtuar ai. Ai duhet t’i paraqesë edhe ngjarjet e këndshme edhe të hidhurat. Prezantimi mund të jetë edhe përmes vizatimit, por edhe përmes një vizatimi abstrakt, ngjyrë, mendim, këngë, thënie ose diçka tjetër. Me rëndësi është që ajo të prezantohet të ketë kuptim për atë që e ka krijuar. Pasi të mbarojnë, nxënësit i ngjisin shiritat në klasë.



DISKUTIM

1. Si ndjeheshit gjatë fantazisë?
2. Si ndjeheshit derisa vizatonit/shkruanit?
3. Cilat ngjarje ishin më lehtë të kujtohen? Të këndshmet apo të hidhurat?
4. Cilat ngjarje kanë intensitet më të lartët ndjenjave? Të këndshmet apo të hidhurat?

5. Çka të bëjmë me ndjenjat e fuqishme që na paraqiten në situata kur jemi shumë të pikëlluar, kur kemi humbur diçka ose ndonjë të afërt?
6. Çka bëjnë fëmijët e vegjël kur janë të pikëlluar?
7. A duhet të qajnë edhe fëmijët më të mëdhenj? A ju lejojnë ose ju nxisin të rriturit që të qani? Çka mendoni pse ndodhë kështu?
8. Si ndjehemi kur qajmë?
9. Çka ndodhë me pikëllimin dhe dhimbjen me kalimin e kohës? A zhduket ai?
10. Sa ndihmon biseda me dikë?



PËRFUNDIM

Humbja dhe keqardhja janë të pashmangshme në jetën e secilit prej nesh. Në situata kur kemi humbur dikë ose diçka që është i afërt dhe i rëndësishëm për ne, paraqiten ndjenja shumë të fuqishme dhe të rënda të pikëllimit dhe keqardhjes. Mbajtja e atyre ndjenjave të fuqishme në vete nga frika e përbuzjes dhe mosmiratimit të tyre mund të shkaktojë probleme serioze në organizmin e njerëzve (kokëdhimbje, dëmtime të lukthit, ndryshime të disponimit etj.). Prandaj është me rëndësi të nxirren jashtë dhe të ndahen me dikë. Qarja ndihmon që të ulet tensioni dhe shqetësimi. Pikëllimi dhe dhimbja në lidhje me humbjen nuk zhduken asnjëherë, por njeriu më vonë mësohet që të jetojë me ato.

REFLEKTIM


1. Çka bëmë?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA I-4.3: ME KË TË BISEDOJ KUR JAM I/E PIKËLLUAR?

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Personat me të cilët mund të bisedoj
- Fleta letre
- Pajisje për të shkruar
- Gazeta të vjetra



AKTIVITETI KRYESOR 1

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth dhe një nga një duhet ta përfundojnë fjalinë: Kur jam shumë i/e pikëlluar, më vjen të...

DISKUTIM 1

1. Çka na vjen të bëjmë kur jemi të pikëlluar?
2. Si reagojmë zakonisht kur kemi përjetuar ndonjë humbje të madhe dhe kur jemi shumë të pikëlluar?
3. A mund të na ndihmojë biseda me dikë tjetër?

PËRFUNDIM

Kur jemi të pikëlluar, na vjen të sillemi në mënyra të ndryshme. Kur përjetojmë ndonjë humbje të madhe, zakonisht mund të kemi reaksione të tërheqjes në vete dhe izolim ose edhe reaksione të tërbimit – jemi të zemëruar, vuajmë dhe nuk duam të bisedojmë me askënd. Në fillim rëndom qajmë, pikëllohem dhe nuk duam të bisedojmë me askënd. Pas një kohe, mund të bisedojmë me dikë dhe kjo mund të na bëjë shumë dobi.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Secilit nxënës i jepet nga një kopje e fletës së punës “Personat me të cilët mund të bisedoj”. Pastaj kërkohet nga nxënësit që ta plotësojnë tabelën në ato fusha që ata mendojnë se janë adekuate personalisht për ata.

Pastaj nxënësit ndahen në çifte dhe secili në çift duhet t’ia shpjegojë njëri-tjetrit sesi ndihmon (ose u ka ndihmuar) biseda me dikë që është shkruar aty.

DISKUTIM 2

1. Sa veta nga ju do të zgjidhnit që së pari të bisedoni me anëtarët e familjes?
2. E me miqtë?
3. Si është me kategoritë e tjera?
4. Nga çka varet zgjedhja juaj?



PËRFUNDIM

Është mirë ta dimë se kur jemi të pikëlluar kemi me kë të bisedojmë. Biseda ndihmon me atë që fillojmë të ndjehemi të kuptuar, të pranuar, se kemi ndarë një pjesë të ndjenjave dhe kështu zvogëlohet ngarkesa. Ajo ndihmon për ta ditur se edhe të tjerëve u ka ndodhur diçka e ngjashme si neve dhe se nuk ndjehemi vetëm ne aq të vetmuar në atë humbje. Se kujt do t’ia hapim zemrën, kjo varet nga shkalla e afërsisë që e ndjejmë, nga besimi që e kemi, si dhe nga lloji i humbjes që e kemi përjetuar.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Secilit fëmijë i jepet nga një fletë gazete ku ai duhet të qëndrojë në këmbë – ai e përfaqëson ishullin e tij. Pastaj, kur të jepet shenjë, fëmijët duhet ta gjejnë një ishull të ri në të cilin do të qëndrojnë. Arsimitarja i përkujton se s'është patjetër që ata të vrapojnë dhe të shpejtojnë – e vetmja gjë që duhet ta bëjnë është të kenë kujdes që të ketë vend për të gjithë. Pastaj gjatë ndërrimit të dytë ajo i heq 2-3 fleta, ndërsa fëmijët duhet të vendosen në fletat e mbetura. Në rrethin e dytë përsëri i heq 2-3 fleta dhe kërkon nga të gjithë fëmijët që të qëndrojnë në fletat e mbetura. Loja vazhdon derisa të mbesin vetëm dy ose tre gazeta me të gjithë fëmijët në ato.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja I-4.3: Me kë të bisedoj kur jam i/e pikëlluar?

Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: PERSONAT ME TË CILËT MUND TË BISEDOJ

Me kë mund të bisedoj kur përjetoj ndonjë humbje të madhe ose kur ndjej ndonjë pikëllim të madh?

Me cilin anëtar të familjes	Me cilin shok apo mik?	Me cilin person të shkollës (shërbimin profesional, arsimtarë)?	Me cilët persona të tjerë profesionalë jashtë shkollës?	Me cilat shërbime të tjera për ndihmë (telefon SOS, rubrika të revistave)?
------------------------------------	-------------------------------	--	--	---

Përmbajtja I-5:**BALLAFAQIMI ME SUKSESIN/MOSSUKSESIN****Pritet që nxënësi/nxënësja:**

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> T'i dijë konceptet e tejkalimit të mossuksesit në mësim
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> Të mund të hartojë plan për tejkalimin e mossuksesit në mësim, të angazhohet dhe me kohë të kërkojë ndihmë gjatë mossuksesit në mësim dhe në punë
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> Ta pranojë mossuksesin si pjesë/fazë të punës dhe jetës së përditshme

PUNËTORIA I-5.1: NGA SUKSESI DREJT MOSSUKSESIT – NGA MOSSUKSESI DREJT SUKSESIT

MATERIALET

- Fleta të mëdha të letrës
- Pajisje për të shkruar
- Sellotej



AKTIVITETI HYRËS

Nxënësit ndahen në dy grupe të barabarta (me jo më shumë se tetë fëmijë në një grup). Pastaj rregullohen karriget në dy vija paralele. Karriget duhet të jenë kthyer me ulëset e tyre kah njëra tjetra (largësia ndërmjet karrigeve duhet të jetë rreth 1,5 metra) dhe duhet të ketë nga një karrige më shumë se që ka fëmijë. Pastaj të gjithë fëmijët ulen në karrige, ndërsa karrigia e parë e secilit rresht mbetet e zbrazët. Fëmija që ulet pranë karriges së zbrazët duhet ta ngrejë karrigen në duar (por pa u ngritur nga karrigia në të cilën është i ulur) dhe t'ia japë fëmijës që gjendet pranë atij dhe kështu më tej karrigia duhet të vazhdojë të qarkullojë derisa të arrijë te fëmija i fundit, i cili duhet ta lëshojë pranë vetes dhe të ulet në të. Në atë moment të gjithë fëmijët zhvendosen nga një karrige më tej dhe karrigia në të cilën është ulur fëmija i parë mbetet e zbrazët. Tash ajo karrige jepet ashtu siç e ka dhënë fëmija i parë dhe përsëri vazhdohet më tej derisa fëmija që ka filluar të gjendet në pozicionin fillestar. Aktiviteti i të dyja grupeve fillon kur të jepet shenjë, ndërsa fitues është ai grup që i pari i bart karriget. Pastaj mund të vazhdohet me nxënësit e tjerë.

AKTIVITETI KRYESOR 1

Nxënësit ndahen në grupe me nga katër vetë dhe pastaj secili grup në fletë të madhe të letrës duhet t'i shkruajë asociacionet për fjalën sukses (në çka i shkon mendja kur e dëgjon fjalën SUKSES), ndërsa gjysma e grupeve duhet të shkruajnë asociacione për fjalën mossukses.

Pastaj nga një grup i atyre që kanë shkruar për suksesin dhe një grup i atyre që kanë shkruar për mossuksesin e prezantojnë atë që e kanë shkruar, ndërsa të tjerët i plotësojnë.

DISKUTIM 1

1. A ka në jetë dikush që vazhdimisht radhit suksese apo që vazhdimisht radhit mossuksese në të gjitha fushat?
2. Si ndikon sukse si ndaj të arriturave tona të ardhshme?
3. A mund të ndikojë edhe në mënyrë negative?
4. Si ndikon sukse si ndaj të arriturave tona të fundit?
5. A mund të ndikojë edhe pozitivisht?



PËRFUNDIM

Edhe sukse si edhe mossuksesi janë pjesë përbërëse e jetës së secilit njeri. Kur arrijmë sukses në ndonjë aktivitet, kjo na motivon që edhe më tej të vazhdojmë të angazhohemi, na e shton vetëbesimin dhe kështu na i shton edhe mundësitë për sukses të ri. Por, ndonjëherë arritja e suksesit mund "të na çlirojë", të mos përpiqemi aq shumë dhe kështu të përjetojmë mossuksesi. Përkundrazi, nëse mossuksesi pranohet si diçka që është pjesë e jetës së përditshme dhe nëse e analizojmë sjelljen dhe situatën përkatëse, do ta kuptojmë se ku kemi gabuar, gjë që do na ndihmojë t'i përmirësojmë gabimet dhe të arrijmë sukses në ndonjë përpjekje tjetër.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Duke qenë të ndarë në ato grupe nxënësit duhet të përkujtohen ose të mendojnë ndonjë situatë në të cilën suksesi ka ndikuar negativisht ndaj të arriturave të fundit dhe një në të cilën mosesuksesi ka ndikuar negativisht ndaj të arriturave të ardhshme. Pastaj duhet të zgjedhin një të arritur dhe ta përsërisin, e pastaj atë do të duhet ta aktrojnë.

Secili grup shpërblehet me duartrokitje.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA I-5.2: QËLLIMI I AZRËS

MATERIALET

- Letër për të shkruar
- Pajisje për të shkruar
- Fletë pune për nxënësit: Qëllimi i Azrës
- Fletë pune për nxënësit: Qëllimi im
- Fletë pune për nxënësit dhe arsimtarin /arsimtaren: Përtej lumit
- Fletë pune për arsimtarin /arsimtaren: Zgjidhje për përtej lumit



AKTIVITETI KRYESOR 1

Arsimtari e parashtron problemin që duhet të zgjidhet duke e lexuar përrallën e fletës së punës “Përtej lumit” dhe pastaj formohen grupe me nga 4-5 nxënës. Secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës “Përtej lumit”. Në kuadër të secilit grup zgjidhet nga një nxënës që do ta përfaqësojë njeriun që duhet ta kalojë lumin me ujkun dhe qengjin, një nxënës që do të jetë ujkun dhe një që do të jetë qengji, ndërsa 1-2 të tjerët kanë rol të vëzhguesve dhe/ose ndihmësve. Secili grup e paramendon një lumë që duhet të kalohet, madje merret edhe ndonjë send që do të jetë zëvendësim për barin. Grupeve u jepet detyrë që duke i provuar të gjithë mënyrat e mundshme aty për aty, të zbulojnë mënyrë sesi do ta nxjerrë njeriu ujkun, qengjin dhe barin në anën tjetër të lumit. Pas më së shumti 15 minutave (ose pasi të gjitha grupet ta gjejnë zgjidhjen), aktiviteti ndërpritet. Grupet që kanë zgjidhje, e prezantojnë atë para të tjerëve duke e aktruar kalimin e lumit. Nëse asnjëri grup nuk arrin ta zbulojë zgjidhjen, atëherë arsimtari e zbulon atë – derisa ai e lexon atë nga fleta e punës “Zgjidhje për përtej lumit”, njëri nga grupet i zbaton udhëzimet e dhëna në zgjidhje.

DISKUTIM

1. A e kishit vështirë apo lehtë të arrini në zgjidhjen e problemit?
2. Pse ishte vështirë të arrihet zgjidhja?
3. Si arrinit sukses në lojë? A ndihmonte përsëritja e verbër e përpjekjeve?
4. A kishte momente kur ndaleshit, mendonit dhe planifikonit sesi të veproni?
5. Sa ju ndihmoi ai plan?

PËRFUNDIM

Që të arrihet sukses zakonisht nuk mjafton vetëm përsëritja e vazhdueshme e përpjekjeve, por duhet të bëhet edhe analiza e situatës dhe parashtrimi i planit të veprimit.

AKTIVITETI KRYESOR 2¹

Nxënësit ndahen në çifte dhe secilit çift i jepet nga një fletë e punës “Qëllimi i Azrës”. Çifti duhet ta lexojë tekstin dhe të përgjigjet në pyetjet e parashtruara.

Pasi të përfundojë arsimtari, ai kërkon vullnetarë që do ta prezantojnë atë që është shkruar, bile për secilën pyetje nga një vullnetar.



1 Ideja për aktivitetin është marrë nga Keller, A. & Floersch, G. for The Bureau for At-Risk Youth (1993). The Value of Responsibility. New York: The Bureau for At-Risk Youth

DISKUTIM

1. Çka mendoni për planin e Azrës?
2. Si ju ndihmoi ky plan në atë që e kishit parashtruar si qëllim?
3. Çka mendoni, a do t'u ndihmonte edhe juve hartimi i një plani të këtillë që të keni sukses në realizimin e qëllimeve tuaja?

AKTIVITETI KRYESOR 3

Secilit nxënës i jepet nga një kopje e fletës së punës “Qëllimi im” dhe sipas këtij principi ai duhet ta plotësojë formularin.

PËRFUNDIM

Njëra nga mënyrat për tejkalimin e mosuksesit është parashtrimi i qëllimeve reale dhe hartimi i planit për realizimin e tyre. Plani zakonisht përmban qëllim, kornizë kohore, procedura konkrete për realizimin e qëllimit, burime të mbështetjes dhe ndihmës, probleme të mundshme dhe mënyra për tejkalimin e tyre, si dhe rezume të asaj që është arritur.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja I-5.2: Qëllimi i Azrës

Fletë pune për nxënësit dhe arsimtarin /arsimtarene: PËRTEJ LUMIT


Një njeri e kishte blerë një ujk, një qengj dhe një duaj bar. Të gjitha këto duhej t'i dërgonte në shtëpi.

Duke ecur rrugës, arriti te një lumë. Me vete e kishte vetëm një barkë të vogël, në të cilën në një kalim mund të merrte vetëm një gjë me vete.

Si ta zgjidhte problemin? Nëse e merrte ujkun dhe e linte qengjin vetëm me barin, qengji do ta hante barin. Ose, po ta linte ujkun dhe qengjin vetë, ndërsa ta merrte me vete barin, ujkun do ta hante qengjin.

Punëtorja I-5.2: Qëllimi i Azrës

Fletë pune për nxënësit dhe arsimtarin /arsimtarene: ZGJIDHJE PËR PËRTEJ LUMIT



- 1) Njeriu e dërgon së pari në anën tjetër të lumit qengjin, duke e lënë ujkun me barin.
- 2) Kthehet dhe e merr ujkun dhe e nxjerr në anën tjetër. Por, kur kthehet për barin, e merr me vete edhe qengjin.
- 3) Pastaj e lë këndej qengjin, ndërsa e merr barin dhe e dërgon andej dhe e lë në anën tjetër të lumit bashkë me ujkun.
- 4) Në fund kthehet për qengjin dhe nxjerr në anën tjetër.

Përmbajtja I-6:
SHPREHJA E MENDIMIT

Pritet që nxënësi/nxënësja

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> T'i dijë mënyrat formale të shprehjes së mendimit
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> Të mund ta zgjedhë mënyrën përkatëse të shprehjes së mendimit personal
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> Ta kuptojë përgjegjësinë e shprehjes së mendimit personal

PUNËTORIA I-6.1: TË SHKRUAJ LETËR

MATERIALET

- Shkumës dhe tabelë
- Pajisje për të shkruar
- Letër për të shkruar



AKTIVITETI HYRËS

Nxënësit qëndrojnë në këmbë dhe ndahen në çifte. Pastaj njëri nga çifti duhet “t’ia shkruajë” një fjalë të shkurtër në shpinë partnerit të tij duke bërë me gisht, ndërsa ai do të duhet t’ia qëllojë se çka i ka shkruar. Pastaj ata do të duhet t’i ndërrojnë rolet – ai që “ka shkruar” ia qëllon, ndërsa që ka qëlluar tash “shkruan”.

AKTIVITETI KRYESOR

Nxënësit në çiftet e njëjta duhet të shkruajnë letër me KËRKESË në të cilën do ta shprehin pakënaqësinë e tyre nga diçka që ndodhë në shkollë dhe të parashtrojnë kërkesë për ndryshimin e asaj (diçka që mund të bëhet, të zbatohet, të ndërrohet). Kërkesat duhet t’i dorëzohen drejtorit të shkollës. Mund t’u referohen gjërave të vërteta ose të imagjinuara.

Arsimtarja e shkruan në tabelë formën që duhet ta ketë letra.

1. kujt i drejtohen
2. cili është shkaku i kërkesës (çka e shkakton pakënaqësinë dhe pse)
3. çka kërkohet
4. kush kërkon
5. data

Pasi të përfundojnë, disa vullnetarë i lexojnë kërkesat e tyre.

DISKUTIM

1. Si ndjeheshit në lidhje me atë që mund ta parashtronit si kërkesë personale?
2. A ka në kërkesat tona fjalë ose shprehje të caktuara që mund të jenë ofenduese dhe të cilat duhet të ndryshojnë?
3. Pse është me rëndësi të shprehet mendimi dhe pse duhet në mënyrë të shkruar, duke e respektuar strukturën e caktuar të letrës?
4. Për çfarë tjetër do të dëshironit ta shprehnit mendimin tuaj?
5. Të shprehet mendimi a do të thotë që ai duhet të jetë vetëm për diçka që nuk të pëlqen apo duhet të shprehet mendimi edhe për gjëra që na pëlqejnë?
6. Pse është me rëndësi që njerëzit të mund ta shprehin mendimin e tyre? Çka do të ndodhë nëse nuk mund ta shprehin mendimin e tyre? A do të ndalen ta mendojnë atë?



Pastaj arsimtarja kërkon edhe njëherë që t’i lexojnë letrat e tyre dhe, nëse ka nevojë, t’i korrigjojë ato shprehje ose fjalë që mund të jenë ofenduese dhe pasi të përfundojnë, ia dorëzojnë letrat arsimtares që e merr përsipër t’ia japë ato drejtorit ose e zgjedhin një nxënës që do t’ia sjellë drejtorit. Ose, nëse kanë, i fusin në arkën e lëvdatave dhe ankesave.

PËRFUNDIM

Njëra nga mënyrat për ta shprehur mendimin është edhe të shprehurit me shkrim. Gjatë kësaj duhet të respektohet një formë e caktuar që atij që i dërgohet ajo të mund ta kuptojë se çka ka dashur të thotë ai që e ka shkruar atë. Të shprehurit me shkrim të mendimit është me rëndësi, sepse paraqet dokument për atë që kërkohet dhe më pak mund të keqinterpretohet. Mënyra e shprehjes së mendimit duhet të jetë pa ofendime, pa sulme ose nënçmime. Letra detyrimisht duhet të nënshkruhet, sepse në këtë mënyrë e potencon edhe përgjegjësinë e atij që e ka shkruar atë, i cili duhet të shkruajë qartë dhe me argumente dhe të qëndrojë pas asaj që e ka shkruar.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth, ndërsa me numërim përcaktohet se cili do të jetë numër një, e cili numër dy. Pastaj të gjithë që janë numër një duhet të kthehen djathtas kah numri dy dhe të përshëndeten si me dikë që edhe nuk e kanë shumë për qejfi. Pasi të përfundojnë ata, pastaj të gjithë nxënësit numër dy duhet të kthehet majtas kah numri një dhe ta përshëndesin atë si një farefis i dashur të cilin s'e kanë parë me vite. Pasi të përfundojnë ata, pastaj përsëri nxënësit me numër një duhet të kthehen djathtas kah nxënësit me numër dy dhe ta përshëndesin si dikë që sapo e kanë kuptuar se i ka fituar një milionë e gjysmë euro në lotari.

REFLEKTIM


1. Çka bëmë?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA I-6.2: MOLLËKUQET E BARDHA ME PIKA TË GJELBRA

MATERIALET

- Pajisje për të shkruar
- Pajisje për të vizatuar
- Letër për të vizatuar
- Sellotej dhe ngjitës
- Gërshërë



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth me dorën e majtë të shtrirë dhe të prekur me gishtin e djathtë tregues të dorës së shtrirë të nxënësit që është në anën e djathtë të tyre. Kur të japë shenjë arsimtari: “Tre...dy...një...tash!”, secili me dorën e tij të majtë duhet të përpiqet ta kapë gishtin tregues të atij që është në anën e tij të majtë dhe të orvatet që mos t’ia kapin gishtin tregues të dorës së djathtë. Loja mund të përsëritet disa herë, derisa të shkaktojë qeshje dhe argëtim në mesin e nxënësve.

AKTIVITETI KRYESOR

Nxënësit ndahen në katër grupe, ndërsa secili grup duhet të përgatitë një prezantim në temën “T’i mbrojmë nga zhdukja mollëkuqet e bardha me pika të gjelbra”.

Grupi i parë përgatit ekspozitë artistike në temën e dhënë;

Grupi i dytë mendon këngë;

Grupi i tretë përgatit demonstrata (me parulla të shkruara);

Grupi i katërt përgatit prezantim në konferencë.

Secilit grup i jepet nga gjysmë ore kohë që ta përgatitë prezantimin e tij. Pastaj secili grup e prezanton një mënyrë të shprehjes së mendimit para nxënësve të tjerë.

DISKUTIM

1. Si ju pëlqeu të mund ta shprehni mendimin tuaj?
2. A mund të paramendoni edhe mënyra të tjera të shprehjes së mendimit?
3. Si u tregojnë njerëzit të tjerëve se çka mendojnë për diçka?
4. Pse duhet ta ketë secili lirinë që ta shprehë mendimin e tij?
5. A mund të jetë e rrezikshme shprehja e mendimit?
6. Cili është kufiri i shprehjes së mendimit?

PËRFUNDIM

Secili fëmijë ka të drejtë ta shprehë mendimin e tij për gjëra që për atë janë të rëndësishme, pa marrë parasysh se sa i konsiderojnë edhe të rriturit ato të rëndësishme. Shprehja e mendimit është njëra nga mënyrat e shprehjes kreative dhe vetaktualizimit. Ekzistojnë mënyra të ndryshme të shprehjes së ndonjë mendimi – vizatim, roman, këngë, grafit, skulpturë, parullë, spot, film, dramë, ueb-faqe... Në një mjedis shoqëror secili ka të drejtë ta shprehë mendimin e tij në mënyrë që nuk do t’i cenohet të drejtat e të tjerëve dhe në atë rast nuk do të kishte nevojë të ekzistonte shkak që shprehja e mendimit të jetë e rrezikshme.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



AKTIVITETI KRYESOR 2

Nxënësit ndahen në gjashtë grupe dhe atyre u jepet për detyrë që ta shkruajnë përrallën “e tjetrit” për njërën nga fabulat e ofruara:

1. Si do ta rrëfente ujku përrallën për Kësulëkuqen
2. Si do ta rrëfente njerka përrallën për Borëbardhën
3. Si do ta rrëfente shtriga përrallën për Jovançen dhe Marikën

Kur ta shkruajnë përrallën e përmbytur, duhet të kenë kujdes që të vihen në vend të atij që e rrëfen përrallën.

Pas njëzet minutave grupi e lexon përrallën e tij.



DISKUTIM 2

1. Çka mendoni për mendimet që i morëm këtu? A janë më ndryshe?
2. A na befasoi pak ndonjëra nga përrallat?
3. Cili nga versionet e rrëfyera ju duket më i besueshëm? A është e mundur të ndodhë ashtu siç rrëfen “tjetri”?
4. Pse është me rëndësi të dëgjojmë se çka mendojnë të tjerët?
5. A kemi ndonjëherë parafytyrim të gabuar për diçka vetëm pse e kemi dëgjuar vetëm njërën anë të përrallës?
6. Prej ku mund të marrim informacione për gjërat që na interesojnë?

PËRFUNDIM

Të gjitha palët e përfshira në një situatë duhet të kenë mundësi ta shprehin mendimin e tyre (shikim dhe përjetim) për ngjarjen. Vetëm ashtu do të mund të merret pasqyrë më e plotë për atë që ka ndodhur. Kur e shprehim mendimin tonë, patjetër këtë e bëjmë edhe me një dozë të subjektivitetit dhe animit. Që të krijojmë mendim më të plotë për atë që na intereson, ne duhet të kërkojmë informacione plotësuese nga burime të ndryshme të rëndësishme. Para së gjithash nga palët që janë të përfshira në atë situatë, si dhe nga vëzhguesit dhe dëshmitarët e pavarur.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Përmbajtja I-7:**MENAXHIMI I KOHËS SË LIRË****Pritet që nxënësi/nxënësja**

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • Ta dijë se cilat mënyra të përdorimit të kohës së lirë janë produktive e cilat janë joproduktive
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mund të mbajë baraspeshë ndërmjet kohës së lirë dhe kohës së punës • Të mund ta organizojë kohën e lirë
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Të pranojë se koha e lirë është në funksion të zhvillimit personal dhe kryerjes efikase të detyrimeve të punëve

PUNËTORIA I-7.1: ÇKA DUHET TË BËHET NË KOHËN E LIRË?


MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Çka duhet të bëhet në kohën e lirë
- Tabelë dhe shkumës



AKTIVITETI KRYESOR

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup ulet pranë një banke dhe merr nga një kopje prej fletës së punës për nxënësin “Çka duhet të bëhet në kohën e lirë” me fotografi të prera. Pastaj arsimtari e vizaton në tabelë këtë skemë të diamantit:



dhe shpjegon se në fotografitë që i kanë ata janë paraqitur mënyrat e ndryshme të shfrytëzimit të kohës së lirë. Ata do të duhet t'i shikojnë ato, ndërsa në fletat e zbrazëta duhet të shkruajnë diçka që do të dëshironin ta bëjnë në kohën e lirë, e që nuk gjendet nëpër fotografi. Pastaj do të duhet të diskutojnë dhe t'i shpërndajnë letrat në formë të diamantit – sipas vizatimit të bërë në tabelë, me ç'rast në majë të diamantit e vendosin atë fotografi që shënjon aktivitet për të cilin mendojnë se është më së miri të bëhet në kohën e lirë, nën të i vendosin dy letra (aktivitete) për të cilat mendojnë se janë shumë të rëndësishme të bëhen në kohën e lirë, pastaj tre të tjera më pak të rëndësishme, pastaj dy edhe më pak të rëndësishme dhe më në fund e vendosin një letër me diçka që grupi konsideron se është më së paku e rëndësishme të bëhet kohën e lirë.

Pasi të përfundojnë, nga një përfaqësues i secilit grup duhet ta shpjegojë zgjedhjen e bërë për fotografinë më të rëndësishme dhe më pak të rëndësishme.

DISKUTIM

1. A e kanë bërë të gjitha grupet zgjedhjen e njëjtë?
2. Pse dallohen zgjedhjet e bëra?
3. Nga çka varej zgjedhja që e bëtë?
4. Nga çka varet zakonisht se si do të zgjedhim ta kalojmë kohën tonë të lirë?
5. A janë çdoherë gjërat e njëjta të rëndësishme apo edhe ato ndryshojnë? Pse?
6. Cilat janë dobitë që i kemi nga aktivitetet që i praktikojmë në kohën e lirë?



PËRFUNDIM

Në kohën e lirë mund të bëhen gjëra të ndryshme që mund të kontribuojnë ndaj zhvillimit tonë personal, për pushim dhe rekreacion. Njerëzve të ndryshëm gjëra të ndryshme u shkaktojnë kënaqësi ose u sjellin relaksim. Mënyra më e mirë e kalimit të kohës së lirë dhe përparësia që do t'u jepet disa aktiviteteve po ashtu varet nga nevojat dhe interesat tona momentale që mund të luhaten në rrethana të ndryshme jetësore.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë në rreth, ndërsa aktivitetin e fillon një nxënës duke thënë se është duke bërë diçka, ndërsa duket se po bën diçka tjetër. Për shembull: nxënësi thotë se po i lan dhëmbët, ndërsa bën sikur e prashit kopshtin. Pastaj nxënësi që është afër tij duhet të tregojë se e bën atë që e ka aktruar nxënësi para tij, ndërsa do të bëjë diçka tjetër. Për shembull, nxënësi thotë: “Po e prashis kopshtin”, ndërsa bën sikur vozit biçikletë. Loja vazhdon më tej me të gjithë nxënësit në rreth.

REFLEKTIM


1. Çka bëmë?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA I-7.2: KOHËN E LIRË – E HARXHOJ, E KURSEJ, E SHFRYTËZOJ?

MATERIALET

- Fletë letre
- Pajisje për të shkruar
- Fletë pune për nxënësit: Orari i kohës së lirë



AKTIVITETI KRYESOR 1

Secilit nxënës i jepet nga një fletë në të cilën ai do të duhet të shkruajë nëse do t'i kishte pesë orë të pandërprera të kohës së lirë me çka do t'i kalonte. Pastaj formohen grupe dhe në ato grupe nxënësit do të duhet t'i këmbëjnë përgjigjet dhe të merren vesh se çka është ajo që do ta bënin si grup nëse i kanë pesë orë të pandërprera më kohë të lirë. Më pas përsëri secili duhet të shkruajë për vete se me çka do ta kalonte kohën e lirë nëse do t'i kishte tre orë të pandërprera me kohë të lirë, e pastaj përsëri në bisedë të përbashkët do të duhet ta përcaktojë aktivitetin e përbashkët. Procedura përsëritet edhe për një orë kohë të lirë.

Secili nxënës i shënon në fletë tre aktivitete që i bën më së shpeshti në kohën e tij të lirë dhe tre aktivitete që do të dëshironte t'i bëjë më shumë në kohën e tij të lirë, ndërsa nuk i bën për shkaqe të ndryshme.

Pastaj nxënësit ndahen në grupe dhe secili në grupin e tij i lexon aktivitetet që i ka dhënë në fletë në të dyja kategoritë dhe pastaj grupi do të duhet të dalë me prezantim të përbashkët për atë se cilat aktivitete janë më të shpeshta në atë grup, ndërsa cilat aktivitete janë më të dëshiruara për të gjithë anëtarët e grupit.

Nxënësit do të duhet të diskutojnë në grupe për aktivitetet e zgjedhura bashkërisht për kohën e lirë se a janë të dobishme apo janë vetëm humbje kot e kohës së lirë, e pastaj nga një përfaqësues i grupit duhet t'i njoftojë grupet e tjera për atë që kanë diskutuar.

DISKUTIM 1

1. Sa keni kohë të lirë?
2. A ju mjafton ajo që ta bëni atë që e dëshironi?
3. Si e shfrytëzojmë kohën e lirë?
4. A e shfrytëzojmë kohën e lirë në mënyrë të dobishme ose e kalojmë kot?
5. Nëpër cilat aktivitete e kalojmë kohën tonë të lirë në mënyrë të kotë?
6. Si e shfrytëzojmë kohën tonë të lirë në mënyrë të dobishme? Me çka? Pse është me rëndësi kjo?
7. A mund të kursejmë kohë?
8. Si mund ta kursejmë kohën që të kemi më shumë kohë për atë që dëshirojmë ta bëjmë? Si mund të organizohen aktivitetet ditore që të shtohet koha e lirë?

PËRFUNDIM

Secili ka të drejtë të kohës së lirë, të cilën mund ta shfrytëzojë për pushim, për rekreacion dhe për zhvillim personal. Kohën e lirë që e kemi ne në disponim mund të shfrytëzojmë në mënyrë të dobishme ose të padobishme. Për shfrytëzimin e kohës së lirë në mënyrë të padobishme ("surfim" pa asnjë qëllim në internet, qëndrim para televizorit me orë të tëra duke i rrotulluar kanalet, vjedhja e kohës së nevojshme për pushim dhe gjumë dhe harxhimi i saj në përgojim etj.) themi se janë harxhim i kohës, ndërsa shfrytëzimi i kohës në mënyrë të dobishme themi se ajo është investim i kohës (për miqësi, në mësim, në mësimin e gjuhëve të huaja ose për sport etj.). Çdoherë kur një aktivitet e kryejmë për një kohë më të shkurtër nga koha e

parashikuar, mund të themi se kemi kursyer kohë të cilën pastaj mund ta investojmë në diçka të dobishme e cila është e dobishme për ne. Planifikimi i aktiviteteve do të mund të na ndihmojë të bëhemi më të vetëdijshëm për kohën që e kemi kaluar me aktivitete të caktuara dhe do të na ndihmonte që atë ta radhisim si duhet.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Nxënësit ndahen në grupe me nga tre vetë dhe secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës “Orari i kohës së lirë” të cilën bashkërisht duhet ta plotësojnë. Pasi të përfundojnë, arsimtari propozon që nxënësit, secili për vete, të bëjnë këso planifikimesh ditore për një javë dhe të përpiqen të veprojnë sipas atyre, që ashtu ta shikojnë se a do të shtohet koha e lirë, a do të rritet efikasiteti dhe a do të jemi më të kënaqur me vetveten.



AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Nxënësit ndahen në tre ose katër grupe. Arsimtari u thotë një fjalë dhe ua jep nga një detyrë grupeve që të mendojnë sa më shumë këngë në të cilat gjendet ajo fjalë (lule, vajzë, dashuri). Pastaj me numëratore përcaktohet grupi i cili do të fillojë ta këndojë këngën që e përmban atë fjalë. Pas një kohe të shkurtër arsimtari e ndërpret këngën dhe kërkon që grupi i dytë të prezantohet me këngë të re e cila do ta përmbajë atë fjalë. Veprimi përsëritet derisa të harxhohen të gjitha këngët.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë?
2. Si ndjeheshim?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



TEMA II:

UNË DHE TI RAPORTET NDËRPERSONALE

Përmbajtja II-1:

FORMIMI, MBAJTJA DHE NDËRPRERJA E LIDHJEVE


Pritet që nxënësi/nxënësja

Dituri	<ul style="list-style-type: none">• Ta dijë se cilat janë dobitë e shoqërimit• T'i dijë shkaqet e ndërprerjes së miqësisë
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none">• Të mund t'i vërejë anët pozitive dhe negative të shokëve të tij• Të mund të ballafaqohet me ndjenjat e pakëndshme që paraqiten gjatë ndërprerjes së miqësisë
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none">• Ta vërejë se dobitë e shoqërisë janë të ndërsjella

PUNËTORIA II-1.1: VIJAT E MIQËSISË

MATERIALET

- Shkumës, sellotej
- Fleta letre
- Pajisje për të shkruar
- Balonë



AKTIVITETI HYRËS:

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Aktivitetin e fillon një nxënës duke treguar se kujt po ia lëshon balonën dhe me këtë rast e përmend edhe ndonjë tipar pozitiv ose diçka të mirë që e ka bërë nxënësi që i jepet balona. Nëse dikush një herë ka lëshuar balonë kah një fëmijë, ai fëmijë nuk mund të pranojë më balona edhe nga fëmijët e tjerë.

AKTIVITETI KRYESOR

Nxënësit ndahen në 4-5 grupe. Secilit grup i jepet për detyrë të shkruajë në 4-5 fleta të letrës nga një tipar të shokëve që për të janë më të rëndësishëm. Kur të jenë gati, mblidhen fletët nga të gjitha grupet dhe përzihet, e pastaj radhiten një nga një sipas gjatësisë së një shiriti të ngjitësit sellotej/shkumësit. Nëse ka tipare që përsëriten, ato vihen njëri pranë tjetrit. Pastaj secili nxënës kalon nëpër vijën e tipareve duke e thënë me këtë rast fjalinë “Miku im duhet të...” dhe me duke i seleksionuar vendoset pranë atyre tipareve që i konsideron si shumë të rëndësishme për miqësinë e tij. Kur të shkelë në tiparin që ai e konsideron si të rëndësishmin, ai shpjegon shkurtimisht se pse është aq i rëndësishëm pikërisht ai tipar për miqësinë e tij. Pasi të kalojnë të gjithë nëpër vijën e miqësisë, zhvillohet diskutim rreth këtyre çështjeve:

DISKUTIM

1. Cilat tipare ishin më të rëndësishme? Në cilat fleta u ndalët më shumë?
2. A ishin për të gjithë të rëndësishme tiparet e njëjta?
3. Pse tipari është i rëndësishëm ta kenë shokët tanë? (për secilin tipar kontrolli bëhet veçmas)



PËRFUNDIM

Disa gjëra të gjithë ne i vlerësojmë njësoj dhe presim që edhe shokët tanë t'i kenë. Por, po ashtu për ne disa gjëra janë më të rëndësishme se disa të tjera, ndërsa për të tjerët ka gjëra të tjera që dëshirojnë t'i kenë shokët e tyre.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithëve u jepet nga një fletë letre e cila ngjitet me sellotej në shpinë. Pastaj duke lëvizur lirisht nëpër klasë të gjithë do të duhet ta shkruajnë nga një porosi pozitive dhe të bukur në fletën e secilit nxënës. Kur të jenë gati të gjithë, ulet në dysheme (nëse është e mundur kjo) ose në karrige të radhitura në rreth dhe pastaj lexohen porositë që i kanë shkruar. Më pas secili nxënës e veçon nga një porosi që e pëlqen më shumë dhe e lexon para gjithë grupit.


REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

PUNËTORIA II-1.2: LAMTUMIRË MIQËSI

MATERIALET

- Shkumës dhe tabelë
- Fletë pune për nxënësit: Çka kur zhduket miqësia



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Secili tregon për vete diçka që e ka bërë ose që nuk e ka bërë, ndërsa me të ka kontribuar që t'i përkeqësohem marrëdhëniet me ndonjë mik/mike ose që ua ka bërë atyre ndonjë mik/mike që ka qenë shkak për t'u hidhëruar mes vete. Për shembull, mund të thuhet kështu: “Njëherë e harrova ditëlindjen e shoqes sime dhe ajo një kohë të gjatë m'u hidhërua.” Ose: “Shoqet kanë dalë të shëtisin, e mua nuk më kanë ftuar” etj.

AKTIVITETI KRYESOR 1

Kërkohen dy vullnetarë që do të dalin në tabelë dhe do ta kenë për detyrë që ta prezantojnë një situatë të shkurtër të pastrukturuar në të cilën një anëtar i çiftit i afrohet tjetrit dhe ia thotë se nuk dëshiron më të jetë mik i tij. Paraprakisht nxënësve të tjerë u thuhet ata do ta shohin një situatë e cila mund të ndodhë ndërmjet cilëve do dy shokë të mirë. Pasi ta aktrohet kjo situatë, nga nxënësit që janë të ndarë në çifte kërkohet të mendojnë dhe bashkërisht të tregojnë se për çfarë arsye është bërë ndërprerja e marrëdhënieve të miqësisë së imagjinuar që është paraqitur në tabelë para nxënësve të tjerë. Pastaj çiftet i thonë përgjigjet, ndërsa arsimtari i rezymon duke i shënuar në tabelë. Pasi të thuhet/shkruhen të gjitha shkaqet, arsimtari shkurtimisht i përmbledh përgjigjet.

DISKUTIM 1

1. Kush është përgjegjës për ndërprerjen e miqësisë? Ne apo miqtë tanë?
2. Kur raportet tona me miqtë tanë nuk janë shumë të mira, kush është përgjegjës për të ndërmarrë diçka? Ne apo miqtë e tanë? Pse?

PËRFUNDIM

Miqësitë ndërpriten për arsye të ndryshme. Ndonjëherë për shkak se ndodhë diçka që e lëndon dikë, por ndonjëherë edhe me kalimin e kohës ne njoftohemi edhe me miq të rinj dhe gjithnjë e më pak takohemi me disa miq të mëparshëm. Ndonjëherë e kuptojmë se kemi filluar të interesohemi për gjëra të ndryshme dhe shoqërimi me disa shokë të caktuar nuk është më për ne interesant ose argëtues si më parë, ashtu që gjithnjë e më pak takohemi dhe shoqërohemi me ata.

Përgjegjësia e ndërprerjes së miqësisë është e ndërsjellë. Dikush mund të jetë iniciator për diçka, por edhe nga reagimi i tjetrit varet se a do të bëhet ndërprerja e miqësisë.

Pa marrë parasysh se kush është iniciator i marrëdhënies së prishur, për mbajtjen e miqësisë mund dhe duhet të përpiqen të dyja palët të bëjnë diçka për përmirësimin e marrëdhënieve të tyre.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Secilit nxënësi i jepet nga një kopje e fletës së punës me detyrë që së pari në kolonën e majtë t'i vizatojë ato ndenja që do të paraqiteshin te ai në situatën e ndërprerjes së miqësisë. Pastaj në kolonën e djathtë secili nxënësi duhet t'i vizatojë ato gjëra që i bën/do t'i bënte zakonisht në situatë të tillë.

Në fund secili për vete do të duhet ta lidhë me një vizë ndjenjën e vizatuar me reagimin përkatës të kolonës së djathtë – me atë reagim që do të kontribuonte për lehtësimin dhe ballafaqimin më të mirë me ndjenjat negative.

Pastaj në grupe me nga katër persona i krahasojnë përgjigjet se sa nga reagimet e vizatuara i kanë të njëjta.



DISKUTIM 2

1. Çarë ndjenjash dominojnë kur ndërpritet shoqërimi?
2. A keni përmendur në grupet tuaja mënyra të njëjta të reagimit, në atë që mund ta bëni që të ndjeheni më mirë?
3. Si kontribuon reagimi për lehtësim, që ta kemi më lehtë kur e ndërpresim një miqësi? (kontrollohet secili reagim veçmas)

PËRFUNDIM

Kur bëhet ndërprerja e ndonjë miqësie, zakonisht nuk ndjehemi shumë mirë, veçanërisht nëse ajo miqësi ka qenë e rëndësishme për ne.

Njerëzit bëjnë gjëra të ndryshme që të ballafaqohen më lehtë me humbjen e miqësisë. Disa gjëra ndikojnë më shumë te disa njerëz, ndërsa te dikush tjetër mund të ndikojnë gjëra të tjera.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimtari nxit shtrirje të pjesëve të ndryshme të trupit dhe për secilën prej tyre e thotë këtë fjali: “Një, dy, tre, martir kalo”. Pastaj vijon një pjesë tjetër e trupit me fjalinë e njëjtë derisa të mos kalojnë të gjitha ekstremitetet: koka (qafa), supet, beli..

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Përmbajtja II-2:**RUAJTJA E FSHEHTËSISË****Pritet që nxënësi/nxënësja**

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • Ta dijë se kur dhe si ndahet fshehtësia “e keqe” • Ta dijë si të reagojë kur të marrë vesh ndonjë fshehtësi “të keqe”
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mund të vlerësojë se cila fshehtësi mund të jetë e dëmshme • Të mund të reagojë ndaj fshehtësisë “së keqe” pa e thyer besimin
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Të pranojë se disa gjëra nëse mbeten fshehtësi mund ta dëmtojnë atë ose të tjerët

PUNËTORIA II-2.1: TË TREGOJ APO JO

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Pyetje për fshehtësi
- Mbështjellës për sy



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Pastaj të gjithë një nga një e thonë nga fjali të imagjinuar e cila fillon kështu: “A t’ju tregoj se e pashë Sarën/Leon si..... (bënte/bëri diçka fshehurazi – këtu të gjithë thonë diçka nga vetja e tyre, po që është ndonjë fshehtësi, diçka që nuk është mirë ta dinë të gjithë). Djemtë tregojnë për Leon, ndërsa vajzat për Sarën.

AKTIVITETI KRYESOR

Secilit nxënës i jepet fleta e punës me udhëzime që të përgjigjet në pyetje duke e rrethuar një përgjigje nga tre përgjigjet e ofruara për secilën pyetje. Pastaj në çifte i shkojnë dhe i diskutojnë përgjigjet. Në fund arsimtari i lexon pyetjet një nga një, ndërsa nxënësit përgjigjen se çka kanë rrethuar (japin përgjigje), kërkon shpjegim nga nxënësit se pse mendojnë ashtu.

DISKUTIM

1. Pse duhet të reagohet nëse merret vesh ndonjë fshehtësi “e keqe”? Kush duhet të kontaktojë me këtë rast? Pse?
2. Nga çka varet se a do të jetë e dëmshme ndonjë fshehtësi apo jo?
3. Si mund të na dëmtojë neve ruajtja e ndonjë fshehtësie? E si mund t’i dëmtojë të tjerët?

PËRFUNDIM

Fshehtësitë “e këqija” mund të shkaktojnë dëm të madh, andaj duhet të reagohet ndaj tyre. Që të ruhet besimi, më së miri është që së pari të përpiqemi të shohim se çka mund të bëjmë me ata që janë të rrezikuar. Në rast se të tjerët aspak nuk duan të ndërmerret diçka, atëherë mund t’u themi se nuk do të mund ta ruajmë atë fshehtësi edhe më tej dhe se ata do të duhet të ballafaqohen me pasojat pasi të kontaktohen personat të cilët mund të bëjnë diçka në lidhje me shmangien e pasojave të dëmshme.

Fshehtësia mund të jetë e dëmshme varësisht nga pasojat që i shkakton ndaj nesh ose ndaj të tjerëve.

Nëse me vendosmëri e ruajmë një fshehtësi që ka të bëjë me vetë neve dhe ajo pastaj zbulohet, kjo mund të na dëmtojë me vetë faktin se të tjerët mund ta humbin besimin te ne ose të ndjehen të lënduar që ne nuk kemi pasur sa duhet besim dhe nuk u kemi treguar.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë në rreth dhe mbahen për duar duke formuar një kështjellë magjike. Nxënësit që mbahen për duar paraqesin mure të kështjellës, ndërsa vetëm dy veta prej tyre nuk mbahen për duar, por qëndrojnë gjysmë metri larg – ata paraqesin portën e kështjellës. Brenda në rreth (përkatësisht në kështjellë) është një i burgosur. Ai i ka sytë e lidhur me një mbështjellëse dhe detyra e tij është që ta gjejë portën dhe të dalë nga kështjella magjike. Derisa ai lëviz nëpër brendinë e rrethit, duke e kërkuar daljen, nuk guxon t’i prekë nxënësit e tjerë (muret), por do të duhet të orientohet vetëm përmes tingujve që i prodhojnë nxënësit që paraqesin mure. Në fakt ata gjithë kohën



duhet të fishkëllejnë, të këndojnë ose të fryjën si erë. Vetëm ata që paraqesin portë – heshtin dhe nuk prodhojnë kurrfarë tingujsh. I burgosuri i ndjek tingujt - aty ku nuk dëgjohe asgjë aty duhet të jetë porta dhe aty duhet të përpiqet të dalë nga kështjella. Kur e gjen portën dhe del, atë duhet ta zëvendësojë një nxënës tjetër.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Përmbajtja II-3:**DHËNIA DHE PRANIMI I NDIHMËS****Pritet që nxënësi/nxënësja**

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • Ta dijë se me çka mund të ndihmojë në shtëpi, në shkollë dhe në bashkësi • Ta dijë kur u duhet ndihmë njerëzve të moshuar në aktivitetet e tyre të përditshme • Ta dijë se me cilat vështirësi ballafaqohen njerëzit me nevoja të veçanta (vështirësi që burojnë nga njerëzit dhe nga mjedisi)
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mund të ofrojë ndihmë kur dikush ka nevojë • Të mund t'i kundërshtojë paragjykimet ndaj njerëzve me nevoja të veçanta
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Ta pranojë se njerëzit e moshuar kanë nevojë për ndihmë • Ta kuptojë se ndihma ndaj njerëzve me nevoja të veçanta është vlerë

PUNËTORIA II-3.1: NDIHMA NË SHTËPI, NË SHKOLLË DHE NË BASHKËSI.

MATERIALET

- Fleta letre
- Sellotej
- Kuti



AKTIVITETI HYRËS

Nxënësit ndahen në dy grupe. Anëtarët e njërit grup nga xhepat ose nga çantat e tyre e zgjedhin një send të cilin e vendosin në një grumbull sendesh në tavolinë, por pa i parë anëtarët e grupit tjetër. Pastaj nxënësit e njërit grup shkojnë pranë grumbullit të sendeve dhe secili e zgjedh nga një send. Pastaj nxënësit që zgjedhin sende bëhen çifte me pronarët e sendeve të zgjedhura.

AKTIVITETI KRYESOR

Në çiftet e formuara më parë nxënësve u jepen nga 2-3 fleta të punës në të cilat do të duhet të shkruajnë ndonjë mënyrë me të cilën mund të ndihmojnë në shtëpi (diçka që mund ta bëjnë në shtëpi që ajo të merret si ndihmë). Në secilën fletë shkruhet vetëm një gjë që mund të bëhet. Kur të përfundojnë, fletat futen në një kuti në të cilën shkruan “Ndhma në shtëpi”

Pastaj po ashtu në çiftet e formuara më parë nxënësve u jepen nga 2-3 fleta të punës, ku kësaj radhe do të duhet të shkruajnë ndonjë mënyrë me të cilën mund të ndihmojnë në shkollë. Në secilën fletë shkruhet vetëm një gjë që mund të bëhet. Kur të përfundojnë, fletat futen në një kuti në të cilën shkruan “Ndhma në shkollë”

Përsëri edhe një herë në çiftet e formuara nxënësve u jepen nga 2-3 fleta të punës, ku do të duhet të shkruajnë ndonjë mënyrë me të cilën mund të ndihmojnë në bashkësi. Kur të përfundojnë, fletat futen në një kuti në të cilën shkruan “Ndhma në bashkësi”

Pastaj nxënësit ndahen në tre grupe dhe secilit grup i jepet nga një prej tre kutive të mbushura me fleta. Detyra e tyre është që t'i grupojnë përgjigjet (t'i eliminojnë përgjigjet e përsëritura).

Përgjigjet që do të mbeten ngjiten në një fletë të madhe të letrës në formë horizontale, e cila është e ndarë në tre pjesë, me tre kolona (ndihma në shtëpi, ndihma në shkollë dhe ndihma në bashkësi). Kur t'i ngjisin të gjitha fletat e letrës në flipçart, pastaj nga një përfaqësues i secilit grup i lexon propozimet për atë se si mund të ndihmohet në shtëpi, në shkollë dhe në bashkësi.



DISKUTIM

1. A ndihmoni ju në shtëpi? Po në shkollë? Po në bashkësi?
2. A e zbuluat mënyrën e ndihmës që e praktikoni, qoftë në shtëpi, qoftë këtu në shkollë apo në bashkësi? Cila ishte ajo?
3. A ka edhe diçka që ne nuk e kemi shkruar?
4. Ku është më lehtë të ndihmohet? Ku është më vështirë, ku ndodhë të ndihmojmë më pak?

PËRFUNDIM

Ekzistojnë mënyra të ndryshme me të cilat mund ta ndihmojmë edhe në shtëpi edhe në shkollë edhe në bashkësi.

Në shtëpi dhe në shkollë ndodhë të ndihmojmë më shpesh, ndërsa në bashkësi sikur më rrallë na bie të ndihmojmë, sepse jo çdoherë kjo kërkohet qartë nga ne dhe njerëzit zakonisht mendojnë se dikush tjetër do të ndihmojë.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Secilit i jepet nga një balonë. Pastaj fryhen balonat dhe kërkohet nga nxënësit që të radhiten si tren – secili shikon në shpinën e atij që e ka para vetes. Pastaj balonat vendosen ndërmjet dy nxënësve, duke u prekur kështu gjoksi i njërit me shpinën e nxënësit tjetër. Por, duhet të kihet kujdes që të jenë mjaft ngushtë që të mos bie balona. Pastaj kur të jepet shenjë, në njëjtën kohë ata fillojnë të lëvizin duke pasur kujdes që mos t'u bie ndonjë balonë.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PËRFUNDIM

Ndonjëherë personat me nevoja të veçanta kanë nevojë për ndihmë edhe pse ata vetë nuk e kërkojnë atë. Në ato raste mund t'u ofrohet ndihmë. Por, kur të thonë ata se diçka mund ta bëjnë edhe vetë, pra pa ndihmën tonë, atëherë nuk është më patjetër t'u ofrohet ndihmë.

Njerëzit zakonisht kanë paragjykime ndaj njerëzve me nevoja të veçanta. Për gjëra të ndryshme mund të konsiderojnë se nuk janë të aftë. Në ato raste duhet të reagohet dhe të vihet në pah se personat me nevoja të veçanta nuk janë më pak të vryeshëm dhe të rëndësishëm.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Në tabelë shkruhet: “Kur je plak, të duhet ndihmë për...” Pastaj në çdo 10 nxënës jepet nga një fletë letre me udhëzim që nxënësi i parë të shkruajë diçka si vazhdim i fjalisë së tabelës, diçka që ka lidhje me ndonjë ndihmë të nevojshme për njerëzit e moshuar.

Nxënësi i parë shkruan në fund të fletës dhe menjëherë pastaj pjesën e shkruar e mbështjell kah ana e prapme e fletës, që mos të shihet ajo që është shkruar. Ashtu i dorëzohet nxënësit tjetër në grup, i cili po ashtu shkruan diçka si vazhdim i fjalisë së tabelës, edhe ai e mbështjell fletën në mënyrën e njëjtë dhe ia jep nxënësit tjetër. Kështu kalohet me radhë derisa të gjithë të shkruajnë diçka.

Kur të jenë të gjithë të gatshëm, nga një vullnetar i lexon fjalitë që janë shkruar në secilën fletë, çdoherë duke filluar me fjalinë hyrëse të shkruar në tabelë.

**DISKUTIM 2**

1. A ju ka ndodhur ndonjëherë që vërtet t'i ndihmoni ndonjë personi të moshuar? Kur dhe në çfarë rrethanash?
2. Pse duhet t'u ndihmohet njerëzve të moshuar?

PËRFUNDIM

Njerëzit e moshuar ndonjëherë kanë nevojë për ndihmë, sepse nuk mund të ballafaqohen vetë me disa situata.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimitarja i këndon këto vargje: “Notoj, notoj në pishinë unë. Me gjoks, kraul, jam në ujë”. Me këtë rast arsimtarja dhe nxënësit i bëjnë lëvizjet sipas asaj që thuhet në vjershë. Kështu imitohen stilet e notit, si dhe zhytja, kjo duke e mbyllur hundën dhe duke u ulur ngadalë poshtë.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Përmbajtja II-4:**PRANIMI DHE MIRATIMI I GABIMEVE****Pritet që nxënësi/nxënësja**

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> Ta dijë se çka duhet të ndërmerret kur bëhet ndonjë gabim (me ose pa pasoja për njerëzit ose objektet)
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> Të mund të nxjerrë mësim nga gabimi i bërë Të mund të ndërmarrë veprime të cilat do ta përmirësojë gabimin e bërë
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> Ta vërejë se problemi nuk është në bërjen e gabimeve, por në përsëritjen e gabimeve të njëjta Ta vërejë se duhet ta pranojë përgjegjësinë e gabimeve të bëra, në vend që ta hedhë përgjegjësinë te të tjerët

PUNËTORIA II-4.1: GABIMI

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Deklarata për gabime 1-7
- Fleta letre: pajtohem dhe Nuk pajtohem
- Sellotej, shkumës



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimtarja i ndërlidh disa numra me disa lëvizje të caktuar të trupit:

- 1 – duart lart;
- 2 – me dorën e majtë e prekë thembrën e majtë;
- 3 – kryqëzimi i duarve;
- 4 – dora e djathtë mbi sy si kur shikojmë larg.

Numrat thuhet tre herë që të ushtrohen lëvizjet. Pasja fillohet me lojën kur arsimtari i përmend numrat me radhitje të përzier, ndërsa nxënësit i bëjnë lëvizjet e ndërlidhura me ato lëvizje. Nëse dikush e bën ndonjë lëvizje gabimisht për ndonjë numër, ai del prej loje, ndërsa të tjerët vazhdojnë më tej. Loja luhet derisa të mbeten në të 3-4 nxënës – atëherë ndërpritet (nuk shkohet deri në fund, deri në fituesin e fundit)

AKTIVITETI KRYESOR

Nxënësit ndahen në tre grupe. Secilit grup i jepet nga një komplet i fletës së punës “Deklarata për gabime 1-7” me 6-7 pohime të shkruara në letër. Detyra e tyre do të jetë t’i radhisin ato në një vijë (secilën veçmas) të formuar me ngjitës sellotej/të vizatuar me shkumës, ndërsa në skajet e kësaj vije qëndron PAJTOHEM në njërin anë dhe NUK PAJTOHEM në anën tjetër. Vijat janë vendosur paralelisht njëra pranë tjetrës që kështu të mund të bëhen krahasime në pikëpamje vizuale. Secili, varësisht nga shkalla e pajtueshmërisë, i vendos fletat në një vend të caktuar përgjatë vijës.

Varësisht nga ajo se a ka dallime në raport me atë se ku janë vendosur pohimet e ndryshme të të tria grupet, zhvillohet diskutim për ato pohime ku vërehen më shumë dallime

DISKUTIM

1. A mund të shmangen gabimet dhe asnjëherë në jetë mos të gabojmë?
2. Cila mund të jetë pasoja e gabimeve që i bëjmë?
3. Pse është me rëndësi të ndërmarim diçka kur gabojmë, madje edhe kur me atë veprim nuk ka pasoja ndaj njerëzve dhe objekteve edhe pse është gabim?
4. Çka mësojmë nëse nxjerrim mësim nga gabimet e bëra? Me se ka të bëjë ky mësim?
5. Çka do të ndodhë nëse vazhdimisht e bëjmë gabimin e njëjtë?
6. Kush është përgjegjës për gabimet e bëra?
7. Pse është me rëndësi të pranohet përgjegjësia për gabimet tona, në vend që ajo t’u hidhet të tjerëve?

PËRFUNDIM

Gabimet janë pjesë përbërëse e jetës. Nuk ka asnjë njeri që nuk mund të gabojë për ndonjë gjë. Me rëndësi është që kur të gabohet të ndërmerret diçka që të tjerët ta ruajnë besimin ndaj nesh, të mos krijojnë mendimin ose pritjen se ne nuk mbajmë llogari se a gabojmë apo jo.



Kur marrim mësim nga gabimet e bëra, ne e zvogëlojmë mundësinë që përsëri ta bëjmë gabimin e njëjtë. Ky mësim ka të bëjë me diturinë/qasjen për atë se cilat kushte dhe cilat gjëra kontribuojnë për veprimin e bërë.

Nëse neve vazhdimisht na përsëritet gabimi i njëjtë, së pari vetë ne do të nervozohemi dhe do të na bie vetërespekti (do ta konsiderojmë veten si të marrë), ndërsa e dyta, edhe të tjerët nuk do të dëshirojnë të kenë punë me ne, veçanërisht nëse gabimet tona i prekin edhe të tjerët.

Që të mund t'i shmangim gabimet, së pari duhet të ballafaqohemi me përgjegjësinë kur e bëjmë ndonjë gabim. Hedhja e përgjegjësisë te të tjerët na pamundëson që të ndër marrim veprime për përmirësimin e gabimeve dhe hap mundësi për përsëritjen e tyre. Hedhja e përgjegjësisë te të tjerët po ashtu mund të kontribuojë në përkeqësimin e raporteve me të tjerët.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Detyra e nxënësve është që lirisht të lëvizin nëpër klasë, në të gjitha drejtimet dhe, sapo ta dëgjojnë ndonjë udhëzim nga arsimtarja, të reagojnë në pajtim me udhëzimin. Pas 10-të sekondave përsëri vazhdojnë të lëvizin lirisht nëpër hapësirë. Pastaj jepet ky udhëzim dhe ashtu me radhë derisa nuk jepen të gjitha udhëzimet.

Shembuj për udhëzime:

- Fillon të bie shi
- Para jush është një gropë e madhe
- Duhet të ecni nëpër prush
- Një tigër ju ndjek
- Kërkoni taksi
- Voziteni me rolerka
- E shkyçni derën
- Keni lëshuar një “gjarpër” në ajër
- Ngjiteni në ndonjë shkëmb
- Notoni në ujë
- Hidhni guralecë në ujë
- Ecni me gishta, që të mos e zgjoni dikë
- Bisedoni në telefon



REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Përmbajtja II-5:**BALLAFAQIMI ME EMOCIONET****Pritet që nxënësi/nxënësja**

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> Të dijë se si manifestohet dashuria ndaj të rriturve
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> Të mund të ballafaqohet me situata të ndryshme jetësore që shkaktojnë emocione të fuqishme (pikëllim, dashuri, xhelozë)
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> Ta pranojë se dashuria ndaj moshatarit/moshatares nuk është patjetër të kthehet Ta pranojë se humbja e një të afërmi është e lidhur me ndjenja të pakëndshme me të cilat duhet të ballafaqohet secili

PUNËTORIA II-5.1: KUR E KAM VËSHTIRË

MATERIALET

- Fletë pune: Emocionet në trupin tim
- Fllomasterë, ngjyra



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë qëndrojnë të ulur në rreth. Aktivitetin e fillon një nxënës duke treguar diçka për vete dhe duke e plotësuar me fjalinë: “Më së shumti pikëllohem kur ... (shton diçka për vete), ndërsa më së shumti më bën të qeshi ... (shton diçka për vete).”

AKTIVITETI KRYESOR

Secilit nxënës i jepet nga një kopje e fletës së punës (secila situatë mund të jetë në fletë të veçantë!!!). Pastaj secili e lexon situatën e parë për vete dhe shkruan se si do të ndjehej në lidhje me situatën e përshkruar, e pastaj në kolonën e dytë e ngjyros atë pjesë të trupit ku ajo ndjenjë është e shprehur më shumë. Në kolonën e tretë nxënësit së pari bisedojnë në çifte se çka do të mund të bënin që do t'u ndihmonte të ndjehen më mirë dhe ato ide i shkruajnë në vendin e përcaktuar për këtë. Në fund secili për vete e shkruan se me kë do të kishte mundur të bisedojë për atë që e mundon në lidhje me situatën e përshkruar. Pastaj përmes diskutimit me tërë grupin kontrollohet se cilat ndjenja janë dhënë, ku ndjehen më shumë në trup dhe çka mund të bëjnë ata. Në veçanti i kushtohet kujdes detajit të fundit. Nxënësit pyeten se a e kanë lehtë të flasin me dikë në lidhje me situatën e përshkruar apo në lidhje me ndonjë situatë tjetër. Në këtë mënyrë kalohet edhe situata e dytë dhe e tretë.

DISKUTIM

1. Kur ballafaqohemi me situata të vështira dhe kemi emocione të fuqishme, pse është me rëndësi të mund të ndërmarrim diçka, ndonjë aktivitet?
2. Pse është me rëndësi të bisedojmë me dikë që e kemi të afërt dhe të cilit i besojmë?



PËRFUNDIM

Ndërmarrja e ndonjë aktiviteti, bërja e ndonjë gjëje kur ballafaqohemi me ndjenja intensive, i mundëson trupit tonë të çlirohet nga tensioni që e ndejnë pjesë të caktuara të trupit.

Biseda me ndonjë të afërt që është i gatshëm të na dëgjojë, të na ndërpresë dhe të na qortojë, po ashtu e ka funksionin e lehtësimit, ndriçimit të situatës, si dhe të çlirimit të tensionit.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Nxënësit ndahen në grupe me nga tetë pjesëmarrës. Shtatë bëjnë luhatëse me duart e tyre, ndërsa i teti shtrihet aty. Me rëndësi është që ai që luhatet të prekë mbi duar me qafë, supe, bel dhe gjunjë. Pastaj ngadalë lëvizet para-prapa. Këtë luhatje mund ta provojë secili me radhë. Me këtë rast duhet të mbahet llogari që ai që e luhatim të ndjehet i sigurt.


REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

PUNËTORIA II-5.2: MË SHFAQ DASHURI

MATERIALET

- Fletë pune për arsimtarin/arsimtares: Të dua në gjuhë tjetër
- Komplet letrash për lojë
- Letër
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Fillohet me ndonjë vullnetar i cili ia përcjell një “impuls” nxënësit pranë tij duke ia bërë me sy. Nxënësi e pranon “impulsin”, ia kthen po ashtu duke ia bërë me sy e pastaj kthehet kah nxënësi tjetër dhe njësoj e përcjell impulsin. Kështu vazhdohet derisa nuk kalojnë të gjithë.

AKTIVITETI KRYESOR 1

Nxënësit ndahen në grupe me nga 4-5 nxënës. Secilit grupi i jepet për detyrë të mendojë se do ta paraqesë manifestimin e dashurisë në njërin nga këto mënyra: me pantomimë, me krijim të skulpturës me trupat e tyre, me të shkruar të këngës, me krijim të një mesazhi dhe me dramatizim (nëse ka më shumë se pesë grupe, mënyrat përsëriten). Pas 10-të minutave grupet prezantohen.



DISKUTIM 1

1. Cila mënyrë e shprehjes së dashurisë ju pëlqeu më shumë?
2. Në çfarë mënyre do të dëshironit që dikush t’ju tregojë se i pëlqeni?
3. Cila mënyrë e shfaqjes së dashurisë është më e mirë?

PËRFUNDIM

Njerëz të ndryshëm parapëlqejnë mënyra të ndryshme të shfaqjes së dashurisë.

Nuk ekziston vetëm një mënyrë e shfaqjes së dashurisë. Disa mënyra janë më adekuate për disa raste, ndërsa disa të tjera për raste të tjera. Ndonjëherë kjo varet nga interesimi i atyre që shprehin dashuri.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Nxënësit ndahen në dy grupe të njëjta dhe grupohen në një grumbull në dy anë të kundërta dhe me një hapësirë të zbrazët në mes. Secili nxënës duhet të tërheqë një kartelë nga njëri prej dy grumbujve të letrave (njëri për njërin grup dhe tjetri për grupin tjetër). Qysh më parë (gjatë përgatitjes së materialeve) mbahet llogari që të kemi numër të njëjtë të letrave nga secila ngjyrë (gjeth, lule, zemër dhe bakllava) në të dy grumbujt. Varësisht nga numri i nxënësve mund të kemi edhe më shumë letra prej një ngjyre, por me rëndësi është që numri i letrave sipas ngjyrës (gjeth, lule, zemër dhe bakllava) të jetë i njëjtë në të dy grumbujt e letrave. Nxënësi kanë kujdes që të mos shihet se cila letër është tërhequr.

Aktivitetin e fillon një vullnetar i cili duhet të afrohet pranë ndonjë nxënësi të grupit të tjetër dhe me këtë rast duhet të shprehet se ai nxënës i pëlqen, duke e thënë këtë frazë: “Mimi/ Beni, ti më pëlqen, dëshiroj të shoqërohem me ty”. Në atë moment, derisa e thotë fjalinë, ai e tregon edhe letrën e tij. Personi të cilit ky i drejtohet po ashtu e tregon letrën e tij dhe, nëse është me ngjyrë të njëjtë (bakllava me bakllava, zemër me zemër, gjeth me gjeth, lule me lule), thotë: “Edhe ti mua më pëlqen”, e pastaj të dy kapen për duar dhe shkojnë e ulen në karrige. Nëse ngjyrat e letrave janë të ndryshme (të atij që shpreh pëlqim dhe të atij që dëgjon), atëherë

dëgjuesi, pasi ta shfaqë letrën, thotë: “I/e mirë je ti, por mua më pëlqen dikush tjetër”. Në atë rast ai që është drejtuar te ky person kthehet te grupi i ri dhe pret që dikush tjetër t’ia shprehë atë pëlqim. Radhitja e shprehjes së pëlqimit ndryshon, një herë një përfaqësues i një grupi shpreh pëlqim, ndërsa në rastin e ardhshëm kjo ndryshon. Secili nxënës vetë zgjedh se a do t’i drejtohet nxënësit që e pëlqen me “Mimi” ose me “Beni.

Aktiviteti rrjedh derisa të gjithë të mos ulen në banka (pasi kanë gjetur dikë me të cilin u janë përshtatur letrat)

DISKUTIM 2

1. Si ndjehemi kur dikush na thotë se ne i pëlqejmë?
2. Si ndjehemi kur ne i themi dikujt se na pëlqen?
3. A mjafton që ti ta duash dikë që edhe ai/ajo të dojë?
4. Si do të ndjeheni nëse i shprehim dashuri ose pëlqim dikujt dhe gjatë kësaj na refuzojnë? A do të thotë kjo se ne nuk jemi të mirë dhe nuk meritojmë që dikush të na dojë?

PËRFUNDIM

Kur dikush na thotë se i pëlqejmë, në ndjehemi mirë, të respektuar, të vyeshëm, ndërsa kur pëlqimi nuk është i dyanshëm, ne mund të ndjehemi të shqetësuar.

Ndonjëherë nuk është aq lehtë të dëshmojmë se dikush na pëlqen, sepse pëlqimi mund të mos jetë i dyanshëm. Por, nga ana tjetër, mund të ndjehemi edhe lehtësim, gëzim dhe lumturi që dikujt ia kemi shprehur se na pëlqen, veçanërisht nëse pëlqimi është i dyanshëm.

Nuk mjafton vetëm ta duash dikë që edhe të të dojë dikush.

Nëse dikush na refuzon, kjo nuk do të thotë se nuk jemi të mirë dhe se nuk meritojmë dashuri. Kjo nënkupton se njerëzit kanë shije të ndryshme, gjëra të ndryshme janë të rëndësishme për ata, andaj kur ka përkime në pëlqimin e gjërave të ndryshme, atëherë edhe dashuria mund të jetë më e fuqishme.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Në mes të rrethit vendosen 3-4 kopje të fletës së punës “Të dua në gjuhë tjetër”. Aktivitetin e fillon një vullnetar i cili i drejtohet një nxënësi afër tij me “të dua” në njërën nga gjuhët e dhëna dhe e shqipton emrin e tij. Ndërkaq ai ia kthen po ashtu me “të dua”, por në një gjuhë tjetër sipas dëshirës së tij. Pastaj kthehet kah nxënësi i ardhshëm dhe e përsërit procesin. Kështu me radhë derisa të gjithë t’i thonë dikujt pranë vetes “të dua”.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja II-5.2: Më shfaq dashuri

**Fletë pune për arsimtarin/arsimtare:
TË DUA NË GJUHË TJETËR**

I love you – anglisht

Ich liebe dich – gjermanisht

Ti amo – italisht

Volim te – serbisht, kroatisht, boshnjakisht

Seni Seviyorum – turqisht

Te amo – spanjisht

Mangava tu – gjuha rome

Je t'aime – frëngjisht

Mi amas vin - esperanto

Të dua – shqip

...


Përmbajtja II-6:**BALLAFAQIMI ME SJELLJEN E DHUNSHME****Pritet që nxënësi/nxënësja**

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • Të dijë si të reagojë ndaj sjelljes së dhunshme që të mbrohet viktima • Të dijë si të reagojë që ta pengojë sjelljen e dhunshme
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të dijë të reagojë ndaj sjelljes së dhunshme që është e drejtuar drejt tij/saj • Të dijë të reagojë ndaj sjelljes së dhunshme që është e drejtuar drejt të tjerëve
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • T'i vërejë pasojat negative nga mosreagimi ndaj situatave kur dikush tjetër ose diçka tjetër është viktimë e sjelljes së dhunshme

PUNËTORIA II-6.1: REAGIME NDAJ NËNÇMIMIT

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Viktima të nënçmimit
- Fletë pune për nxënësit: Reagime ndaj nënçmimit 1
- Fletë pune për nxënësit: Reagime ndaj nënçmimit 2
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI HYRËS

Nxënësit lëvizin lirisht në klasës sipas tempit të tyre, mundet më lehtë, por mundet edhe më ngadalë. Kur thuhet “atom”, të gjithë ndalen dhe secili përfaqëson një atom. Pas një kohe të shkurtër thuhet “Lëvizje” dhe të gjithë fillojnë të lëvizin përsëri. Pastaj mund të thuhet “molekula 3”, me ç’rast nxënësit do të duhet të formojnë tresha duke u kapur për duar nga tre nxënës. Kur jepet udhëzimi “molekula 4”, ofrohen katërshe, me “molekula 5” formohen pesëshe etj. Udhëzimi i fundit ka të bëjë me numrin që do ta përcaktojë se nga sa anëtarë do të kenë grupet e punës në aktivitetin e ardhshëm.

AKTIVITETI KRYESOR 1

Nxënësit ndahen në grupe të vogla (3-5 nxënës). Secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës “viktimat e nënçmimit”, bashkë me udhëzimin që të mendojë dhe në vendin adekuat të fletës të shkruajë fjalë të ndyta që përdoren kur synohet të nënçmohet personi i vizatuar në fotografi.

Pasi të kryejnë grupet detyrën, secili anëtar i grupit duhet ta mbajë mend së paku një fjalë të ndytë që e ka menduar grupi.

Pastaj nxënësit dalin në vendin e zbrazët para bankave dhe radhiten në dy rreshta njëri përballë tjetrit, me distancë 1-1,5 metra nga njëri-tjetri. Arsimtari i inkuadron në aktivitet, duke shpjeguar se në mesin e tyre ndërmjet rreshtave do të kalojnë një nga një me temp normal. Pastaj do të fillohet nga njëri kënd i mesrreshtave duke hyrë në mes të gjithë nxënësit një nga një. Secili që kalon ndërmjet rreshtave do të duhet të ndalet në fund të mesrreshtave dhe përsëri të bëhet pjesë e rreshtave.

Derisa kalon një nxënës aty, nxënësit e tjerë që janë pjesë e mesrreshtave duhet t’i thonë atij fjalë të ndyta që i kanë mbajtur mend nga detyra paraprake.

Aktiviteti përfundon kur të gjithë nxënësit të kalojnë mes rreshtave dhe të jenë të ekspozuar në fjalët e ndyta.

DISKUTIM 1

1. Si ndjeheshit kur kalonit nëpër mesin e rreshtave? Pse?
2. Si ndjeheni si pjesë e mesrreshtave? Pse?
3. Në cilën situatë e kishit më vështirë: mes rreshtave apo si rresht? Pse?
4. Si do të ndjehej fëmija i fotografisë (nga fleta e punës) kur do t’i dëgjonte fjalët e ndyta që i thoni për të?

PËRFUNDIM

Është normale që, kur dikush na drejtohet me fjalë të ndyta, ne të ndjehemi të parespektuar dhe të ofenduar.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Nxënësve që janë të ndarë përsëri në grupet e njëjta u ndahen fleta e punës “Reagime ndaj nënçmimit 1”. Nga grupet kërkohet që të mendojnë dhe të shkruajnë sesi (me çfarë fjalësh dhe/ose supozimesh) do të mund të reagojë fëmija i fotografisë me të cilat:

- Do të dekurajohet sjellja e ardhshme sulmuese (nuk do të sulmojë) dhe do të shmanget konflikti
- Nuk do ta dëmtojë vetërespektin e tij (nuk do të mbrohet dhe nuk do të arsyetohet)

Pas 3-5 minutave punë secili grup i ekspozon mënyrat e reagimit ndaj sulmeve nënçmuese që janë prezantuar. Pas prezantimit të shembujve, ato nuk komentohen, por vetëm jepet duartrokitje.

Secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës “Reagime ndaj nënçmimit 2” dhe detyra që t’i lexojë reagimet e dhëna të nënçmimit dhe të përpiqet që shembujt e reagimit që i ka menduar në aktivitetin paraprak tash t’i vendosë në ndonjë nga kategoritë e dhëna në fletë. Për ato kategori për të cilat nuk ka shembuj paraprak, duhet të mendojë shembuj të tjerë dhe ato t’i shkruajë në fletën e punës “Nënçmimi” (versioni a dhe b)

Pas rreth 3 minutash arsimtari kërkon nga nxënësit që t’i lexojnë me zë shembujt për të gjitha nga katër kategoritë e pajisjes së punës – e përmend kategorinë dhe kërkon shembuj të reagimeve konkrete të nënçmimit të secilit grup. Secili shembull është i përcjellë me lëvdata të tipit: shumë mirë, shkëlqyeshëm, super.

Në fund arsimtari zhvillon diskutim në lidhje me këto çështje:

DISKUTIM 2

1. A ndodhin këto situata edhe në jetën e përditshme?
2. Si ndjehen fëmijët që janë viktimë e këtyre situatave?
3. Pse është me rëndësi të dihet si të reagohet ndaj këtyre situatave në mënyrë që të pamundësohet forcimi i konfliktit?

**PËRFUNDIM**

Fatkeqësisht edhe në jetën e përditshme ndodhin ngasje, provokime dhe hedhje të fjalëve fyese dhe ofenduese që paraqesin forma të veçanta të dhunës psikike. Pa marrë parasysh se a pranohen në mënyrë direkte ose indirekte, këto forma të dhunës e lëndojnë personalitetin “e viktimës” dhe përjetojnë si sulm ndaj vetërespektit dhe vetëbesimit.

Që të mund të ballafaqohet me sulmet nënçmuese të dhunuesve, secila viktimë potenciale duhet të mësojë se si të reagojë ndaj ngasjeve, provokimeve dhe fjalëve ofenduese/fyese me çka do ta pengojë të lëndohet vetërespekti i tij dhe njëherazi do të pamundësojë forcimin e sjelljes së dhunshme të sulmuesit.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Pastaj dalin dy fëmijë që përqafohen dhe derisa qëndrojnë ashtu të përqaftuar, atyre u bashkohen një nga një edhe nxënësit e tjerë duke formuar kështu një “lakër” të përqafimeve.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA II-6.2: NËSE NUK REAGUJ

MATERIALET

- Copëza letre
- Fletë pune për nxënësit: Viktima e mosreagimit
- Top



AKTIVITETI HYRËS

Krijohet 2-3 grupe me nga 9-10 nxënës. Të gjithë qëndrojnë në rreth dhe i tërheqin fletëzat e përgatitura qysh më parë, duke pasur kujdes që askush mos të shohë se çfarë kanë tërhequr. Në dy fletëza të tilla është shkruar shkronja “E”, ndërsa fletëzat e tjera janë të zbrazëta. Ata që e kanë pranuar shkronjën “E” paraqesin “eliminues”, ndërsa të tjerët do të jenë qytetarë të thjeshtë. Detyra e “eliminuesve” do të jetë që t’i eliminojnë të tjerët duke ua bërë me sy kur shikimet do të ndeshen, por pa i vërejtur askush. Detyra e qytetarëve të thjeshtë është që të zbulojnë se kush janë eliminuesit dhe kur ta vërejnë se dikush ia bën me sy dikujt, ata do të duhet të reagojnë dhe të bërtasin “eliminues”. Kështu “eliminuesi” del prej loje. Po ashtu, edhe qytetari i thjeshtë, kur ta kuptojë se dikush ia bën me sy pikërisht atij, edhe ai duhet të dalë nga loja, sepse është “eliminuar”.

AKTIVITETI KRYESOR 1

Nxënësit ndahen në 4 grupe dhe secilit grup i jepet për detyrë që ta mendojnë ndonjë mënyrë të sjelljes së dhunshme ndaj dikujt dhe pastaj ta aktrojnë atë para nxënësve të tjerë. Dy grupe marrin për detyrë që ta paraqesin situatën ashtu që personi i sulmuar vetëm do të mbrohet nga sjellja e dhunshme, ndërsa dy grupet e tjera e marrin për detyrë që ta prezantojnë situatën duke u përzier në të një personi i tretë i cili do të reagojë ndaj sjelljes së dhunshme.

Pas një kohe të caktuar për përgatitje dhe marrëveshje, grupet i prezantojnë situatat.

DISKUTIM 1

1. Çka mund të bëjmë që të shpëtojmë kur dikush na sulmon, në ofendon dhe na maltreton?
2. A është mirë që çdoherë të përpiqemi të bisedojmë kur dikush ka qëllime të dhunshme ndaj nesh?
3. Çka mund të bëjmë kur dikush e sulmon, e ofendon ose dhe e maltreton dikë tjetër?

PËRFUNDIM

Kur dikush sillet keq ndaj nesh (dhunshëm), ne mund të provojmë ta pyesim se pse e bën një gjë të tillë dhe me këtë rast të themi se nuk na pëlqen aspak ajo që na e bën ai.

Ndonjëherë biseda nuk ndihmon, ngase dhunuesi është shumë i tërbuar ose përpiqet të na lëndojë me diçka, andaj duhet kërkuar ndihmë nga njerëz të tjerë, por edhe shmangia e situatës mund të jetë reagimi më adekuat.



Kur shohim dhunë ndaj dikujt tjetër, ne mund të reagojmë duke e penguar atë dhe duke u përpiqur të kërkojmë të bisedohet për problemin ose të kërkojmë ndihmë nëse vlerësojmë se vetë ne nuk mund të ndihmojmë pengimin ose ta ndalojmë dhunën.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Duke qenë në çifte nxënësve u shpërndahet fleta e punës “Viktima të mosreagimit” (ose thënia e shkruar më parë në tabelë). Pastaj në çifte diskutohet çka do të thotë/çfarë mesazhi jep ajo thënie. Pastaj zhvillohet diskutim me të gjithë.

**DISKUTIM 2**

1. Pse e ka pësuar autori i thënies/viktimës së nazizmit?
2. Pse është me rëndësi të reagohet kur dikush është viktimë e sjelljes së dhunshme?
3. A ndodhë kjo ndonjëherë në shkollë? Çka bëjmë ne kur e shikojmë atë sjellje?

PËRFUNDIM

Kur shikojmë sjellje të dhunshme, e nuk ndërmarrim asgjë, ajo është njësoj sikur ta miratojmë dhunën.

Nëse nuk reagohet ndaj sjelljes së dhunshme me kohë, ka shumë gjasa që ajo sjellje të paraqitet gjithnjë e më shpesh, ashtu që edhe ne të jemi viktima të asaj sjelljeje.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Aktivitetin e fillon një vullnetar i cili duhet ta thotë një fjali e cila duhet të fillojë me “Nuk ka”, e pastaj përmendet diçka e pastaj shtohet edhe “pa” dhe përsëri përmendet diçka që është e lidhur me atë që është thënë më parë. Së pari fillon arsimitari duke e thënë këtë, e pastaj kjo shërben edhe si shembull: “Nuk ka verë pa dallëndyshe”. Nxënësi tjetër sipas këtij principi vazhdon, por thotë diçka tjetër që nuk është pa... Dhe, ashtu me radhë derisa të gjithë nuk e thonë nga një fjali sipas modelit të dhënë.

REFLEKTIM


1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA II-6.3: PASIVE, AGRESIVE OSE MANIPULUESE

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Llojet e sjelljes
- Fletë pune për nxënësit: Llojet e sjelljes, situata



AKTIVITETI KRYESOR 1

Nxënësit ndahen në gjashtë grupe. Tre grupeve u jepet nga një situatë e fletës së punës për nxënësit “Llojet e sjelljes, situata”, ndërsa tre grupe të tjera e vëzhgojnë nga një grup që ka marrë situatë, por pa ju përzier. Detyra e grupeve që kanë marrë situata është që t’i lexojnë situatat dhe t’i përgatitin për aktrim para nxënësve të tjerë, e pastaj t’i aktrojnë.

Në fund nxënësve të grupeve u jepet fleta e punës “Llojet e sjelljes” me udhëzim që t’i lexojnë ato dhe të përpiqen t’i ndërlidhin situatat e aktruara.

DISKUTIM 1

1. Çfarë sjellje kishim në situatën me piknikun? Pse ajo është sjellje agresive? Pse ai që e përdor atë sjellje quhet ndjekës?
2. Çfarë sjellje kemi në situatën me globin? Pse ajo është sjellje pasive? Pse ai që e përdor atë sjellje quhet viktimë?
3. Çfarë sjellje kemi në situatën me lektyrën e palexuar? Pse ajo është sjellje manipuluese? Pse ai që e përdor atë sjellje quhet shpëtimtar?

PËRFUNDIM

Gjatë sjelljes agresive zakonisht dikujt i drejtohem me fjalë të këqija dhe me këtë rast bëjmë që ai të ndjehet i lënduar dhe të frikësohet se do t’i ndodhë diçka e keqe. Kur sillemi ashtu, ne i ndjekim të tjerët, u shkaktojmë shqetësim.

Kur ankohemi se asgjë nuk po na shkon për dore, se të tjerët nuk sillen miqësisht ndaj nesh, ne shfaqim sjellje pasive. Atëherë hymë në rolin e viktimës dhe ideja e saj është që të shkaktohet keqardhje të të tjerët dhe ata të shfaqin mëshirë që pastaj të sillen më mirë ndaj nesh.

Sjellje manipuluese kemi kur përpiqemi të tregohemi si të mirë para dikujt që janë më të pafuqishëm dhe ne e kryejmë punën në vend të tyre; kështu e fitojmë mbështetjen e tyre. Kur sillemi në këtë mënyrë, kjo do të thotë se jemi në rolin e shpëtimtarit, sepse përpiqemi t’i shpëtojmë të tjerët nga gjendja e pakëndshme, në vend që vetë ata të luftojnë me gjendjet e pakëndshme.



AKTIVITETI KRYESOR 2

Nga grupet që në aktivitetin paraprak ishin vëzhgues tash kërkohet që t’i aktrojnë situatat që i vëzhgonin, por tash me reagime më ndryshe. Tash grupet do të duhet të ofrojnë reagime në të cilat tregohet se çka është ajo që nuk na pëlqen në situatën e dhënë. Grupet që në aktivitetin paraprak aktronin, tash paraqesin vëzhgues. Në fund situatat e përgatitura aktrohen.

DISKUTIM 2

1. Çka ishte e ndryshme në këto situata? A kishte sjellje agresive ose sjellje pasive? A e shpëtuan dikë? Çka bëhej në ato raste?
2. A e dini se si quhet sjellja kur e tregojmë atë që na pengon apo që nuk na pëlqen? Pse është me rëndësi ta bëjmë atë?

Përmbajtja II-7:**ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE****Pritet që nxënësi/nxënësja**

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • Ta dijë se çka do të thotë të jesh palë “fituese”, e çka palë “humbëse” në konflikt dhe se cilat janë pasojat nga kjo • T’i dijë rregullat e marrëveshjes bashkëpunuese
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mund ta shikojë konfliktin edhe nga pozicioni i palës tjetër • Të mund të bëjë dallim ndërmjet pozicioneve dhe nevojave në konflikt • Të mund të kërkojë zgjidhje të konfliktit bashkë me palën tjetër
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Ta vërejë se konflikti është problem që duhet të zgjidhet bashkërisht • Ta vërejë se konflikti është i zgjidhur plotësisht vetëm atëherë kur të dyja palët ndjehen fituese

PUNËTORIA II-7.1: NË VEND TË TJETRIT

MATERIALET

- Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Ombrellë ose lëpirëse
- Dy kartonë (ose dy tabakë letër) në dy ngjyra të ndryshme
- Letër



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë qëndrojnë në rreth dhe përkulen deri poshtë që të mund t'i kapin gishtat e këmbëve. Thuhet se do të numërohet nga 1 deri në 20 dhe gjatë secilit numërim nxënësit ngadalë do të drejtohen, ashtu që kur të thuhet numri 20 ata do të jenë të drejtuar plotësisht me duar të ngritura mbi kokë. Nxënësit duhet të kenë kujdes që në secilin numër të drejtohen nga pak që në fund të jenë plotësisht të drejtuar. Përveç kësaj, nxënësit duhet të përpiqen ta mbajnë mend se cilën pozitë e kanë marrë gjatë secilit numër. Pasi të gjithë nxënësit të drejtohen dhe t'i kenë vënë duart mbi kokë, fillohet me numërim pa ndonjë radhë, ndërsa nxënësit do të përpiqen ta marrin atë pozitë që u përgjigjet numrave përkatës.

AKTIVITETI KRYESOR 1

Nxënësve u paraqitet vizatimi i fletës së punës (mund edhe të vizatohet në tabelë), me udhëzim që secili për vete të shkruajë në fletë se çka mendon se është paraqitur në atë vizatim. Pastaj nxënësit tregojnë se çka kanë shkruar. Me këtë rast mbahet llogari që të dëgjohen sa më shumë përgjigje të ndryshme.

DISKUTIM 1

1. A pamë të gjithë diçka të njëjtë?
2. Pse dikush ka parë diçka, të tjerët diçka tjetër, e të tretët diçka krejt tjetër?

PËRFUNDIM

Të gjithë njerëzit kanë përvoja të ndryshme, u ndodhin gjëra të ndryshme dhe një gjë e njëjtë mund t'u ndodhë shumë njerëzve të ndryshëm dhe ata ta përjetojnë atë në mënyra të ndryshme.



AKTIVITETI KRYESOR 2

Nxënësit ulen në rreth. Në mes të rrethit vendosen dy kartonë me ngjyrë, njëri përballë tjetrit.

Nxënësve u shpjegohet se dy kartonët e vendosur në mes të klasës paraqesin dy pikëpamje të ndryshme – kur ndalemi pranë njërit, gjërat i shikojmë nga një perspektivë, ndërsa kur ndalemi pranë tjetrit, i kundrojmë nga një perspektivë tjetër.

Arsimtarja jep shembull. Së pari e përshkruan konfliktin vijues:

“Paramendoni një situatë në të cilën nëna nuk e lëshon të birin të luajë me top me shokët derisa t'i bëjë detyrat e shtëpisë”.

Pastaj njëri ndalet te njëri karton (i kthyer kah tjetri) dhe thotë:

“Nëse i bën detyrat e shtëpisë tash kur je i çlodhur, do të mbeten pa bërë. Kur të kthehesh i lodhur nga loja me top, do të qahesh se të flihet dhe do të kërkosh ndihmë, ndërsa unë nuk do të mundem të të ndihmoj.”

Pastaj kalon te kartoni tjetër (i kthyer po ashtu kah tjetri) dhe thotë:

“Nëse nuk dal tash të luaj me top, pastaj nuk do të kem me kë të luaj. Shokët do të shkojnë e unë gjithë ditën duhet të rri në shtëpi.”

Kërkohet nga nxënësit të përmendin këso konfliktesh nga jeta e përditshme.

Secili që do ta përmendë një konflikt, ka të drejtë ta ftojë edhe një nxënës tjetër që të ndalet një herë në njërin e një herë në kartonin tjetër, duke i prezantuar pikëpamjet e palëve të ndryshme në konflikt (duke e vendosur veten një herë në njërin e një herë në anën tjetër). Pikëpamjet duhet t'i përmbajnë *shkaqet* pse secila palë në konflikt e kërkon atë që e kërkon.

Nëse ndonjë nxënës tjetër ka ide për qasje më ndryshe për konfliktin e njëjtë, ai mund ta marrë rolin e prezantuesit, duke u ndalur një herë në njërin e një herë në kartonin tjetër, që kështu të vihet një herë në njërin anë e një herë në anën tjetër të konfliktit.

Aktiviteti kryhet kur të prezantohet pikëpamjet e palëve së paku në tre konflikte të reja ose kur të shteren të gjithë idetë e nxënësve.

DISKUTIM 2

1. Si duket kur përpiqemi të ndaleni në një anë dhe ta shikojmë konfliktin nga ajo pikëpamje?
2. A ndihmon ose pengon kjo në zgjidhjen e konfliktit? Pse?

PËRFUNDIM

Që të mund të zgjidhet konflikti me sukses, secila palë duhet të përpiqet ta vendosë veten në vend të tjetrës dhe ta shikojë konfliktin nga perspektiva e saj.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Secili pjesëmarrës duhet ta ngjësë një copë sellotej në supin e djathtë. Selloteji duhet të jetë i mbështjellë, me qëllim që të jetë i ngjitsëm nga të dyja anët. Pjesëmarrësit shëtisin nëpër klasë, ndërsa kur jepet shenjë, ata do të duhet të gjejnë partner me të cilin do të ngjiten. Ngjitet supi i djathtë i njërit që ka sellotej me supin e majtë të tjetrit që nuk ka sellotej. Pastaj vazhdojnë të shëtisin, ndërsa kur të jepet shenjë duhet të gjejnë ndonjë çift tjetër me të cilin do të ngjiten (në mënyrën e njëjtë). Pastaj shëtisin të gjithë katër së bashku të ngjitur, ndërsa, kur jepet shenjë, ata ngjiten me një katërshe tjetër. Kështu vazhdojnë derisa të ngjiten të gjithë anëtarët e grupit.


REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja II-7.1: Në vend të tjetrit


**Fletë pune për arsimtarin/arsimtarene:
OMBRELLË OSE LËPIRËSE**



PUNËTORIA II-7.2: BASHKËPUNIM OSE GARA

MATERIALET

- Banka dhe karrige
- Kasetofon/kompjuter



AKTIVITETI HYRËS

Nxënësit të ndarë në çifte e shtrijnë dorën duke dhënë shenjë për OK (me gishtin përpyetë) dhe pastaj kapen për dore me katër gishtat e tjerë, por gishti i madh u mbetet i lirë. Numërohet deri në tre dhe fillohet lufta për robërimin e gishtit të madh të tjetrit po ashtu me gishtin e madh. Pas disa raundeve të robërimit të gishtit të madh, kjo mund të provohet edhe me dorën e majtë.

AKTIVITETI KRYESOR 1

Nxënësit ndahen në tresha. Në hapësirën e tyre vendosen aq banka sa ka tresha. Përreth secilën bankë vendosen karriget, nga një në të dyja anët e kundërta të bankës.

Secili tresh vendoset pranë një banke: dy vetë prej treshit ulen në karrige njëri përballë tjetrit, ndërsa i treti qëndron pranë bankës.

Atyre dyve që janë ulur njëri përballë tjetrit u jepet ky udhëzim:

“Shtrini duart e djathta, vendosni bërrylat në bankë dhe kapuni pëllëmbë për pëllëmbë (pozicioni është njëjtë si në lojën për mundjen e duarve, por nuk thuhet se është fjala për të). Qëllimi i aktivitetit është që me pëllëmbën e partnerit ta prekni tavolinën sa më shumë herë që mundeni gjatë 30 sekondave”.

Anëtari i tretë i treshit duhet të kontrollojë dhe të numërojë se cila pëllëmbë sa herë e ka prekur tavolinën.

Arsimtari jep shenjë për fillimin e aktivitetit. Pas 30 sekondave e përfundon aktivitetin.



DISKUTIM 1

1. Kush ka arritur rezultat më të lartë e kush rezultat më të ulët?
2. Si u arrit rezultati më i lartë? Pse dikush pati rezultat më të ulët?
3. Kush janë fitues e kush humbës në lojë?
4. A mund të ndodhte ndryshe – secili të arrinte më shumë dhe secili të ishte fitues? Si do të ishte nëse partneri në lojë nuk shikohej si kundërshtar? Çka do të ndodhte nëse ai merrej si bashkëpunëtor?

PËRFUNDIM

Është gabim të mendohet se që të arrihet fitore duhet të mundet tjetri. Kjo qasje është garuese – ka kundërshtarë të përkufizuar saktë.

Në shumicën e rasteve të jetës së përditshme më lehtë është të arrihet sukses nëse respektohet qasja bashkëpunuese – mundëson që të gjitha palët të fitojnë.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Nxënësit kthehen në treshat e formuar më parë. Aktiviteti përsëritet pasi që arsimtari ta përsëritë udhëzimin.

“Qëllimi i aktivitetit është që me pëllëmbën e partnerit ta prekni tavolinën sa shumë herë që mundeni gjatë 30 sekondave”.

Derisa zgjat “mundja e duarve”, anëtari i tretë i treshit përsëri kontrollon dhe numëron se sa herë cila dorë e ka prekur bankën. Aktiviteti ndërpritet pas 30 sekondave.

Nëse në asnjë tresh nuk arrijnë ta zbulojnë se si duket sjellja bashkëpunuese, arsimtari u shpjegon se secili anëtar i çiftit që merr pjesë në mundjen e duarve pa rezistencë duhet të lëshojë pe që t’i mundet dora që tjetri të fitojë pikë, e pastaj edhe ai vetë të marrë pikë derisa tjetri nuk do të rezistojë. Kështu gjithë kohën pa rezistencë anëtarët e çiftit një pas një ia mundin dorën njëri-tjetrit duke arritur rezultatet të larta, të cilat nuk do të arriheshin nëse i rezistonin njëri-tjetrit.

DISKUTIM 2

1. A kishte dallime në rezultatet e arritura tash? Pse?
2. Si u ndryshua qasja? Kush ishte tash fitues, e kush ishte humbës?
3. Si ndjeheshit në situatën e parë e si në situatën e dytë?
4. Si ndjehen gjatë konfliktit ata që humbin, që lëndohen?
5. Cilat janë pasojat në ato raste?
6. A mund të zbatohet kjo qasje në situata konflikti? Çka nëse i qasemi konfliktit si një problemi të përbashkët, i cili mund të zgjidhet me sukses vetën nëse palët bashkëpunojnë mes vete?
7. Çka nëse pala tjetër në konflikt shikohet si bashkëpunëtor, në vend që të shikohet si kundërshtar? Çka do të fitonim në atë rast? E çka do të humbnim?

PËRFUNDIM

Kur të kemi në një situatë konflikti fitues dhe humbës, pala humbëse do të dëshirojë gjithnjë të hakmerret, ta barazojë dhe do të presë momentin e parë që ta bëjë këtë.

Çdoherë kur t’i qasemi konfliktit si ndaj një problemi të përbashkët, kështu hapet mundësia që palët të bashkëpunojnë në zbulimin e zgjidhjes me të cilën të dyja palët do të ndjehen fituese, në vend që njëra të ndjehet humbëse.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Nxënësit ndahen në çifte. Pjesa e mesme e hapësirës së tyre lirohet që të ketë më shumë hapësirë për lëvizje. Secilit çift i jepet nga një balonë e cila fryhet dhe pastaj vendoset ndërmjet personave derisa ata e prekin me ballë. Në atë pozitë fillojë të lëvizin me ritmin e muzikës që lëshohet nga kasetofoni/kompjuteri ose nga diçka tjetër, duke u përpjekur që mos t’u bie balona. Çiftit që i bie balona del nga loja.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA II-7.3: POZICIONE DHE NEVOJA

MATERIALET

- Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Mbretëria e kafshëve
- Shkumës dhe tabelë/flip çart (ose pajisje adekuate për të shkruar)
- Pajisje për të shkruar
- Fletë pune për nxënësit: Pozicione dhe nevoja 1
- Fletë pune për nxënësit: Pozicione dhe nevoja 2
- Fletë pune për nxënësit: Pozicione dhe nevoja 3
- Fletë pune për nxënësit: Pozicione dhe nevoja 4
- Fletë pune për nxënësit: Pozicione dhe nevoja 5



AKTIVITETI HYRËS

Nxënësit ulen në rreth. Secili e thotë për vete nga një fjali në të cilën tregohet se çka do të dëshironin të arrijnë ata në vitin e ardhshëm dhe çka do të fitonin me arritjen e asaj që kanë zgjedhur ta thonë. Për shembull: Dëshiroj të ngjitem në Pelister. Kjo do të më bënte të ndjehem i vyeshëm dhe i fuqishëm.

AKTIVITETI KRYESOR 1

Fëmijët ulen në rreth. Arsimitarja kërkon nga fëmijët që të prodhojnë ide (sipas rregullës *stuhi idesh*) në temën për çka mund të kërkojnë fëmijët t'u blihet çokollatë e tipit *Mbretëria e kafshëve*.

Arsimitarja i shënon idetë në tabelë. Prodhimi i ideve patjetër duhet të zgjatë së paku derisa të paraqiten në tabelë këto dy nevoja: ngrënia dhe mbledhja e fotografive. Pastaj arsimtarja e lexon situatën e fletës së punës për arsimtarin/arsimtare, e pastaj kërkon nga të gjithë fëmijët që të gjejnë zgjidhje që do t'i kënaqte të dy fëmijët: edhe vëllain që ha çokollatë, por edhe motrën që mbledhë fotografi. Zgjidhja shkruhet në tabelën e murit.

DISKUTIM 1

1. Çka mendonte nëna, pse vëllai dhe motra kërkojnë çokollatë?
2. A ka vepruar drejt nëna kur e ka ndarë çokollatën në dy pjesë?
3. Si është dashur të veprojë nëna që ta zbulojë se çka kanë dashur ata dy në të vërtetë?
4. Çka ndodhë ku vetëm grindemi për diçka, pa thënë se na duhet diçka e tillë?



PËRFUNDIM

Që të mund të zgjidhet konflikti me sukses, duhet të dihet se çka dëshirojnë në të vërtetë palët kur i shprehin kërkesat e tyre – cili është shkaku që qëndron pas kërkesave të tyre. Shkaku për shprehjen e kërkesës më së shpeshti është ndonjë nevoja, e cila duhet të përmbushet që të mund të ndjehen të dyja palët të kënaqura nga zgjidhja.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Fëmijët ndahen në grupe me 4-5 vetë. Secilit grup i jepet nga një version i fletës së punës për nxënësit “Pozicione dhe nevoja” me detyrë që së pari ta lexojnë situatën që e ilustron konflikti e pastaj të plotësojnë në këtë mënyrë:

“Në një vend adekuat të tabelës së parë shkruani se çka ka dashur njëra palë e çka ka dashur pala tjetër. Nën atë shkruani çka mendoni, cilat do të ishin shkaqet, gjegjësisht nevojat, për shkakun e të cilave e kanë dashur pikërisht atë.”

Grupet e prezantojnë rastin e tyre një nga një me atë që së pari e lexojnë situatën e dhënë, e pastaj tregojnë se çka kanë shkruar se dëshiron njëra palë, e çka dëshiron pala tjetër, ndërsa arsimtarja shkruan një flip çart për secilin grup veçmas – në tabelë të njëjtë ashtu siç është në fletën e punës për nxënës.

Pastaj po ashtu njëri pas tjetrit i prezantojnë edhe nevojat (shkaqet pse e duan atë). Arsimtarja i shkruan në flip-çart.

Grupet vazhdojnë ta plotësojnë fletën e tyre të punës, duke e përcjellë këtë udhëzim:

“Tash do ta plotësojmë tabelën e dytë. Së pari do të zgjidhni një nevojë të njëres palë dhe një nevojë të palës tjetër dhe ato do t’i



Pas 15 minutave aktiviteti ndërpritet. Secili grup i lexon nevojat që i ka zgjedhur dhe zgjidhjet që i ka ofruar për përmbushjen e nevojave të të dyve.

DISKUTIM 2

1. A e kishit vështirë të mendoni zgjidhje që mund t’i plotësonin nevojat e të dyja palëve? Pse?
2. Çka do të ndodhte nëse plotësoheshin nevojat vetëm të njëres palë? A do të zgjidhej konflikti përgjithmonë?
3. Si do të ishin raportet ndërmjet palëve nëse përmbushet nevoja vetëm e njëres palë? Si do të ndjehej pala humbëse?
4. Çfarë ndjenjash mbizotërojnë kur zgjidhja i përmbush nevojat e të dyja palëve. Si do të jenë marrëdhëniet e ardhshme në atë rast?

PËRFUNDIM

Përmbushja e nevojave të të dyja palëve është zgjidhje e tipit “fitore-fitore” – të dyja palët e shohin veten si fitues. Te ata dominojnë ndjenja të këndshme dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre në të ardhmen mund të jenë edhe të përmirësuar.

Si zgjidhje më të mirë për këtë do të llogaritet që vetë palët në konflikt do të përcaktohen për të (e jo dikush i tretë), varësisht nga ajo që më së miri i përmbush nevojat e tyre.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja II-7.3: Pozicione dhe nevoja**Fletë pune për arsimtarin/arsimtaren:****MBRETËRIA E KAFSHËVE**

Vëllai dhe motra e hapin sirtarin përnjëherë dhe duan ta marrin çokollatën e fundit që ka mbetur *Mbretëria e kafshëve*. Vëllai thotë: “Unë e dua çokollatën!” dhe e merr. Motra thotë: “Unë e dua çokollatën!” dhe përpiqet t’ia marrë vëllait të saj nga dora. “Unë e dua, unë dua!” i bërtasin njëri-tjetrit të hidhëruar dhe kështu fillon lufta për çokollatë.


Duke e dëgjuar zhurmën, në dhomë hyn nëna dhe u drejtohet të dyve: “Më shkatërruat ju dy, si grindeni gjithë kohës!” ua merr çokollatën dhe ashtu të mbështjellë e thyen përgjysmë, e shqyen mbështjellësen dhe të dyve ua jep nga një gjysmë. Pastaj u thotë: “Nëse ju shoh edhe një herë të grindeni, do t’jua marr dhe vetë do ta hajë, e ju do të mbeteni pa asgjë!”.

Vëllai dhe motra shikohen mes vete me hidhërim dhe përnjëherë e hedhin gjysmën e tyre në koshin e mbeturinave dhe në mënyrë demonstrative dalin nga dhoma. Vëllai është ofenduar, sepse një gjysmë çokollate aq e vogël qumështi nuk i mjaftonte që të ëmbëlsohet, ndërsa motra u tërbua, sepse fotografia e çokollatës që ajo e donte për album, nëna ia shqeu duke e ndarë çokollatën përgjysmë.

PUNËTORIA II-7.4: STUHI IDESH PËR ZGJIDHEN E KONFLIKTEVE

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Konflikti rreth atleteve
- Fletë pune për nxënësit: Rregullat për “stuhi idesh”
- Shkumës dhe tabelë
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI KRYESOR 1

Arsimtari i prin aktivitetit “stuhi idesh” me të cilin duhet të arrihet zgjidhja e këtij konflikti:

Në një fushë sporti në të cilën ka vetëm një kosh vijnë të luajnë basket dy grupe të fëmijëve të dy shkollave të ndryshme. Në të dyja grupet janë nga gjashtë vetë. Konflikti është krijuar nga shkaku se të dyja grupet dëshirojnë të luajnë aty në dy orët e ardhshme.

Çka do t’u ofronim si zgjidhje të mundshme për këtë konflikt?

Realizuesi i shkruan të gjitha idetë në tabelë, duke mbajtur llogari që të respektohen të gjitha rregullat “e stuhisë së ideve”; shkruhet gjithçka dhe asgjë nuk komentohet.

Pas shterjes së propozimeve, të gjithë bashkërisht merren vesh se cila është zgjidhja më e mirë, që do t’i kënaqte të dyja palët.

DISKUTIM 1

1. Cila/cilat zgjidhje do t’i kënaqnin të dyja palët përnjëherë?
2. Sikur të ishit ju anëtar i njërit apo grupit tjetër, cila nga zgjidhjet e ofruara do të ishte më e qëlluar?
3. Sa ndihmoi “stuhia e ideve” që të arrihet deri te zgjidhja? Pse? Si?

PËRFUNDIM

Me “stuhinë e ideve” arrihen shumë ide të ndryshme, ashtu që pastaj është lehtë të zgjidhen një ose dy gjëra që më së miri i përmbushin interesat/nevojat e të dyja palëve.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Nxënësit ndahen në grupe të vogla me nga 3-5 nxënës. Secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënës “Konflikti rreth atleteve”, në të cilën është përshkruar shkurtimisht një konflikt rreth blerjes së atleteve, si dhe nga një kopje e fletës së punës “Rregullat për stuhi idesh”. Detyra e grupit është që, duke iu përmbajtur rregullave të teknikës “stuhi idesh” të arrijë në sa më shumë ide që mund të ndihmojnë në zgjidhjen e konfliktit. Pasi t’i shterin të gjitha idetë, grupi duhet të zgjidhë atë ide (ose ato ide) që konsideron se i përmbush nevojat e të dyja palëve në konflikt.

Pas 10 minutave grupet e prezantojnë punën e tyre. Secili grup e lexon zgjidhjen, e pastaj e lexojnë edhe listën e propozimeve të cilat janë dhënë gjatë “stuhisë së ideve” nga të cilat ka buruar zgjidhja.

DISKUTIM 2

1. A u përmbaheshit të gjithë në grupe rregullave “të stuhisë së ideve”?
2. Si arritët deri te zgjidhja?
3. Çka ishte më e vështirë? Çka ishte më lehtë?

PËRFUNDIM

Nuk është aq lehtë t’u përmbahemi rregullave “të stuhisë së ideve”, por meqë dëshirojmë të kemi sa më shumë ide dhe ato të jenë sa më të ndryshme, ato patjetër duhet të respektohen, sepse në atë mënyrë më lehtë arrihet deri te zgjidhja.

TEMA III:

UNË DHE TË TJERËT MARRËDHËNIET SHOQËRORE

Përmbajtja III-1:

NJOHJA E TË DREJTAVE THEMELORE TË NJERIUT

Pritet që nxënësi/nxënësja

Dituri	<ul style="list-style-type: none">• Të dijë për ekzistimin e të drejtave dhe lirive elementare konceptuale të njerëzve• Ta dijë se pse është krijuar koncepti i të drejtave dhe lirive elementare të njeriut• Të dijë për Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut• Të dijë për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none">• Të mund t'i njohë të drejtat elementar dhe shkeljen e tyre• Të mund të diskutojë për të drejtat dhe përgjegjësitë elementare• Të mund të reagojë në mënyrë aktive kur i rrezikohen të drejtat
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none">• Ta pranojë se të gjitha raportet ndërmjet njerëzve bazohen në konceptin e të drejtave të njeriut• Ta kuptojë rëndësinë e gjithmbarshme qytetëruese të konceptit të të drejtave të njeriut• Të dëshirojë që të drejtat të zbatohen dhe të respektohen

PUNËTORIA III-1.1: TË DREJTAT E NJERIUT – A I MERITOJMË?

MATERIALE

- Fletë e madhe e letrës në të cilën është shkruar fjalia: Meqë jam qenie njerëzore, kam të drejtë të...
- Pajisje për të shkruar
- Fletë pune për nxënësit: Testi i të drejtave të njeriut
- Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Testi i të drejtave të njeriut me përgjigje



AKTIVITETI KRYESOR 1

Nxënësit ndahen në pesë grupe, ndërsa secilit grup i jepet nga një fletë në të cilën është shkruar fjalia: Meqë jam qenie njerëzore, kam të drejtë të... Anëtarët e grupit duhet ta kryejnë fjalinë duke dhënë sa më shumë ide pa u censuruar, duke e thënë gjënë e parë që u bie ndër mend. Fletat varen në mur, ndërsa arsimtari lexon se çka është shkruar në secilën fletë.

DISKUTIM 1

1. A kishit mjaft kohë që t'i shkruani të gjitha idetë që ju bien në mend?
2. A dallohen idetë shumë nga njëra-tjetra? A ka edhe ide më të përgjithshme dhe më specifike? (për shembull: e drejta e pushimit përballë të drejtës që të kotem gjysmë orë pas dreke dhe askush të mos më zgjojë)
3. Cilat të drejta u përsëritën më shpesh? Pse?

AKTIVITETI KRYESOR 2

Nxënësit formojnë grupe të reja me nga katër anëtarë dhe secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës "Testi i të drejtave të njeriut".

Pastaj secili grup duhet të përgjigjet në test, ndërsa një anëtar i grupit duhet t'i prezantojë një nga një përgjigjet dhe t'i shpjegojë ato. Këtu mund të inkuadrohen edhe nxënësit e tjerë me plotësim ose me mendim të kundërt. Arsimtari bën koment që i referohet përgjigjes së saktë.

PËRFUNDIM

Të drejtat dhe liritë elementare janë ato të drejta dhe liri për të cilat njerëzit kanë arritur të merren vesh në nivel ndërkombëtar se ato u takojnë të gjithëve nëse dëshirojmë që një bashkësi ta quajmë bashkëkohore, civilizuese dhe demokratike. Të drejtat e njeriut mund të jenë të përkufizuara edhe si standarde elementare pa të cilat njerëzit nuk mund të jetojnë si qenie njerëzore me dinjitet. Të drejtat e njeriut paraqesin themelin e lirisë, të drejtës dhe paqes. Respektimi i tyre u mundëson individëve dhe bashkësisë që të zhvillohen në mënyrë të plotë. Në përcaktimet e të drejtave dhe lirive të njeriut është koncentruar dimensionin i gjithmbarshëm human i zhvillimit të deritanishëm të religjionit (pavarësisht nga mësimi fetar me të cilin manifestohen), filozofia, e drejta, psikologjia dhe sociologjia. Ato paraqesin shumë të përgjithshme të vlerave të arritura dhe të dëshiruara. Disa autorë i përkufizojnë të drejtat e njeriut si "principe të pranuar përgjithësisht të barazisë dhe drejtësisë", ndërsa të tjerët si "të drejta universale morale që u takojnë të gjithëve njësoj thjesht sepse janë njerëz".

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja III-1.1: Të drejtat e njeriut – a i meritojmë?**Fletë pune për arsimtarin/arsimtare:****TESTI I TË DREJTAVE TË NJERIUT ME PËRGJIGJE****Testi i të drejtave të njeriut – përgjigjet e sakta janë shënuar**

1. a. Të drejtat e njeriut janë të drejta për të cilat njerëzit janë marrë vesh në nivel ndërkombëtar.
b. Të drejtat e njeriut janë të drejta për të cilat janë marrë vesh njerëzit e një shteti.
2. a. Të drejtat e njeriut meritohen – vetëm të mirët, të dëgjueshmit dhe të bukurit mund t'i gëzojnë ato.
b. Të drejtat e njeriut nuk meritohen – ato i përkasin secilës qenie njerëzore me vetë lindjen e tij.
3. a. Të drejtat e njeriut janë ato standarde themelore që e garantojnë dinjitetin e njeriut.
b. Të drejtat e njeriut janë ato standarde themelore që e dëshmojnë dashurinë ndaj njeriut.
4. a. Të drejtat e njeriut nuk vlejnë për njerëzit që janë në burg.
b. Të drejtat e njeriut vlejnë në të gjitha kushtet (në paqe dhe në luftë).
5. a. Të drejtat e njeriut paraqesin shumë të vlerave të arritura dhe të dëshiruara.
b. të drejtat e njeriut paraqesin shumë të vlerave të arritura dhe të realizuara në secilën shoqëri.
6. a. Secili njeri është përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tij.
b. Secili njeri është përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive personale dhe për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve.

PUNËTORIA III-1.2: TË DREJTA E MIA – PËRGJEGJËSITË E MIA

MATERIALE

- Fletë punë për nxënësit: Të drejtat
- Fletë e madhe e letrës
- Letër për të shkruar
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI KRYESOR 1

Nxënësit ndahen në çifte (me përafërsisht karakteristika të njëjta fizike) dhe detyra e tyre është që të ndalen njëri përballë tjetrit, duke u prekur me majat e gishtave të këmbëve. Pastaj duhet të kapen për duar dhe gradualisht duhet të largohen me trupat e tyre, por pa u larguar me majat e gishtave. Qëllimi konsiderohet i arritur kur të dy në çift do të jenë të larguar maksimalisht me trupa dhe mbahen me duar plotësisht të shtrira duke krijuar një baraspeshë ideale.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Nxënësit ndahen në grupe me nga tre deri në pesë nxënës. Secili grup i tërheq nga tre fleta me të drejta (duhet të ketë nga të tre të drejta për secilin grup, të cilat mund të përsëriten) nga fleta e punës për nxënës “Të drejtat”. Pasi t’i tërheqin, ata do të duhet t’i konkretizojnë të drejtat në kontekst shtëpiak dhe shkollor, përkatësisht të shkruajnë se çka nënkuptojnë më saktë këto të drejta në kontekstin përkatës. Për shembull: nëse grupi e tërheq të drejtën e privatësisë, atëherë kjo në kontekst shtëpiak do të mund të nënkuptonte: të mos hymë në dhomën e fëmijëve pa trokitur në derë/të mos ua lexojmë porositë e telefonave celularë; ose në kontekst shkollor: të mos u kontrollohet çanta shkollore pa leje/të mos kërkohet shpjegim publik i shkaqeve për mungesën e nxënësit etj.

Pasi të përfundojnë, pastaj për secilën situatë të konkretizuar duhet ta shkruajnë edhe sjelljen e tyre që do të paraqiste përgjegjësi ndaj të tjerëve.

Për shembull: nuk guxoj të hulumtoj nëpër vrimën e çelësit të dhomës tjetër ose nuk guxoj të paraqitem kur cingëron një telefon i huaj etj.

Pasi të jenë gati të gjithë, nga një nxënës i secilit grup e prezanton punën e grupit duke lexuar nga një të drejtë, ndërsa grupet e tjera që kanë shkruar për të drejtën e njëjtë e plotësojnë atë.

DISKUTIM 2

1. A mund të konkretizohet e drejta e njëjtë në mënyra të ndryshme?
2. Në cilin kontekst e kishit më lehtë t’i konkretizoni të drejtat: në kontekst shkollor apo shtëpiak? Pse?
3. A kishit lehtë apo vështirë të mendoni përgjegjësi përkatëse për secilën të drejtë? Pse?
4. Si i kundrojmë përgjegjësitë tona e si përgjegjësitë e tjetrit?
5. Pse themi se shteti është përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive elementare? Çka do të thotë kjo?



PËRFUNDIM

Të drejtat nënkuptojnë përgjegjësi për ne në zbatimin e tyre. Kjo do të thotë se ne duhet t’i dimë, t’i praktikojmë dhe të marrim pjesë në mënyrë aktive kur ato të jenë të rrezikuara ose të cenuara, si dhe në mbrojtjen e të drejta dhe lirive të të tjerëve. Përgjegjësi do të thotë edhe vendosje e kufirit të të drejtave dhe lirive tona – një ndarje që lëviz nëpër vizën e realizimit të

të drejtave dhe lirive të njerëzve të tjerë. Shteti, si nënshkrues i Konventës mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe konventave të tjera ndërkombëtare ka marrë përsipër të krijojë mekanizma dhe mekanizma me të cilët do të mundësojë zbatimin e të drejtave dhe lirive elementare dhe të mekanizmave për mbrojtjen e tyre dhe sanksionimin e shkeljeve.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Nxënësit qëndrojnë në rreth, ndërsa një nxënës (vullnetar) duhet “t’i përshëndetë” të tjerët duke thënë “Në rregull” ose “Mirë”, ndërsa gjithë të tjerët duhet t’ia kthejnë me “Mirë” ose “Në rregull” ose “Në rregull” (nëse ka thënë “Mirë”). Kjo do të thotë se nëse dikush thënë “përshëndet” në një mënyrë, të tjerët duhet t’ia kthejnë në një mënyrë tjetër. Udhëheqësi i aktivitetit nuk është e thënë që vazhdimisht t’i thotë “përshëndetjet” një pas një, por edhe t’i përsërisë ndonjëherë, ndërsa tempin e përshëndetjes duhet ta shpejtojë vazhdimisht që loja të jetë argëtuese dhe të ndodhin më shumë gabime në “të përshëndetur”.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PËRFUNDIM

Të drejtat dhe liritë e njeriut janë pjesë e jetës sonë të përditshme, të komunikimit me të tjerët dhe të zgjidhjes së situatave konfliktuozë në të cilat ndeshemi. Kufiri i të drejtave dhe lirive të secilit individ janë të drejtat dhe liritë e individit tjetër. Mosrespektimi i të drejtave dhe lirive të të tjerëve qëndron në bazën e shumë konflikteve. Në zbatimin e të drejtave dhe lirive të njeriut patjetër duhet të vendoset baraspeshë ndërmjet dobive të individit dhe të shoqërisë. Në bazën e të drejtave dhe lirive të njeriut qëndron nevoja e përmbushjes së nevojave dhe interesave të sa më shumë njerëzve dhe roli i shtetit në ato situata është që të sigurojë kushte (përmes ligjeve të caktuara, sanksioneve, rregulloreve) për zbatimin e tyre.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth. Qëllimi i aktivitetit është që ata të përcjellin impuls duke i rrahur shuplakat e duarve. Fillon një nxënës që i rrah duart e pastaj vazhdon menjëherë nxënësi që është në anën e tij të djathtë, pastaj ai që është në të djathtën e këtij të dytit e kështu me radhë derisa ky impuls me duartrokitje të përcillet te të gjithë nxënësit në rreth dhe të kthehet përsëri te nxënësi i parë. Aktiviteti mund të përsëritet më shumë herë derisa të arrihet një zinxhir i pandërprerë i duartrokitjeve.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja III-1.3: Mbajtja e detyrueshme e rripit


Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: INFORMACION PËR TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË

Ka shumë situata në të cilat të drejtat dhe përgjegjësitë e njerëzve të ndryshëm vijnë në konflikt mes vete. Për shembull, në disa vende ekziston një ligj sipas të cilit është e detyrueshme mbajtja e rripit në veturë. Shumë njerëz e kundërshtojnë këtë ligj, duke e arsyetuar se kjo do të thotë kufizim i të drejtës së tyre për të vepruar lirshëm. Qeveritë e këtyre vendeve shpjegojnë se njerëzit që vozisin veturë kanë përgjegjësi ndaj spitaleve, mjekëve dhe pjesës tjetër të shoqërisë që të bëjnë gjithçka munden që t'i shmangin lëndimet gjatë vozitjes. Nëse njerëzit nuk mbajnë rrip gjatë vozitjes dhe lëndohen, ata marrin kohë, të holla dhe vend nëpër spitale nga njerëzit e sëmurë, me çka e kufizojnë të drejtën e tyre për mbrojtje shëndetësore.

PUNËTORIA III-1.4: RREGULLA PËR TË GJITHË NJERËZIT NË BOTË

MATERIALE

- Fletë e madhe e letrës
- Fllomaster
- Fletë punë për nxënësit: Bingo për të drejtat e njeriut
- Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Informacione për Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut
- Fletë punë për nxënësit: Nene të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë qëndrojnë në një hapësirë të zbrazët dhe secilit i jepet nga një kopje e fletës së punës “Bingo për të drejtat e njeriut” dhe laps. Nxënësit duhet të lëvizin nëpër hapësirë, të përpiqen që ndërmjet të gjejnë nxënës të tjerë që i dinë përgjigjet e bingos. Kur ta gjejnë nxënësin që e di përgjigjen e ndonjë fushe të bingos, ai nxënës duhet ta shënojë përgjigjen dhe të nënshkruhet në fushën përkatëse të fletës së nxënësit që e kërkon nënshkrim. Pastaj duhet të vazhdojnë më tej, duke kërkuar një nxënës të ri i cili do ta dijë ndonjë pyetje tjetër kur ta gjejnë atë, ai nxënës duhet të ta plotësojë fushën përkatëse sipas po këtij principi. Një nxënës mund të përgjigjet dhe nënshkruhet vetëm në një pyetje të një nxënësi. Loja vazhdon derisa të gjenden së paku tre-katër nxënës që kanë përgjigje në të gjithë pyetjet.

AKTIVITETI KRYESOR 1

Arsimtarja i ndan nxënësit në grupe me nga katër vetë dhe secili i grup i tërheq nga tre fleta të prera nga fleta e punës për nxënës “Nene të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut”. Pastaj secili e ka për detyrë të përcaktojë se ku, kur, në çfarë situatash dhe ndaj cilave grupe të vendit tonë dhe/ose të botës ndeshet cenimi i të drejtave të dhëna dhe atë ta shkruajë në fletë e madhe e letrës. Pastaj nga një nxënës i secilit grup e prezanton punën e grupit.

DISKUTIM 1

1. A mundët të gjeni situata të shkeljes për të gjitha situatat që i tërhoqët?
2. A ka ndonjë të drejtë për të cilën nuk keni dëgjuar se ka ose ka pasur shkelje?
3. Cilat ishin më lehtë të gjenden e cilat më vështirë? Pse?
4. Ku ndodhin shkeljet e të drejtave të njeriut? Vetëm në disa shtete apo gjithkund?
5. A mund të ndihmojnë në pengimin e shkeljes së të drejtave të njeriut disa dokumente që u referohen të drejtave dhe principeve elementare të sjelljes së njerëzve në gjithë botën?
6. A keni dëgjuar për Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut?



PËRFUNDIM

Procesi i krijimit të shoqërisë në të cilën nuk do të ketë shkelje të të drejtave të njeriut ose ku shkeljet do të jenë të thjeshtuara në minimum është i ngadalshëm dhe afatgjatë. Shkeljet e të drejtave të njeriut në masë më të madhe a më të vogël kanë ndodhur në të gjitha vendet në një periudhë të caktuar të ekzistimit të tyre. Ekzistimi i disa dokumenteve që u referohen principeve themelore të sjelljes së njerëzve në gjithë botën mund të ndihmojë në pengimin e shkeljes së të drejtave të njeriut.

Ekziston një dokument ndërkombëtar i cili i përmban principet themelore të sjelljes së njerëzve në gjithë botën - Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Ajo është një marrëveshje e pranuar gjerësisht për të drejtat e njeriut në botë. Deklarata është miratuar në vitin 1948. Në të janë vendosur të drejtat dhe liritë elementare që i referohen secilit njeri në botë. Deklarata Universale është fryt i punës disavjeçare të personave profesionistë të fushave të ndryshme dhe përfshin të drejta që personat profesionistë i kanë përcaktuar se janë shkelur ose janë rrezikuar në situata të ndryshme të luftës dhe të paqes.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA III-1.5: KONVENTA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT**MATERIALE**

- Fletë pune për arsimtarin/arsimtares: Informacione për Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Elementare të Njeriut
- Fletë punë për nxënësit: Version i shkurtuar i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)
- Zarfe
- Fletë më të mëdha të letrës
- Pajisje për të shkruar

**AKTIVITETI KRYESOR**

Secilit nxënësi i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënësin “Version i shkurtuar i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)” të prerë në pjesë (një pjesë – një nen) të vendosur në zarf. Detyra e nxënësve është që t’i shqyrtojnë nenet e KEDNJ dhe t’i zgjedhin gjashtë të drejta që në atë moment janë më të rëndësishme dhe ato t’i radhisin. Në një fletë të veçantë duhet t’i shkruajnë numrat e neneve të të drejtave të zgjedhura.

Pastaj nxënësit grupohen në katërshe dhe secili katërsh e merr nga një detyrë të veçantë. Përsëri do të duhet të zgjidhen gjashtë të drejta më të rëndësishme, por tash në situata të ndryshme:

1. Grupi 1 – në situatë të luftës
2. Grupi 2 – në kushte të varfërisë ekstreme
3. Grupi 3 – kur pushtetin në vend e ka një qeveri jodemokratike (totalitare)
4. Grupi 4 – në kushte të katastrofës natyrore me përmasa të mëdha

Pasi të përfundojnë, në kuadër të grupeve të formuara secili i krahason këto të dhëna me zgjedhjen e tyre individuale. Pastaj i shkruajnë ato në fletë të letrës dhe nga një përfaqësues i secilit grup e prezanton zgjedhjen dhe radhitjen e grupit, duke e shoqëruar këtë edhe me një shpjegim të shkurtër.

**DISKUTIM**

1. A kishte dallime në zgjedhjen e parë individuale që e bëtë në raport me grupet? Ku ishin dallimet kryesore?
2. Çfarë dallime kishte mes grupeve?
3. Pse ishin ato dallime?
4. A ishte lehtë të arrihet pajtueshmëri rreth zgjedhjes së të drejtave?
5. A ekzistojnë të drejta më shumë a më pak të rëndësishme? Nga çka varet se cilat të drejta do të përjetohen si më të rëndësishme?
6. Çka është Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut? Në çka vërehet dallimi ndërmjet Deklaratës për të Drejtat e Njeriut dhe Konventës?

PËRFUNDIM

Të gjitha të drejtat janë të rëndësishme, ndërsa se cilat do të perceptohen dhe trajtohen si më të rëndësishme, kjo varet nga konteksti aktual. Nuk është krejt lehtë të vendoset se cilat të drejta duhet të kenë në një moment përparësi. Harmonizimi kërkon bisedim dhe matje precize të nevojave më të rrezikuara të personave konkretë. Qeveritë e vendeve anëtare të Këshillit të Evropës e kanë miratuar Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, me çka i kanë

bërë hapat e parë për zbatimin e shumë të drejtave që janë përfshirë në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Kjo konventë është e rëndësishme sepse për herë të parë është miratuara një marrëveshje ndërkombëtare për të drejtat e njeriut me një mekanizëm konkret për mbrojtje, i cili ishte i hapur për ratifikim nga vendet anëtarë të Këshillit të Evropës. Konventa është e rëndësishme edhe për shkak se u shërben parlamenteve dhe gjykatave në vende të caktuara si bazë për miratimin dhe interpretimin e ligjeve në lidhje me të drejtat e njeriut. Deklarata nuk është dokument ndërkombëtar obligues, ndërsa konventa krijohet pas ratifikimit nga shteti përkatës. Me ratifikimin e konventës, shteti merr përsipër që gjithë ligjësinë e vet ta harmonizojë me konventën dhe në rast të kontestit ndërmjet ligjeve nacionale dhe Konventës, t'u referohet dhe t'i respektojë para së gjithash nenet dhe parimet e Konventës.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth, ndërsa njëri prej tyre fillon t'i pëshpëritë atij që e ka në atë majtë një të drejtë nga KEDNJ. Sipas principit të lojës “Telefoni i prishur” e drejta përcillet nga veshi në vesh dhe kur arrin te nxënësi i gjashtë, ndërpritet dhe kërkohet prej tij që ai ta thotë me zë atë që e ka dëgjuar. Loja vazhdon prej atij e tutje.

REFLEKTIM


1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA III-1.6: VEPRA DHE DËNIME

MATERIALE

- Topa të vegjël të butë
- Fletë punë për nxënësit: Propozime për vepra dhe dënime
- Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Vepra dhe dënime
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI HYRËS

Nxënësit qëndrojnë në dy rrahë (secilin me gjysmën e nxënësve) të kthyer kah njëri-tjetri. Arsimtarja që qëndron në njërin rresht fillon me dhënien e topit për nxënësin e parë në rreshtin përballë saj, duke e theksuar njëherazi edhe emrin e tij. Pastaj ai nxënës ia jep topin nxënësit që është pranë arsimtares, duke e theksuar po ashtu emrin e atij. Ky princip i dhënies përsëritet derisa topi të arrijë në fund të rreshtave, nga njëri nxënës te tjetri sipas radhitjes së nxënësve. Si të arrijë në fund, topi kthehet prapa, sipas principit të njëjtë, me atë që kësaj radhe ndryshon ai që e jep me atë që e merr.

Nxënësit zhvendosen nga ato vende, por përsëri i formojnë dy rreshta dhe, sipas principit të njëjtë, loja fillon në mënyrën e njëjtë, por tash arsimtarja fut në lojë edhe topa të tjerë. Kur t'i kalojë topi i parë disa fëmijë, arsimtarja e fut edhe një top të ri duke e theksuar emrin e tij sipas radhitjes së shembullit paraprak. Arsimtarja mund ta komplikojë lojën duke futur edhe nga dy topa varësisht nga madhësia e grupit.

AKTIVITETI KRYESOR

Secilit fëmijë i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënës “Propozime për vepra dhe dënime” në të cilën janë shkruar gjashtë propozime të mundshme gjatë kundërvajtjeve të caktuara dhe katër kundërvajtje për të cilat vetë fëmijët duhet të mendojnë dënim adekuat.

Secili fëmijë përgjigjet individualisht në pyetjet se a i përgjigjet dënimi veprës (fëmijët duhet ta shkruajnë shkronjën e dënimit përkatës nën numrin e veprës), ndërsa në vendin e zbrazët ta shtojnë propozimin e tyre. Pastaj formohen grupe me nga katër fëmijë të cilët bashkërisht në grupe do të duhet t'i lexojnë përgjigjet dhe të harmonizohen në raport me propozimet e dënimeve që i kanë shkruar vetë.

Pasi të përfundojnë, arsimtarja i lexon pyetje pas pyetje dhe nga një nxënës i secili grup e lexon variantin që e kanë fëmijët, e pastaj arsimtarja e lexon përgjigjen e saktë nga fleta e punës për arsimtarin/arsimtare (për veprat për të cilat është parashikuar diçka e tillë).

Pastaj lexohet propozimet e fëmijëve për dënime ndaj veprave për të cilat është dhënë dënimi.

DISKUTIM

1. Çka mendoni për dënimet e propozuara?
2. A keni ndonjë propozim tjetër?
3. A është më mirë që fëmija të shkojë në burg, në shtëpi për mirësimi apo t'i shqiptohet një dënim i këtillë? Pse?
4. A duhet të ketë lidhje dënimi me kundërvajtjen që e ka bërë fëmija apo për të gjitha kundërvajtjet duhet të vlejë dënimi i njëjtë? Pse?
5. Si nuk duhet të jenë dënimet për fëmijë? Pse?



PËRFUNDIM

Fëmija që e ka thyer ligjin ka të drejtë të procedurës që të do krijojë kushte për kthim sa më të shpejtë dhe më të thjeshtë dhe përshtatje me jetën normale. Në vend që fëmija të dënohet me qëndrim në burg ose në shtëpi përmirësuese, më mirë është të formulohen sanksione alternative që do të zbatohet për thyerjen e ligjit nga të miturit. Sanksionet duhet të jenë në lidhje të drejtpërdrejtë me veprën e kryer dhe duhet të paraqesin pasojë logjike që do të shpijë në zvogëlimin e dëmeve të veprës dhe mundësi për qasje te fëmija për veprimin e tij të parregullt. Interesi dhe e mira e fëmijës janë element i rëndësishëm për të cilin duhet të mbahet llogari gjatë përcaktimit të sanksionit bashkë me peshën e veprës së kryer. Në asnjë moment nuk lejohet të veprohet me fëmijën në mënyrë që e lëndon dinjitetin e tij ose që e rrezikon jetën ose shëndetin e tij. Patjetër duhet të kihet parasysh se fëmijët janë persona në zhvillim, të cilëve u ndodhë shpesh të gabojnë dhe se duhet të kemi qasje pozitive ndaj mundësisë që të përmirësohen dhe të ndërtohen në personalitete që do t'i respektojnë ligjet.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja III-1.6: Vepra dhe dënime

Fletë pune për arsimtarin/arsimtare:

VEPRAT DHE DËNIMET

Veprat dhe dënimet

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
B	C	A	D	Ç					

Përmbajtja III-2:

**RESPEKTIMI I TË TJERËVE
(MOSDISKRIMINIMI)**

Pritet që nxënësi/nxënësja

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • Ta dijë se ekzistojnë dallime ndërmjet njerëzve (racore, gjinore, etnike, religjioze, politike, sociale, statusore etj.) • Ta dijë se çka janë stereotipat • Ta dijë se çka janë paragjykimet • T'i dijë bazat e ndryshme të mundshme të diskriminimit • T'i dijë pasojat e diskriminimit ndaj individëve dhe bashkësisë
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mund ta dallojë praninë e stereotipave dhe paragjykimeve • Të mund t'i kundërshtojë aktivisht stereotipat dhe paragjykimet e përditshmërisë • Të mund t'i kundërshtojë aktivisht format e ndryshme të diskriminimit
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Ta kuptojë negativitetin e stereotipave dhe paragjykimeve • Ta kuptojë se çfarë pasojash mund të ketë diskriminimi në realizimin e të drejtave të njerëzve • Ta miratojë dhe ta pranojë kundërshtimin aktiv të diskriminimit

PUNËTORIA III-2.1: DETYRA JOSTEREOTIPE

MATERIALE

- Letër për të shkruar
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI KRYESOR 1

Nxënësit e luajnë lojën e njohur të asociacioneve. Së pari ndahen në grupe me nga katër vetë, e pastaj në kuadër të grupit ndahen në çifte. Çiftet garojnë në atë se cili çift do ta qëllojë më shpejt fjalën e dhënë nga arsimtarja në bazë të asociacioneve. Njërit anëtar të çiftit i jepet fjala që duhet ta qëllojnë (arsimtarja ua pëshpërit në vesh), e pastaj një nga një me asociacion të një fjale mundohen ta përkujtojnë partnerin e tyre. Në secilin rreth të ardhshëm ata që asociojnë mund të përdorin edhe fjalë të reja që ta asociojnë atë fjalë që ua ka thënë arsimtarja. Fjalët që duhet të përdoren në lojë duhet të jenë përshkrime ose tipare të fjalës së dhënë për asociim. Loja mbaron ku njëri çift do ta qëllojë fjalën. Pastaj dy të tjerëve të çiftit u jepet një fjalë e re dhe loja vazhdon derisa të qëllohet fjala e re.

FJALË

FËMIJË
GJYSHE
GRUA
POLIC
AKTORE
ARSIMTAR



DISKUTIM1

1. Si ndjeheshit kur ia qëlloni? A ishte lehtë apo vështirë?
2. Sa tregojnë fjalët që i përdorët për ta qëlluar fjalën e kërkuar për qasjen e përgjithësuar, të zakonshme dhe të thjeshtësuar të nocionit që kërkohej?
3. A u referohen ato fjalë disa personave individualisht apo u përkasin grupeve të caktuara?
4. Sa janë të sakta ato karakteristika?
5. Sa u referohen ato të gjithë anëtarëve të grupit përkatës?
6. A e dini si quhen ato karakteristika të sakta që ua përshkruajmë të gjithë anëtarëve të një grupi të caktuar edhe pse ato nuk vlejnë për të gjithë dhe zakonisht nuk janë të sakta?

PËRFUNDIM

Rëndom më lehtë është të qëllohet kur përdoren fjalë që asociojnë në stereotipat e nocionit, sepse ato janë shumë të shpërndara dhe janë të njohur për të gjithë.

Stereotipat paraqesin pohime më të thjeshta, pa bazë logjike dhe janë pjesërisht të sakta për të gjithë pjesëmarrësit e një grupi. Ato kryesisht janë gabim, sepse nuk e marrin parasysh llojllojshmërinë dhe individualitetin e individëve që i përkasin një grupi konkret.

AKTIVITETI KRYESOR 2¹

Duke qenë të ndarë në grupe të njëjta nxënësit duhet t'i shkruajnë nga pesë detyra matematikore në të cilat do të prezantohen së paku dy persona që bëjnë diçka. Për shembull: Ogneni i bleu

1 Ideja për aktivitetin është marrë nga: Schniedewind, N. and Davidson, E. (1983) Open Minds to Equality. Massachusetts, USA: Allyn and Bacon A Division of Simon & Schuster, Inc,

në treg 3 kg molla me çmim prej 30 den. për kg. Prej këtyre mollëve bashkë me shoqen e tij Rinën i bënë 60 kulaçe ëmbëlsira...

Pastaj secili grup ia jep detyrat e veta grupit që është në anë të majtë nga ai që ai t'i zgjidhë. Detyrat duhet të jenë të lehta që të mund të zgjidhen për një kohë të shkurtër.

DISKUTIM 2

1. Cilët persona ishin përmendur në detyrat tuaja matematikore?
2. A kishte dallime sipas moshës, gjinisë dhe përkatësisë etnike?
3. Në çarë rolesh ishin paraqitur ata?
4. A ishin paraqitur në role të zakonshme, të thjeshta dhe të papersonalizuara?
5. A ishin paraqitur kryesisht në role stereotipash?
6. A kishte grupe që nuk ishin përfshirë aspak?
7. Pse ndodhi kjo? Si i fitojmë ne stereotipat?
8. Si ndikonte ekspozimi i përditshëm jonë ndaj stereotipave dhe paragjytimeve të llojeve të ndryshme ndaj kryerjes së detyrave matematikore?



PËRFUNDIM

Nën ndikim të mediave, librave shkollorë, komunikimit të përditshëm me moshatarët dhe edukimit në mënyrë të pavetëdijshme ne përvetësojmë stereotipa dhe pa u kushtuar shumë kujdes vazhdojmë t'i përcjellim më tej përmes sjelljes dhe veprimit tonë. Në të folurit e përditshëm gjatë përshkrimit të individëve të grupeve të caktuara shumë shpesh i paraqesim ata në role stereotipash që zakonisht janë role të zakonshme, të thjeshta dhe të papersonalizuara.

AKTIVITETI KRYESOR 3

Secilit grup i jepen prapa detyrat origjinale që i ka bërë tash dhe kërkohet prej tij që t'i përpunojë dhe të inkuadrojë përfaqësues të grupeve të ndryshme (etnike, të moshës, gjinore...) e pastaj ato t'i prezantojë në role jo të stereotipizuara.

Në fund secili grup e lexon nga një detyrë të punuar, ndërsa të tjerët e shpërblejnë me duartrokitje.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA III-2.2: NUK NA DUHEN GJYSHE!

MATERIALE

- Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Nuk na duhen gjyshe!



AKTIVITETI KRYESOR 1

Arsimtarja e lexon listën e pohimeve dhe kërkon nga nxënësit që duke e ngritur gishtin e madh të dorës të tregojnë se sa mendojnë që është i saktë pohimi:

- nëse mendojmë se pohimi është i vërtetë, ata duhet ta ngrenë lart gishtin e madh të njëjës dorë
- nëse nuk janë të sigurt se a është i vërtetë pohimi, ata duhet ta mbajnë gishtin e madh në pozitë horizontale;
- nëse mendojnë se pohimi aspak nuk është i vërtetë, ata duhet ta kthejnë gishtin tregues teposhtë.

Shembuj të pohimeve:

- Vajzat janë basketbolliste të dobëta.
- Djemtë për nga natyra janë më të fortë dhe më të mençur se vajzat.
- Myslimanët i kanë nga dy e më shumë gra.
- Romët janë muzikal.
- Maqedonasit janë të paqëndrueshëm.
- Tetovarët janë dorështrënguar.
- Shqiptarët i kanë nga pesë-gjashtë fëmijë.
- Njerëzit e moshuar janë të pafuqishëm.
- Të rinjtë janë agresivë

Pas secilit pohim ajo i numëron votat dhe i tregon ato me zë.

DISKUTIM 1

1. A janë të vërteta këto pohime? Për cilin prej grupit që i referohen janë të vërteta? A u referohen të gjithë individëve të grupit të përfshirë? A e njihni ndonjë vajzë që është basketbolliste e mirë? A e njihni ndonjë mysliman që e ka vetëm një grua?
2. A dini se si quhen këto pohime? A e dini se çka do të thotë fjala stereotipa?
3. Për kë ekzistojnë stereotipat?
4. A ka stereotipa vetë negativë apo ekzistojnë edhe stereotipa pozitivë për disa grupe?
5. Cilat stereotipa i dini për afro-amerikanët? E për grupet profesionale, për shembull për policët ose për arsimtarët?
6. Cilat stereotipa i dini për njerëzit e moshuar?

PËRFUNDIM

Stereotipat janë kuptime të thjeshtë dhe të vrazhda për karakteristikat e pjesëmarrësve në disa grupe sociale. Janë të thjeshta sepse janë përgjithësime të individëve për të gjitha grupet, ndërsa janë të vrazhda sepse shumë vështirë mund të ndryshojnë.

Ato kryesisht janë jo të sakta, sepse të gjithë pjesëmarrësit e një grupi nuk kanë tipare të njëjta dhe secili pjesëmarrës i një grupi nuk është e thënë të ketë tipare të caktuara vetëm sepse i

takon atij grupi. Por, ato janë edhe pjesërisht të sakta, sepse disa tipare mund t'i referohen shumicës së njerëzve të atij grupi.

Stereotipat ekzistojnë për grupe të ndryshme dhe më shpesh janë negative, por ndonjëherë janë edhe pozitive. Për shembull, stereotipa më të shpeshta për afro-amerikanët janë se ata janë vjedhës, dilerë të drogës, jo sa duhet të arsimuar (negativë), por edhe se janë sportistë dhe muzikantë të shkëlqyeshëm.

Stereotipa të zakonshëm për njerëzit moshuar janë se ata janë konservatorë, të prapambetur, të ngadalshëm, të pafuqishëm dhe jo aktivë, të orientuar vetëm për kritika ndaj të rinjve, të sëmure etj.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Arsimtarja e lexon përrallën nga fleta e punës për arsimtarin/arsimtarene “Nuk na duhen gjyshe”.

Pastaj i ndan nxënësit në pesë grupe dhe secilit grup ia jep për detyrë ta mendojë vazhdimin e përrallës dhe, pasi ta ushtrojnë, do të duhet ta prezantojnë para të tjerëve. Pas secilit prezantim të tjerët e shpërblejnë me duartrokitje grupin që ka prezantuar.



DISKUTIM 2

1. Çfarë stereotipi kishte arsimtarja Sonja për njerëzit e moshuar?
2. Për çfarë arsye ajo e ka atë stereotip?
3. Pse Edona e ka propozuar gjyshen e saj për alpinizëm? Pse Edona nuk ka pasur stereotip për njerëzit e moshuar?
4. Çka mendoni për përfundimet e ndryshme të përrallës që e prezantuat? A kishte në to korrigjim të stereotipit?
5. Si mund të veprojmë në jetën reale nëse e shohim se dikush ka ndaj dikujt paragjykime në bazë të ndonjë stereotipi?
6. Me çfarë mënyrash mund t'i luftojmë stereotipat?

PËRFUNDIM

Stereotipat krijohen nën ndikim të familjes, shkollës, shokëve, mediave.

Është me rëndësi t'i dimë stereotipat që i kemi dhe ndaj individëve të grupeve të ndryshme të veprojmë hapur, t'i njoftojmë, të shoqërohemi me ata, e jo qysh më parë të formojmë mendim për ata në bazë të përkatësisë së tyre në ndonjë grup.

Të gjithë jemi përgjegjës që të luftojmë kundër stereotipave dhe paragjykimeve që i vërejmë në vetvete dhe te të tjerët, por këtë duhet ta bëjmë në mënyrë të argumentuar duke i kundërshtuar stereotipat dhe duke u përpjekur t'i shpjegojmë karakteristikat e personit, pavarësisht nga përkatësia e tij në ndonjë grup të caktuar.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja III-2.2: Nuk na duhen gjyshe!

Fletë pune për arsimtarin/arsimtare:

NUK NA DUHEN GJYSHE!

Arsimtarja Sonja: “A i ka pyetur dikush dje prindërit e vet që të na bashkëngjiten në shëtitjen tonë nëpër mal? A ju kujtohet, na duhen së paku pesë të rritur që të mund të shkojmë?”

Ramizi: “Unë u përpoqa ta bind babanë tim që të na bashkëngjitet, por ai nuk beson se do t’ia lejojë shefi të marrë ditë të lirë.”

Jovana: “Pasi më refuzuan të dy prindërit e mi, unë iu paraqita Iles, Bojanit dhe Azrës, por edhe prindërit e tyre nuk mund të vijnë. Madje iu paraqita edhe tezes sime Joli, por ajo është e zënë – pikërisht atë ditë ka orë për mësimin e gjuhës shqipe.

Arsimtarja Sonja: “Siç duket do të kemi problem. Vërtet nuk do të dëshiroja ta anulojmë shëtitjen në mal.”

Edona: “Nëna ime është e zënë atë ditë, por gjyshja më tha se mund të vijë, madje me shumë dëshirë donte të na ndihmojë.”

Arsimtarja Sonja: “Shumë mirë, Edona, por kjo do të jetë një shëtitje e mundimshme në mal. Thuaji gjyshes tënde se ne falënderojmë për ofertën e saj, por unë vërtet nuk mendoj se do të jetë kjo shëtitje në mal që mund ta durojnë gjyshet.”

Edona: “Po, arsimtare, ju thatë se na duhen më shumë njerëz të rritur; gjysha ime do të jetë super. Ajo vërtet dëshiron shumë të shëtitet në mal.”

Arsimtarja Sonja: “Edona, pas disa muajve do të mësojmë për gatimin dhe do të jetë shumë mirë që për atë aktivitet ta pyesësh gjyshen tënde se a do të dëshironte të marrë pjesë.”

Edona: “Gjyshja ime vërtet gatuan mirë. Mund të vijë edhe atëherë edhe tash në shëtitjen në mal – jam e sigurt se asaj do t’i pëlqejë shoqërimi me klasën tonë.”

Arsimtarja Sonja: “Jo, Edona, unë mendoja të vijë të na ndihmojë në gatim, në vend që të na ndihmojë për shëtitjen në mal. Ecja nëpër mal nuk është diçka me të cilën mund të merren gjyshet. Falënderoje edhe në emrin tim, ndërsa ne do të vazhdojmë të kërkojmë prindër të tjerë..”

Marko: “Arsimtare, unë javën e kaluar ishte mysafir te Edona dhe gjyshja e saj...”

PUNËTORIA III-2.3: AUTOMEKANIKET

MATERIALE

- Limonë
- Shportëz/kuti
- Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Automekaniket
- Fletë pune për nxënësit: Rina dhe Sasho



AKTIVITETI KRYESOR 1

Arsimtari kërkon një vullnetar në klasë i cili do ta përshkruajë limonin. Ai duhet të tregojë si duket limoni dhe çfarë shije ka.

Arsimtari i vë në mes të klasës disa limonë (në vend të limonëve mund të përdoren edhe portokaj ose mandarina) dhe i ndan në mesin e pjesëmarrësve në aq grupe aq sa ka limonë (5-6). Grupi e zgjedh një përfaqësues i cili duhet ta marrë një limon dhe ta sjellë në grup. Anëtarët e grupit duhet ta shikojnë limonin, ta shohin se çfarë është dhe cilat janë tiparet e tij. Pastaj duhet t'i japin emër dhe të mendojnë ndonjë këngë të shkurtër, rimë ose përrallë për limonin e tyre. Pas disa minutave arsimtari kërkon që secili grup ta prezantojë limonin e vet para të tjerëve dhe ata ta prezantojnë atë që e kanë përgatitur. Në fund të gjithë i vendosin limonët në një shportë të përbashkët. Pastaj arsimtari i përzier dhe kërkon nga një përfaqësues prej secilit grup të vijë dhe ta gjeje limonin e grupit të tij.

DISKUTIM 1

1. Si e njohët limonin tuaj? Si e qëlluat se është pikërisht ai?
2. Si ju dukeshin limonët në fillim? A ju dukeshin të njëjtë ndërmjet vete?
3. Si ju duken tash, pasi i “njohët”?

PËRFUNDIM

Mënyra stereotipe e të menduarit na nxit të pohojmë se të gjithë anëtarët e një grupi janë të njëjtë ndërmjet vete, por kur kemi mundësi t'i takojmë dhe të t'i njoftojmë më mirë, do ta shohim se ekzistojnë shumë dallime ndërmjet tyre, se ato nuk janë të njëjtë.

AKTIVITETI KRYESOR 2¹

Arsimtari e lexon para nxënësve tekstin e fletës së punës për arsimtarin/arsimtare “Automekaniket”. Kur të ndalet teksti, arsimtari vazhdon me pyetjet e propozuara për diskutim, e pastaj e përfundon leximin e tekstit.

DISKUTIM 2

1. Çka mendoni, si do të ndjeheshit në vend të Evës?
2. Çfarë stereotipash ka ky njeri ndaj femrave?
3. Si i shfaq stereotipat e tij ndaj femrave pronari i garazhit përmes sjelljes së tij?
4. A e dini si quhen emocionet dhe qëndrimet që burojnë nga stereotipat?
5. A janë të bazuara paragjykimet në ndonjë të menduar logjik dhe përvojë konkrete apo jo?



1 Ideja për aktivitetin është marrë nga Open Minds to Equality, A sourcebook of learning activities to promote race, sex, class and age equity, Schniedewind, N. and Davidson, E. 1983 Allyn and Bacon A Division of Simon&Shuster, Inc. Massachusetts, USA

PËRFUNDIM

Stereotipat janë bindje dhe njohuri, ndërsa prej tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë burojnë paragjykimet, përkatësisht qëndrimet dhe emocionet në lidhje me stereotipin.

Paragjykimet janë qëndrime ndaj objekteve të caktuara, që janë pa bazë logjike dhe janë të përcjella me emocione të fuqishme. Ato njëlloj si stereotipat janë bindje shumë të fuqishme, që do të thotë se shumë vështirë ndryshojnë.

AKTIVITETI KRYESOR 3

Nxënësit ndahen në çifte dhe secilit çift i jepet nga një rol nga fleta e punës dhe Sasho". Detyra e tyre është që ta mendojnë vazhdimin e përrallës së aktrimit. Pastaj arsimtari kërkon vullnetarë që do t'i aktrojnë vazhdimet e

DISKUTIM 3

1. Si ju pëlqente roli i Rinës? Si ndjeheshit?
2. Si ju pëlqente roli i Sashos? Si ndjeheshit?
3. A ia dolët dhe si ia dolët që ta bindi Sashon që megjithatë ta lërë vetu
4. A dini stereotipa të tjerë për femrat?
5. Si mund t'u kundërviheni paragjykimeve që i lëndojnë njerëzit vetëm

PËRFUNDIM

Kur ballafaqohemi me stereotipa dhe paragjykime, ne ndjehemi jo mirë, m të ofenduar, madje edhe të nënçmuar. Në ato situata mund të tërhiqemi o Mund të kundërshtojmë me grindje dhe me ofendim, por edhe me shpj të zgjedhjes së bërë dhe aftësive personale.

Kur shohim se ndaj dikujt ka sjellje me paragjykime, ne mund të bisedojm shembullit personal, të dëshmojmë se jemi të hapur dhe kemi gatishmëri

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja III-2.3: Automekaniket**Fletë pune për arsimtarin/arsimtaren:
AUTOMEKANIKET**

Rina dhe Eva janë dy femra të reja që jetojnë në një qytet të vogël të Maqedonisë. Ato kanë mbaruar shkollë të mesme për automekanike dhe menjëherë pas maturës kanë filluar të punojnë si vullnetare, ndërsa më vonë edhe janë punësuar në servisin e Fordit në qytetin e tyre. Pas shtatë viteve përvojë pune dhe autoritet të shkëlqyeshëm në fushën tyre, ato kanë vendosur të hapin një servis privat për riparimin e veturave. Ato nuk kishin lokacion, por kishin kursyer mjaft të holla që ta paguajnë qiranë për disa muaj më parë. Kur u paraqit Eva në shpalljen e dhënë nga pronari i një garazhi, ai i tha se bashkëshorti i saj mund të vijë të shohë se a i pëlqen garazhi dhe të merren vesh për kushtet. Kur pas disa orëve Eva arriti te ai, pronari i garazhit u habit dhe e pyeti se ku është bashkëshorti i saj. Eva iu përgjigj se AJO dëshiron ta marrë me qira garazhin për vete dhe për kolegen e saj, ndërsa ai i qeshi para syve.

“Çka? Ti dëshiron ta marrësh garazhin me qira! Marri.”

“Shihni, unë jam automekanike dhe ja – kam para që t’jua paguaj disa muaj para kohe.”

“Shihni, zonjë, s’ka mundësi t’jua jap. Ashtu vetëm do të humb para. JU asnjëherë nuk do të mund të fitoni që ta paguani qiranë. Askush nuk do ta sjellë veturën që ta rregullojë në servis ku punojnë femra. Haj, hiqni dorë nga kjo ide! Shkoni hapni ndonjë butik ose ëmbëltore!”

Vijon diskutim 2

Eva: “Të merremi vesh kështu – unë do t’jua paguaj qiranë për tre muaj – ashtu që ju nuk do të brengoseni se po humbni para, ndërsa pas kalimit të kësaj kohe, nëse vërtet na shkon punë, do ta ripërtërijmë marrëveshjen. E nëse nuk kemi punë, ne do të ikim..”

Pronari i garazhit e kuptoi se nëse e pranon këtë propozim, nuk do të humb asgjë, andaj u pajtua. “Mirë... le të jetë ashtu. Por, nëse nuk ju shkon, mos thoni se nuk ju kam paralajmëruar.”

I mori të hollat dhe iku.

PUNËTORIA III-2.4: KUSH DO TË VIZATOJË MË BUKUR?

MATERIALE

- Kutu me fleta të përgatitura për ndarje në grupe
- Letër për të vizatuar ($\frac{1}{4}$ e fletave për $\frac{3}{4}$ fëmijëve dhe $\frac{3}{4}$ e fletave për $\frac{1}{4}$ e fëmijëve)
- Fllomasterë (për $\frac{1}{4}$ e fëmijëve fllomasterë në të gjitha ngjyrat dhe në numër të madh, për $\frac{3}{4}$ e fëmijëve vetëm disa fllomasterë në dy ngjyra)
- Fletë e madhe e bardhë
- Sellotej



AKTIVITETI KRYESOR 1

Fëmijët ndahen në dy grupe duke i përdorë fletët e përgatitura enkas për këtë qëllim ($\frac{1}{4}$ e fëmijëve dhe $\frac{3}{4}$ e fëmijëve). Ndarja patjetër duhet të bëhet me zgjedhje krejt të rastësishme (p.sh.: në kuti mund të vendosen fletë me numër përkatës të shenjave me ngjyrë të ndryshme të cilat fëmijët i tërheqin pa shikuar kur hynë në klasë).

Para se të fillojë ora, klasa ndahet në mënyrë vizuale ose fizike në dy pjesë (një pjesë e madhe – me shumë hapësirë, karrige dhe banka dhe një pjesë e vogël – me pak hapësirë, pak karrige dhe një bankë).

Në pjesën e vogël vendoset grupi më i madh, ndërsa në pjesën e madhe grupi më i vogël i nxënësve.

Në mënyrë të paqartë ndahen edhe fletat e letrës dhe fllomasterët.

Arsimtari e thekson se fëmijët nuk guxojnë ta kalojnë kufirin vizual dhe nuk guxojnë t'i japin njëri-tjetrit fllomasterë dhe letër ose t'ia marrin me dhunë njëri-tjetrit.

Pastaj kërkojnë nga fëmijët e të dyja grupeve që secili prej tyre ta vizatojë nga një lule.

Fëmijëve të grupit më të madh (nëse kujtohet vetë ata) u sugjerohet që t'i ndajnë fletët e letrës që i kanë në pjesë më të vogla që të mund të vizatojë lule secili fëmijë.

Në fund të gjitha lulet e vizatuara arsimtari i ngjet në tabelë ose në fletë të madhe të letrës.

Arsimtari i krahason shkurtimisht lulet (sipas madhësisë, sipas ngjyrës që është përdorë etj.)

DISKUTIM 1

1. Si ndjeheshin fëmijët e grupit të vogël? A u mungonte diçka që ta kryejnë detyrën në mënyrën më të mirë? A u vinte mirë atyre? Çka mendonin ata për fëmijët e grupit më të madh?
2. Si ndjeheshin fëmijët e grupit më të madh? A kishin gjithçka u nevojitej që ta kryejnë detyrën? A ndjeheshin mirë? Çka u pengonte? Çka mendonin ata për fëmijët e grupit të vogël?
3. A ishin ndarë gjërat mirë?
4. A e kishin të gjithë mundësinë e njëjtë që ta vizatojnë lulen më së miri që munden?
5. A e dini se çka është diskriminimi? Si duket të jesh i diskriminuar?
6. Në çfarë baze mund të diskriminohen fëmijët në botë?



PËRFUNDIM

Diskriminimi është veprim joadekuat me njerëzit në kushte të barabarta. Të jesh i diskriminuar kjo do të thotë të kesh trajtim të pabarabartë ndaj të tjerëve në bazë të ndonjë karakteristike të tij – sipas ngjyrës së lëkurës, gjinisë, gjuhës, përkatësisë religjioze, pasurisë, hendikepit, sëmundjes etj.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Fëmijët i marrin prapë vizatimet e tyre dhe gjithë materialin dhe tani kanë mundësi t'i vizatojnë lulet siç duan ata dhe përsëri t'i ekspozojnë.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Përmbajtja III-3:

PËRKRAHJA DHE BASHKËPUNIMI I NDËRSJELLË

Pritet që nxënësi/nxënësja

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • Ta dijë se relacionet ndryshojnë • Ta dijë se të arriturat e njerëzve janë bërë me punë ekipore • Ta dijë se çka janë grupet e lëndueshme
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mund t'i këmbejë informacionet dhe përvojat me të cilat disponon • Të mund t'i afirmojë pozitivisht të tjerët • Të mund të dallojë kur të tjerët kanë nevojë për përkrahje dhe ndihmë
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Ta pranojë bashkëpunimin dhe përkrahjen si pjesë të relacionit ndërmjet njerëzve

PUNËTORIA III-3.1: GRUPET E LËNDUESHME

MATERIALE

- Fletë punë për nxënësit: Grupet e lëndueshme
- Fletë punë për nxënësit: Grupet e palëndueshme
- Fletë punë për nxënësit: Diskriminimi pozitiv dhe negativ



AKTIVITETI KRYESOR 1

Secili fëmijë i tërheq nga njëmbëdhjetë fleta të prera nga fleta e punës për nxënësit “Grupet e lëndueshme” dhe i mban të kthyera me tekst teposhtë, ndërsa duhet të jenë të radhitura sipas numrave rendorë – letra me numër një është më lart, ndërsa ajo me numër njëmbëdhjetë është më poshtë.

MËNYRA E PËRDORIMIT TË LETRAVE TË FLETËS SË PUNËS:

Arsimtarja duhet të kopjojë numër të njëjtë të fletave të punës “Grupet e lëndueshme” dhe nga fleta e punës “Grupet e palëndueshme” që e përbëjnë numrin e përgjithshëm të nxënësve në klasë.

Pastaj duhet t’i presë të gjitha fletat dhe t’i grupojë në njëmbëdhjetë grumbuj, sipas numrin rendor të fletëve, me ç’rast në një grumbull të njëjtë do të përzihen të gjitha fletat me numër 1 të fletës së punës “Grupet e lëndueshme” dhe të gjitha letra me numër 1 të fletës së punës “Grupet e palëndueshme”. Pastaj secili nxënësi duhet ta tërheqë nga një fletë prej secilit grumbull, duke filluar nga grumbulli me numër 11, e duke lëvizur drejt grumbullit me numër 1. Fletët e tërhequra duhet t’i mbajë në dorë, të kthyera me tekst teposhtë dhe secilën fletë të ardhshme e vendos mbi fletën paraprake. Ashtu në fund të gjithë fëmijët do të kenë nga njëmbëdhjetë fleta në duar të radhitura nga 1 deri në 11.

Pastaj të gjithë duhet të ndalen njëri pranë tjetrit përgjatë një vije të drejtë të vizatuar drejt fundit të klasës. Arsimtarja i lexon letrat një nga një, ndërsa fëmijët duhet të kontrollojnë se cilën letër e kanë në dorë dhe të veprojnë sipas udhëzimit të arsimitares.

Secili fëmijë që ka në dorë letër në të cilën është dhënë grupi i lëndueshëm, duhet të qëndrojë në vendin e tij, ndërsa secili fëmijë që në letër e ka grupin e palëndueshëm duhet të shkojë nja hap përpara. Kjo procedurë përsëritet për secilën letër.

Për shembull, arsimtarja thotë: “Kthejeni letrën e parë dhe lexojeni. Të gjithë që kanë letër në të cilën shkruan GRA DHE VAJZA le të qëndrojnë në vendet e tyre, ndërsa të gjithë ata që kanë letër në të cilën shkruan MESHKUJ DHE DJEM le ta bëjnë një përpara.”

Pasi t’i lexojnë të gjitha letrat, fëmijët mbeten në pozicionet në të cilat kanë arritur dhe aty zhvillohet diskutim.

DISKUTIM

1. Si ndjeheshin ata që ecnin më shpesh një hap përpara?
2. Si ndjeheshin ata që mbeteshin prapa, përkatësisht që ecnin rrallë përpara?
3. Çka mendoni, pse disa fëmijë ecnin përpara, e disa qëndronin në vend?
4. Cilat grupe ishin shënuar në letrat e atyre që shkonin përpara, e cilat në ato letra që qëndronin në vend?
5. Çka është e përbashkët për ato grupe që mbeten në vend?
6. Si është qasja në mundësitë për zhvillim, vetërealizim dhe socializim të atyre grupeve të cilat kur i lexonit e kishit patjetër të qëndronit në vend në raport me ato që kur i lexonit shkonit një hap përpara?

7. A e keni dëgjuar shprehjen “grupet e lëndueshme”? Çka mendoni, cilave prej këtyre grupeve që përmenden në aktivitet u referohet ajo shprehje dhe pse?
8. Nëse e paramendojmë se vija nga e cila jemi nisur e paraqet pozicionin fillestar të barazisë së të gjithë njerëzve, ndërsa përkatësia në secilin grup paraqet pengesë në realizimin e potencialeve maksimale të secilit prej nesh, atëherë a do të dallohej përparimi në jetë i atyre që i takojnë atij grupi dhe i atyre që nuk i takojë një grupi të caktuar të lëndueshëm?
9. A duhet të bëjë diçka bashkësia në lidhje me çështjen e sigurimit të mundësive të barabarta për anëtarët e grupeve të lëndueshme? Çka do të mund të bënte?
10. A duhet të jetë çdoherë diskriminimi diçka negative (trajtim i pabarabartë i një grupi ose individit të caktuar për shkak të disa karakteristikave të tij negative)?
11. Çka do të thotë që dikush të jetë i diskriminuar pozitivisht?
12. Pse është me rëndësi kjo?



PËRFUNDIM

E përbashkët për ato letra me të cilat mbetet në vend është ajo se në ato ishin dhënë grupet që në periudha dhe kushte të caktuara llogariten si grupe të lëndueshme në shoqëri. Ato janë grupe të veçanta të cilat për shkaqe të ndryshme janë më të ndjeshme dhe të lëndueshme dhe kanë nevojë të kenë mbrojtje të veçantë që të kenë mundësi të njëjtë dhe në mënyrë efektive t’i përmbushin të drejtat e tyre. Ato grupe, për shkak të disa tipareve të tyre në procesin e jetës sociale, lehtë mund të bëhen viktimat të diskriminimit, andaj nevojitet angazhim i veçantë që të barazohen pozicioni i tyre fillestar në raport me qasjen ndaj të drejtave dhe mundësive të përcaktuara. Që të mbrohen të drejtat e grupeve të lëndueshme dhe të barazohen mundësitë e tyre, nuk janë të mjaftueshme vetëm barazia para ligjit dhe ndalesa e diskriminimit me ligj. Ajo që duhet të arrihet është niveli i barazisë faktike të njerëzve në realizimin e të gjitha të drejtave. Kjo e nxit nevojën për diskriminim pozitiv (ose trajtim i dedikuar i pabarabartë) të njerëzve me qëllim të arritjes së barazisë së tyre faktike në mundësisë e tyre që t’i praktikojnë të drejtat e barabarta.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Nxënësit ndahen në çifte dhe secilit çift i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënës “Diskriminimi pozitiv dhe negativ”, në të cilin duhet të vendosë se cili nga rastet e ofruara të diskriminimit është i arsyeshëm dhe i lejuar, përkatësisht pozitiv, e cili negativ.

Pastaj arsimtarja i lexon shembujt një nga një dhe kërkon nga nxënësit e çiftit që e kanë punuar atë shembull të deklarohen se a është diskriminimi pozitiv a negativ dhe të shpjegojnë se pse mendojnë ashtu. Nëse nxënësit e tjerë nuk pajtohen, ata mund ta arsyetojnë mendimin e tyre.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth me sy të mbyllur. Kur jepet shenjë nga arsimtari, të gjithë duhet t’i hapin sytë dhe ta shikojnë dikë në sy. Ata që do t’i kryqëzojnë shikimet, duhet të bërtasin shumë dhe të dalin nga loja. Kjo lojë përsëritet derisa të mbetet vetëm një çift në lojë.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA III-3.2: SHOKË E MI

MATERIALE

- Fletë për të vizatuar
- Pajisje për të shkruar
- Tabelë dhe shkumës



AKTIVITETI KRYESOR 1

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth dhe një nga një japin asociacione të fjalës SHOK, por me këtë rast nuk lejohet që asociacioni i njëjtë të përsëritet nga dy fëmijë.

DISKUTIM 1

1. Sa janë të rëndësishëm shokët në jetën tonë?
2. Pse janë aq të rëndësishëm?
3. Pse janë të nevojshëm?
4. Çfarë lloje të shokëve kemi?
5. A i kemi të gjithë shokët “shokë më të mirë”?
6. Në çfarë mënyrash mund t’i dëshmojnë shokut tonë se ai na vlen?
7. A ekzistojnë gjëra që mund t’i bëjmë vetëm me shokun? Cilat?
8. A ekzistojnë gjëra për të cilat na nevojitet ndihma ose përkrahja e shokut?



PËRFUNDIM

Gjatë jetës sonë ne shoqërohemi me shumë shokë. Ato mund të jenë moshatarë me ne, shokë të internetit, shokë të jetës etj. Ashtu si rritemi ne, ashtu rritet edhe vendi dhe roli i shokëve në jetën tonë. Shokët janë të rëndësishëm dhe të nevojshëm sepse me ata shoqërohemi, bisedojmë, kalojmë bashkërisht nëpër përvoja të ndryshme, përkrahemi dhe mbështetemi mes vete etj.

Gjatë shoqërimit ne e zgjedhin një ose dy shokë me të cilët ndjehemi mirë, të çliruar dhe te të cilët kemi besim.

Me shokët dëshmojmë se sa na vlejné ata në mënyra të ndryshme, mes tjerash edhe përmes respektimit, mbajtjes së fshehtësive, mospërqeshjes etj.

Disa gjëra nuk mund t’i bëjmë vetë – nevojiten shokë. Kur diçka nuk arrijmë ta bëjmë vetë ose kur nuk jemi të sigurt ose nuk e dimë si, ndihma e shokëve është shumë e rëndësishme.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Secili nxënës duhet t’i shkruajë emrat e shokëve të tij në një fletë letre. Pastaj duhet ta zgjedhë një nxënës të cilin e konsideron si shokun më të mirë në atë moment dhe atë e vizaton si karikaturë, duke e shkruar edhe një fjali që do ta përshkruajë atë.

Pastaj nxënësit ndahen në çifte dhe ia prezantojnë njëri-tjetrit shokët më të mirë.

Pasi të përfundojnë, arsimtari kërkon që përmes stuhisë së ideve të prodhojnë karakteristika të shokut të mirë dhe ato i shkruan në tabelë.

Pastaj nxënësit ndahen në grupe me nga katër vetë dhe secili grup duhet ta mendojë dhe ta përgatitë një situatë në të cilën do të manifestohet një tipar i shokut të mirë dhe atë duhet ta aktrojë para të tjerëve, por pa bërë fjalë. Detyra e të tjerëve është që t’ia qëllojnë se për çfarë tipari është fjala.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA III-3.3: ASHTU SI ËSHTË TE UNË – ËSHTË EDHE TE TI

MATERIALE

- Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Dy gra
- Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Parajsa dhe ferri



AKTIVITETI KRYESOR 1

Nxënësit janë ulur në rreth derisa arsimtarja e lexon përrallën “Dy gra”.

Pastaj nxënësit ndahen në grupe me nga pesë vetë me detyrë që të diskutojnë dhe të përcaktojnë se cili është mesazhi i përrallës

Pastaj secili grup e prezanton pikëpamjen e tij dhe merr përkrahje për këtë.

DISKUTIM 1

1. Pse gruas së parë nuk iu lejua të hyjë, ndërsa gruas së dytë iu lejua? Cili ishte dallimi ndërmjet dy grave?
2. A është e mundur që në një qytet të ketë vetëm njerëz të mirë apo vetëm njerëz të këqij? Pse ndonjëherë i shohim vetëm anët e mira, e ndonjëherë vetëm anët e këqija?
3. A ndikon sjellja e të tjerëve ndaj sjelljes sonë? A mund të ndikojmë edhe ne me sjelljen tonë ndaj sjelljes së të tjerëve?
4. A mund të bashkëpunohet nëse sjellja e dikujt në grup ndikon negativisht ndaj sjelljes së të tjerëve? Pse?



PËRFUNDIM

Sjellja e secilit prej nesh ndikon ndaj sjellje së të tjerëve në grup. Se si do t'i kundrojmë të tjerët, kjo varet nga ajo se çfarë jemi ne në momentin përkatës. Që të ekzistojë bashkëpunimi, të gjithë në grup duhet të insistojnë të kontribuojnë drejt qasjes pozitive ndaj gjërave.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Të gjithë nxënësit qëndrojnë ulur në rreth. Arsimtarja e lexon përrallën “Parajsa dhe ferri” deri në momentin kur parashtrohet pyetja pse. Këtu ndalet.

Formohen çifte nga nxënësit (dy fqinj në rreth). Detyra e tyre është që të përpiqen të zbulojnë sa më shumë njerëz që në parajsë janë të ngopur, ndërsa në kushte të njëjtë njerëzit e ferrit janë të uritur.

Pas 1-2 minutave ndërpritet diskutimi dhe, nëse askush nga nxënësit nuk ka sukses ta zbulojë çelësin, arsimtarja e lexon përrallën deri në fund.

DISKUTIM 2

1. Cili është dallimi ndërmjet ferrit dhe parajsës? (Ku është sjellja e njerëzve më bashkëpunuese e ku nuk është?)
2. Si zgjidhen problemet në shkollën tuaj: me bashkëpunim, përmes garave ose secili për vete – individualisht?
3. Cili është dallimi ndërmjet zgjidhjes së problemeve përmes bashkëpunimit, përmes garave dhe individualisht?
4. Si është ë mirë të zgjidhen problemet që i ka gjithë grupi? Pse?

PËRFUNDIM

Problemet me të cilat ballafaqohet grupi më së miri zgjidhen kur të gjithë anëtarët e grupit bashkëpunojnë ndërmjet vete. Kur zgjidhen problemet me bashkëpunim, të gjithë pjesëmarrësit në grup marrin pjesë në sjelljen e vendimit dhe ajo zgjidhje është më e mira.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja III-3.3: Ashtu si është te unë – është edhe te ti

Fletë pune për arsimtarin/arsimtaren
DY GRA

Një grua shkoi të jetojë në një qytet të ri. Kur arriti në portën e qytetit, rojtari e pyeti: “Si ishin njerëzit në qytetin nga i cili vjen ti?” Ajo u përgjigj: “Kishin karakter të keq, grindeshin dhe përgojonin. Kryesisht ishin njerëz jo shumë të këndshëm.” Rojtari u përgjigj: “Edhe këtu do të gjesh njësoj njerëz të këqij, prandaj të propozoj ta vazhdosh rrugën.”

Pastaj erdhi një grua tjetër. Rojtari edhe asaj ia parashtrij pyetjen e njëjtë, ndërsa ajo u përgjigj: “Njerëzit e qytetit prej të cilit po vij ishin të dashur dhe të mirë. Ishin të guximshëm në kohë të vështira dhe çdoherë të gatshëm që të më ndihmojnë. Për ata të huajt ishin të mirëseardhur.” Pas kësaj rojtari iu përgjigj: “Hyn, sepse edhe këtu do të gjesh po aq njerëz që janë shërbyes dhe nikoqirë të mirë.”

Punëtorja III-3.3: Ashtu si është te unë – është edhe te ti

Fletë pune për arsimtarin/arsimtare:

PARAJSA DHE FERRI

Parajsa dhe ferri

përrallë e vjetër kineze

Njerëzit gjithmonë kanë dëshiruar gjëra të ndryshme. Një njeri që jetonte në Kinë kishte një dëshirë të çuditshme: dëshironte ta shohë sesi duket ferri dhe parajsa para se të vdesë. Dhe, një ditë kjo dëshirë iu plotësua.

Se pari e vizitoi ferrin. Aty pa grumbuj të mëdhenj të ushqimeve të shijshme, por të gjithë njerëzit ishin të uritur dhe të hidhëruar. Ushqim kishte më shumë se që nevojitej, por njerëzit asesi nuk mund ta shijonin asnjë kafshatë. Ata e kishin patjetër të qëndrojnë një metër nga tavolina dhe të përdorin thupra për ushqim një metër të gjata, por me ato asesi nuk mund të vinin ushqim në gojë.

Kur shkoi ta shohë parajsës, u befasua shumë kur pa se ajo ishte plotësisht ienjëtë me ferrin. Ishin po ato tavolina të mëdha me ushqime shumë të shijshme dhe njësoj njerëzit ishin larg tavolinave një metër larg me po aso thupra të gjata, me të cilat ishte e pamundur të ushqeheshin. Pra ishte njësoj si në ferr, vetëm që këtu njerëzit ishin të ushqyer dhe shumë të lumtur.

PSE?

Sepse në ferr secili përpiquej të ushqehet vetë, ndërsa në parajsë të gjitha ushqeheshin ndërmjet vete.

Përmbajtja III-4:

NJOHJA E STRUKTURËS SË GRUPIT

Pritet që nxënësi/nxënësja

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • T'i dijë elementet e grupeve të ndryshme (bashkësinë më të gjerë, shtetin, komunën, organizatat joqeveritare) • Ta dijë raportin ndërmjet elementeve të caktuara • Ta dijë rolin e secilit element • Ta dijë vendin e tij në grup
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mund të krijojë grupe
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Ta kuptojë dhe ta pranojë vlerën e strukturës • Të dëshirojë të jetë pjesë e ndonjë strukture • Ta pranojë ekzistimin e strukturave të ndryshme

PUNËTORIA III-4.1: SECILI E KA FUNKSIONIN E TIJ

MATERIALE

- Letër për të shkruar
- Pajisje për të shkruar
- Sellotej
- Letra për t'u ndarë në grupe
- Fletë pune për nxënësit: Kërkesa



AKTIVITETI KRYESOR 1

Përgatiten letra aq sa ka nxënës dhe në secilën letër shkruhen një nga një grupet e mëposhtme në shoqëri:

- „qytetarë 1“
- „qytetarë 2“
- „komuna 1“
- „komuna 2“
- „organizata joqeveritare - OJQ 1“
- „organizata joqeveritare - OJQ 2“
- „shteti 1“
- „shteti 2“.

Nxënësit ndahen në tetë grupe me zgjedhe të rastësishme përmes tërheqjes së një letreje.

Secilit grup i jepet nga një fletë letre dhe pajisje për të shkruar, në të cilën do të duhet t'i shkruajë së paku tre funksione më të rëndësishme të cilat i ka grupi i tij në shoqëri, përkatësisht çka duhet të bëjë ai grup që shoqëria të funksionojë mirë.

Pastaj nga dy grupe të njëjta e lexojnë para të tjerëve atë që e kanë shkruar, fletët i ngjisin në tabelë dhe kështu zhvillohet një diskutim për secilin lloj të grupit.



DISKUTIM 1

1. Cilat janë rolet më kryesore të këtij grupi në shoqëri? (rezymohet shkurtimisht nga të dyja fletat)
2. A ka diçka që askujt nuk i shkoi mendja, e që llogaritet se është po ashtu shumë e rëndësishme dhe se duhet të shtohet në fleta?

PËRFUNDIM

Secila nga strukturat e dhëna në shoqëri (qytetarë, OJQ, komuna, shteti) i ka funksionet e veta, ndërsa disa prej tyre janë dhënë më poshtë.

Qytetarët: pjesëmarrje në jetën publike, informim për çështje të interesit publik, përcjellje se si e shfrytëzojnë përfaqësuesit politikë fuqinë e tyre, shprehje e mendimit dhe interesave të tyre, votimi në zgjedhje në bazë të bindjes personale dhe pasi të kundrohen me kujdes pikëpamjet e kandidatëve të partive të ndryshme, pjesëmarrje në fushatat politike ose vetëkandidim, debat për çështje të interesit publik, pjesëmarrje në takime të bashkësisë, dorëzim i peticioneve në qeveri, protestim, anëtarësim në OJQ ose në parti politike sipas bindjes personale...

OJQ: sigurim i serviseve të ndryshme, lehtësim i pjesëmarrje së qytetarëve në bashkësitë e tyre, mundësim që të dëgjohet zëri i atyre qytetarëve që kanë formuar grup dhe që kanë vlera dhe interesa të ngjashme, mundësim për mirëkuptim mes qytetarëve dhe shtetit, sigurim të mjeteve të shprehjes, orientim aktiv të nevojave të ndryshme dhe komplekse të shoqërisë, promovim i pluralizmit, llojllojshmëri dhe tolerancë në shoqëri, e njëherazi edhe mbrojtje dhe fuqizim të identiteteve kulturore, etnike, religjioze, gjuhësore dhe të tjera, përparim i shkencës, kulturës dhe artit, mbrojtja e mjedisit, përkrahja e të gjitha aktiviteteve që krijojnë një shoqëri të gjallë qytetare, motivimi i qytetarëve nga të gjitha aspektet që të ndikojnë më shumë se që të jenë të varur nga fuqia e shtetit, krijimi i agjencive alternative shtetërore dhe sigurimi i shërbimeve me pavarësi dhe fleksibilitet më të madh, themelimi i mekanizmave përmes të cilëve qeveritë dhe tregu mund të jenë dikush te i cili mund të llogaritet nga opinioni...

Komuna: ndikon në përmirësimin e standardit të njerëzve që jetojnë në komunë; ngritja e vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë e decentralizimit dhe pasojat e tij, si dhe për rolin e pushtetit lokal në përmirësimin e standardit të qytetarëve që jetojnë në komunë; krijimi i partneritetit efikas ndërmjet sektorit publik, privat dhe civil, si dhe ndërmjet grupeve të ndryshme në shoqëri ose kontributi i veçantë në përmirësimin e standardit të grupeve të lëndueshme; kontributi për jetën shoqërore dhe zhvillimin kulturor; kontributi për qëndrueshmërinë ekonomike dhe ekologjike; përmirësimi i politikës publike lokale, këmbimi dhe përcjellja e diturisë, profesionalizmit dhe përvojës...

Shteti: në mënyrë legale mund të përdorë fuqi që ta mbrojë jetën, lirinë dhe pronën e qytetarëve të tij, mund t'i ndëshkojë ata që e sulmojnë, kujdeset për mirëqenien e shoqërisë, kujdeset për sigurinë elementare dhe rendin publik – pa të cilët individët nuk mund të jenë të gëzuar, në kompetencë të tij janë mbrojtja, siguria e brendshme, siguria ekonomike dhe sociale, siguria e mjedisit, kujdesi shëndetësor, arsimiti...

AKTIVITETI KRYESOR 2

Nxënësit punojnë në grupet e njëjta të formuara në aktivitetin paraprak. Secilit grup i jepet nga një pjesë përkatëse e fletës së punës “Kërkesa” në të cilën duhet të numërohen së paku tre gjëra që i kërkon ai grup në punën e secilit nga tre llojet e tjera të grupeve që të mund t'i përmbushë me sukses rolet e tij në shoqëri (sikur ato t'i referohen atij grupi, rolit dhe aktiviteteve të tij, çka të bëjnë/çka mos të bëjnë).

Pastaj secili grup e zgjedh një përfaqësues i cili në emrin e grupit do ta lexojë atë që është shkruar, ndërsa të gjithë të tjerët do ta dëgjojnë me vëmendje. Në fund fletat varen në një vend të dukshëm në klasë.

DISKUTIM 2

1. Çka do të ndodhte nëse grupit “të qytetarëve” i ndalohet ndonjë nga rolet e dhëna ose për shkaqe të brendshme ky grup nuk e kryen ndonjë nga këto role? (pastaj për secilin grup veçmas parashtrahet pyetja e njëjtë) A do të ketë kjo ndikim edhe në punën e grupeve të tjera? Si?
2. A mund të funksionojnë këto grupe në mënyrë të pavarur, pa njëra-tjetrën? Pse?
3. Si mund të ndihmohen këto grupe ndërmjet vete? Cila do të ishte dobia në atë rast për të dyja palët?



PËRFUNDIM

Që të mund të funksionojë shoqëria pa pengesa, secila nga këto struktura duhet t'i dijë funksionet e veta, si dhe funksionet e strukturave të tjera, duhet t'i kryejë pa pengesë ato dhe të mundësojë që edhe strukturat e tjera të mund të punojnë pa pengesa.

Të gjitha këto struktura janë të ndërlidhura në veprimin e tyre, varen nga njëra-tjetra dhe duhet t'i ndihmojnë njëra-tjetrës – nëse kanë qëllim të përbashkët përfundimtar – krijimin e një shoqërie që është në bazë të parametrave të njeriut në të, në bazë të nevojave të tij dhe në bazë të nevojave të shoqërisë që mundëson zhvillimin e jetës normale.

REFLEKTIM


1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA III-4.2: BASHKËRISHT DERI TE ZGJIDHJA

MATERIALE

- Letër për të shkruar
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI KRYESOR

Nxënësit ndahen në tre grupe sipas një zgjedhjeje të rastësishme: qytetarë, komuna OJQ.

Pastaj vijon ushtrimi i procedurës së parashtrimit të kërkesës për zgjidhjen e ndonjë problemi real me të cilin ballafaqohet qytetarët, e deri në zgjidhjen e tij, kjo përmes inkuadrimit në segmente të ndryshme në shoqëri.

Së pari grupi “qytetarët” e mendon ndonjë problem real nga përditshmëria e tij ose ndonjë problem që ka të bëjë me vendbanimin e tyre (ajri i ndotur, mbeturinat në vende publike, kafshët endacake, maltretimi fizik i fëmijëve... Menjëherë pas kësaj ata ia shprehin problemin e tyre me zë grupeve të tjera që ata të mund të mendojnë në lidhje me atë problem, përkatësisht të mendojnë për çështjen se si mund të ndihmojnë nga ky aspekt për zgjidhjen e tij, derisa grupi “qytetarët” e bën këtë që vijon.

Grupi “qytetarët” e përgatit një letër me shkrim për komunën dhe OJQ-në përkatëse (nga dy kopje të njëjta për të dyja strukturat) duke theksuar:

- çka është problemi
- pse është ai problem dhe cilat pasojat e tij
- çka kërkon / si të ndihmojë komuna, përkatësisht OJQ-ja që të zgjidhet problemi
- data e dorëzimit të kërkesës
- nënshkrimet e atyre që e parashtrojnë kërkesën
- personi përgjegjës i grupit
- në cilën adresë mund të kontaktohet grupi

Pastaj grupi “komuna” dhe grupi “OJQ” veçmas:

- e pranojnë kërkesën me shkrim nga qytetarët (të dyja kopjet e dedikuara për ata), e vërtetojnë pranimin e tyre (gjoja i vendosin vulë) dhe përgjigjen me shkrim se për çfarë afati kohor do të bëhet përgjigjja ndaj kërkesës
- një kopje të kërkesës së vërtetuar e mbajnë për vete, ndërsa kopjen tjetër ia japin parashtruesit të kërkesës.

Derisa grupi “komuna” dhe grupi “OJQ” diskutojnë mes vete për mënyrën me të cilën mund të ndihmojnë në tejkalimin e problemit, grupi “qytetarët” po ashtu mendon dhe i shkruan në fletë idetë për atë çka mund të ndërmarrin vetë ata në lidhje me atë çështje.

Në fund secili grup e zgjedh nga një përfaqësues të vetin i cili ulet në bankë të përbashkët dhe të re ku do të duhet të merren vesh si mund ta tejkalojnë problemin bashkërisht, duke filluar me atë që janë marrë vesh me anëtarët e grupit të tyre, por duke qenë të hapur drejt edhe gjetjes së zgjidhjes së përbashkët me strukturat e tjera. Gjatë kësaj kohe nxënësit ulen përreth dhe e përcjellin me kujdes procesin. Nëse procesi komplikohet në ndonjë moment, përfaqësuesi i cilitdo grup mund të kërkojë një minutë pauzë (deri në dy herë për secilën strukturë) për shkak të konsultimit me grupin sesi të vazhdojë më tej me bisedimet.



Aktiviteti llogaritet si i kryer kur të gjitha palët janë të kënaqura nga zgjidhja përfundimtare dhe kur secila palë e ka përgjegjësinë e vet për përmbushjen e saj (kjo u thuhet qartë grupeve para së të fillojnë me bisedimet që ta dinë se kah duhet të jenë të orientuar).

DISKUTIM

1. A erdhët te zgjidhja e përbashkët?
2. Kur erdhët deri te ajo zgjidhje?
3. A pritet nga përfaqësuesit e të gjitha grupeve që të marrin pjesë në realizimin e zgjidhjes?

PËRFUNDIM

Në jetën e njerëzve ekzistojnë një sërë problemesh me të cilat ballafaqohen ata, e ndërsa me tejkalimin e tyre cilësor do të ndodhë që më shumë struktura shoqërore, që janë kompetente për zgjidhjen e problemit, të inkuadrohen në të në mënyrë konstruktive, përkatësisht të marrin një pjesë të përgjegjësisë mbi vete, të investojnë fuqi të tyre për tejkalimin e problemit dhe në mënyrë aktive të bashkëpunojnë me strukturat e tjera për tejkalimin e problemit dhe të bashkëpunojnë në mënyrë aktive me strukturat e tjera të inkuadruara drejt zbulimit të zgjidhjes së përbashkët.

REFLEKTIM


1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA III-4.3: SHKOJMË NË EKSKURSION

MATERIALE

- Fletë punë për nxënësit: Planifikimi i ekskursionit
- Fletë punë për nxënësit: Shkojmë në ekskursion 1-4
- Fletë punë për nxënësit: Letër drejtorit/drejtoreshës së shkollës
- Fletë punë për nxënësit: Letër prindërve/kujdestarëve të nxënësve
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI KRYESOR 1

Të gjithë fëmijët ulen në vendet e tyre. Arsimitarja e lexon këtë tekst:

“Paramendoni se kjo klasë ka fituar shpërblim nga shkolla një mundësi të shkojë në një ekskursion dyditor në pushimoren e fëmijëve “Feniks” në malin Dauticë, që është rreth dy orë vozitje nga shkolla juaj. Ekskursioni do duhej të realizohet vikendin e ardhshëm dhe të zgjasë nga e shtuna në mëngjes deri të dielën në mbrëmje. Tashmë janë vendosur edhe shpenzimet që do t’i mbulojë shkolla.

Por, që të realizohet ekskursioni, ekziston një kusht: të gjithë nxënësit e kësaj klase duhet të marrin pjesë aktive në planifikimin e të gjitha detajeve të nevojshme për ekskursionin që ai të zhvillohet pa problem.”

Pastaj nxënësit ndahen sipas një zgjedhjeje të rastësishme në disa grupe me minimum katër anëtarë në secilën prej tyre. Secilit grup i jepet fleta e punës “Planifikimi i ekskursionit” në të cilën duhet të plotësohen fushat e zbrazëta.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Formohet katër grupe të reja, secila e përbërë nga nxënës që në aktivitetin paraprak janë përcaktuar për planifikim të ndonjë pjese të caktuar të ekskursionit (grupi i transportit, grupi për pushim, grupi për rregullat e sjelljes dhe grupi për gjërat e nevojshme për bartje).


Të gjithë anëtarëve të secilit grup u jepet fletë përkatëse e punës (Fletë punë për nxënësit “Shkojmë në ekskursion 1-4”) dhe ata bashkërisht i plotësojnë me informacione të nevojshme për zhvillimin e papenguar të ekskursionit (disa informacione kërkojnë marrëveshje, ndërsa disa kërkojnë që nxënësit të paramendojnë se gjoja i kanë marrë nga organizata). Hapësira e zbrazët e fletës mund të përdoret për të shtuar ndonjë detaj tjetër për të cilin grupi mendon se është i rëndësishëm.

Pastaj të gjithë nxënësit kthehen në grupet e tyre fillestare.

AKTIVITETI KRYESOR 3

Secili anëtar i grupit i informon anëtarët e tjerë për atë që janë marrë vesh në grupet paraprake për një pjesë të planifikimit të ekskursionit. Pastaj në bazë të kësaj disa grupe shkruajnë letër për drejtorin/drejtoreshën e shkollës (Fletë punë për nxënësit: Letër drejtorit/drejtoreshës së shkollës), ndërsa disa të tjerë shkruajnë letër për prindërit/kujdestarët e nxënësve (Fletë punë për nxënësit: Letër prindërve/kujdestarëve të nxënësve) në të cilat i informojnë për detajet e ekskursionit të planifikuar dhe kërkojnë pëlqim për realizimin e tij.

Në fund vullnetarë të disa grupeve e lexojnë letrën e shkruar para nxënësve të tjerë.



DISKUTIM

1. Si na ndihmon planifikimi i një aktiviteti të komplikuar, siç është vajtja në ekskursion?
2. Nga çka varet se a do të realizohet ajo që është planifikuar?

PËRFUNDIM

Realizimi i suksesshëm i ndonjë aktiviteti më të komplikuar fillon me planifikimin e tij të hollësishëm i cili përfshin një listë të të gjithë çështjeve të mundshme me atë, në të cilat do të gjendet përgjigje. Nëse ka mundësi, grupet mund t'i ndajnë pyetjet për më shumë persona që do të jenë përgjegjës për mbledhjen e informacioneve të nevojshme.

Për realizimin e suksesshëm të asaj që është planifikuar, rol të madh luan jo vetëm zgjedhja paraprake e të gjitha informacioneve të nevojshme, por edhe këmbimi i tyre i ndërmjet atyre që janë përgjegjës për ndonjë pjesë të planifikimit për shkak të harmonizimit të tyre, ashtu që të gjithë pjesëmarrësit në një aktivitet të dhënë ta dinë se çka presin dhe çka kërkohet prej tyre.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Përmbajtja III-5:

**MARRJA E VENDIMEVE NË GRUP DHE
KUPTIMI I DEMOKRACISË**

Pritet që nxënësi/nxënësja

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • Ta kuptojë rëndësinë e demokracisë • T'i dijë procedurat demokratike • T'i dijë strukturat demokratike dhe rolin e tyre në procesin e vendimmarrjes • T'i dijë mënyrat e pjesëmarrjes në vendimmarrjen demokratike
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mund të propozojë mënyra të ndryshme të pjesëmarrjes në vendimmarrje • Të mund të përdorë burime të ndryshme të informacioneve • Të mund të gjejë në mënyrë të pavarur informacione të dobishme dhe të nevojshme për vendimmarrjen • Të mund të përzgjedhë dhe të sublimojë • Të mund të përdorë procese të ndryshme për marrjen e vendimeve (votimi publik dhe i fshehtë, konsensusi, llojet e ndryshme të shumicës)
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Të pranojë se informacionet janë pjesë e kulturës së përgjithshme të secilit njeri • Të pranojë se informacionet e përzgjedhura janë kusht për dituri cilësore dhe afatgjata • Të ketë qëndrim pozitiv ndaj demokracisë

PUNËTORIA III-5.1: KAMPIMI

MATERIALE

- Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Kampimi
- Fleta me pika të kaltra dhe të verdha
- Fletë punë për nxënësit: Problemet që duhet të zgjidhen
- Letër për të shkruar
- Pajisje për të shkruar
- Sellotej



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth dhe kështu zgjidhet njëri që do të qëndrojë në mes të rrethit. Ai duhet të sillet rreth vetes me sy të mbyllur, me dorë të shtrirë dhe me gishtin tregues të drejtuar. Në një moment ai duhet të ndalet, t'i hapë sytë dhe ta thotë njëren nga tre fjalët e mundshme:

ELEFANT, PALMË ose MAJMUN. Fëmija drejt të cilit është i drejtuar gishti tregues në atë moment bëhet elementi i mesëm i figurës së përmendur, ndërsa fëmijët majtas dhe djathtas atij po ashtu inkuadrohen në figurë.

ELEFANTI – fëmija që është në mes vjen pak më përpara, i ngre duart mbi kokë dhe i shtrin si bori elefanti. Ndërkaq fëmija që është majtas dhe djathtas atij i formojnë veshët e mëdhenj të elefantit, duke i shtrirë duart sa më shumë që munden dhe duke u afruar me fëmijën që është në mes.

MAJMUNI – fëmija që është në mes kërcen dhe lëshon tinguj si të majmunit dhe kruhet nën sqetulla, ndërsa fëmijët që janë djathtas dhe majtas atij e kruajnë në kokë.

PALMA – fëmija që është në mes është trangu i palmës. Ai qëndron i drejtuar, i ngre dhe i shtrin duart lart mbi kokë. Fëmija që është majtas atij po ashtu i ngre duart e tij, por i lakon majtas, ndërsa fëmija që është djathtas atij i ngre duart e tij dhe i lakon djathtas.

Pasi që fëmija që është në mes ta thotë figurën përkatëse, treshi i përkatës duhet ta bëjë figurën, ndërsa në të njëjtën kohë grupi duhet të bërtasë me zë ELEFANTI, PALMA, MAJMUNI. Nëse treshi arrin ta krijojë figurën para se të thotë grupi ELEFANTI, PALMA, MAJMUNI, atëherë lojtari që ka qenë në mes të rrethit përsëri duhet të rrotullohet dhe ta thotë emrin e figurës përkatëse. E nëse grupi është më i shpejtë, atëherë fëmija që ka qenë në mes të figurës vjen në mes të rrethit dhe tash ai duhet të rrotullohet dhe ta thotë emrin e figurës.

AKTIVITETI KRYESOR

Nxënësit ndahen në katër grupe. Arsimitarja e lexon tekstin e fletës së punës për arsimtarin/ arsimtaren “Kampimi”.

Secili nga të tre gupet shkon në një pjesë të hapësirës dhe e merr nga një kopje të fletës së punës për nxënësit “Problemet që duhet të zgjidhen” (komplet me letra të prera në të cilat janë shkruar problemet) dhe udhëzimin individual për atë grup. Letrat lexohen një nga një sipas numrit rendor dhe për secilën prej tyre vendoset veçmas.

Dy grupeve të para arsimtarja u thotë se në grupin e tyre mbisundon atmosferë demokratike, ngase secili në atë grup ka të drejtë të njëjtë të votës, të vendimmarrjes dhe të shprehjes së mendimit. Të gjitha zgjidhjet patjetër duhet të vendosen me pajtueshmëri të plotë të të gjithë anëtarëve të grupit.



Në dy grupet e tjera pjesëmarrësit tërheqin fletëza. Atyre që u jepet fletë me pikë të kaltër e përfaqësojnë “klasën sunduese”, ndërsa ata që tërheqin fletë të verdhë e përfaqësojnë “klasën e nënshtruar”. Rregulla themelore e punës së këtyre grupeve është se:

- Për gjithçka vendosin vetëm të kaltërtit, ndërsa të verdhët patjetër duhet t’i nënshtrohen vendimit të tyre.
- Të verdhët mund duhet ta shprehin mendimin e tyre vetëm nëse pyeten dhe nëse kjo u lejohej.

Zgjidhjet shkruhen në Fletë e madhe të letrës.

Në fund duhet të shkruajnë se në çfarë mënyre do t’i detyrojnë të gjithë t’i respektojnë rregullat dhe cilat janë sanksionet.

Pas përfundimit të aktivitetit, secili grup i lexon vendimet e miratuara.

DISKUTIM

1. A ka dallim ndërmjet vendimeve që i marrin dy grupet e para nga vendimet e dy grupeve të dyta?
2. A janë të kënaqura të gjitha grupet me këto zgjidhje?
3. Kush nuk është i kënaqur dhe nga cili grup?
4. Ku ishte më lehtë të merren vendime e ku ishte më vështirë? Pse?
5. Ku ka më shumë të pakënaqur nga vendimet e ku ka më pak?
6. Për cilat të drejta nuk mbahet llogari në të dyja grupet e ndara?
7. A ka dallim në mënyrat e kërkimit të respektimit të rregullave dhe kush do të dënohet për mosrespektimin e tyre?
8. Kush do ta ketë më lehtë që t’i zbatojë rregullat?
9. A mund të realizohen të drejtat e njeriut në mjedis jodemokratik?
10. Çka ndodhë zakonisht në këso situatash?



PËRFUNDIM

Grupet në të cilat njerëzit marrin vendime në mënyrë demokratike zakonisht janë të kënaqura dhe janë të përgatitura që maksimalisht të kontribuojnë drejt realizimit të vendimeve, ndërsa në atmosferën jodemokratike të vendimmarrjes në të shumtën e rasteve është shumë i vogël numri i njerëzve që marrin pesë në miratimin e vendimeve dhe ata zakonisht ndjehen mirë, por të tjerët ndjehet të privuar dhe të nënçmuar. Te ata motivi për punë drejt realizimit të vendimeve është shumë i dobët.

Vendimmarrja në atmosferë demokratike është një proces më i vështirë dhe më afatgjatë, sepse kërkon këmbim të mendimeve të të gjithëve dhe harmonizim të tyre. Realizimi i të drejtave të njeriut është i pamundur në mungesë të ligjeve që e mundësojnë këtë: mekanizma për mbrojtjen e të drejtave, procedura të kontrollit, atmosferë të pranimit dhe mbështetjes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Të drejtat e njeriut në një mjedis jodemokratik janë të rrezikuara, shpesh nuk respektohen dhe shkelen. Kjo mund të shpijë në pakënaqësi, rezistencë pasive ose aktive ndaj vendimeve që janë marrë në mënyrë jodemokratike.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja III-5.1: Kampimi

Fletë pune për arsimtarin/arsimtare:

KAMPIMI

Paramendoni se shkoni në kamp me një grup moshatarësh tuaj. Shkoni në një lokacion të mrekullueshëm në pyll pranë një lumi. Ju planifikoni të qëndroni aty dy javë. Pas një ecjeje të gjatë, ju arrini në vendin e mrekullueshëm. Me vete keni gjithçka që u nevojitet, përfshirë edhe një shator të madh në të cilin të gjithë do të mund të flini. Nuk ka rregulla, nuk ka ndalesa dhe nuk ka të rritur që mund t'u vënë kufizime të ndryshme. Megjithatë gjatë kohës së kampimit dalin probleme që kërkojnë zgjidhje.

PUNËTORIA III-5.2: FAJTORË APO JO?

MATERIALE

- Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Dilema
- Fletë punë për nxënësit: Tabela për votim
- Letër për të shkruar
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI KRYESOR

Formohen tre grupe nxënësish: dy prej tyre formohen me pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në aktivitet (me 5 ose me 7 nxënës në secilin grup), ndërsa grupi i tretë formohet me vëzhgues (nëse ka më pak se 14 nxënës, nuk duhet të ketë vëzhgues.)

Të dyja grupet janë ulur në grumbuj në dy anë të kundërta të hapësirës. Vëzhguesit janë vendosur ndërmjet tyre.

Secilit fëmijë i jepet nga një fletë e zbrazët për votim të fshehtë. Secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënësit “Tabela për votim”.

Duke iu drejtuar të dyja grupeve, arsimtari e lexon udhëzimin e fletës së punës “Dilema”.

Votimi zbatohet në secilin grup veçmas, pra nuk lejohet që anëtarët e grupit të merren vesh mese vete. Secili nxënës në fletën e tij të votimit shkruan:

ose PO – nëse konsideron se ekipi i tij duhet ta pranojë fajin

ose JO – nëse konsideron se ekipi i tij nuk duhet ta pranojë fajin.

Vëzhguesit i mbledhin fletët dhe i numërojnë votat. Për vendim të grupin e shpallin atë që e kanë votuar më shumë anëtarë.

Në bazë të vendimeve, arsimtari e përcakton dënimin dhe i informon grupet për të dhe për vendimin.

Votimi përsëritet pasi lejohet marrëveshje (më së shumti 5 minuta) në kuadër të secilit grup veçmas.

Rinumërimin e votave e bëjnë vëzhguesit. Vendimet dhe dënimin i shpall arsimtari.

Nëse grupet nuk e kanë kuptuar se vendimi JO-JO është më i dobishëm për ata, procedura e marrëveshjes, rivotimit dhe shqiptimit të dënimin mund të përsëritet edhe një herë.

DISKUTIM

1. Cili vendim është më i mirë për njërin e ekip e cili për tjetrin? Kur paraqitet një situatë e tillë?
2. Cili vendim është më i mirë për të dyja ekipet? Pse?
3. Si vendosët në votimin e patë, kur nuk kishit mundësi të merreni vesh me të tjerët ne ekip? A u penduat pse keni votuar ashtu?
4. Kur e kishit më lehtë të vendosni, kur vetë duhej të merrni vendim ose kur vendimin duhej ta marrë ekipi? Pse?
5. Cili vendim i solli më shumë dobi ekipit tuaj? Pse?
6. Si është ndjenja kur grupi e pëson për shkak të vendimit të gabuar të ndonjë anëtarit të tij? Si është ndjenja kur vendimi është marrë në mënyrë grupore? Pse?



PËRFUNDIM

Vendimmarrja individuale duket më e thjeshtë se ajo grupore, sepse në vendimmarrjen grupore duhet më shumë kohë për t'u marrë vesh.

Vendimi që merret bashkërisht, duke marrë pjesë të gjithë në grup, zakonisht është më i drejtë - përmes diskutimit vërehen të gjitha anët e mira dhe këqija para se të merret qëndrimi përfundimtar.

Për vendimin e grupit që e kanë pranuar të gjithë anëtarët e tij është përgjegjës gjithë grupi. Prandaj edhe pasojat e vendimit të keq të miratuar në pajtim me të gjithë anëtarët e grupit miratohet më lehtë, sepse përgjegjësia ndahet me të tjerët.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja III-5.2: Fajtorë apo jo?

Fletë pune për arsimtarin/arsimtarene:

DILEMA

JU jeni dy ekipe sportive që garoni për vendin e parë në ligën e qytetit. Përgatitëni intensivisht për garën që do ta keni mes vete, e cila duhet të luhet javën e ardhshme. Ekziston vetëm një sallë ku mund të përgatitëni, andaj atë e përdorni me radhë njëra pas tjetrës.

Por, të dyja ekipet janë akuzuar për vandalizëm për shkak të mureve të shkarravitura dhe fjalëve fyese të shkruara për ekipin kundërshtar. Të gjithë e dini se disa anëtarë të ekipit tuaj kanë marrë pjesë në këtë, sepse edhe ju keni qenë i pranishëm gjatë shkarravitjes së mureve.

Drejtori i sallës ju pyet: “A është apo nuk është fajtor ekipi yt?”

Vendimin e këtillë duhet ta merrni me votim të fshehtë, pra në bazë të shumicës së votave. Pastaj duhet ta keni parasysh se pasojat e atij vendimi mund të jenë këto (shpjegimet e Tabela për votim):

Në situatën PO-PO – nëse të dyja ekipet e pranojnë fajin – dënohen me 5 ditë ndalesë për stërvitje në sallë.

Në situatën JO-JO – nëse asnjëra nuk e pranon fajin – të dyja ekipet dënohen me 2 ditë ndalesë për stërvitje në sallë.

Në situatën PO-JO / JO-PO – nëse njëri ekip e pranon fajin, e tjetri jo – ekipit që e ka pranuar fajin nuk i ndalohet asnjë ditë të stërvitet, ndërsa ekipit që nuk e ka pranuar fajin i ndalohen 7 ditë stërvitje.

Përmbajtja III-6:

BALLAFAQIMI ME TRYSNINË SOCIALE

Pritet që nxënësi/nxënësja

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • T'i njohë normat kulturore në shoqëri • Ta dijë se normat dhe traditat sociale ndryshojnë/zhvillohen • T'i dijë rreziqet e trysnisë sociale me të cilën mund të ballafaqohet (të ballafaqohen moshatarët e tij), përfshirë edhe trysninë e miqve të familjes • T'i dijë burimet e trysnisë në relacione • T'i dijë mënyrat e kryerjes së trysnisë ndaj tij/saj dhe të tjerëve • Të dijë shembuj të kundërshtimit të trysnisë sociale (nga historia, nga jeta e përditshme)
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mund t'i vlerësojë normat dhe traditat e pranuar • Të mund të kundërshtojë hapur ndaj trysnisë ndaj vetvetes dhe ndaj të tjerëve • Të mund të konfrontohet në mënyrë aktive ndaj atyre që bëjnë trysni • Të mund të rezistojë ndaj trysnisë së shokëve dhe të familjes • Të mund të kërkojë ndihmë nga burime të ndryshme me qëllim që ta fuqizojë pozicionin e tij.
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Të mendojë për atë që e bën të papranueshme trysninë • Ta hedh poshtë trysninë si fenomen të papranueshëm social • Ta vërejë se për t'u konfrontuar në mënyrë energjike me trysninë nevojitet vetëbesim • Ta dijë vlerën e kundërshtimit të qëndrimit dhe mendimit personal • T'i analizojë fjalët dhe sjelljen kritike të njerëzve pavarësisht nga statusi i tyre

PUNËTORIA III-6.1: TRYSNIA

MATERIALE

- Letra të vogla për të shkruar
- Pajisje për të shkruar
- Bonbone
- Letra të vogla për të shkruar (në gjysmën e fletës shkruan: Përgatitu ta hash bonbonen tënde (por mos e ha ende) dhe përpiku t'i bindësh të tjerët t'i hanë bonbonet; ndërsa në gjysmën tjetër shkruan: Mos e ha bonbonen dhe përpiku t'i bindësh të tjerët që mos t'i hanë bonbonet e tyre) ose Fletë punë për nxënësit: Ha/Mos ha
- Tabelë dhe shkumës



AKTIVITETI HYRËS

Arsimtarja kërkon nga nxënësit që të kujtohen në së paku një gjë që e kanë bërë javën e kaluar e cila në ndonjë mënyrë ka qenë në kundërshtim me vullnetin e tyre dhe të mendojnë për shkaqet se pse e kanë bërë atë. Pastaj ato duhet t'i shkruajnë në copa letre dhe fletat t'i mbajnë për vete.

AKTIVITETI KRYESOR 1

Arsimtarja u thotë nxënësve se tash secilit do t'ia japë nga një bonbone dhe nga një fletë në të cilën është shkruar detyra e tij. Askush nuk ka të drejtë ta hajë bonbonen derisa nuk e bën detyrën e dhënë në fletë. Pastaj arsimtarja i ndan bonbonet dhe fletët, ndërsa fëmijët duhet të lëvizin nëpër klasë duke u përpjekur që ta kryejnë detyrën. Pas disa minutave aktiviteti ndërpritet.

DISKUTIM 1

1. Sa ishte vështirë apo lehtë që t'i bindni të tjerët ta bëjnë atë që e kërkonte ju prej atyre? A ju bindi dikush ta bëni ju atë që e kërkonte ai prej jush?
2. Si ndjeheshit kur i bindnit të tjerët?
3. Si ndjeheshit kur ju bindnin?
4. Çka ndikonte në atë që e bënit?

PËRFUNDIM

Disa persona e kanë lehtë të bindin, e disa të tjerë jo aq. Disa fëmijë e kanë më lehtë të binden, e disa e kanë më vështirë. Disa kënaqen duke i bindur të tjerët dhe janë shumë të vendosur, ndërsa disa të tjerë nuk janë shumë të rehatshëm dhe shpejt heqin dorë. Ndaj sjelljes së vendimit ndikon si detyra e dhënë, ashtu edhe trysnia e mjedisit

AKTIVITETI KRYESOR 2

Arsimtarja e vizaton në tabelë një figurë qesharake - ☺ dhe disa vija si të diellit përreth tij. Pastaj kërkon nga nxënësit që të përgjigjen në pyetjen se çka ndikon ndaj vendimeve të tyre. Përgjigjet i shkruan në vija derisa nuk shteren të gjitha idetë.

DISKUTIM 2

1. Çka është ndikimi? A mund të jetë ndikimi negativ apo pozitiv? Në çfarë situatash është pozitiv e në çfarë negativ?
2. E çka është trysnia? Kur bëhet ndikimi trysni?
3. Çfarë ndikimi kanë moshatarët në jetën tuaj të përditshme?
4. Çka është ai ndikim i moshatarëve?
5. Si manifestohet trysnia ndaj atyre që kryhet ajo?
6. Për çfarë arsye mund të ndodhë që të lëshojmë pe para trysnisë? Çka fitojmë në atë rast?
7. Nëse i dimë pasojat ose karakteristikat e asaj që na ofrohet, a mund të bëjmë zgjedhje adekuate dhe të përgjegjshme?
8. Cilat mund të jenë pasojat e pranimit të trysnisë që të bëjmë diçka për pasojat e së cilës nuk jemi të informuar sa duhet?

**PËRFUNDIM**

Moshatarët ndikojnë shumë ndaj jetës së të rinjve – mënyrën së të menduarit, sistemin e vlerave, zgjedhjet që i bëjnë. Ndikimi që e kanë moshatarët ndaj njëri-tjetrit mund të jetë pozitiv (kur të mësojmë ndonjë mjeshtëri të re në basket ose në skejt bord ose kur na rekomandojnë ndonjë film të mirë etj.) dhe negativ (kur të gjithë ikin nga ora, ik edhe unë; shoqet e mia më të mira mbajnë xhinse shumë të ngushta, andaj mbaj edhe unë).

Kur ndikimi bëhet shumë i madh dhe është i shoqëruara me bindje intensive, përqeshje dhe kanosje (të shprehur ose të pashprehur) për largim nga grupi, atëherë bëhet fjalë për trysni. Disa fëmijë e pranojnë trysninë për shkak të frikës nga largimi prej grupit ose nga frika prej përqeshjes, pastaj nga nevoja që të jenë të dashur dhe të pranuar, nga kërshëria ose për shkak se “të gjithë e bëjnë atë”. Të gjithë këto gjëra mund të ndikojnë ndaj fëmijës dhe ta prishin gjykimin e tij të pavarur dhe autentik. Që të mund bëjë fëmija zgjedhje përkatëse në situata të trysnisë së moshatarëve, ai para së gjithash duhet të jetë i informuar mirë për karakteristikat dhe pasojat e asaj që i ofrohet dhe ta marrë përgjegjësinë për zgjedhjen e tij.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA III-6.2: PATJETËR – NUK DUA

MATERIALE

- Fletë pune për nxënësit: Situata të trysnisë nga moshatarët
- Tabelë dhe shkumës
- Fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Si mund të reagohet në situatat e trysnisë së moshatarëve



AKTIVITETI KRYESOR 1

Nxënësit ndahen në çifte dhe dy fëmijët e çiftit ndalen njëri përballë tjetrit. Ata mund të komunikojnë duke i përdorë vetëm dy fjalë: PO dhe JO. Njëri çift thotë vetëm PO, ndërsa tjetri thotë vetëm JO, duke insistuar që ta bindë tjetrin të lëshojë pe. Nxënësit merren vesh në çifte se cili do të fillojë të thotë PO, e cili do të thotë JO. Kur të jepet shenjë nga arsimtari, çiftet mund të fillojnë të bindin. Pas rreth dy minutave, arsimtari jep shenjë që nxënësit në çift t'i ndërrojnë rolet: ai që ka thënë PO tash do të thotë JO dhe anasjelltas.

Pas dy minutave grupeve u jepet ky udhëzim: njëri mendon diçka me të cilën dëshiron ta detyrojë tjetrin ta bëjë atë, ndërsa tjetri mendon diçka që aspak nuk dëshiron ta bëjë. Asnjëri nuk i ka treguar tjetrit se çka ka menduar. Kësaj radhe i përdorin fjalët PATJETËR dhe NUK DUA. Njëri thotë vetëm PATJETËR, duke e pasur në mend atë që ashtu ta detyrojë tjetrin ta bëjë atë veprim, ndërsa tjetri thotë vetëm NUK DUA, duke e pasur në mendje atë që aspak nuk do të dëshironte ta bëjë.

Pas dy minutave përsëri ndërrohen rolet.

Pas dy minutave aktiviteti përfundon dhe secili nga çiftet duhet t'i thotë tjetrit se çka ka dashur ta bindë të bëjë ai, gjegjësisht çka nuk ka dashur të bëjë dhe kështu nxiten të bisedojnë për atë se a ka qenë problem në realitet që të binden me njëri-tjetrin për atë që e kanë pasur në mend.

DISKUTIM 1

1. Si ndjeheshit në rolin e atij që bindte?
2. E si ndjeheshit në rolin e dikujt që kundërshtonte?
3. Çfarë intonacioni të zërit kishit kur e bindnit partnerin? A ishte intonacion lutës apo urdhërues? Tjetër?
4. Si ishte pozicioni i trupit?
5. Çfarë refuzimesh kishte? A ishin të turpshme dhe të pasigurta? A kishte të fuqishme dhe të prera?
6. Si ishte pozicioni i trupit?
7. A ka ndodhur ndonjëherë që tjetri “të lëshojë” pe dhe të thotë: “Mirë, nuk e ke patjetër” ose të thotë: “Epo, mirë më – PO!”?
8. A ndeshni në jetën e përditshme këso situatash? Si ndjeheni në ato raste? A e keni vështirë apo lehtë ta refuzoni dikë ose ta kundërshtoni dikë kur u bëhet trysni?



PËRFUNDIM

Trysnia me fjalë nuk është e thënë që çdoherë të bëhet me zë dhe me sjellje urdhëruese. Ajo mund të bëhet edhe me ton kërcënues, lutës, urdhërues ose nënçmues të zërit. Refuzimet po ashtu mund ta jenë të ndryshme – nga ato si me dyshim, e deri te ato me zë dhe prerazi ose të qarta dhe të vendosura. Pozita e trupit është shumë e rëndësishme gjatë të bindurit, veçanërisht gjatë refuzimit. Jeta e përditshme ka plot situata të trysnisë dhe disa është më lehtë e disa më vështirë që të refuzohen. Zakonisht kur dikush na bën trysni, ne mund të ndjehemi jo mirë, të shqetësuar, të pasigurt, të frikësuar etj.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Arsimtari ofron nga fleta e punës së arsimtarit/arsimtares mënyra të kundërshtimit të ndonjë trysnie të padëshiruar dhe atë e shkruan në tabelë, duke kërkuar që nxënësit shkurtimisht ta shprehin mendimin e tyre në lidhje me mënyrën ofruar të kundërshtimit.

Pastaj disa nxënës ndahen në grupe dhe secilit çift i jepet nga një letër e prerë e fletës së punës për nxënës “Situata të trysnisë nga moshatarët” në të cilën janë dhënë dy situata të trysnisë së moshatarëve. Një anëtar i çiftit duhet ta lexojë letrën dhe të përpiqet ta bindë tjetrin që të inkuadrohet në aktivitetin e dhënë në letër. Çifti tjetër duhet ta refuzojë duke e zbatuar strategjinë e mësipërme. Pastaj anëtarët e grupit i ndërrojnë rolet dhe e realizojnë situatën e dytë të letrës.

DISKUTIM 2

1. Si ndjeheshit në rolin e atij që bind – që bën trysni?
2. E si ndjeheshit në rolin e atij që duhet ta refuzojë trysninë?
3. Cilat ishin vështirësitë kryesore?
4. Çka mund të bëhet në lidhje me ato?
5. A mund të vendosim të bëjmë diçka nëse nuk kemi informacion për atë?
6. Kush është përgjegjës për zgjedhjen e bërë?
7. Kush i bart pasojat?



PËRFUNDIM

Para se të merret vendimi, fëmija duhet të jetë i informuar drejt dhe mirë, si dhe të ketë dituri të rëndësishme në lidhje me atë që kërkohet prej atij të bëjë. Pas zgjedhjes së bërë, fëmija duhet të jetë i vetëdijshëm se pavarësisht nga të tjerët AI VETË është përgjegjës për zgjedhjen e tij dhe VETË AI do t'i ndjejë dhe bartë pasojat.

Kundërshtimi i trysnisë së grupit nuk është aspak i lehtë dhe i thjeshtë, por kjo bëhet më lehtë nëse ushtrohet. Veçanërisht është vështirë kur fëmija është nën kërcënim për përjashtim nga grupi ose është në kërcënim të drejtpërdrejtë për shëndetin dhe sigurinë e personit që i bën trysni.

Dilemë e madhe paraqet edhe ikja nga situata përballë qasjes aktive ndaj zgjidhjes së problemit ose ndihmës “së viktimës”. Në situatat kur fëmija do të vlerësojë se nuk ka mundësi ta kundërshtojë grupin ose ta mbrojë “viktimën”, më së miri është ta braktisë situatën, e pastaj menjëherë të kërkojë ndihmë nga personi i rritur në të cilin ai ka besim.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja III-6.2: PATJETËR – NUK DUA

**Fletë pune për arsimtarin/arsimtarene:
SI MUND TË REAGOHET NË SITUATAT E
TRYSNISË SË MOSHATARËVE**

Krijoi vetes mjaft kohë sa të informohesh, të mendosh se a e dëshiron atë dhe cilat do të ishin pasojat. Pasi të vendosësh:

1. qartë thuaj JO (pa agresivitet dhe pa u shtirë si i rëndësishëm)
2. shpjego pse (pa “mbajtur mësim” dhe pa u shtirë si i mençur)
3. propozo diçka tjetër (“mund të jetë argëtuese edhe”)
4. dil nga situata (ik, përdor arsyetim) dhe, nëse ka nevojë, kërko ndihmë nga personi i i rritur në të cilin ke besim.

PUNËTORIA III-6.3: MË MIRË ËSHTË TË...**MATERIALE**

- Shkumës
- Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Pohime

**AKTIVITETI HYRËS**

Të gjithë fëmijët qëndrojnë në rreth dhe kështu zgjidhet një fëmijë që do të jetë “Thashë”. Ai fëmijë qëndron në mes të rrethit dhe duhet të japë udhëzime të caktuara që fillojnë me fjalën “Thashë thotë...” dhe të gjithë fëmijët duhet ta ndjekin udhëzimin e tij. “Thashë” mund të japë udhëzim edhe pa thënë “Thashë thotë...”, por atëherë fëmijët nuk duhet të bëjnë ashtu si thotë ai. Nëse ndonjë fëmijë e dëgjon udhëzimin e tij edhe në këtë rast, atëherë ai del nga loja derisa nuk mbeten vetëm disa fëmijë në lojë.

Për shembull: fëmija në mes thotë “Thashë thotë që të gjithë të kërceni!” dhe të gjithë fëmijët duhet të kërcëjnë. Por, ai mund të thotë edhe “Kërceni!” dhe atëherë asnjëri nuk duhet ta bëjë atë që e kërkon ai. Nëse ndonjë fëmijë kërcen, atëherë ai del nga loja. Loja vazhdon me udhëzime të tjera që nuk guxojnë të jenë shumë të vështira ose të pamundshme për realizim.

AKTIVITETI KRYESOR

Të gjithë fëmijët qëndrojnë në këmbë, ndërsa arsimtarja me shkumës e vizaton një vijë të gjatë në mes të klasës dhe në njërin anë e vizaton shenjën “+”, ndërsa në anën tjetër e vizaton shenjën “-”, e pastaj thotë se do t’i lexojë disa pohime, ndërsa nxënësit do duhet të ndalen në vijë varësisht nga ajo se a pajtohen me pohimin e lexuar. Pastaj arsimtarja e lexon një pohim të caktuar nga fleta e punës për arsimtarin/arsimtare “Pohime” dhe kërkon nga nxënësit të marrin një pozicion të caktuar në vijë. Pasi të gjithë të vendosen, ajo kërkon nga disa prej tyre që gjenden në skaje dhe në mes që ta shpjegojnë zgjedhjen e bërë dhe të diskutojnë me të tjerët, por pa ofendime dhe nënçmime. Arsimtarja e thekson se në cilëndo pjesë të diskutimit kush dëshiron mund ta ndryshojë pozicionin nëse e ndryshon mendjen në bazë të pohimit.

Procedura përsëritet për të gjitha pohimet e propozuara.

DISKUTIM

1. A mund të burojë trysnia për të bërë diçka ose për t’u sjellë në një mënyrë edhe nga të rriturit e jo vetëm nga moshatarët? Prej kujt tjetër mund të burojë kjo?
2. A vendosin edhe normat sociale të sjelljes kërkesa të caktuara të sjelljes që ndonjëherë janë të kundërta me disa dëshira dhe afinitete tona autentike?
3. Çka mund të bëjmë? Cilat janë sfidat me të cilat ballafaqohemi nëse me zgjedhjet tona i kundërshtojmë normat sociale të prindërve?
4. Cilat janë dobitë nga zgjedhjet tona autentike?

Arsimtarja mund të propozojë që në ndonjë orë të ardhshme ta shikojnë bashkërisht filmin „Billy Elliot“ të regjisorit Stephen Daldry.

**PËRFUNDIM**

Mund të ekzistojë trysni edhe nga të rriturit (prindër, arsimtarë), si edhe nga normat sociale të sjelljes, që të bëjmë diçka që nuk u përgjigjet nevojave dhe dëshirave tona autentike.

Kundërshtimi i prindërve ose i normave sociale mund të shkaktojë një sërë reagimesh të mosmiratimit, madje edhe hedhje poshtë. Nënshtrimi para normave sociale ndonjëherë mund të shkaktojë çlodhje momentale nga trysnia, por edhe jetë i vazhdueshëm me pasojat e bëra prej zgjedhjes joautentike.

Mënyra më e mirë e realizimit të nevojave dhe dëshirave tona autentike është para së gjithash që përmes një diskutimi të argumentuar ta prezantojmë pikëpamjen tonë dhe në mënyrë kritike t'i analizojmë sjelljet dhe argumentet e të rriturve, pavarësisht nga statusi i tyre. Zgjedhja e bërë ka lidhje me vetë neve, andaj ne vetë duhet t'i durojmë edhe pasojat.

Zgjidhja ndonjëherë mund të jetë edhe kompromis në të cilin do të bashkohen anët e mira të qëndrimit të të rriturve ose të normës sociale me nevojat e fëmijës.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja III-6.3: Më mirë është të...**Fletë pune për arsimtarin/arsimtare:****POHIME**

Më mirë të mos regjistrohem në balet, edhe pse dua shumë, sesa që babai dhe vëllai im të më përqeshin.
Më mirë të dëgjohet më i vjetri në familje, sepse ai çdoherë e di më mirë se çka duhet të bëhet, sesa të hymë në diskutime dhe grindje.
Më mirë të martohem në 18 vjeç sesa të jem “dele e zezë” në familje dhe të gjithë të mendojnë se më mungon diçka që edhe pas 18 viteve nuk jam e martuar.
Më mirë të regjistrohem në shkollë të mjekësisë dhe ta vazhdoj traditën familjare sesa të regjistrohem ku vërtet dua – në shkollë të muzikës.
Më mirë të shoqërohem me ata shokë që i pëlqejnë edhe prindërit e mi sesa edhe me ata që për mua janë interesant, por që prindërit e mi nuk i pëlqejnë.
Më mirë të vishem si më thonë të rriturit sesa të vishem sipas shijes sime dhe vazhdimisht të dëgjoj si më japin vërejtje. (varësisht nga grupi, arsimtari mund të inkuadrojë përshkrim të veshjes tipike të fëmijëve në atë mjedis)
Më mirë të kem frizurë moderne dhe të mos mund të shikoj nga tufat e flokëve që më varen mbi sy sesa të qethem siç dëshirojnë prindërit e mi.
Më mirë të shkoj në kishë/xhami me prindërit e mi gjatë festave, edhe pse kjo më mërzit shumë, sesa t'i duroj prindërit që vazhdimisht të më akuzojnë se nuk e respektoj festën.
Më mirë të inkuadrohem në seksion, sepse vetëm ashtu arsimtari do të më vë pesë, edhe pse nuk më intereson aq shumë lënda, sesa të refuzoj dha ta kaloj kohën në futboll ku kënaqem.

Përmbajtja III-7:

NDËRMARRJA E PËRGJEGJËSISË PËR VEPRIMET

Pritet që nxënësi/nxënësja

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • Ta dijë rolin e tij dhe rolin e të tjerëve në bashkësi • T'i dijë detyrimet dhe përgjegjësitë e tij • T'i dijë pasojat e sjelljes së vet ndaj jetës së tij dhe jetës së të tjerëve
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mund ta vërejë lidhjen shkak-pasojë ndërmjet veprimeve dhe rezultatit të atyre veprimeve (mund t'i vërejë pasojat e veprimeve të tij ndaj të tjerëve)
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Ta çmojë rëndësinë e marrjes së përgjegjësisë për vete dhe për të tjerët • Ta kuptojë se veprimet e kujtdo mund të kenë pasoja ndaj të tjerëve • Ta kuptojë ndikimin kthyes të veprimeve të tij në një situatë tjetër • Të ndjejë përgjegjësi ndaj të tjerëve dhe përgjegjësi për nevojat e tyre

PUNËTORIA III-7.1: SJELLJA E PËRGJEGJSHME

MATERIALE

- Çarçaf
- Top
- Letër për të shkruar
- Pajisje për të shkruar
- Kuti
- Fleta më të mëdha të letrës
- Fletë punë për nxënësit: Përgjegjësitë e ndryshme
- Fletë punë për nxënësit: Orientimet e sjelljes së përgjegjshme



AKTIVITETI KRYESOR 1

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth dhe me duar të ngritura përpjetë i mbajnë skajet e një çarçafi të madh. Çarçafi është i shtrirë maksimalisht dhe në mes të tij arsimtari e ka vendosur një top. Detyra e nxënësve është që ta hedhin topin dhjetë herë në ajër, pa u rënë nga çarçafi dhe pa u rrokullisur, por vetëm të kërcejë.

DISKUTIM 1

1. Si ndjeheshit gjatë aktivitetit?
2. A ia dolët?
3. Kush ishte përgjegjës?
4. Çka është përgjegjësia?
5. Çka do të thotë të jesh përgjegjës?



PËRFUNDIM

Përgjegjësia është një nocion i komplikuar i cili në vete përfshin më shumë gjëra. Zakonisht edhe në këtë rast me përgjegjësi nënkuptojmë kryerje me kohë dhe të plotë të detyrimeve. Të jesh i përgjegjshëm do të thotë të përpiqesh maksimalisht ta arrish atë që e ke marrë përsipër ta bësh. Në këtë aktivitet përgjegjësia e suksesit bie mbi të gjithë pjesëmarrësit.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Në një fletë të vogël të letrës secili nxënës e kryen fjalinë e cila fillon në këtë mënyrë: Përgjegjësi kemi kur....

Pastaj fletat vendosen në një kuti, ndërsa arsimtari i nxjerr një nga një dhe i lexon, e pastaj i ngjet me sellotej në një fletë kur shkruan *përgjegjësia*. Në fund i përmbledh përgjigjet dhe i miraton.

DISKUTIM 2

1. Si ndjehemi kur e kryejmë mirë atë për çka jemi përgjegjës?
2. Ndaj kujt jemi përgjegjës?

PËRFUNDIM

Kur e kryejmë mirë atë për të cilën jemi përgjegjës, ne ndjehemi të kënaqur dhe kemi vetërespekt të lartë. Secili nga ne ka përgjegjësi ndaj vetvetes, ndaj shokëve, ndaj familjes, ndaj ledhatakëve, ndaj shkollës, ndaj bashkësisë më të gjerë dhe më të ngushtë, ndaj botës etj.

PUNËTORIA III-7.2: PËRGJEGJËSITË E MIA

MATERIALE

- Fletë punë për nxënësit: Për këtë botë
- Fletë punë për nxënësit: Me çka mund të kontribuoj për jetë më të mirë të fëmijëve?
- Pajisje për të shkruar
- Tabelë
- Shkumës



AKTIVITETI KRYESOR 1

Arsimtari e lexon këngën e Toshe Proeskit, të incizuar për nevojat e UNICEF-it – PËR KËTË BOTË dhe secilit nxënës i jepet nga një kopje e këngës “Për këtë botë”.

DISKUTIM 1

1. A e keni dëgjuar këtë këngë?
2. A ju pëlqen?
3. Si ndjeheshit derisa e dëgjonit?
4. Kush është ai që duhet të luftojë për këtë botë?
5. Çka bënte Toshe Proeski për këtë botë që ajo të jetë vendbanim i mirë për fëmijët?
6. A mund të kontribuoni ju në ndonjë mënyrë që kjo botë të bëhet vend në të cilin fëmijët do të jetojnë pa frikë, pa uri dhe pa brenga?

PËRFUNDIM

Këngëtari Toshe Proeski ka organizuar shumë koncerte ku të hollat e mbledhura nga biletat janë dhuruar për ente të ndryshme të fëmijëve (jetimore, shkolla, klinikë fëmijësh) që të përmirësohen kushtet e qëndrimit dhe trajtimit të fëmijëve. Ai vazhdimisht u tregonte fëmijëve se sa i do dhe sa mirë ndjehet në praninë e tyre.

Edhe shfaqja e dashurisë kontribuon që njerëzit të ndjehen mirë, freskët dhe pa brenga.

Secili nga ne është përgjegjës dhe mund të luftojë që bota të bëhet vend më i mirë për jetën e fëmijëve.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Secilit nxënës i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënës “Me çka mund të kontribuoj për jetë më të mirë të fëmijëve?” dhe aty t’i shkruajë së paku nga dy veprime konkrete që mund t’i ndërmarrë, pavarësisht të tjerëve, në familje, në shkollë, në fqinjësi, në vend dhe jashtë.

Pasi t’i plotësojnë, nxënësit ndahen në grupe me nga katër vetë dhe në secilin grup do të duhet t’i diskutojnë propozimet dhe të verifikojnë se a janë ato vërtet konkrete dhe, nëse nuk janë, ta zgjedhin një ose dy dhe të përpiqen t’i konkretizojnë dhe t’i shpërndajnë detyrat dhe përgjegjësitë konkrete ndërmjet vetë. Në konkretizim mund të ndihmojë edhe arsimtari.

Pas përfundimit nga një përfaqësues i secilit grup i prezanton para të tjerëve propozimet e miratuara.



DISKUTIM 2

1. Sa ju duken të pranueshme dhe të realizueshme propozimet që i dëgjuat?
2. Prej kujt varet realizimi i tyre?

PËRFUNDIM

Nëse përpiqemi t'i konkretizojmë propozimet deri në nivelin e përkufizimit të detyrave dhe përgjegjësive individuale të secilit që ka vendosur të marrë pjesë në realizimin e tyre, ato shumë lehtë mund të bëhen realitet. Realizimi i tyre varet para së gjithash nga kryerja e përgjegjshme dhe me dinjitet e detyrës, por edhe nga disa faktorë të jashtëm, si mbështetja, bashkëpunimi etj.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Përmbajtja III-8:

NDËRTIMI I RAPORTIT POZITIV NDAJ VENDIT TË VET

Pritet që nxënësi/nxënësja

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • Ta dijë përbërjen etnike, kulturore dhe religjioze të vendit të tij • T'i dijë të arriturat e vendit të tij
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të marrë pjesë në aktivitete me të cilat prezantohen të arriturat e vendit të tij • Të marrë pjesë në manifestime, gara dhe festa që kanë lidhje me prezantimet e vendit të tij
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Ta vërejë rëndësinë e të arriturave të vendit të tij • Ta pranojë vetveten si pjesë të vendit të tij

PUNËTORIA III-8.1: MAQEDONIA

MATERIALE

- Tabelë dhe shkumës
- Letër për të shkruar
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI KRYESOR 1

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth dhe duhet të përshëndeten ndërmjet vete në gjuhën e ndonjë grupi të ndryshëm etnik që jeton në Maqedoni.

Arsimtarja i regjistron në tabelë përshëndetjet:

Maqedonisht - Добар ден
Shqip – Mirëdita
Turqisht – Günaydın
Gjuha rome – Šukar dive
Serbisht – Добар дан
Vllahisht – Bunëdzua



dhe secili nxënës me radhë e përshëndet nxënësin që është në anë të djathtë të tij në njërën nga gjuhët e propozuara. Lista mund të plotësohet edhe me përshëndetje në gjuhët të cilat i flasin nxënësit e klasës konkrete.

DISKUTIM 1

1. Cilat gjuhë fliten në Maqedoni?
2. Cilat grupe etnike jetojnë në Maqedoni?
3. Si është shteti ynë, monokulturor apo multikulturor? Pse?

AKTIVITETI KRYESOR 2

Nxënësit ndahen në grupe me nga katër vetë dhe secilit prej tyre i jepet nga një detyrë që t'i shkruajë nga dy përparësi dhe dy dobësi të shtetit monokulturor dhe multikulturor. Pasi të përfundojnë, nga disa vullnetarë i lexojnë përfundimet e tyre.

DISKUTIM 2

1. Si ju duken përparësitë e shtetit multikulturor në raport me mangësitë e shtetit monokulturor?
2. A ju duket se ato janë gjëra të njëjta? Ose, e kundërta, a është e saktë se mangësitë e shtetit multikulturor janë përparësi të shtetit monokulturor?

PËRFUNDIM

Përparësitë e shtetit multikulturor perceptohen si mangësi për shtetin monokulturor dhe e anasjelltas – zakonisht këtu bëhet fjalë për gjëra të njëjta. Për shembull, mundësia për ndikime pozitive dhe pasurim të kulturave përmes tyre është përparësi e shtetit multikulturor në raport me shtetin monokulturor dhe e kundërta – pamundësia për pasurimin e kulturës së një grupi etnik për shkak të mungesës së ekzistimit të grupeve të tjera etnike është dobësi e shtetit monokulturor.

AKTIVITETI KRYESOR 3

Nxënësit janë ulur në rreth dhe arsimtarja i shkruan në tabelë këto fjalë: DOMATE, QEPË, SPECA, VAJ dhe KRIPË e pastaj i kërkon dy vullnetarë nga pjesëmarrësit që do të duhet të japin shpjegime: njëri të shpjegojë se si mund të bëhet sallatë nga këto gjëra, ndërsa tjetrit duhet të shpjegojë se si prej tyre mund të bëhet supë.

Arsimtarja duhet të presë ose t'i orientojë këto përshkrime:

Sallata

Priten të gjitha produktet në copëza të imëta, vendosen në pjatë, shtohet kripë dhe vaj dhe pastaj përzihen. Ose, priten të gjitha produktet në copëza të imëta dhe vendosen në pjesë të veçanta të pjatës.

Supë

Fërgohet qepa në vaj, e pastaj shtohen edhe domatet dhe specat e prerë, qitet kripë dhe ujë dhe kjo vlohët.

DISKUTIM

1. Në cilin prej këtyre ushqimeve përbërësit e tyre e mbajnë shijen e tyre? Në cilën sallatë në veçanti?
2. A e ruajnë shijen edhe në sallatën e përzier?
3. Çka ndodhë me supën? A e ruajnë përbërësit e saj shijen e tyre apo jo? Çfarë shije do të ketë supa?
4. Nëse këtë e krahasojmë me shtetet multikulturore, çka mund të përfundojmë? Çfarë shtete multikulturore ka?
5. A ka shtete që janë si supa ku të gjithë anëtarët e kulturave të ndryshme heqin dorë nga një pjesë e tipareve të tyre kulturore dhe shkrihen në një kulturë të re të përbashkët? Si ndjehen kulturat e këtyre shteteve?
6. Ndërkaq kulturat si sallata ku secila kulturë i ruan tiparet e veta (gjuhën, traditën, zakonet), por njëherazi edhe përzihet me kulturat e tjera duke i dhënë shije specifike tërësisë? Si ndjehen kulturat në këto shtet?
7. E a ka shtete që janë si sallata që është vetë në një pjatë pa kurrfarë kontaktesh me kulturat e ndryshme ose me shumë kontakte të atyre që kufizohen me njëri-tjetrin? Si ndjehen kulturat në këto shtete?
8. Në çfarë shteti dëshironi të jetoni ju? Pse?

**PËRFUNDIM**

Republika e Maqedonisë është shtet multikulturor në të cilin jetojnë grupe të ndryshme etnike: maqedonas, shqiptarë, turq, romë, vllahë etj. Jeta në shoqëri multikulturore sjell gjëra pozitive (pasurim të kulturës amë përmes njoftimit dhe pjesëmarrjes në aktivitete të përbashkëta me përfaqësues të kulturave të tjera), por edhe sfida (nevoja për dialog të vazhdueshëm për pranimin e dallimeve dhe tejkalimin e mospajttimeve).

Koncepti i tenxheres së çorbës i referohet krijimit të një kulture të re dhe të vetme si rezultat i përzierjes së kulturave të ndryshme, me ç'rast kulturat e ndryshme shkrihen në një, duke hequr dorë nga identiteti i tyre, ndërsa koncepti i pjatës për sallatë i referohet mbrojtjes së identitetit vetjak kulturor të grupeve të ndryshme kulturore, me ç'rast me grupet e tjera ndodhë këmbimi i elementeve të përbashkëta kulturore.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë pjesëmarrësit qëndrojnë në rreth dhe përshëndeten mes vete me radhë në një rreth nga gjuhët që i flasin bashkësitë e ndryshme etnike në Maqedoni:

Maqedonisht – Пријатно

Shqip – Mirupafshim

Turqisht - Güle güle

Gjuha rome - Adio

Vllahisht - Dievelsa

Serbisht - Довиѓења

REFLEKTIM


1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA III-8.2: HERONJTË BASHKËKOHORË

MATERIALE

- Tabelë dhe shkumës
- Letër për të shkruar
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI KRYESOR 1

Arsimtari e shkruan në tabelë fjalën HERO dhe kërkon nga nxënësit që të krijojnë asociacione të kësaj fjale dhe ato i shkruan në tabelë. Pastaj i dallon ato fjale që e përmbajnë konotacionin e luftimit.

DISKUTIM 1

1. Cila është dituria e zakonshme që ia përshkruajmë fjalës HERO?
2. A vetëm ajo e nënkupton fjalën HERO?
3. Kush mund të jetë HERO?
4. Kush janë heronjtë e sotëm – njerëzit me të cilët Maqedonia njihet si vend në të cilin jetojnë dhe punojnë njerëz të jashtëzakonshëm?

Arsimtari i shkruan në tabelë dhe, nëse nuk paraqiten asnjë prej këtyre, ai i shkruan:

Krie Llazarov – hendbollist

Mumin Veli – mundës

Simon Tërçevski – muzikant

Toshe Proeski – muzikant

Zhan Mitrev – mjek

Esma Rexhepova – muzikante

Sllobodan Unkovski – regjisor

Goran Pandev – futbollist

Goran Stefanovski – shkrimtar

Bllazhe Koneski – shkrimtar

Luan Starova – shkrimtar

Borsi Trajkovski – kryetar i R. së Maqedonisë

Marko Çallosan – informatist



5. Pse themi për këta njerëz se janë heronj?

PËRFUNDIM

Me fjalën HERONJ nuk nënkuptohen vetëm njerëzit që janë dalluar me tiparet dhe sjelljet e tyre në kushte lufte ose në situata të përdorimit të forcës. HERONJ janë edhe ata persona që për shkak të tipareve të ndryshme, aftësive dhe sjelljeve të tyre kanë arritur suksese të jashtëzakonshme në fushën e shkencës, artit dhe sportit dhe në këtë mënyrë e kanë promovuar vendin e tyre.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Secili fëmijë duhet ta zgjedhë njërin nga “heronjtë modernë” të ofruar dhe t’ia shkruajë atij një letër në të cilën duhet:

- t’i përshkruajë ndjenjat e tij dhe mendimin e tij për të;
- t’i parashtojë pyetje në lidhje me diçka që e intereson dhe

- të tregojë se si ai/ajo vetë me disa tipare të veta i ngjan heroit.
- Pasi të përfundojnë, ndahen në grupe dhe ia lexojnë letrat njëri-tjetrit.

DISKUTIM 2

1. Si ndjeheshit gjatë aktivitetit?
2. Çka mendoni, si janë bërë heronj këta njerëz të Maqedonisë? A janë lindur si të tillë?
3. Si mund të bëheni ju heronj të Maqedonisë?
4. Kujt i shërbejnë heronjtë?

PËRFUNDIM

Heroi nuk lind, por bëhet. Përmes punës, ushtrimit, vendosmërisë dhe mosheqjes dorë njeriu mund të bëhet HERO.

Heronjtë me aftësitë dhe të arriturat e tyre të jashtëzakonshme e përfaqësojnë Maqedoninë në dritën më të mirë jashtë kufijve të vendit tonë.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë në rreth dhe secili duhet të shprehet se, nëse në jetën e tij do të paraqitej në film, çfarë filmi do të ishte ai: komedi, dramë, aksion, triler etj. Përveç zhanrit mund të thuhet edhe një a dy fjali me të cilat do të shpjegohet filmi.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Përmbajtja III-9:

**KRIJIMI I NDJENJËS PËR PËRKATËSINË
E GJITHMBARSHME QYTETËRUESE**

Pritet që nxënësi/nxënësja

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • T'i dijë të arriturat regjionale dhe botërore, si dhe zhvillimin global të qytetërimit • Ta dijë se çka ndodhë në botë (nga aspekti i paqes botërore dhe zhvillimit të përbashkët teknologjike) • T'i dijë elementet e ndërlidhjes dhe dallimit të botës • Ta dijë se ekzistojnë qëllime mijëvjeçare • Të dijë për rolin e BE-së
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mund të gjejë dhe të prezantojë informacione për të arriturat qytetërimore • Të mund të diskutojë për problemet e gjithmbarshme të qytetërimit dhe të zhvillimit • Të mund të diskutojë për zhvillimin e mëtejshëm të bashkësisë botërore • Të mund të mendojë dhe të diskutojë për paqen botërore
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Ta pranojë përkatësinë e bashkësisë botërore njerëzore • T'i llogaritë si të rëndësishme përpjekjet për arritjen e bashkëpunimit dhe paqes botërore • Të përkrahë aksione që janë të orientuara drejta paqes botërore

PUNËTORIA III-9.1: QËLLIMET MIJËVJEÇARE - 1

MATERIALE

- Fletë e kaltër ose e gjelbër me ngjitës
- Fletë pune për nxënësit dhe arsimtarin/arsimtare: Komplet i qëllimeve dhe nënqëllimeve mijëvjeçare
- Sellotej
- Fletë e madhe e letrës



AKTIVITETI KRYESOR 1

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth, ndërsa arsimtarja secilit fëmijë të tretë ia jep ta ngjisë mbi vete një letër me ngjyrë të kaltër, ndërsa secilit fëmijë të pestë i jep të ngjisë mbi vete një letër të gjelbër. Pastaj i pyet nxënësit se çka mendojnë, sa është numri i fëmijëve të uritur në botë. Pastaj u thotë atyre me fleta të kaltra të ngrihen dhe thotë se secili fëmijë i tretë në botë ballafaqohet me vuajtje të rregullt nga uria, e pastaj kërkon që secili fëmijë me letër ngjitesë të gjelbër të ngrihet, e ajo përsëri thotë se secili fëmijë i pestë në botë jeton në varfëri të skajshme, me më pak se një dollar në ditë (më pak se 50 denarë), pa mundësi që t'i plotësojë nevojat elementare për ushqim, ujë, mbrojtje shëndetësore dhe higjienë.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Arsimtarja pyet se a e dinë ata se çka janë qëllimet mijëvjeçare dhe pastaj shpjegon se **qëllimet mijëvjeçare për zhvillim janë tetë qëllime të cilat në Samitin mijëvjeçar të OKB-së në vitin 2000 të gjitha 191 vendet anëtare morën përsipër t'i pranojnë dhe të përpiqen t'i realizojnë deri në vitin 2015.**

Ato morën përsipër se në periudhën e përcaktuar kohore do të punojnë në zvogëlimin e varfërisë në botë përmes krijimit të programeve individuale për realizimin e secilit nga tetë qëllimet në nivel nacional dhe ndërkombëtar.

Secili qëllim përmban në vete qëllime të detajuara.

Në aktivitetin vijues nxënësit duhet të përpiqen të përcaktojnë se cili nënqëllim cilit qëllim i takon.

Nxënësit ndahen në grupe me nga pesë vetë dhe secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënësit dhe arsimtarin/arsimtare "Komplet i qëllimeve dhe nënqëllimeve mijëvjeçare (të prera në pjesë)" dhe detyra e grupit është që nënqëllimet t'i rendisin në qëllimet kryesore (që puna të jetë më e shpejtë dhe më e thjeshtë, arsimtarja mund t'i ndajë qëllimet në gjysmë dhe secilit grup t'ia japë nga një komplet me katër qëllime.

Pasi të përfundojnë, i ngjisin fletat në një fletë të madhe të letrës dhe secili grup e prezanton posterin e tij duke i shpjeguar dilemat që i ka pasur për më së shumti tre nënqëllime.

Pasi të gjithë grupet të përfundojnë me prezantimin e tyre, arsimtarja i ekspozon drejt qëllimet mijëvjeçare bashkë me nënqëllimet dhe nxit bisedë.

DISKUTIM

1. Si ndjeheshit kur duhej ta përcaktoni se cilin qëllim ku do ta vini? Pse për disa ishte më lehtë e për disa ishte më vështirë?
2. A mendoni se qëllimet janë të lidhura ose janë të pavarura nga njëri-tjetri? Pse?
3. A është e mundur që një qëllim të realizohet pa u realizuar qëllimet e tjera? Si?



4. Pse fokusi kryesor u vihet fëmijëve? Cila është lidhja ndërmjet qëllimeve mijëvjeçare me të drejtat e fëmijëve? Ndaj kujt shprehen më shumë kushtet e kësaj jetësore?
5. Pse janë të detyruara të punojnë edhe vendet e pasura për realizimin e qëllimeve mijëvjeçare, ndonëse te ata nuk haset pjesa më e madhe e këtyre problemeve?

PËRFUNDIM

Qëllimet mijëvjeçare paraqesin pikëpamje dhe qasje multidimensionale ndaj problemeve dhe zhvillimit. Ato flasin për ndërlidhjen e ndërsjellë të problemeve. Për shembull, mungesa e ujit të pastër të pijshëm në rajonin tonë mund të kërkojë që vajzat nga disa orë të kalojnë duke furnizuar me ujë të pastër, që sigurisht do t'i pengojë të shkojnë në shkollë. Qëllimet mijëvjeçare fokusohen në sigurimin e kushteve për realizimin e të drejtave të njeriut dhe, në veçanti, për realizimin e të drejtave të fëmijëve – si grupi më i lëndueshëm.

Të gjitha shtetet anëtare të OKB-së janë zotuar se do të punojnë në realizimin e qëllimeve zhvillimore mijëvjeçare. Kjo u mundëson agjencive ndërkombëtare që ta koordinojnë dhe orientojnë punën drejt prioriteteve në botë. Disa nga problemet e vendeve të varfra janë ë lidhura drejtpërdrejt me ekzistimin e një borxhi të madh ndaj vendeve të pasura. Vetëm me përpjekje të përbashkëta të të gjitha vendeve mund të përmirësohen kushtet e jetës për të gjithë njerëzit në botë.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja III-9.1: Qëllimet mijëvjeçare - 1

Pajisje pune për nxënësit dhe arsimtarin/arsimtarene: KOMPLET I QËLLIMEVE DHE NËNQËLLIMEVE MIJËVJEÇARE

	<p>QNM 1. Zvogëlimi i varfërisë ekstreme dhe urisë</p> <p>Zvogëlim deri në gjysmë i numrit të njerëzve që jetojnë me më pak se një denar në ditë</p> <p>Zvogëlim deri në gjysmë i numrit të njerëzve që vuajnë nga uria</p> <p>Rritja e sasisë së ushqimit për ata që vuajnë nga uria</p>
	<p>QNM 2. Realizimi i arsimit fillor për të gjithë</p> <p>Sigurimi së paku i shkollës fillore për të gjithë fëmijët.</p> <p>Regjistrimi i shtuar i nxënësve patjetër duhet të jetë i përcjellë edhe me përpjekje që të gjithë të mbahen në shkollë dhe të kenë arsimim më cilësor.</p>
	<p>QNM 3. Promovimi i barazisë ndërmjet gjinive</p> <p>Eliminimi i pabarazisë ndërmjet gjinive në arsimimi fillor dhe të mesëm, mundësisht deri në vitin 2005, ndërsa në të gjitha nivelet deri në vitin 2015.</p> <p>Rritja e pjesëmarrjes së grave në procesin e marrjes së vendimeve.</p> <p>Rritja e shkallës së punësimit të femrave.</p>
	<p>QNM 4. Zvogëlimi i vdekshmërisë të fëmijët</p> <p>Zvogëlimi për dy të tretat i shkallës së vdekshmërisë së fëmijëve më të vegjël se pesë vjet.</p> <p>Zvogëlimi i vdekshmërisë të foshnjat.</p> <p>Rritja e shkallës së vaksinimit të fëmijët më të vegjël se një vjet.</p>

PUNËTORIA III-9.2: QËLLIMET MIJËVJEÇARE - 2

MATERIALE

- Fletë punë për nxënësit: Qëllimet mijëvjeçare
- Letër për të shkruar
- Fletë e madhe e letrës
- Pajisje për të shkruar
- Pajisje për të vizatuar
- Sellotej



AKTIVITETI HYRËS

Nxënësit ndahen në numër çift të grupeve – nëse klasa është më e vogël se 20 nxënës – në dy grupe, ndërsa nëse është më e madhe – në katër grupe. Ato dy grupe garojnë njëri kundër tjetrit. Në mes të klasës janë radhitur dy rreshta me karrige të kthyer kah njëra-tjetra, ndërsa në njërin rresht të karrigeve ulen nxënës të njërit grup, e në tjetrin rresht nxënës të grupit tjetër. Secili grup merret vesh mes vete se cilën nga tre shenjat e propozuara do ta zgjedhë (pa i dëgjuar grupi tjetër) dhe kur të japë shenjë arsimtari, të gjithë e bëjnë atë. Ai grup që ka bërë shenjë më të fuqishme e fiton një pikë. Loja luhet derisa njëri grup t'i fitojë pesë pikë. Në klasën me më shumë se 20 nxënës loja mund të vazhdojnë me edhe me grupet e tjera.

Shenjat

- Ushqim – lëvizje të duarve dhe gojës si gjatë ngrënies
- Shëndet – ngrihen duart në lartësi të supeve, mbliidhen mbi supe, ngrihen përpyetë, shtrëngohen muskujt dhe bëhen grushte
- Arsimit – mbahen duart me pëllëmbë të hapura, të afruara ndaj njëra-tjetrës njëzet centimetra afër fytyrës – si kur lexohet libër

Secila shenjë është me e fuqishme se shenja tjetër, por është më e dobët se një shenjë tjetër.

Ushqimi është më i fuqishëm se arsimiti, por është më i dobët se shëndeti.

Shëndeti është më i fuqishëm se ushqimi, por është më i dobët se arsimiti

Arsimiti është më i fuqishëm se shëndeti, por është më i dobët se ushqimi

Arsimtari e shkruan në tabelë këtë skemë, e cila do t'u shërbejë nxënësve si përkujtues:

USHQIM > ARSIM
ARSIM > SHËNDET
SHËNDET > USHQIM

Vërejtje: Arsimtari duhet t'u lejojë nxënësve pak kohë që t'i ushtrojnë shenjat.

AKTIVITETI KRYESOR

Fëmijët ndahen në tetë grupe dhe secilit grup i jepet nga një qëllim mijëvjeçar nga fleta dhe pajisja e punës për nxënës "Qëllimet mijëvjeçare" (nëse arsimtari konsideron se disa qëllime janë abstrakte ose jo sa duhet të qarta për fëmijët e klasës konkrete, ai mund të bëjë zgjedhje të tre-katër qëllimeve dhe ato t'i shpërndajë në grupe) dhe të mendojë së paku tre aktivitete konkrete të cilat mund të kontribuojnë drejt realizimit të qëllimeve mijëvjeçare dhe ato t'i shkruajnë në letër. Pastaj duhet të bëjnë një poster, strip ose pllakat në të cilin në mënyrë simbolike do t'i paraqesin aktivitetet e tyre të planifikuara dhe me të cilat do mund ta ngrenë

vetëdijen publike për nevojën e veprimit në drejtim të realizimit të qëllimeve mijëvjeçare. Pastaj secili grup e prezanton punën e tij para të tjerëve dhe e thekson prodhimin e tij në vend të dukshëm në klasë.



DISKUTIM

1. Pse është e nevojshme që të gjithë të aktivizohemi dhe të përpiqemi të kontribuojmë drejt realizimit të qëllimeve mijëvjeçare? A është i rëndësishëm kontributi i vogël apo janë të rëndësishme vetëm hapat dhe aktivitetet e mëdha? Pse?
2. Pse është me rëndësi të ngrihet vetëdija publike në lidhje me qëllimet mijëvjeçare?

Arsimtari mund t'i udhëzojë nxënësit ta vizitojnë ueb-faqen <http://endpoverty2015.org/> përmes së cilës vijon progresi në raport me realizimin e qëllimeve dhe e cila ofron ide dhe aktivitete në të cilat secili mund të inkuadrohet dhe ta japë kontributin e tij në realizimin e qëllimeve mijëvjeçare.

PËRFUNDIM

Secili kontribut, pra edhe kontributi më i vogël që shërben për realizimin e qëllimeve me rëndësi dhe dobi të gjithmbarshme njerëzore është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Dhe, jo vetëm si kontribut konkret, por edhe për shkak të zhvillimit të vetëdijes së përgjegjësive personale ndaj mirëqenies së njerëzimit dhe krijimit të personalitetit i cili me kalimin e viteve ndërmerret gjithnjë me shumë përgjegjësi dhe aktivitete.

REFLEKTIM


1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA III-9.3: TUNGJATJETA

MATERIALE

- Fletë pune për nxënësit: TUNGJATJETA në gjuhë të ndryshme
- Fletë pune për nxënësit: Zbulime, vite dhe shtete
- Fletë pune për nxënësit: Letra me emrat e shteteve në Evropë
- Fletë pune për nxënësit dhe arsimtarin/arsimtaren: Përgjigje të sakta



AKTIVITETI KRYESOR 1

Të gjithë ulen në rreth dhe secili fëmijë e tërheq një fletëz (nëse ka më shumë fëmijë se fletat e ofruara, përgatitet edhe një kopje e fletës së punës.) e prerë nga fleta e punës për nxënësit “TUNGJATJETA në gjuhë të ndryshme” në të cilën është shkruar TUNGJATJETA në ndonjë gjuhë. Secili do të duhet ta lexojë fletën e tij dhe një nga një ta thonë fjalën TUNGJATJETA në gjuhën që është në fletën e tyre dhe të tregojnë se për cilën gjuhë është fjala.

DISKUTIM 1

1. A dini të thoni TUNGJATJETA në ndonjë gjuhë tjetër, që nuk ishte ofruar këtu?
2. Çka mendoni, sa gjuhë të ndryshme fliten sot në botë?
(Në botë ekzistojnë rreth 2.800 gjuhë të ndryshme.)
3. Çka mendoni se është më mirë: në botë të flitet vetëm një gjuhë apo të ruhen sa më shumë gjuhë?
4. Cilat janë anët e mira/përparësitë e komunikimit vetëm në një gjuhë?
5. E cilat janë anët e mira / përparësitë e komunikimit në sa më shumë gjuhë?



AKTIVITETI KRYESOR 2

Fëmijët ndahen në çifte dhe secilit çift i jepet nga një kopje e fletës së punës “Zbulime, vite dhe shtete”. Detyra e secilit çift është të përploqet t’i ndërlihdë zbulimet me vitet përkatëse dhe shtetet nga të cilat mendon se burojnë ato.

Pas dhjetë minutave arsimtarja ua jep nga një kopje të fletës së punës “Përgjigjet e sakta” dhe nxënësit i krahasojnë përgjigjet e tyre me përgjigjet e sakta, e pastaj arsimtarja i lexon me zë përgjigjet e sakta.

DISKUTIM 2

1. A kishte përgjigje që ju shqetësuan, që ishin të papritura? Cilat?
2. Si do të zhvillohej bota nëse secili popull vetë i zbulon të gjitha gjërat? A është e mundur kjo?
3. Çka do të ndodhte nëse nuk do të ekzistonte këmbimi i zbulimeve (secili ta ruajë zbulimin e tij)?
4. Pse themi se është e drejtë e secilit që të ketë qasje në zbulimet më të mëdha në botë? A është një zbulim rezultat i diturisë së vetëm një njeriu, një shteti ose një populli?
5. A janë dhënë këtu zbulime që janë të dëmshme? Cilat? A janë të dëmshme zbulimet apo përdorimi i tyre?
6. Çfarë ndodhë me artin?

7. Cilët janë filmat, librat dhe muzika juaj e pëlqyer (nga cili vend janë?). A janë vetëm nga Maqedonia?
8. Si do të dukej bota nëse secili kënaqet vetëm me artin e tij?

PËRFUNDIM

Secili popull në ndonjë mënyrë të veçantë të tij kontribuon për zhvillimin e botës. Nëse secili popull do t'i bënte vetëm për vete të gjitha zbulimet, kjo do të thoshte qëndrim në vend për zhvillimin e njerëzimit. Këmbimi i zbulimeve është stimulim në pikëpamje të zhvillimit dhe përkryerjes së zbulimeve aktuale, si dhe atyre të reja. Disa shpikje, si për shembull fuzioni atomik, mund të përdoren edhe për qëllime të dëmshme, siç është zhvillimi i bombës atomike. Të gjithë popujt e ndryshëm në të gjitha tiparet e tyre origjinale dhe të veçanta, përfshirë edhe gjuhën e tyre, kontribuojnë për bukurinë, llojlojshmërinë dhe pasurinë e botës. Kultura, përveç që duhet të kuptohet në dimensionin e saj si element i ndryshueshmërisë, duhet të shikohet edhe si trashëgimi e akumuluar e njerëzimit (të gjitha artet, shkenca, arsimit, mediat e popullarizuara dhe aktivitetet e ndryshme të kohës së lirë) dhe ato janë prodhim i njerëzimit, andaj si të tilla duhet të jenë në disponim të secilit njeri, e jo privilegj i vetëm disa popujve ose elitave. Secili njeri njëherazi i përket popullit të tij dhe shtetit të tij, por edhe kontinentit të tij dhe gjithë botës.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Secili nxënës e tërheq nga një fletë të prerë në të cilën është shkruar shteti evropian nga fleta e punës për nxënës “Letra me emrat e shteteve në Evropë” dhe të gjithë nxënësit duhet të vendosen në klasë njëri pas tjetrit, ashtu që me trupat e tyre do ta krijojnë hartën e Evropës. (Arsimtarja duhet t'i zgjedhë qysh më parë letrat në pajtim me numrin e nxënësve që të mos ketë “vrime”, por të gjitha shtetet të kufizohen ndërmjet vete.)

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja III-9.3: Tungjatjeta**Fletë pune për nxënësit dhe arsimtarin/arsimtare:
ZBULIME, VITE DHE SHTETE****PËRGJIGJET E SAKTA**

Kalendari	3000 p.e.r	Egjipt
Paratë e farkuara	600 p.e.r	Azia e Vogël
Makina e kontabilitetit	1834	Angli
Shkrimi	3500 p.e.r	Sumer
Telegrafi	1794	Francë
Letra	100	Kinë
Gazetat	748	Kinë
Numrat arabë	814	Indi
Bomba atomike	1945	SHBA
Barometri	1643	Itali
Televizioni	1825	Skoci
Teleskopi	1600	Holandë

PUNËTORIA III-9.4: PAQE NË BOTË

MATERIALE

- Fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Shenja e paqes
- Fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Kombet e Bashkuara
- Letër për të vizatuar
- Pajisje për të shkruar
- Pajisje për të vizatuar
- Sellotej

AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë nxënësit qëndrojnë ulur në banka dhe atyre u jepet për detyrë që në një fletë të vogël të letrës ta vizatojnë shenjën e paqes dhe në të ta shkruajnë emrin e tyre dhe atë ta stolisin. Pastaj duhet të presin shenjën dhe ta ngjisin mbi vete me sellotej. Derisa nxënësit punojnë, arsimtari shkurtimisht e shpjegon dhe vizaton ose tregon fletën e punës për arsimtarin/arsimtaren “Shenja e paqes”.

AKTIVITETI KRYESOR 1

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup duhet të diskutojë dhe të shkruajë në një fletë letre se çka nënkupton ai me PAQEN BOTËRORE, e pastaj një përfaqësues i grupit i prezanton përfundimet. Arsimtari i pranon përfundimet e secilit grup.

Pastaj arsimtari shkurtimisht shpjegon:

“Paqja mund të përkufizohet në mënyra të ndryshme – nga mungesa e luftërave (definicioni i zakonshëm) deri te gjendja e dhunës planetare në të cilën shtetet bashkëpunojnë vullnetarisht ose përmes ndonjë sistemi të organizuar të masave dhe udhëheqjes e cila e pengon luftën.”

DISKUTIM 1

1. Cilat organizata i dini ju që merren me mirëmbajtjen dhe ruajtjen e paqes botërore?
2. Çka dini për Organizatën e Kombeve të Bashkuara?
Arsimtari e lexon me zë tekstin për Kombet e Bashkuara nga fl

Arsimtarja thotë: “Merruni vesh për tri gjëra, të cilat ju i konsideroni si më të rëndësishme që të ndërpriten të gjitha luftërat në botë dhe për të cilat zotoheni se në pesë vitet e ardhshme do t’i realizoni dhe merruni vesh për tri gjëra që vijnë pas tyre të cilat e garantojnë qëndrueshmërinë e paqes botërore.”

Pastaj nga një përfaqësues i secilit grup e prezanton punën e grupit para të tjerëve dhe pas secilit prezantim vijon duartrokitje nga gjithë grupi.



REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja III-9.4: Paqe në botë**Fletë pune për arsimtarin/arsimtare:****SHENJA E PAQES**

Ky simbol është përdorë nga Lëvizja Britanike për Çarmatim Nuklear dhe paraqet shfaqje simbolike të shkronjave N – nuclear (nukleare) D – disarmament (çarmatim), të paraqitura me shenja semafori me flamuj dhe të vendosura njëri pranë tjetrit. Autori që e ka stilizuar këtë shenjë njëherazi është orvatur ta paraqesë edhe një njeri në pozicion të vuajtjes, me duar të lëshuara teposhtë përreth trupit dhe me pëllëmbë të hapura të kthyer jashtë. Në vitet e gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar gjatë lëvizjes së madhe antiushtarake në botë dhe në lëvizjen hipi, kjo shenjë është pranuar si simboli paqes.

N**D**

Punëtorja III-9.4: Paqe në botë

Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: KOMBET E BASHKUARA

Njëra ndër organizatat më të rëndësishme që merret me mbështetjen e paqes dhe sigurisë në botë është Organizata e Kombeve të Bashkuara. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, çështja më themelore e zhvillimit të botës ishte si të ruhet paqja dhe siguria në botë, si të përmirësohet bashkëpunimi ndërkombëtar dhe marrëdhëniet miqësore ndërmjet shteteve.

Kombet e Bashkuara edhe sot i kanë po atë qëllime themelore dhe atë strukturë siç ka qenë kur janë formuar në vitin 1945. Qëllimi i tyre primar është që ta ruajnë paqen botërore. Përveç që e kanë këtë si qëllim parësor, OKB-ja u shërben edhe anëtareve të saj në mënyra të ndryshme.

OKB-ja ka parashikuar forum të vendeve që t'i përparojë qëndrimet e tyre dhe t'i zgjidhë konfliktet pa dhunë.

Ajo mundëson që vendet të bashkëpunojnë që t'i zgjidhin problemet në botë, si: varfërinë, sëmundjet dhe shkatërrimin e mjedisit.

Ajo shërben si simbol i rendit ndërkombëtar dhe identitetit global.

OKB-ja e përparon dhe e koordinon përparimin ekonomik dhe shoqëror të vendeve në zhvillim me idenë se ato probleme krijojnë burime të konflikteve që mund të shpijnë në luftë.

OKB-ja e ndihmon dhe e koordinon punën e qindra agjencive dhe programeve që janë në vetë organizatën dhe jashtë saj.

Ajo po ashtu mbledh dhe boton të dhëna ndërkombëtare.

Selia e OKB-së gjendet në Nju-Jork, SHBA. Në të aktualisht janë anëtare 192 shtete.

OKB-ja ka më shumë trupa, mes të cilëve edhe Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Ai është organ i Kombeve të Bashkuara i cili e ka për detyrë ta ruajë paqen dhe sigurinë e kombeve. Edhe pse organet e tjera të OKB-së mund t'i japin vetëm rekomandime qeverive të vendeve anëtare, Këshilli i Sigurimit ka fuqi të marrë vendime të cilat vendet anëtare e kanë patjetër t'i zbatojnë. Vendimet e Këshillit janë të njohura me emrin rezoluta. Kryesia me Këshillin është me rotacion dhe zgjat 1 muaj.

PUNËTORIA III-9.5: HISTORIA E BE-SË

MATERIALE

- Fletë punë për nxënësit: Historia e BE-së
- Letër për të shkruar
- Pajisje për të shkruar
- Tabelë dhe shkumës



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë fëmijët qëndrojnë në rreth dhe secili duhet të tregojë se në cilin shtet evropian do të dëshironte të udhëtojë dhe për këtë të tregojë dy arsye. Për shembull: “Dua ta vizitoj Spanjën që ta shikoj lojën Real – Barcelona dhe të takohem me një djalosh që e njoftova para dy viteve në pushim”.

AKTIVITETI KRYESOR 1

Të gjithë fëmijët ndahen në grupe dhe secilit i jepet nga teksti i integral për BE-në nga pajisja e nxënësve “Historia e BE-së”. Detyra e tyre është që ta lexojnë tekstin, ndërsa pastaj secilit grup përmes numëratores i jepet nga një pjesë, ndërsa detyra e tyre është që t’i mendojnë së paku dy pyetje me tre përgjigje të ofruara nga pjesa e tyre. Pastaj duhet të bëhet kuiz dhe secili e parashtron një pyetje, ndërsa grupet e tjera, duke e ngritur fletën ku shkruan a., b., ose c., vendosin se cila është përgjigje e saktë. Grupet i kanë nga 10 sekonda që të mendojnë e të merren vesh. Ndërkohë arsimtari e vizaton në tabelë dhe në të i shkruan pikët e secilit grup – një përgjigje e saktë sjell një pikë.

Fitues i kuizit është ai grup/ato grupe që kanë më së shumti pikë.

Vërejtje: Derisa nxënësit të mendojnë pyetje, arsimtari duhet të jetë aktiv dhe vazhdimisht t’i mbikëqyrë dhe orientojë fëmijët. Pyetjet nuk guxojnë të jenë pyetje me “truk”; nuk guxojnë të kenë më shumë se një përgjigje të saktë; përgjigja patjetër duhet ta përmbajë tekstin e ofruar dhe duhet t’i referohet një gjëje që është relativisht e rëndësishme.

DISKUTIM 1

1. Çka ju bëri më shumë përshtypje nga ajo që u prezantua?
2. A është Maqedonia anëtare e Bashkimit Evropian? E a ka aspirata të bëhet?
3. Pse shtetet dëshirojnë të bëhen pjesë e BE-së?

AKTIVITETI KRYESOR 2

Nxënësit ndahen në numër çift të grupeve me nga pesë nxënës. Pastaj formojnë çifte nga grupet. Në secilin çift të grupeve njëri grup e ka për detyrë që në një fletë e madhe të letrës t’i shkruajë anët E MIRA, përkatësisht dobitë e shteteve nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian, ndërsa grupi tjetër i çiftit duhet të theksojë se cilat, sipas mendimit të tyre, do të ishin anët E KËQIJA, përkatësisht mangësitë e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Pasi të përfundojnë, ata do të duhet t’i këmbëjnë fletët e punës dhe t’i plotësojnë ato. Pastaj nga një përfaqësues i secilit grup e prezanton punën e tij dhe e ekspozon punën e tij në një vend të dukshëm.



DISKUTIM 2

1. Cilat janë sipas jush dobitë e një vendi nga anëtarësimi në BE?
2. E cilat janë anët e dobëta?
3. A ka vetëm anë të mira apo vetëm anë të këqija?
4. Çka mund të bëhet që të zvogëlohen anët e këqija?

PËRFUNDIM

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian nënkupton edhe shumë dobi për vendet anëtare. Dobitë janë me karakter ekonomik, sociologjik dhe kulturor. Llojllojshmëria e kulturave dhe kombeve e pasuron diturinë e secilit prej nesh. Njerëzit e këtyre vendeve mund të udhëtojnë lirisht, të studiojnë në cilindo universitet të vendeve anëtare. Nga ana tjetër, si dobi negative është edhe mundësia për rritjen e kriminalitetit, qëndrimet ilegale të personave të vendeve të treta etj.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

kanë hequr dorë, kanë qenë progresivë dhe të palëkundur. Veprat e tyre janë shembuj për shumë gjenerata që do të vijnë.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Pasi të përfundojnë me prezantimin e të gjitha grupeve, secili nxënës në një fletë të letrës do të duhet të shkruajë se cili nga personalitetet e dhëna i ka lënë më shumë përshtypje dhe me çka ai i ngjason atij. Arsimtarja pyet duke i ngritur duart se cili personalitet u ka bërë më shumë përshtypje, duke i përmendur emrat e personaliteteve dhe kërkon që të gjithë fëmijët t'i ngrënë duart që të tregojnë se kush e ka zgjedhur personalitetin përkatës. Pastaj të gjithë i marrin me vete fletat e shkruara.

REFLEKTIM


1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA III-10.2: ÇMIMI NOBËL

MATERIALE

- Tabelë dhe shkumës
- Letra të vogla për të shkruar
- Fletë punë për nxënësit: Tekst i shkurtër me informacione për çmimin Nobël
- Fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: Fituesit e çmimit Nobël
- Fletë punë për nxënësit: Fituesit e çmimit Nobël
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI KRYESOR 1

Arsimtari e shkruan në tabelë ÇMIMI NOBËL dhe kërkon që të gjithë nxënësit në fleta të vogla të letrës t'i shkruajnë nga disa gjëra që i asocojnë në atë që është shkruar.

Pastaj nxënësit ndahen në pesë grupe dhe secilit grup i jepet nga një letër e prerë e fletës së punës për nxënësit "Tekst i shkurtër me informacione për çmimin Nobël". ecili grup duhet ta lexojë tekstin e tij dhe të bisedojë për të, ta plotësojë me informacionet që i ka, e pastaj nga një përfaqësues i secilit grup duhet ta prezantojë tekstin e tij të plotësuar me dituritë dhe informacionet e tij para të tjerëve. Pas përfundimit të prezantimeve, arsimtari shkurtimisht i rezymon dhe krijon lidhshmëri ndërmjet prezantimeve në një tërësi të përbashkët.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Nxënësve të grupeve të njëjta u jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënësit "Fituesit e çmimit Nobël", ku ata duhet t'i lidhin fituesit e çmimit me arritjet e tyre. Pasi të përfundojnë, arsimtari i lexon fituesit dhe fushat e arritjeve nga fleta e punës për arsimtarin/arsimtaren "Fituesit e çmimit Nobël".

DISKUTIM

1. Pse është me rëndësi ndarja e çmimit Nobël?
2. Si ndikon çmimi Nobël ndaj përpjekjeve të mëtejme në fushën ku është dhënë ky çmim?
3. Si kontribuon çmimi Nobël për zhvillimin e njerëzimit?
4. A dini ndonjë njeri nga Maqedonia që është nominuar për çmimin Nobël?

PËRFUNDIM

Çmimi Nobël është mirënjohja më e lartë që u jepet individëve ose grupeve që kanë kontribuar më së shumti për mirëqenien e njerëzimit.

Ai ka bazë të mirë financiare dhe është dedikimi i mjeteve duhet të jetë vetëm për thellimin e gjurmimeve dhe punës në atë fushë. Shuma prej rreth 1.000.000.000 EUR që e merr fituesi i këtij çmimi, duhet të investohet në punën e mëtejme në fushën që është me interes të përgjithshëm për zhvillimin e njerëzimit.

Artisti i Maqedonisë Zhviko Cvetkovski – Cvetin në vitin 2009 është nominuar për çmimin Nobël për paqe me projektin e tij "Lulja e paqes".

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja III-10.2: Çmimi Nobël**Fletë pune për arsimtarin/arsimtare:****FITUESIT E ÇMIMIT NOBËL**

Fitues të Çmimit Nobël	Fusha/të arritura
Albert Ajnshtajn	fizikë / ligji i efektit fotoelektrik
Nils Bor	fizikë / struktura e atomit dhe radiacioni
Marija Skllodosvka Kiri	kimi / zbulimi i radiumit dhe poloniumit
Doroti Kraufut Hodkin	kimi / zbulimi rëntgenik i strukturës së lidhjeve të rëndësishme biokimike
Beri Marshall dhe Robin Voren	mjekësi / roli i baktereve për krijimin e gastritisit dhe t'thatit të lukth
Robert Kuk	mjekësi / studimi i tuberkulozit
Amartja Sen	ekonomi / ekonomika e mirëqenies
Milton Fridman	ekonomi / analiza e shpenzimeve, historia monetare dhe teoria e komplikimi i politikës stabilizuese
Ivo Andriq	letërsi
Perl Bak	letërsi
Nënë Tereza	paqe / ngritja e vetëdijes për varfërinë
Marrtin Luter King	paqe / luftëtar për të drejtat e njeriut

Përmbajtja III-11:

ZHVILLIMI I QASJES KRITIKE NDAJ MEDIAVE

Pritet që nxënësi/nxënësja

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • Të dijë për qëllimet dhe kufizimet e informimit
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mund t'i vendosë informacionet në kontekst të të drejtave të njeriut • Të mund t'i vërejë pasojat negative nga disa informacione të caktuara në media • Të mund t'i kontrollojë informacionet që i merr përmes mediave • Të mund t'i zbulojë gabimet e informimit të mediave • Të mund të krijojë qëndrim personal në lidhje me informacionet e më shumë mediave
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Ta vërejë rëndësinë e informimit të plotë dhe të gjithanshëm • T'i kuptojë pasojat e informimit medial ndaj njerëzve

PUNËTORIA III-11.1: VAJZË DHE “DJALË” NGA REKLAMA

MATERIALE

- Fletë e madhe e letrës
- Tabelë dhe shkumës
- Revista të vjetra Gërshërë
- Ngjitës
- Fletë e madhe e letrës
- Sellotej



AKTIVITETI KRYESOR 1

Arsimtari e ekspozon fletën e tij të punës (ose e shkruan në tabelë) në të cilën më parë i ka shkruar pyetjet e mëposhtme dhe kërkon nga nxënësit të mendojnë dhe sinqerisht secili për vete vete të përgjigjet në ato pyetje.

1. A keni marrë ndonjëherë koment të ligë në raport me pamjen ose madhësinë tuaj?
2. A ju kanë thënë të tjerët në ndonjë mënyrë se ju nuk jeni sa duhet fizikisht joshës?
3. A e keni mërzi ndonjëherë blerjen e veshjes, sepse frikësoheni se të tjerët do të bëjnë koment negative për zgjedhjen tuaj?
4. A keni refuzuar ndonjëherë të merrni pjesë në ndonjë aktivitet që t'ju shmangeni komenteve në lidhje me pamjen tuaj?
5. A keni menduar “të mbani” dietë që të mund të futeni në ndonjë madhësi “0”?
6. A keni bërë ndonjëherë koment të ligë për pamjen fizike të dikujt?

DISKUTIM 1

1. Si ndjeheni në ato situata?
2. Prej nga zbulojmë ne ide se si duhet të dukemi?



PËRFUNDIM

Arsimtari thekson se sigurisht secili nga ne, së paku ndonjëherë, është gjetur në situatë të përshkruar në pyetjet e mëposhtme.

Përmes mediave (TV, gazetave, filmave, reklamave, faqeve të internetit ose edhe përmes vido-lojërave) vazhdimisht plasohen informacione për atë se cila pamje fizike është e dëshirueshme. Shumë shpesh ajo pamje fizike është joreale.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Nxënësit ndahen në pesë ose gjashtë grupe dhe ulen përreth bankës. Secilit grup i jepen revista të ndryshme (mund të sjellin edhe vetë prej shtëpie) dhe detyra e tyre është të shohin sesi janë paraqitur femrat dhe meshkujt në reklama, t'i presin ato fotografi dhe t'i ngjisin në fletë të madhe të letrës. Pastaj, në vazhdim të fletës, duhet t'i shkruajnë me marker karakteristikat e njerëzve të reklamave. Pasi të përfundojnë, secili grup e prezanton posterin dhe e ekspozon atë në klasë.

DISKUTIM 2

1. Si ndjeheshit gjatë aktivitetit?
2. Cilat tipare/karakteristika të personazheve të reklamave përsëriten më shpesh?
3. Në çfarë moshe janë ato më së shpeshti?
4. Çfarë gjinie?

5. Si ndikojnë ato te ne kur e shikojmë reklamën?
6. Çfarë mesazhesh përcjellin ato në raport me pamjen fizike?
7. Pse reklamat bëhen ashtu? Çka dëshiron prodhuesi i një produkti të caktuar të arrijë me këtë?
8. A e promovojnë këto reklama shëndetin e njerëzve ose janë të orientuara drejt promovimit të prodhimit edhe me çmim të jetesës së pashëndetshme?
9. Çfarë mesazhesh që ju i konsideroni si të rëndësishme janë lëshuar këtu?
10. Sa është e rëndësishme pamja e jashtme për të rinjtë? Pse?
11. Çka mendoni për thënien Bukuria e njeriut është në shpirtin e tij, e jo në pamjen e tij”?
12. Sa duket në kohën tonë kjo thënie e thjeshtë dhe e zbrazët?
13. Si mund ta gjallëroni këtë thënie? Çka mund të bëni në mjedisin tuaj (klasë) që kjo thënie të jetohet? Në çfarë mënyre konkrete mund të silleni me njëri-tjetrit që ajo të bëhet realitet për ju?



Nxënësit japin ide sesi mund të sillen/veprojnë, ndërsa arsimtari i shkruan ato në tabelë.

PËRFUNDIM

Qëllimi themelor i reklamave është që të prezantohet dhe të shitet prodhimi i reklamuar. Që të mund ta arrijnë këtë, prodhuesit plasojnë nëpër reklama personazhe jashtëzakonisht joshëse meshkuj dhe femra, shumë shpesh të paraqitur në role stereotipash. Zakonisht ata janë persona të rinj, jashtëzakonisht të bukur, me trup të drejtë dhe të zhvilluar në mënyrë ideale. Prodhimet shumë shpesh reklamohen përmes porosisë NËSE DONI EDHE JU TË BËHENI KËSHU, ATËHERË BLIJENI PRODHIMIN TONË, që mundet, por nuk është patjetër, të thuhet në mënyrë eksplicite.

Paraqitja e shpeshtë e reklamave ndikon ndaj nesh ashtu që fotografitë e prezantuara na imponohen dhe regjistrohen në mendime, andaj ne dëshirojmë të jemi si personat e reklamave. Dëshira e këtyllë na shpie drejt zbatimit edhe të mënyrave jo të shëndosha të jetesës, na bën të heqim dorë nga veçantia dhe individualiteti jonë, gjithë kjo në emër të realizimit të fotografisë së reklamës

Nëpër reklama kryesisht vihet theksi në pamjen fizike, por edhe në vlerat si: garat, pasuria, statusi dhe imazhi i lartë, joshja seksuale etj. Nëpër reklama mungojnë mesazhe dhe paraqitje që u referohen vlerave të vërteta shpirtërore.

Edhe përkundër asaj se pamja e jashtme është shumë e rëndësishme për të rinjtë, megjithatë ekzistojnë edhe vlera të tjera që janë të rëndësishme për ata. Ato mund të respektohen dhe të zbatohen në klasë dhe të kontribuojnë që të gjithë të ndjehen më mirë dhe të jenë më të pranuar.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Nxënësit ndahen në çifte dhe pastaj ndërmjet vete do të duhet t'i tregojnë njëri-tjetrit se çka u pëlqen te tjetri dhe kështu të përmendin një karakteristikë fizike dhe një psikike.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA III-11.2: PJESA DHE TËRËSIA

MATERIALE

- Fletë punë për nxënësit: Pjesë të fotografive
- Fletë punë për nxënësit: Fotografi të plota



AKTIVITETI HYRËS

Nxënësit ndahen në grupe me nga pesë vetë dhe detyra e tyre është që të mendojnë se si do ta paraqesin një lokacion ose hapësirë të caktuar (p.sh.: në autobus, në polin e Veriut, në Hënë, në tualet, në diskotekë), por pa fjalë. Secili grup e zgjedh një lokacion/hapësirë të caktuar dhe merret vesh mes vete sesi do ta prezantojë atë. Pastaj grupet prezantohen një nga një, ndërsa nxënësit e tjerë ia qëllojnë për se është fjala.

AKTIVITETI KRYESOR

Nxënësit ndahen në pesë grupe dhe secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënësit “Pjesë të fotografive”, ndërsa ata do të duhet të merren vesh në grup për atë se çka mendojnë se paraqet fotografia në tërësi dhe kështu të japin shpjegim të shkurtër të tërësisë (çka bëjnë njerëzit e fotografisë, si ndjehen, çka ka në pjesën e fshehur).

Pastaj nga një përfaqësues i secilit grup e thotë mendimin e grupit për fotografinë e parë. Pasi të shprehen të gjithë se çka mendojnë për fotografinë e parë, arsimtarja ua jep të gjitha grupeve “Fotografinë e plotë” e pastaj të gjithë së bashku e verifikojnë se çka në të vërtetë ka pasur në fotografi. Kjo procedurë përsëritet për secilën fotografi.



DISKUTIM

1. A patë ju të gjithë gjëra të njëjta në fotografi kur u mungonte një pjesë?
2. Me çka e plotësojmë pjesën e fotografisë që na mungon?
3. A kishte mospajtime në kuadër të grupit gjatë përcaktimit të rëndësisë së tërësisë?
4. Pse aq ndryshe i shikojmë fotografitë? A mund të na ndodhë kjo edhe në jetën e përditshme (ta dimë vetëm një pjesë dhe ta paramendojmë se si është tërësia dhe kështu te gabojmë)
5. Si është ndikimi i mediave ndaj formimit të qëndrimeve dhe mendimeve: në tërësi apo vetëm për një pjesë?
6. Si plasohen zakonisht informacionet në media? A plasohen në tërësi apo vetëm nga një pjesë?
7. Nga çka varet se çka do të plasohet në media?
8. A mund të lihet edhe pa qëllim ndonjë pjesë ose të interpretohet në mënyrë subjektive (në mënyrë që u përgjigjet disa njerëzve të caktuar)?
9. Duke u nisur nga ajo se mediat mbajnë anë, si mund ta dimë se çka ndodhë në të vërtetë në jetë?
10. Si mund ta shikojmë në tërësi gjithë ngjarjen?

PËRFUNDIM

Mediat luajnë rol jashtëzakonisht të madh në formimin e qëndrimeve dhe mendimin e fëmijës. Ato ndikojnë që njerëzit shumë shpesh të marrin qëndrim ose të krijojnë mendim për diçka pa i pasur parasysh të gjitha ose pjesën më të madhe të elementeve në një situatë. Në një situatë të tillë mund të gabohet dhe një situatë ose një ngjarje e caktuar të perceptohet në mënyrë krejt tjetër nga situata për të cilën kemi më shumë informacione dhe nga më shumë burime. Mediat

shumë shpesh ofrojnë informacione të pjesshme dhe vetëm një perspektivë të paraqitjes. Kjo mund jetë për shkak të politikës redaktuese të informacioneve ose për shkak të subjektivitetit të raportuesit. Kur kemi vetëm informacion të pjesshëm, atëherë vetë ne e plotësojmë atë në mënyrë subjektive, sipas përvojës sonë, sipas nevojave, qëndrimeve dhe dëshirave tona – që shumë shpesh është joobjektive. Fëmijët duhet të kërkojnë informacione, por edhe të jenë kritikë ndaj informacioneve që i marrin nga mediat dhe duhet të përpiqen të marrin sa më shumë informacione të ndryshme dhe kështu ta krijojnë mendimin e tyre në bazë të të gjitha informacioneve që i kanë.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Përmbajtja III-12:

**SHFRYTËZIMI I INSTITUCIONEVE
PËR MBROJTJE DHE SIGURI**

Pritet që nxënësi/nxënësja

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> T'i dijë procedurat e veprimit para institucioneve të caktuara
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> Të mund të kërkojë ndihmë nga institucione të caktuara në mënyrë adekuate
Qëndrime/ vlera	

PUNËTORIA III-12.1: LETRA KRYETARIT TË KOMUNËS

MATERIALE

- Tabelë dhe shkumës
- Fletë punë për nxënësit: Letra kryetarit të komunës
- Fleta
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth dhe secili fëmijë e zgjedh, por pa folur fare, një fëmijë nga klasa i cili do të jetë mbrojtësi i tij dhe një “fëmijë” që do të jetë “rreziku”.

Pastaj të gjithë duhet të fillojnë të lëvizin nëpër klasë, me ç’rast secili përpiket të ndalet ashtu që “mbrojtësi” i tij të jetë ndërmjet tij dhe “rrezikut”. Loja është shumë dinamike dhe vetëm pas disa minutave ajo duhet të ndërpritet.

AKTIVITETI KRYESOR 1

Arsimtari kërkon nga fëmijët që t’i numërojnë institucionet e shtetit që kujdesen për mbrojtjen dhe sigurinë tonë, e pastaj i shkruan në tabelë përgjegjësitë e tyre: policia, shërbimet shëndetësore (ndihma e shpejtë, mjekët, motrat medicinale, dentistët), shërbimet komunale (rrugë dhe rrugica, higjiena komunale, ujësjellësi dhe kanalizimi), shërbimi kundër zjarrfikësve, organizatat joqeveritare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, avokati i popullit, shërbimet e inspektimit (ushqim, ujë, të drejtat e konsumatorëve, shkolla).

DISKUTIM 1

1. Si mund t’u drejtohem këtyre institucioneve dhe shërbimeve?

AKTIVITETI KRYESOR 2²

Arsimtari i ndan nxënësit në grupe dhe secilit grup ia jep nga një komplet prej letrave me kërkesa që qytetarët ia kanë drejtuar kryetarit të komunës - Fletë punë për nxënësit “Letra kryetarit të komunës”. Secili grup e përfaqëson Këshillin e Komunës dhe letrën duhet t’ia drejtojë, përkatësisht t’ia dërgojë, shërbimit përkatës dhe t’i rekomandojë se çka duhet të ndërmarrë saktë. Pastaj do të duhet të shkruajë se si mund të ndihmojnë edhe institucionet e tjera dhe/ose qytetarët.

Pasi të përfundojnë, nga një përfaqësues i secilit grup i lexon letrat një nga një dhe tregon se kujt ia kanë dërguar ato, si dhe çka duhet të bëjë secili institucion përkatës, ndërsa grupet e tjera e plotësojnë këtë.

DISKUTIM 2

1. A ju ka ndodhur ndonjëherë në jetë që t’i drejtoheni ndonjë institucioni ose shërbimi për ndonjë ndihmë? Cilit? Si?
 2. Çka mendoni, cili lloj i komunikimit është më efikas: me shkrim apo me gojë? Pse?
 3. Në cilat raste është më mirë të drejtohem me gojë? E në cilat me shkrim?
- Çka mendoni për komunikimin telefonik? Në cilat raste është i qëlluar?

2 Ideja për aktivitetin është marrë nga The Value of Cooperation, Values For Life, Keller, A. and Floersch, G. for The Bureau for At Risk Youth, New York, USA 1993.

PËRFUNDIM

Në secilin shtet ekzistojnë institucione që kujdesen për mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve. Sa herë që konsiderojmë se jemi të rrezikuar ose se kemi nevojë për çfarëdo mbrojtje, ne duhet të drejtohem te ato. Se cilën mënyrë të komunikimit do ta zgjedhim, kjo varet nga nevoja që e kemi.

Mënyra më efikase kur bëhet fjalë për nevojat urgjente është thirrja telefonike, ndërsa kur bëhet fjalë për probleme jo aq urgjente, mënyra më e mirë e komunikimit është me shkrim. Komunikimi me shkrim është i dokumentuar dhe nuk lë mundësi për interpretime të gabuara.

REFLEKTIM


1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA III-12.2: AVOKATI I POPULLIT

MATERIALE

- Fletë pune për arsimtarin/arsimtaren: PËR para Avokatit të Popullit ose JO?
- Gërshërë
- Ngjitës
- Fletë më të mëdha të letrës
- Pajisje për të shkruar
- Sellotej



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth, ndërsa arsimtari në mes të rrethit e vendos një kuti me fletëza. Në secilën fletëz në mes është një pikë, përveç në një prej tyre. Të gjithë nxënësit e tërheqin nga një fletëz dhe e hapin që ta shohin, por nuk ia tregojnë askujt. Ai që do ta tërheqë fletën pa pikë, ai është “kundërvajtësi”. Ai pa u vërejtur nga të tjerët, duhet “ta gjuajë” shikimin e dikujt nga nxënësit e tjerë që janë në rolin e “qytetarëve të ndershëm” dhe, kur t’ia shkelë syrin, qytetari duhet të ulet në ndonjë karrige. “Kundërvajtësi” duhet t’ua shkelë syrin sa më shumë qytetarëve të ndershëm, por të ketë kujdes që mos të vërehet dhe mos të zbulohet nga të tjerët. Kur dikush nga “qytetarët e ndershëm” do të konsiderojë se e di se kush është “kundërvajtësi”, ai mund ta thotë me zë emrin e tij dhe të bëjë me dorë kah ai, duke thënë “(Emrin), ti je kundërvajtësi”. Nëse ia qëllon, loja ndërpritet, ndërsa nëse nuk ia qëllon, loja vazhdon. Nëse edhe pas katër të qëlluarave të pasuksesshme nuk zbulohet “kundërvajtësi”, loja ndërpritet dhe “kundërvajtësi” vetë duhet ta zbulojë identitetin e tij.

AKTIVITETI KRYESOR

Arsimtarja i pyet nxënësit se a e kanë dëgjuar fjalën “Avokati i Popullit” dhe në çfarë konteksti. Përgjigjet e dhëna i orienton dhe me ndihmën e nënpyetjeve duhet t’i shpijë ata drejt përfundimit se: **Avokati i Popullit është organ shtetëror i cili i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve. Detyra e tij themelore është që t’i mbrojtë të drejtat kushtetuese dhe ligjore kur ato shkelen nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet e tjera, si dhe nga organizatat që kanë autorizime publike.**

Pastaj nxënësit ndahen në grupe dhe secilit grup i jepet nga një komplet i prerë i letrave të fletës së punës për arsimtarin/arsimtaren “PËR para Avokatit të Popullit ose JO?” (arsimtari i pret paraprakisht letrat, i palos përgjysmë dhe i ngjet që kështu të fitohen letra në të cilat nga të dyja anët ka tekst. Rastet që janë për t’u nxjerrë para Avokatit të Popullit gjithnjë janë të paraqitura të para në fletën e punës për nxënësit). Nxënësit e kanë për detyrë që ta përcaktojnë se në cilën anë të letrës është paraqitur situata për të cilën personi duhet të ankohet te Avokati i Popullit dhe të gjitha letrat duhet të radhiten në këtë mënyrë.

Pasi të përfundojnë, secili grup e lexon me radhë se çka ka vendosur për vetëm një rast.

DISKUTIM

1. Çka është e përbashkët për të gjitha rastet që duhet të parashtrihen si lëndë para Avokatit të Popullit?
2. Pse është e nevojshme të ekzistojë Avokati i Popullit?
3. Sipas jush, cili është roli i tij më i rëndësishëm?
4. Pse janë falas shërbimet e Avokatit të Popullit?

PËRFUNDIM

Avokati i popullit është organ shtetëror i cili i mbrohet të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve. Detyra e tij themelore është që t'i mbrojtë të drejtat kushtetuese dhe ligjore kur ato shkelen nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet e tjera, si dhe nga organizatat që kanë autorizime publike. Këto organe dhe institucione, përkatësisht të punësuarit në to, mund t'i shkelin të drejtat tona me aktet e tyre (dokumentet e dhëna), me veprimet e tyre (me atë që e bëjnë) ose me lëshimet që i bëjnë (kur bëjnë diçka që nuk është dashur të bëjnë ose nuk e bëjnë siç duhet). Avokati i Popullit i kushton vëmendje të veçantë mbrojtjes së parimit të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive etnike në organet e pushtetit shtetëror, në organet e njësisive të vetëqeverisjes lokale dhe në shërbimet dhe institucionet publike.



Secili qytetar i R. së Maqedonisë dhe secili person tjetër të cilit i janë shkelur të drejtat nga ndonjë organ shtetëror i R. së Maqedonisë, mund të drejtohet te Avokati i Popullit me ankesë. Avokati i Popullit mundet edhe vetë të ngrejë procedurë kur mendon se disa të drejta janë shkelur, por e ka patjetër të marrë pëlqim nga qytetari të cilit konsideron se ia kanë shkelur të drejtat.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja III-12.2: Avokati i Popullit

Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: PËR PARA AVOKATIT TË POPULLIT OSE JO?



<p>1. Personi N.N. ankohet se gjatë një bastisjeje në banesën e tij nga personat zyrtarë të MPB-së i janë shkelur të drejtat dhe i është dëmtuar një pjesë e inventarit.</p>	<p>1. Personi A.A. ankohet se në banesën e tij është kryer vjedhje dhe ia kanë vjedhur shumë sende të vlefshme.</p>
<p>2. Personi T.T. – pjesëtar i një bashkësie etnike joshumicë në Republikën e Maqedonisë ankohet për shkak të veprimeve të ndërmarra për rrënimin e objektit nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, duke theksuar se rrënimi është kryer në bazë të përkatësisë etnike.</p>	<p>2. Personi I.I. – pjesëtar i një bashkësie etnike joshumicë në Republikën e Maqedonisë ankohet se fqinji i tij pa të drejtë ia ka marrë një pjesë të pronës së tij dhe aty e ka ngritur shtëpi.</p>
<p>3. Personi Z.Z. ankohet se i janë shkelur të drejtat nga fusha e sigurimit shëndetësor dhe mbrojtjes shëndetësore nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor për shkak se nuk ia njohin të drejtën e kompensimit të rrogës gjatë kohës së pushimit të lindjes.</p>	<p>3 Personi Z.Z. ankohet se gjatë kohës së pushimit të lindjes shefi i saj e ka kërcënuar se nëse nuk kthehet në punë për tre muaj, do ta përzë nga puna.</p>
<p>4. Personi T.T. ankohet se para disa viteve ia kanë hequr të drejtën e ndihmës sociale në para, sepse Qendra e Çështjeve Sociale gjoja gjatë kontrollit të drejtpërdrejtë ka vërejtur se personi jeton në amvisëri të përbashkët me prindërit e tij pensionistë, ndonëse prindërit e tij kanë vdekur qysh moti.</p>	<p>4. Personi J.J. ankohet se farefisi i tij e keqpërdorin dokumentacionin e tij që t'ia ndërpresin të drejtën e ndihmës sociale në para.</p>
<p>5. Personi O.O. ankohet se inspektori komunal në prani të nëpunësit të policisë ia ka ngritur makinën e prishur dhe se gjatë marrjes së makinës ajo edhe më shumë është dëmtuar.</p>	<p>5. Personi M.M. ankohet se derisa makina e tij ka qenë e parkuar në parking, një grup i të rinjve ia kanë shpuar gomat me gozhdë dhe ia kanë gërvishtur derën.</p>

TEMA IV:

UNË DHE SHËNDETI JETA E SHËNDETSHME

Përmbajtja IV-1:

PËRVETËSIMI I SHPREHIVE PËR USHQIM TË SHËNDETSHËM


Pritet që nxënësi/nxënësja

Dituri	<ul style="list-style-type: none">• T'i dijë llojet e ndryshme të ushqimit (vegjetarian, makrobiotik...)• Të dijë se si mund të përdoret ushqimi për parandalimin e sëmundjeve• Ta dijë se cilat janë nevojat e trupit për materie ushqyese (proteina, karbohidrate, vitamina, minerale) për rritjen dhe zhvillimin e rregullt• Të dijë sesi merret ushqimi me rregull (radhitja e ushqimeve)• T'i dijë pasojat e dietave të parregullta dhe të pakontrolluara (për dobësim, për formësim të trupit...)• T'i dijë pasojat e konsumimit të stimuluesve energjetikë (si pije, si ushqim)
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none">• Të mund të zgjedhë ndërmjet ushqimit të shëndetshëm dhe ati të pashëndetshëm• Të mund t'i vlerësojë shprehitë e tij, në raport me cilësinë dhe sasinë• Të mund të përgatitë ushqime të balancuara• Të mund ta konsumojë ushqimin si duhet në kohë të duhur dhe me radhitjen e duhur• Të mund ta kundërshtojë ofertën e ushqimit të dëmshëm / të pashëndetshëm
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none">• Ta pranojë se gjatë ditës duhet të ketë më shumë ushqime të rregullta• Ta pranojë se ushqimi tradicional nuk është çdoherë i mirë për shëndetin• Ta kuptojë se sëmundjet mund të pengohen ose shërohen me të ushqyer të drejtë

PUNËTORIA IV-1.1: MENY

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Meny 1 dhe 2
- Fletë pune për nxënësit: Llojet e të ushqyerit 1, 2 dhe 3
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITET KRYESOR

Nxënësit ndahen në gjashtë grupe. Secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënësit “Llojet e të ushqyerit”. Atyre u lihen nga 10 minuta që ta shikojnë dhe ta mësojnë atë. Duke qenë në grupin e tyre, ata duhet të përcaktojnë role që do t'i aktrojnë, një pjesë e fëmijëve duhet të jenë mysafirë që do të porosisin aperitiv dhe ushqim kryesor, i cili do të përkojë me llojin e ushqimit që e kanë në fletën e punës, ndërsa një pjesë e fëmijëve duhet ta aktrojnë personelin e ndonjë restoranti.

DISKUTIM

1. Për çfarë lloje të të ushqyerit bëjmë fjalë sot?
2. Si ushqehen veganët?
3. Si ushqehen vegjetarianët?
4. Si është kuzhina makrobiotike?
5. Pse në rastet tuaja veganët i zgjedhën pikërisht ato gjëra?
6. Pse vegjetarianët i zgjedhën pikërisht ato gjëra?
7. Çka ju shtyri të zgjidhni për ushqim makrobiotik?
8. Cilat gjëra ndikojnë ndaj përcaktimi të njerëzve si do të ushqehen?
9. Cilat janë ushqimet tipike për kulturat që jetojnë në Maqedoni?
10. A ka ushqime që janë të rëndësishme për bashkësi të ndryshme etnike në Maqedoni? A ka ushqime që janë specifike vetëm për një bashkësi të caktuar që jeton në Maqedoni?
11. Kush vendos për atë se a do të hamë diçka apo jo?

PËRFUNDIM

Njerëzit në Maqedoni në masë më të madhe ose më të vogël bëjnë zgjedhje të vetëdijshme çka do të hanë/fusin në trupin e tyre. Informacionet për zgjedhjet e mundshme të përgjithshme në mënyrën e të ushqyerit u mundësojnë fëmijëve që më shpesh të mendojnë rreth zgjedhjes së ushqimit në një nivel më të lartë. Ekzistojnë lloje të ndryshme të të ushqyerit që zgjidhen nga motive të ndryshme: shëndetësore, religjioze, morale ose të tjera. Ka ushqime që janë karakteristike për të gjitha kulturat në R. e Maqedonisë, siç janë sarma dhe musaka, ndërsa ka të tjera, si mishi i fshatit që është më karakteristik vetëm për maqedonasit. Secili e ka të drejtën e tij që të zgjedhë se me çka do të ushqehet.

REFLEKTIM


1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA IV-1.2: USHQIM PËR SHËNDET

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: sëmundje-gjendje – të prera qysh më parë
- Fletë pune për nxënësit: produkte
- Fletë pune për nxënësit: pjatë



AKTIVITET KRYESOR

Nxënësit ndahen në shtatë grupe (mjafton edhe nëse janë në çifte ose në tresha). Secilit grup e tërheq një copë nga fleta e punës për nxënësit “Sëmundje-gjendje”, e pastaj e merr edhe nga një kopje të fletës së punës “Produkte” dhe “Pjata”. Detyra e tyre është që të zgjedhin nga produktet e ofruara, sipas asaj që shkruan në fletën e tërhequr, se a do t’i vendosin ato në pjatë si diçka që rekomandohet për konsumim në atë gjendje, si diçka që na rekomandohet dhe që nuk na bën dëm dhe të tilla që, sipas tyre, aspak nuk duhet të konsumohen në atë gjendje. Nga nxënësit kërkohet që të shtojnë së paku edhe diçka në të tria kategoritë e pjatës. Grupet e ekspozojnë atë që e kanë punuar. Gjatë kohës së prezantimit të grupeve arsimtari i parashtron nënpyetje secilit grup.

DISKUTIM

1. Çka është mirë të hamë kur jemi të sëmurë?
2. Çka është mirë të pimë kur jemi të sëmurë?
3. A dini ndonjë tipar shërues të produkteve ushqimore? A mund të ndikojë ushqimi dhe mënyra e të ushqyerit ndaj shëndetit? Si?
4. A mund të vijë trupi jonë në gjendje që të bëhet më pak rezistues ndaj gripave dhe ftohjeve vetëm me mënyrën e të ushqyerit?



PËRFUNDIM

Shëndeti jonë në masë të madhe varet nga ajo se si ushqehemi, pa marrë parasysh se a jemi të sëmurë apo jo. Marrja e rregullt e lëngjeve, e ushqimit të freskët si pemë dhe perime, ndihmon shumë për gjendjen e përgjithshme të trupit. Kur jemi të sëmurë, në veçanti duhet të kemi kujdes që të pimë sa më shumë lëngje dhe vitamina natyrore. Gjatë ftohjeve, gripave dhe çrregullimeve në bark është shumë me rëndësi të pihen lëngje në sasi të mëdha. Në këto raste është mirë të shtrydhet lëng portokalli, limoni, grejpfruti etj., që përveç se janë lëngje, kanë edhe vitaminë C dhe sheqer pemësh. Pastaj vijnë çajet, më së miri çajet natyrore: kamomila – që ka ndikim antibiotik dhe antimiotik, nane – për shtrëngime në bark, shpirti i nënës, çaj mali, çaj kaçe etj. Në ato raste duhet të konsumohet ushqim i lehtë, jo i yndyrshëm, i freskët, me shije të thartë që e ulë temperaturën, supa etj.

Për lukth të çrregulluar rekomandohet ushqim i lehtë, neutral dhe jo me shije të fortë, si patate e zier, oriz ose peksimet, pa mëlmesa dhe në sasi të vogla. Gjatë gjendjes së jashtëqitjes dhe vjelljes me rëndësi është të merren lëngje dhe minerale për shkak të rrezikut të dehidrimit.

Në uljen e temperaturës ndihmon vitamina C, si dhe lëngjet.

Hudhra është antibiotik shumë i fortë, po ashtu edhe mjalti, pluhuri i luleve, propolisi ... Hithrat, thjerrëzat, kakao dhe kanella janë shumë të pasur me hekur.

Nëse në trupin tonë nuk marrim vitamina dhe minerale, nëse marrim vetëm ushqim të njëjtë pa vlera ushqimore, sigurisht se imuniteti i organizimit mund të na bie.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Nxënësit ndahen në grupe me nga katër fëmijë. Secilit grup i jepen nga disa minuta që të merret vesh dhe ta shkruajë me trup/ta prezantojë (në skenën e fundit fëmijët qëndrojnë - nuk lëvizin - për shembull, një fëmijë e shkruan shkronjën “U” – qëndron drejt dhe një dorë e mban të shtrirë nën kënd) njëerën nga këto fjalë:

- HUDHËR
- MJALTË
- ÇAJ
- LËNG
- SUPË

Nëse numri i grupeve është më i madh, disa ose të gjitha fjalët mund të përsëriten.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA IV-1.3: GAZETAT

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Copa të prera të gazetave 1 dhe 2
- Fletë pune për nxënësit: Përqindjet e trasha
- Fletë pune për nxënësit: Baraspesha
- Pajisje për të shkruar
- Fleta të vogla të letrës (2x7cm – më së miri është të jenë të përdorura nga njëra anë)



AKTIVITETI HYRËS

Secili fëmijë e vizaton në letër një rreth të thjeshtë. Rrethi duhet të jetë i ndarë në dy pjesë të pabarabarta sipas asaj sa mendojnë fëmijët se kalojnë kohë ulur, e sa kalojnë në aktivitet fizik. Në të dyja pjesët shkurtimisht duhet të shkruhet se çka bëjnë derisa rrinë ulur dhe çka bëjnë derisa merren me ndonjë aktivitet fizik. Pastaj fëmijët ndahen në çifte dhe secili fëmijë i çiftit i shpjegon fëmijës tjetër se si e ka ndarë rrethin dhe ia shpjegon aktivitetet që i ka shkruar brenda.

AKTIVITET KRYESOR

Nxënësit ndahen në grupe me nga katër deri në gjashtë fëmijë. Gjysmës së grupeve u jepen fleta punë për nxënësit “Copa të prera të gazetave 1” dhe “Përqindje të trasha”, ndërsa gjysmës tjetër i jepen “Copa të prera të gazetave 2” dhe “Përqindje të trasha”. Pasi t’i lexojnë mirë materialet që i kanë marrë, ata duhet të bisedojnë dhe të mendojnë një moto ose parullë me të cilën në mënyrë të qartë pasqyrohet, tregohet ose theksohet ndonjë aspekt i jetës së shëndetshme që është përfshirë në fletat e punës.

Grupet duhet të merren vesh mes vete dhe të zgjedhin ndërmjet disa aspekteve të tilla dhe në fund, kur të zgjedhin, duhet ta dinë se pse pikërisht atë parullë/aspekt e kanë shfrytëzuar. Pastaj secili fëmijë e shkruan parullën për të cilën ka vendosur grupi në së paku pesë fletë të vogla dhe secilën fletë e mbështjellë. Pastaj grupet e prezantojnë dhe e shpjegojnë punën e tyre, ashtu që shkurtimisht do ta shpjegojnë atë që ka qenë e shkruar në fletët e tyre të punës, e pastaj të shkruajnë se çka kanë punuar.

DISKUTIM

1. Pse e zgjodhët pikërisht atë parullë?
2. Çka na mëson ajo?
3. Pse zgjodhët ta trajtoni pikërisht atë aspekt të shëndetit?
4. Cilat gjëra të fletës së punës ju lanë më shumë përshtypje? Pse?
5. A kishte gjëra që nuk i kishit të qarta?
6. Pse është janë të rrezikshme kilogramët e tepërta në trup?
7. Si e motivon shtimin e kilogramëve të tepërt mënyra bashkëkohore e jetës?
8. A e keni ditur se sheqeri është i rrezikshëm? E zëvendësuesit e sheqerit?
9. E kripa? Cili është rreziku nga konsumimi i sasive të mëdha të kripës?
10. E ushqimet për përtyypje më shumë kalori?
11. Çka mund të bëhet që mos të vihet deri te ajo? (ushqimi i shëndetshëm, aktiviteti)
12. Si duhet të ushqehemi? Çka duhet të hahet e çka duhet të shmanget?
13. Si mund t’ua tregojmë këto gjëra njerëzve që janë të rëndësishëm për ne, por që nuk mund të vijnë në orë? (orientohet drejt propozimeve që përfshijnë fleta në të cilat është shkruar



PUNËTORIA IV-1.4: LETRA E DOBISHME E VARGËZUAR

MATERIALET

- Një fletë në të cilën është vizatuar një shigjetë
- Fletë pune për nxënësit: Sheqer
- Fletë pune për nxënësit: Mesazh elektronik

AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimtari e mban në dorë një fletë në të cilën është vizatuar një shigjetë e madhe. U tregohet nxënësve se ajo është shigjetë e tastierës së kompjuterit, ndërsa të gjithë ata janë personazhe të lojës së kompjuterit. Personazhet e kësaj loje lëvizin ashtu siç shtypen shigjetat e tastierës, lirisht në monitor (hapësirën e rrethit)

Në fillim kërkohet nga nxënësit që të radhiten në mes të rrethit ashtu që të ketë mjaft vend ndërmjet tyre (edhe para-prapa edhe majtas-djathtas). Pastaj filloj loja. Arsimtari e kthen fletën ashtu që shigjeta i tregon dy drejtime, lart-poshtë-majtas dhe djathtas, me intervale të caktuara kohore nga një rrotullim në rrotullimin tjetër të shigjetës. Nxënësit duhet të lëvizin sipas asaj siç paraqitet shigjeta, ndërsa arsimtari shpjegon se ajo është një lojë e vjetër dhe e padhunshme, ashtu që personazhet lëvizin ngadalë dhe kanë kujdes të mos lëndohen mes vete.

AKTIVITET KRYESOR

Nxënësit ndahen në grupe me nga tre ose katër persona. Me rëndësi është që secili grup të ketë së paku nga një fëmijë që di të dërgoj porosi e-mail. Të gjitha grupeve u jepet nga një kopje e fletës së punës “Sheqeri” dhe “Mesazhi elektronik”. Pastaj secili grup duhet të zgjedhë ndërmjet dhjetë dhe pesëmbëdhjetë shkaqeve të fletës së punës “Sheqeri” dhe t’i përfshijë në fletën e punës “Mesazhi elektronik” Ata duhet të bisedojnë dhe të merren vesh se pse i kanë zgjedhur pikërisht ato, e jo ndonjë tjetër. Pastaj grupet prezantohen.

DISKUTIM

Diskutimi zhvillohet sipas atyre gjërave që nxënësit i zgjedhin dhe i shpjegojnë se pse i kanë zgjedhur pikërisht ato.

1. A i kishit të njohura këto gjëra? Cilat?
2. Në cilat produkte ka sheqer?
3. A do të vazhdoni të futni sheqer pa menduar më shumë?
4. A duhet të heqim dorë plotësisht nga sheqeri? Pse?
5. A ka zëvendësim për sheqerin e bardhë? Çfarë?

PËRFUNDIM

Rrallë kush e shikon sheqerin si rrezik – ndonëse rreziqet e konsumimit të sheqerit janë të shumta. Zëvendësimet artificiale janë, nëse jo më shumë, së paku po aq të dëmshme për shëndetin. Një pjesë e tyre janë edhe kancerogjene, ndërsa të gjithë ndikojnë në organizëm duke nxitur apetit. Zëvendësimi i vetëm për to është sheqeri i pemëve (fruktoza), malteksi dhe shprehitë e konsumimit të ushqimit jo shumë të ëmbël. Nëse duan, fëmijët vërtet mund të dërgojnë porosi elektronike deri te shokët e tyre me përmajtje të menduar në orë.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë lëvizin lirshëm në rreth. Secili fëmijë duhet të japë kompliment për diçka të mirë që fëmija tjetër e ka bërë së shpejti. Këtë duhet ta bëjë së paku për dy-tre fëmijë.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA IV-1.5: PSE TRASHEMI?

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Pse trashemi?
- Fletë pune për nxënësit: Materiet ushqyese – varfërimi
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Secili fëmijë tregon se cili është aktiviteti i tij dashur fizik dhe e bën një hap para në rreth, duke e bërë një gjest ose një lëvizje që është karakteristike për atë aktivitet. (për shembull: nëse dëshiron të luajë basket, mund të bëjë sikur e gjuan topin në kosh).

AKTIVITET KRYESOR

Nxënësit ndahen në grupe me nga tre deri në pesë persona. Secilit grup i jepet nga një kopje e fletave të punës për nxënësit “Pse trashemi” dhe “Materiet ushqyese”. Pastaj në një fletë të veçantë duhet të përshkruhet se si i kuptojnë ata të gjitha gjërat që janë dhënë në fletën e punës “Pse trashemi?”, të shpjegojnë se si e kuptojnë ata këtë fletë të punës në raport me fletën e punës “materiet ushqyese”. Atyre u thuhet se prej tyre nuk kërkohet të dinë gjithçka, po të përpiqen të bëjnë ndërlidhje të thjeshtë të gjërave që janë paraqitur aty. Dy grupet e paraqesin atë që e kanë punuar.

DISKUTIM

1. Çka është toksina?
2. A është e mundur sot të merret ushqim pa toksina?
3. Si hiqen ato prej trupit?
4. Çka nënkuptohet me të ushqyer të baraspeshuar? (përveç tjerash këtu janë edhe recetat e pakontrolluar për dijeta, uria e tepërt ose konsumimi vetëm i një lloji të ushqimit)
5. Çka është dijeta?
6. A ka dietë që është e mirë për të gjithë?
7. Kush mund ta rekomandojë atë?
8. Çka do të thotë uria e vetëdijshme? A është e rrezikshme? Pse?
9. Si do të dukej të ushqyerit e baraspeshuar?
10. Cili është shkaku për apetitin e shtuar sipas fletës së punës?
11. Çka na tregojnë tabelat e fletës së punës “Materiet ushqyese – varfërim”?
12. Çka ndodhë me produktet ushqyese? Çka është shkak për atë?
13. Si duhet të përshtatet të ushqyerit sipas asaj që e bëmë sot?



PËRFUNDIM

Mënyra bashkëkohore e të ushqyerit shumë shpesh shkakton rritje të peshës trupore. Kjo pjesërisht është edhe për shkak të mënyrës jocalësore të të ushqyerit, por edhe për shkak të materieve të varfëruara ushqyese (nutrientëve) në perime dhe pemë, kjo si pasojë e dëshirës për prodhim të shpejtë, jocalësor dhe të pakontrolluar të ushqimit në botën bashkëkohore. Toksinat janë materie të ndryshme helmuese me prejardhje organike dhe joorganike që ne i fusim në organizmin tonë. Praktikisht dhe fatkeqësisht në kohën tonë nuk është e mundur të gjendet ushqim pa një dozë toksinash, pikërisht për shkak të ndotjes brutale të mjedisit natyror, por ekzistojnë dallime në sasinë e toksinave në prodhime të ndryshme. Po ashtu ekzistojnë edhe

mënyra të caktuara për mënjanimin e tyre prej trupave tanë, siç janë konsumimi i lëngjeve, aktivitetet fizike, dietat e caktuara ose agjërimet etj.

Shumë dieta që bëhen të popullarizuara në fakt nuk kanë bazë mjekësore. Është e rrezikshme që të zbatohet dietë që nuk është rekomanduar nga mjeku i specializuar për këtë. Sidoqoftë nuk mund të ekzistojë dietë që do të ishte e mirë për secilin.

Në shumicën e rasteve shkak për trashje është të ushqyerit jocalësor.

Në kohën tonë po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme që të konsumohen perime dhe pemë në sasi sa më të mëdha, për shkak të varfërimit të tyre nga nutrientët.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Fletat e punës “materiet ushqyese” u ofrohen fëmijëve si ndihmë. Secili fëmijë e thotë emrin e pemës së dëshiruar dhe tregon se cilat materie ushqyese i përmban ajo.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA IV-1.6 GJURMIMI

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Fleta kontrolluese
- Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Pyetje
- Fletë pune për nxënësit: Rezultatet e gjurmimit
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITET KRYESOR

Të gjithë nxënësit, bashkë me arsimtarin, e bëjnë një vizitë në shitore, furra dhe shitore sandviçesh përreth shkollës, përkatësisht deri në ato vende kur nxënësit blejnë ushqim më shpesh gjatë pushimit të gjatë. Nëse është vetëm një vend i tillë, vizitohet vetëm ai, ndërsa nëse ka më shumë, me rëndësi është të vizitohen së paku tre-katër prej tyre që janë më të njohur. Me rëndësi është të kemi kujdes ndaj sigurisë gjatë lëvizjes së tërë klasës. Po ashtu duhet të mundësohet atmosferë konstruktive gjatë vizitës së shitoreve me ushqim. Kërkohet nga të punësuarit aty të plotësojnë një listë ose ata të flasin e një nxënës të shkruajë se cilat janë produktet më të shpeshta që blihen në pushimin e gjatë nga nxënësit.

Pasi t'i vizitojnë shitoret, të gjithë kthehen në klasë. Arsimtari i fton nxënësit që të numërojnë se çka hanë ata më shpesh derisa janë në pushimin e gjatë dhe ato i shkruan në tabelë. Pastaj i shkruan edhe ato gjëra nga fleta e punës “Pyetje”. Pastaj nxënësit ndahen në çifte dhe secilit çift i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënës “Fleta kontrolluese”. Sipas asaj që është dhënë aty, nxënësit në çifte do të duhet të përcaktojnë se a ushqehen me ushqim të shëndetshëm në shkollë, pra sipas asaj që e blejnë në shitoret përreth.

DISKUTIM

1. A ushqehen nxënësit e shkollës sonë me ushqim të shëndetshëm gjatë pushimit të gjatë? Pse? Çka hahet më së shumti?
2. A ushqehen nxënësit e klasës sonë me ushqim të shëndetshëm? Pse?
3. Pse hamburgerët janë dhënë si shumë të dëmshëm? E tostet? Po byreku?
4. Çka mund të themi për çipset dhe ushqimet për përtytje?
5. E për gjërat e ëmbla? Pse?
6. A mund të ushqehemi me ushqim më të shëndetshëm në shkollë? A mund të konsumojmë më pak gjëra të dëmshme? Si?



PËRFUNDIM

Simitja e qumështit nuk ka materie të dëmshme, por sidomos nuk ka nutrientë të rëndësishëm. Hamburgerët, tostet dhe sandviçët e tjerë zakonisht janë shumë të mbushur me yndyra, ndërsa mënyra e përgatitjes është e keqe, sepse fërgohen në kushte jo të mira, në yndyrë që rrallë ndërrohet, ndërsa cilësia e mishit nuk është e verifikuar. Sallama që përdoret për toste dhe në disa ushqime të tjera, si edhe hamburgerët, bie në grupin e ushqimit jo të shëndetshëm. Byreku po ashtu është i mbushur me yndyra dhe nuk ka asgjë të shëndetshme. Çipsat, smokit dhe ushqimet e tjera për përtytje, përveç kripës, emulgatorëve dhe “përmirësuesit të shijes”, nuk përmbajnë asgjë të shëndetshme. Shumica e çipseve janë shumë seriozisht të dëmshëm për shëndetin, sepse, sipas shumë mjekëve, çipset janë ushqime kancerogjene. Biskotat e ëmbla po ashtu janë të mbushura me sheqer dhe yndyra, si dhe ca gjëra të çokollatës dhe lëngjet e gazuara. Një pjesë e lëngjeve të pemëve nuk përmbajnë sheqer dhe prandaj janë vendosur ndërmjet. Pemët e freskëta dhe perimet, si dhe pemët e thata, farat e pjekura dhe kikirikët, në

masë të madhe e ruajnë përbërjen natyrore dhe nutrientët që janë të rëndësishëm për rritje dhe zhvillim.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Nxënësit ndahen në grupe të vogla dhe e plotësojnë fletën e punës për nxënës “Rezultatet e gjurmimit”. Pastaj duke u marrë vesh me arsimtarin, mund ta ngjisin atë në klasë ose në korridor, madje edhe afër shitores ose qoshqeve të sandviçëve.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja IV-1.6 Gjurmimi**Fletë pune për arsimtarin/arsimtare****PYETJE**

- Sipas përvojës suaj, cilat pesë produkte harxhohen më shumë nga nxënësit kur blejnë ushqim derisa janë në shkollë? (renditni nga ato që blihen më shpesh, pastaj ato që blihen më pak e deri te ato që blihen më rrallë etj.)

Produktet	vizita 1	vizita 2	vizita 3	vizita 4
1				
2				
3				
4				
5				


Përmbajtja IV-2:**KUJDESI PËR HIGJIENËN PERSONALE****Pritet që nxënësi/nxënësja**

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • T'i dijë rreziqet e përdorimit joadekuat të pajisjeve për mbajtjen e higjienës personale • T'i dijë pajisjet e ndryshme kozmetike • T'i dijë pasojat e përdorimit joadekuat të pajisjeve kozmetike • Ta dijë se këmbimi i veshjeve është dukuri johigjienike
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mund të bëjë zgjedhje adekuate të pajisjeve kozmetike • Të mund t'i përdorë si duhet pajisjet kozmetike
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Ta kuptojë se nuk duhet ta këmbejë veshjen me të tjerët • Ta kuptojë se pajisjet kozmetike nuk janë zëvendësim për pajisjet e higjienës personale

PUNËTORIA IV-2.1: PAJISJET KOZMETIKE

VËREJTJE

Paraprakisht kërkohet nga fëmijët që ata të sjellin prej shtëpie pajisje të ndryshme kozmetike për fëmijë dhe të rritur. Ato nuk duhet t'i blejnë, por t'i sjellin nga pak prej shtëpie. Llaqe për flokë, surme, shamponë, kremëra të ndryshme, yndyra, parfume, sapunë, mundësisht në paketim origjinal. Mund të sjellin edhe pajisje që janë harxhuar, por me rëndësi është të ketë ndonjë udhëzim në kuti. Rekomandohet që diçka të sjellë edhe arsimtari, mundësisht më shumë lloje të ndryshme.



MATERIALET

- Pajisje për të shkruar
- Pajisje të ndryshme kozmetike

AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë qëndrojnë në rreth dhe aktrojnë me pantomime, pa zë, një nga një, sesi vënë surme/rregullohen para pasqyrës.

AKTIVITET KRYESOR

Nxënësit ndahen në grupe me nga tre deri në pesë fëmijë. Atyre u jepet nga pajisjet kozmetike të llojeve të ndryshme. Detyra e grupeve të vogla është të shpërndahen në dy grumbuj: pajisje që mund t'i përdorin fëmijët dhe pajisje që mund t'i përdorin vetëm të rriturit – sipas asaj që shkruan në udhëzim. Arsimtari e nxit leximin e udhëzimit, pra nuk duhet t'u referohemi përvojave të kaluara. Pas përfundimit, grupet e prezantojnë zgjedhjen e tyre dhe shpjegojnë se pse e kanë bërë atë zgjedhje.

DISKUTIM

1. Pse ekzistojnë pajisje të ndryshme kozmetike për të rritur dhe për fëmijë?
2. A ka mundësi të ndodhin pasoja nga përdorimi joadekuat, për shembull, të kremit për puçrra nga të rinjtë?
3. A gjetët në udhëzimet e përdorimit paralajmërime që i referohen moshës për të cilën është e dedikuar pajisja?
4. Cilat paralajmërime të tjera i zbuluat në udhëzime? Kujt i referohen ato?
5. Çka rekomandohet më shpesh nëse ndodhë ndonjë përdorim joadekuat? Pse?
6. Çka mendoni për surmet Cila është moshë më e re kur lejohet të përdoren ato?
7. Çka mendoni për kozmetikën, veçanërisht për surmet, që shiten nëpër tezga? A janë ato të sigurta për përdorim?

PËRFUNDIM

Përdorimi i pajisjeve kozmetike rekomandohet të bëhet sa më vonë, sepse edhe nëse nuk janë të dëmshme, ajo janë irrituese dhe kanë efekte ndaj lëkurës, sepse janë plot me kimikate të ndryshme.

Në kohën tonë jemi vërsuar nga pajisje të ndryshme kozmetike që në mënyrë agresive ofrohen në treg, ku kufiri i moshës së konsumatorëve gjithnjë bie më poshtë. Kohëve të fundit ka shumë pajisje kozmetike që janë shumë të lira, por që janë me cilësi të dyshimtë, përkatësisht nuk dihet se a garanton dikush për sigurinë e përdorimit të tyre. Një pjesë e madhe e surmeve dhe pajisjeve të tjera kozmetike, edhe kur përdoren në mënyrë adekuate edhe nga të moshuarit, kanë pasoja të caktuara që mund të jenë nga momente të pakëndshme deri në pasoja të rrezikshme për shëndetin. Veçanërisht i dëmshëm është përdorimi i pajisjeve të ndryshme kozmetike të

të rinjtë që janë në fazën e rritjes dhe zhvillimit të shpejtë. Që të mund të gjenden me pajisjet e tilla, fëmijët duhet të dinë çka, pse dhe si përdoren pajisjet kozmetike.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Fëmijët një nga një në rreth e përfundojnë në mënyrë kreative, por të ndryshme nga gjithë të tjerët, fjalinë e njohur “Pasqyra ime, pasqyra ime...”

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA IV-2.2: KËMBIMI I VESHJEVE

AKTIVITET KRYESOR

Nxënësit qëndrojnë në njërin skaj të klasës, ndërsa arsimtari qëndron në skajin e kundërt. Arsimtari u thotë nxënësve se do të ftojë vullnetarë për disa gjëra. Nëse ka vullnetarë për një gjë konkrete, ata duhet të kalojnë në anën e kundërt, te arsimtari. Pastaj, para se ta lexojë gjënë e ardhshme, ata kthehen në anën tjetër, te nxënësit e tjerë. Nëse nuk ka, arsimtari bën vetëm një pauzë të shkurtër dhe vazhdon me leximin e kërkesës vijuese. Arsimtari po ashtu u thekson nxënësve se duhet të mendojnë mirë para se të vendosin për t'u paraqitur vullnetarë.

- Kërkoj vullnetarë që pa problem do t'i këmbenin kapelat me cilindo në klasë
- Kërkoj vullnetarë që pa problem do t'i këmbenin çorapet me cilindo në klasë
- Kërkoj vullnetarë që pa problem do t'i këmbenin maicat me cilindo në klasë
- Kërkoj vullnetarë që pa problem do t'i këmbenin pantallonat me cilindo në klasë
- Kërkoj vullnetarë që pa problem do t'i këmbenin veshjet e brendshme me cilindo në klasë
- Kërkoj vullnetarë që pa problem do t'i këmbenin atletet me dikë në klasë
- Kërkoj vullnetarë që pa problem do t'i këmbenin dorezat me cilindo në klasë

DISKUTIM

Pyetjet për diskutim formulohen varësisht nga ajo se a janë paraqitur për disa pohime numër i paktë i fëmijëve apo nuk është paraqitur asnjë. Në pyetjet për diskutim ato paraqiten të kombinuara. Për shembull:

1. Pse vetëm një numër i vogël i fëmijëve u paraqitën që t'i këmben kapelat?
2. Pse askush nuk u paraqit që t'i këmben çorapet dhe veshjen e brendshme?
3. E për pantallonat e maicat?
4. E pse kishte disa që do t'i këmbenin dorezat?
5. Pse për gjëra të ndryshme kemi numër të ndryshëm të vullnetarëve?
6. Pse disa gjëra është më lehtë të këmben, e disa më vështirë?
7. A ekziston rrezik në këmbimin e veshjes? Çfarë?
8. Cili është rreziku nga këmbimi i këpucëve dhe çorapeve? Cili është rreziku i këmbimit të maicave dhe pantallonave?
9. E për veshjen e brendshme?
10. A është e rrezikshme të këmben kapelat?
11. Nëse dikë e njohim shumë mirë, atëherë a mund të jemi të sigurt që me atë të këmben veshje apo këpucë?
12. Pse të rinjtë e këmben veshjen?
13. Çka nëse dikush të kërkon një veshje?
14. A mund të kuptohesh në mënyrë negative nëse refuzon të këmbesh veshje?
15. Si është më së miri të veprohet?



PËRFUNDIM

Cilado pjesë e veshjes ose këpucët janë pronë personale dhe pa marrë parasysh se si dhe a është e larë, nuk është e shëndetshme që të këmbehet me të tjerët. Disa pjesë të veshjes thuhet asnjëherë nuk këmbehen, por disa megjithatë nuk është naive të këmbehen. Të tilla janë sandalet, këpucët, atletet, maicat, pantallonat, fustanet, kapelat. Rreziqet ndaj shëndetit janë shumë më të mëdha dhe më afatgjata se “dobitë” afatshkurta nga huazimi i veshjes. Dikush mund të jetë vetën bartës i ndonjë bakteri ose i ndonjë sëmundjeje dhe të jetë rezistues ndaj asaj, por me këmbimin e saj ajo sëmundje mund të përcillet lehtë te bartësi tjetër i veshjes. Ndër më të rrezikshme janë infektimet me kërpudha dhe baktere që shumë vështirë çrrënjosen, e që mund të shpijnë në komplikime serioze.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë lëvizin ngadalë lirisht nëpër klasë. Ata duhet të mendojnë se ndonjë pjesë e veshjes ose këpucëve nuk u rri mirë dhe lëvizin në bazë të asaj. Me rëndësi është që atë të mos e bëjnë ashtu haptazi që të mund të qëllohet se për çka është fjala. Derisa shëtisin, nëse shohin ndonjë fëmijë për të cilin mendojnë se e dinë se për cilën pjesë të veshjes bëhet fjalë që atyre nuk u rri mirë, duhet të bëjnë me gisht dhe të pyesin me një fjalë. Nëse është e saktë, fëmija përgjigjet duke pohuar me kokë, ndërsa nëse nuk është e saktë, fëmija po ashtu në mënyrë joverbale thotë “jo” – duke e lëvizur kokën majtas-djathtas.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Përmbajtja IV-3:**PARANDALIMI I SËMUNDJEVE DHE SËMURJEVE****Pritet që nxënësi/nxënësja**

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • T'i dijë pasojat e dëmshme për shëndetin dhe zhvillimin nga gardëroba joadekuate • T'i dijë rreziqet e tatuazhit dhe pirsingut • T'i dijë simptomat e sëmundjeve infektive seksuale • Ta dijë se si sëmuremi nga sëmundjet infektive seksuale • Ta dijë se me cilat mjete dhe procedura mund të parandalohet përhapja e sëmundjeve infektive seksuale • Ta dijë dallimin ndërmjet HIV dhe SIDA • Ta dijë se si përhapet virusi HIV dhe si sëmuremi nga SIDA • Ta dijë se me cilat pajisje dhe procedura mund të parandalohet përhapja e HIV dhe SIDA
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mund të zgjedhë gardërobë adekuate (jo xhinse të ngushta, jo bluza të shkurtra...) • Të mund t'i dallojë kushtet në të cilat përhapen sëmundjet infektive seksuale • Të mund ta mbrojë vetveten nga sëmundjet infektive seksuale dhe përcjellja e virusit HIV përmes marrëdhënieve seksuale
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Ta pranojë përgjegjësinë personale për mbrojtjen e tij nga sëmundjet • Ta pranojë se të sëmurët nuk guxojnë të stigmatizohen (etiketohen)

PUNËTORIA IV-3.1: VESHJA

AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Kur jepet udhëzimi nga arsimtari, të gjithë luajnë sipas muzikës së tyre të imagjinuar, duke aktruar se janë në ndonjë aheng. Pas një kohe të caktuar, arsimtari e ndërron udhëzimin dhe u thotë se ahengu sapo ka mbaruar dhe se tash janë jashtë dhe se po ecin në këmbë për në shtëpi, se u vjen ftohtë; ata duhet ta aktrojnë atë – secili fëmijë për vete.

AKTIVITET KRYESOR

Arsimtari e vizaton në tabelë një siluetë të thjeshtë të trupit të njeriut. Pastaj i fton fëmijët që bashkërisht t'i përcaktojnë pjesët me të ndjeshme të trupit (abdomen/bark, gjenitalet, kokën, gjoksin).

DISKUTIM

1. A janë pjesët e njëjta të ndjeshme njësoj si te meshkujt ashtu edhe te femrat?
2. Në cilat pjesë duhet të kenë kujdes djemtë e në cilat vajzat?
3. I përcaktoam pjesën e ndjeshme të trupit – si i mbrojmë ato?
4. Si ndikon veshja ndaj shëndetit tonë?
5. Duke i pasur parasysh këto gjëra qysh më parë, si vishemi për në shkollë?
6. E si për aheng?
7. E si në plazh?
8. E për ekskursion?
9. Në çka duhet të kemi kujdes gjatë zgjedhjes së veshjes për raste të veçanta?
10. A bëhen ndonjëherë zgjedhje të pashëndetshme të veshjes? Si?
11. Kush ndikon në atë zgjedhje?
12. A është më me rëndësi që disa orë të jesh çapkën/e apo është me rëndësi shëndeti?
13. Cilat janë pasojat e mundshme nga zgjedhja jo e shëndetshme e veshjes?



PËRFUNDIM

Veshja e mbron trupin tonë nga të ftohtit, e mbron lëkurën nga djegiet, si dhe nga lëndimet. Shumë shpesh për shkak të mosdijes në kombinim me trysinë e mjedisit bëjmë zgjedhje jo të mirë të veshjes. Nga veshjet e ngushta dhe të pakëndshme, nga këpucë të ngushta dhe nga këpucë të larta mund të shkaktohen pasoja serioze dhe të përhershme njësoj si nga veshkat ose barku i pambrojtur.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë shëtisin lirisht nëpër klasë. Në një moment arsimtari e përcakton një fëmijë që duhet të fillojë të ecë në gishta sikur të mbajë take të larta. Ai fëmijë përpiket të prekë në supe sa më shumë fëmijë, të cilët pasi t'i prekë fillojnë të ecin njësoj si ai dhe përpiqen të prekin në sup fëmijë të tjerë.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

PUNËTORIA IV-3.2: HIV – SIDA

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Çek-lista – sa di për Hiv-Sida
- Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Çek-lista – sa di për HIV-SIDA
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Kur jepet shenjë, secili fëmijë duhet ta prekë në sup fëmijën tjetër butë vetëm me një gisht. Derisa realizohet aktivitetet, nuk duhet të flitet dhe duhet të mbahet llogari për sigurinë e të gjithëve. Të gjithë lëvizin derisa arsimtarja të hetojë se të gjithë janë të gatshëm / të japë shenjë për fundin e aktivitetit.

AKTIVITET KRYESOR

Nxënësit ndahen në grupe me nga 3-5 fëmijë. Secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës “Çek-lista – sa di për Hiv-Sida”. Ata duhet të bisedojmë për pohimet e dhëna dhe të shënojnë për secilin se a mendojnë se është e saktë apo jo. Arsimtarja u tregon se prej tyre sigurisht nuk pritet t’i dinë përgjigjet e sakta të të gjitha pohimeve, po vetëm ta përcaktojnë nivelin e diturive. Grupet nuk prezantojnë, por pas përfundimit të aktivitetit i prezanton një përfaqësues para të gjithëve përgjigjet e sakta.

DISKUTIM

1. Çka është HIV e çka është SIDA? Cili është dallimi?
2. Çka do të thotë të jesh HIV pozitiv?
3. Si përcillet virusi HIV?
4. A janë të gjithë njerëzit HIV pozitivë edhe të sëmurë nga SIDA?
5. Si duhet të trajtohen ata njerëz nga të tjerët?
6. A mund të njihet personi që është HIV pozitiv nga pamja e përgjithshme?
7. A do të thotë se nëse dikë e njohim një kohë të gjatë se me atë mund të kemi marrëdhënie seksuale edhe pa prezervativ? Pse?
8. Si mund të mbrohemi nga infektimi? Cili është mjeti më i mirë?
9. Kush duhet “të ketë” prezervativ me vete? Djemtë apo vajzat? Pse?
10. Si duhet të ruhen prezervativët?



PËRFUNDIM

HIV/SIDA është njëra ndër sëmundjet më vdekjeprurëse të kohës sonë. Te njerëzit ekzistojnë ide të gabuara për këtë sëmundje. Që të mbrohemi në mënyrë efikase, më rëndësi është të kemi informacione të vërteta. Prezervativi është mjeti më efikas për mbrojtje nga shumë sëmundje infektive seksuale, përfshirë edhe sëmundjet nga virusi HIV. Edhe njohja më e gjatë me dikë nuk është garanci se mund të kihet seks të sigurt pa prezervativ.

Nëse dikush është seksualisht aktiv/e, pa marrë parasysh gjininë, me vete duhet të mbajë prezervativ. Ato duhen të mbrohen nga goditja, shtypja, burimet e ngrohtësisë ose lagështia. Kuleta nuk është vend i sigurt për mbajtjen e prezervativit. Më rëndësi është të flitet për HIV/SIDA në shkollë. Fëmijëve u ofrohen informacione plotësuese në adresën: www.sakamdaznam.org.mk.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Nxënësit ndahen në grupe me nga tre-katër fëmijë. Duhet të aktrohen situata ku së paku dy fëmijë janë në pozitë të shitësit (në barnatore, shitore, market), ndërsa një ose dy fëmijë vijnë një nga një dhe kërkojnë të blejnë prezervativë.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?




Punëtorja IV-3.2: HIV – SIDA**Fletë pune për arsimtarin/arsimtare:
ÇEK-LISTA – SA DI PËR HIV-SIDA?**

POHIMET	SAKTË	GABIM
Shumica e njerëzve që janë të infektuar nga virusi HIV nuk e dinë se janë të infektuar	X	
HIV përcillet edhe përmes gjidhënies	X	
Virusi HIV gjendet në mbeturinat e zorrës së trashë, në lëngjet nazale (qurra), në djersë, pështymë, urinë, lot, lëng të vjellur		X
HIV përcillet përmes: përqaimit, përshtetjes me dorë, tualeteve publike, pishinave, shoqërimit të përditshëm me person të infektuar nga HIV, nga veshja, teshtitja, kollitja, kafshimi i mushkonjave		X
SIDA është përmbledhje e simptomave dhe infektiveve që paraqiten kur është i dobësuar imuniteti i njeriut nga virusi HIV dhe kur ai person e humb aftësinë që të luftojë kundër sëmundjeve	X	
Njerëzit HIV pozitivë kryesisht janë njerëz me gjendje të përgjithshme të mirë, pa shenja të sëmundjes. Ata mund t'i përmbushin detyrat e tyre të përditshme të punës dhe të bëjnë jetë normale.	X	
Njeriu që është i infektuar me HIV mund ta përcjellë virusin.	X	
Nga momenti i infektimit me HIV e deri në paraqitjen e simptomave të para nuk kalon më shumë se një vit.		X
Personi që e ka virusin HIV në gjakun e tij quhet HIV pozitivë (HIV+)	X	
Për një kohë të shkurtër pas infektimit me virus HIV, i sëmurë njihet lehtë edhe me sy.		X
Infektimi HIV nuk mund të shërohet.	X	
Personat HIV pozitivë ende nuk janë të sëmurë nga SIDA	X	
Virusi HIV nuk përcillet me shiringa, me instrumente për pirsing, me instrumente të tatuazhit ose me instrumente për prerje (thika, skalpelë, brisqe)		X

PUNËTORIA IV-3.3: TRUPAT TANË – VEPRA ARTISTIKE

MATERIALET

- Letër në ngjyra të ndryshme / kolazh
- Sellotej
- Gërshërë
- Pajisje për të vizatuar



AKTIVITETI HYRËS

Nxënësit ndahen në grupe me tre deri në pesë vetë. Ata duhet të merren vesh në grupe sesi t'i përdorin trupat e tyre që ta paraqesin një pikturë ose skulpturë të njohur në çka marrin pjesë të gjithë. Pasi ta mendojnë, duhet ta prezantojnë para grupeve të tjera që duhet t'ia qëllojnë se cilën pikturë ose skulpturë e prezantojnë.

AKTIVITET KRYESOR

Nxënësit ndahen në grupe me nga 3-5 vetë. Në secilin grup të vogël duhet të zgjidhet nga një fëmijë i cili do të pranojë që vullnetarisht “të stoliset”. Fëmija-vullnetar duhet të stoliset në mënyra dhe emetime të ndryshme të stolive reale të cilat njerëzit i përdorin në jetën e përditshme. Për stolisje përdoren ngjyra, kolazh letre dhe pajisje tjetër. Ata duhet të paralajmërohen që mos ta lëndojnë fëmijën që e stolisin ose të përdorin ngjyra drejt në lëkurën e fëmijës.

DISKUTIM

1. Si ndjeheshit derisa e stolisnit vullnetarin?
2. Si ndjeheshit derisa ju stolisnin?
3. Në cilat mënyra trupi jonë ndryshon gjatë jetës?
4. A mund të ndikojmë ne ndaj disa ndryshimeve të jashtme të pamjes?
5. Përveç flokëve, ngjyrës së tyre dhe surmeve, a mund të ndryshohet pamja jonë?
6. Çfarë “stoli” mund të përdoren për ndryshimin e pamjes tonë të jashtme?
7. A ka ndonjë gjë që vajzave ua vënë shpesh qysh duke qenë të vogla?
8. Çka janë vëthët? Prej çka bëhet ato?
9. A i shkaktojnë ato trupit ndryshime të përhershme? A mund të ndikojnë dëmshëm ndaj shëndetit tonë? A janë të rrezikshëm vëthët e materialeve të ndryshme për të gjithë njësoj? Në çka duhet të kemi kujdes dhe çka duhet të dihet nëse dikush dëshiron të vë vëth? Ku është më së miri ta bëjë atë?
10. E çka është pirs/pirsingu? Në cilën pjesë të trupit mund të vihet pirs? Ku është më së miri të bëhet kjo?
11. Çka është tatuazhi? Si bëhet? Në cilat pjesë të trupit mund të vihet tatuazh? E në cilat vihet më shpesh?
12. A mund të jetë tatuazhi i dëmshëm? Ku është më së miri të bëhet kjo?
13. Cilat janë aspektet pozitive e cilat janë aspektet negative nga pirsingu dhe tatuazhi?
14. A janë të ndryshëm nga të tjerët njerëzit që kanë pirsing ose tatuazh?
15. A duhet të mirëmbahen disi pirsingu dhe tatuazhi? Si?



PËRFUNDIM

Disa njerëz dëshirojnë ta stolisin trupin e tyre me vëthë, pirs ose tatuazhe. Pirs mund të vihet në gojë, në vetulla, në hundë, në gjuhë, në organet gjenitale, në veshë... Kjo nuk i bën njerëzit “belaxhinj”, “vagabondë”, nxënës të dobët ose njerëz të rrezikshëm. Nëse dikush dëshiron të vë pirs ose tatuazh, ai duhet ta bëjë këtë në sallon që ka leje për atë veprimtari, se në të kundërtën mund të lindin shumë komplikime/infektive serioze dhe ndezje. Është me rëndësi të dëgjohen këshillat e personit që e ka bërë pirsingun ose tatuazhin. Nëse vërehen disa skuqje të pazakonshme, kruajtje a diçka ngjashëm, për këtë duhet të konsultohet mjeku.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimitarja i fton të gjithë nxënësit që të përkujtohen në ndonjë fjali (mendim) të tyre të dashur. Pastaj të gjithë fëmijët një nga një e thonë fjalinë e tyre të dashur sikur të kenë pirs në gjuhë, derisa të tjerët dëgjojnë.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Përmbajtja IV-4:**ZHVILLIMI I VETËDIJES PËR SHËNDE TIN SEKSUAL****Pritet që nxënësi/nxënësja**

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • T'i dijë ndryshimet trupore dhe fiziologjike që janë rezultat i pjekjes seksuale • T'i dijë mjetet kontraceptive dhe ku mund të gjenden ato • T'i dijë pasojat e pakujdesisë seksuale (shtatzëni e padëshirueshme) • Ta dijë se çka është keqpërdorimi seksual (dhunimi, nxitja në prostitucion, trafiku me njerëz) • Ta dijë se cilat procedura mund të ndërmerren që të kundërshtohet keqpërdorimi seksual • Të dijë ku të kërkojë ndihmë në rast të keqpërdorimit seksual • Ta dijë se ekzistojë orientime të ndryshme seksuale
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mund të vë prezervativ • Të mund ta njohë/reagojë/kundërshtojë shqetësimin seksual në situata e përditshme
Qëndrime/vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Ta pranojë seksualitetin si pjesë natyrore të zhvillimit të njeriut • Ta pranojë se kënaqësia seksuale mund të bazohet në orientime të ndryshme seksuale • Ta dijë se shqetësimi dhe keqpërdorimi seksual janë vepra penale

PUNËTORIA IV-4.1: KUIZ – PUBERTET

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Kuiz – pubertet
- Fletë pune për nxënësit: Përgjigje, shpjegime, këshilla

AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Secili fëmijë duhet ta mendojë një pyetje të lehtë, që ka lidhje me rritjen dhe pubertetin, e pastaj ta bëjë një hap brenda rrethit dhe "ta pyesë publikun" sikur në një kuiz të njohur. Nxënësit e tjerë përgjigjen si në kor.

AKTIVITET KRYESOR

Nxënësit ndahen nën tresha. Secilit pjesëmarrës në grup duhet t'i jepet një kopje e fletës së punës për nxënës "Kuiz – pubertet". Në pyetjet e fletës së punës secili duhet të përgjigjet vetë, e pastaj bashkërisht në tresha të merren vesh për përgjigjet. Për pyetjet ose mendimet "kontestuese" duhet të jepen argumente. Pastaj arsimtarja ua jep fletën e punës "Përgjigje, shpjegime, këshilla", ku nxënësit së pari duhet të shohin se në cilat pyetje janë përgjigjur saktë, e në cilat kanë dhënë përgjigje të gabuar. Atyre u thuhet se sigurisht prej atyre pritët të kenë përgjigje të sakta në të gjitha pyetjet. Pasi t'i shohin përgjigjet e tyre individuale, ata do të duhet në tresha t'i kontrollojnë edhe ato përgjigje që i kanë dhënë me konsensus. Për secilën pyetje duhet të bisedohet – pa marrë parasysh se a ka qenë përgjigja e saktë ose jo. Nëse kanë diçka të paqartë, mund ta përdorin xhokerin "ftoje arsimtaren".

DISKUTIM

1. Çka është puberteti?
2. Cilat ndryshime paraqiten te djemtë gjatë pubertetit? Cilat ndryshime paraqiten te vajzat gjatë pubertetit?
3. A ndodhin këto ndryshime në mënyrën e njëjtë dhe me temp të njëjtë te të gjithë? Si ndodhin? Pse?
4. Çka i shkakton ato ndryshime?
5. Cilat ndryshime të sjelljes paraqiten gjatë pubertetit?
6. A janë të shkaktuara të gjitha nga hormonet?
7. A ka ndryshime në emocione? Cilat? Çfarë?
8. Çka shkaktojnë këto ndryshime? Çfarë ndjenjash dhe përjetimesh?
9. Kujt mund t'i kërkojmë ndihmë? Për çfarë gjëra?
10. A ekzistojnë gjëra për të cilat nuk duhet të bisedohet?
11. Kur përfundon puberteti?

PËRFUNDIM

Ndoshta puberteti është periudha më e stuhishme e jetës së shumë njerëzve. Ajo është periudhë e rritjes dhe zhvillimit të shpejtë. Në pubertet ndodhin shumë ndryshime në aspektin fizik, mendor dhe emocional. Te djemtë ndryshon zëri, fillojnë t'u dalin qime nëpër trup, u varen testiset, paraqiten ereksionet dhe ejakulimet e para. Te vajzat rriten gjinjtë, u ndodhë cikli i parë mujor, paraqiten puçrra, trupat e tyre përgatiten për një funksion të rëndësishëm, njësoj si mendjet e tyre – të bëhet seksualisht të pjekur. Puberteti është vetëm fillimi i kësaj. Trupat janë plot hormone që shkaktojnë përvoja të reja, ndonjëherë edhe përjetime befasuese dhe shqetësuese. Këto përvoja na sjellin edhe emocione të reja të papritura. Të shpeshta janë ato ndryshime në disponimin me intensitet të lartë. Fëmijët në pubertet ndjehen të humbur, kanë

PUNËTORIA IV-4.3: SI TË PËRDORËT PREZERVATIVI?

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Gjeje radhitjen
- Letër
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimtarja i lexon udhëzimet, ndërsa fëmijët grupohen në grupe më të vogla sipas udhëzimit. Secili fëmijë duhet të grupohet sipas ndonjë kriteri të caktuar i cili do të jepet në udhëzim, pa pyetur dhe/ose pa folur fare, ashtu siç do ta kuptojë vetë udhëzimin. Zgjedhja individuale respektohet maksimalisht dhe të tjerët nuk guxojnë të tregojnë, të sugjerojnë ose ta pengojnë cilindo që merr në cilindo grup. Udhëzimet janë:

- Bëni grupe të vogla sipas këpucëve që i mbani: ngjyra, lloji (këpucë, atlete, sandale) ose diçka tjetër.
- Bëni grupe sipas ngjyrës së flokëve.
- Grupohuni sipas sendeve të dëshiruara në shkollë.
- Bëni katër grupe sipas lartësisë.
- Grupohuni sipas numrit të madhësisë së këpucëve.
- Grupohuni sipas stinës në të cilin jeni lindur.

Duartrokitje.

AKTIVITET KRYESOR 1

Nëse gjatë grupimit të fundit bëhen grupe me përafërsisht numër të njëjtë të nxënësve (tre deri në pesë), ato grupe mund të përdoren edhe për aktivitetin kryesor. Nëse nuk mundet kështu, atëherë ndahen në grupe të vogla me nga 3-5 fëmijë. Secilit grup i jepet fleta e punës për nxënësit "Gjeje radhitjen". Në rrathët pranë fotografive ata duhet t'i shkruajnë numrat rendorë nga 1 deri në 5, sipas asaj që mendojnë se është radhitja e vërtetë kronologjike e fotografive.

DISKUTIM 1

1. Pse e bëmë këtë?
2. A e dinte dikush radhitjen e saktë?
3. A duhet të flasim për përdorimin e drejtë të prezervativit? Pse?
4. Pse shërbejnë prezervativët?
5. Ku mund të merren?
6. Kush mund të blejë prezervativ?
7. A vetëm personat e rritur mund të blejnë prezervativë? Vetëm djemtë?



PËRFUNDIM

Prezervativët janë pajisjet më shumë të përdorura dhe me efikasitet për kontracepsion dhe mbrojtje nga infektimet e sëmundjeve seksuale. Po ashtu gjinden kudo. Që të jetë efikas prezervativi, ai duhet të përdoret drejt.

Tabutë e shumta në kulturat tona në lidhje me seksualitetin e njeriut shumë shpesh i vënë të rinjtë në situatë që të futen në marrëdhënie seksuale të pambrojtur dhe pa kurrfarë diturish paraprake, që sigurisht është në dëm të tyre. Secili që është seksualisht aktiv, pa marrë parasysh gjininë dhe moshën, mund të mbajë prezervativ.

Informacione plotësuese për përdorimin e prezervativëve nxënësit mund të gjejnë në adresën e internetit: www.sakamdaznam.org.mk

AKTIVITET KRYESOR 2

- A keni ndonjë pyetje në lidhje me përdorimin e prezervativëve?
- “Nëse keni pyetje, por nuk ndjeheni mirë t’i parashtroni gojarisht, shkruani në letër dhe m’i sillni, të mbështjella, me shkrim të lexueshëm, por anonime (pa emër)”.



Të gjithë nxënësit, pa marrë parasysh se a kanë ose pyetje, ia dorëzojnë arsimtares nga një fletë të mbështjellë. Kjo u thuhet nxënësve qysh më parë, para se të fillojnë të mendojnë rreth pyetjeve. Kështu sigurohet anonimiteti. Pyetjet vendosen në grumbull në bankë ose në ndonjë kuti/sirtar. Arsimtarja i hap dhe i lexon. Nëse nuk janë shumë të pacipa, ajo jep përgjigje për pyetjet përkatëse.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë lëvizin lirshëm nëpër rreth. Arsimtarja u tregon se ajo kërkon nga ata që të qeshen në një zanore të cilën do t’ua thotë arsimtarja. Kjo bëhet në këtë mënyrë:

- “Hajt tash të gjithë të qeshemi me “O”!... OOOOHOHOHOOOOO!” (“Hajt tash të gjithë të qeshemi me zë në “A”!.. AAAAAHAHAHAHAHAH!”). “Hajt tash të gjithë të qeshemi me “I”!... IIIIHHHHHHHHHHH!”
- “Hajt tash të gjithë të qeshemi me “E”!... EHEHEEHEHEHEEHEHEE!”
- “Hajt tash të gjithë të qeshemi me “U”!... UUUUUUHUUHUUUUUUUUUU!”

Qeshja në secilën zanore veçmas duhet të jetë përafërsisht nga gjysmë deri në një minutë. Nëse ka kohë dhe atmosferë, udhëzimet mund të përsëriten.

REFLEKTIM


1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA IV-4.4: PREZERVATIVË PA PARAGJYKIME

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Reagime
- Kutë prej ku mund të tërhiqen disa fleta
- Një paketim prezervativësh
- Një sallatë
- Një faculetë



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Nxënësit i tërheqin nga kutia një nga një fletët nga fleta e punës “Reagime”. Derisa një fëmijë tërheq, të tjerët janë publik. Secili fëmijë e tërheq fletën, e lexon atë që është shkruar në fletë, e mbështjellë fletën dhe e kthen në kuti. Derisa e kthen, e përdor atë kohë që ta mendojnë reagimin tij.

Reagimi duhet të jetë me shprehje të fytyrës, të trupit, pra joverbalisht. Pastaj e prezanton atë para të tjerëve. Pasi të prezantohen të gjithë, jepet një duartrokitje e madhe.

AKTIVITET KRYESOR

1. A e di dikush se çka është prezervativi?
2. A e di dikush se pse përdoret?
3. A e di dikush se si përdoret drejt?
4. Arsimtari prezanton se si përdoret me rregull prezervativi, duke i lexuar këto hapa (nëse ka kushte, mund të kërkojë që në vend të tij disa nxënës të tjerë t'i lexojnë/bëjnë ato në vend të tij ose t'i ndihmojnë):
 - “Shikojeni afatin e skadimit të prezervativit (nëse i ka kaluar afati ose nëse nuk është dhënë fare afati, ai prezervativ nuk guxon të përdoret).
 - Shqyejeni me kujdes mbështjellësin (kujdes që mos ta dëmtoni me thonj, me stoli, me dhëmbë ose me diçka tjetër).
 - Shikojeni me kujdes se cila është ana e brendshme e cila ana e jashtme.
 - Duke e mbajtur majën e prezervativit me njërin dorë, me dorën tjetër futeni në sallatë.
 - Prezervativi hiqet ashtu që përsëri mbahet me njërin dorë në majë, ndërsa më tjetrën tërhiqet.
 - Prezervativi mbështillet me faculetë të letrës dhe nuk bën të lidhet.
 - Prezervativi hidhet në koshin e mbeturinave e jo në kazanin e WC-së.

DISKUTIM

1. A e dini se si përdoret prezervativi?
2. A e keni ditur më herët se si përdoret prezervativi?
3. A e dini se çka janë sëmundjet infektive seksuale?
4. Kë e mbron prezervativi?
5. Pse është me rëndësi të dihen këto gjëra në këtë moshë?
6. A duhet t'i dinë vetëm djemtë këto gjëra? Pse jo?



PËRFUNDIM

Njëra nga pajisjet më të njohura dhe më të sigurta për kontracepsion është prezervativi. Atë e përdorin meshkujt, ndërsa i mbron të dy partnerët nga shtatzënia e padëshirueshme, nga sëmundjet infektive seksuale dhe HIV/SIDA. Meqë është i dobishëm për të dy partnerët, informacione për të duhet të kenë edhe vajzat edhe djemtë. Prezervativi nuk do të jetë efikas nëse nuk përdoret si duhet.

Në kulturat tona shumë pak flitet për përdorimin e pajisjeve për kontracepsion, ndërsa si pasojë e kësaj kemi paraqitje të shpeshta të shtatzënisë së padëshirueshme dhe përcjellje të sëmundjeve infektuese seksuale. Nëse flitet hapur për seksualitetin, kështu krijohet atmosferë ku mund të parashtrihen pyetje. Në atë mjedis gabimet e mosdijes thjeshtësohen në minimum.

Jepuni fëmijëve informacione plotësuese në adresën e internetit: www.sakamdaznam.org.mk

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë në një anë të klasës. Kur jepet shenjë, nxënësit mund të lëvizin drejt anës tjetër. Kur jepet shenjë STOP, ata duhet të ngrijnë pikërisht në atë gjendje në të cilën janë gjetur. Procedura përsëritet disa herë, ashtu që pas secilën ngrirje vazhdohet nga vendii ku janë gjetur të ngrirë.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA IV-4.5: MARRËDHËNIET¹

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Pohime
- Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Pohime



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Secili fëmijë e bën ndonjë lëvizje, gjest ose grimasë për të cilën mendon se është karakteristike për të, ndërsa të tjerët mundohen ta përsërisin. Një gjë mund të bëhet vetëm një herë.

AKTIVITET KRYESOR

Secili fëmijë i jepet një kopje e fletës së punës për nxënësit “Pohime” të cilën ai duhet ta plotësojë në mënyrë të pavarur. Pastaj nxënësit grupohen në tresha kur bashkërisht duhet t’i krahasojnë përgjigjet që i kanë dhënë me ato që arsimtarja i shkruan në tabelë nga fleta e punës për arsimtaren “Pohime” Duke qenë në tresha ata i krahasojnë rezultatet e fletave të tyre të punës dhe japin shpjegim se pse mendojnë se ndonjë pohim është I SAKTË ose GABIM.

DISKUTIM

1. A kishte dikush që u përgjigj SAKTË në të gjitha pyetjet?
2. për cilat pohime kishit më shumë dilema?
3. Çka është tableta për kontracëpsion? Ku blihet?
4. A ekzistojnë pasoja negative nga përdorimi i tabletave për kontracëpsion?
5. Si përcillen sëmundjet infektive seksuale?
6. Cili është mjeti më i mirë për mbrojtje nga sëmundjet infektive seksuale? Pse?
7. Pse as njohja disavjeçare nuk është garanci nga infektimi me virusin HIV?
8. Pse është GABIM pohimi se marrëdhënia seksuale është marrëdhënie ndërmjet dy personave të gjinisë së kundërt?
9. Cila është mosha më e hershme kur mund të kihet marrëdhënie seksuale?
10. Çka është shtatzënia e çka është shtatzënia e padëshirueshme? Si ndodhë ajo?
11. Pse është me rëndësi të dihen të gjitha këto gjëra?
12. Me kë mund të bisedohet për këto çështje?



PËRFUNDIM

Fëmijët në pubertet kanë shumë pyetje dhe përjetime që i shqetësojnë. Ata shumë shpesh futen në marrëdhënie për të cilat dinë pak, jo sa duhet dhe shpesh kanë koncepte dhe/ose të pritura të gabuara. Kjo shpie drejt pasojave të padëshirueshme, frustracioneve dhe shtatzënisë së padëshiruar. Tableta për kontracëpsion jepen vetëm me recetë nga mjeku specialist. Përdorimi i tyre nuk rekomandohet vazhdimisht, pos në raste specifike, sepse mund të shkaktojnë pasoja të padëshirueshme të përhershme, veçanërisht te të rinjtë.

Meqë nuk ka mundësi të njihet personi që është i infektuar nga virusi HIV ose që është i sëmurë me SIDA, as njohja disavjeçare nuk është kurrfarë garancie se ai person mund të ketë marrëdhënie pa mbrojtje. Me marrëdhënie seksuale nuk nënkuptohet vetëm marrëdhënia ndërmjet dy personave të gjinisë së kundërt, përkatësisht marrëdhëniet heteroseksuale, por

¹ Aktiviteti është marrë nga „Spol i Rod pod povećalom-Priručnik o identitetima, seksualnosti i procesu socijalizacije“ CESI, Zagreb, 2000

këtu bien edhe marrëdhëniet homoseksuale, marrëdhëniet mes lejsbejgeve, marrëdhëniet biseksuale, si dhe seksi me më shumë persona. Futja në marrëdhënie seksuale është çështje e vendimit personal. Natyrisht pasi që personi të jetë i pjekur seksualisht, përkatësisht kur të ndjehet se është i gatshëm për aso marrëdhënie. Shtatzënia e padëshirueshme është ngjizja e embrionit që nuk ka qenë e planifikuar.

Përkrahja e të rriturve dhe e moshatarëve është shumë e rëndësishme.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Fëmijët përpiqen ta shkruajnë emrin e tyre një nga një, duke imagjinuar se në hundë kanë ngjyrë dhe ashtu shkruajnë në ajër.



REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja IV-4.5: Marrëdhëniet²**Fletë pune për arsimtarin/arsimtare:
POHIME**


1.	Penetrimi (futja e penisit në vagjinë) është njëra nga mundësitë e marrëdhënies seksuale.	SAKTË
2.	Për penetrim penisi patjetër duhet të jetë i fortë.	SAKTË
3.	Vajza nuk mund të mbetet shtatzënë gjatë menstruacioneve.	GABIM
4.	Tableta kontraceptive mbron edhe nga sëmundjet infektive seksuale.	GABIM
5.	Sëmundjet infektive seksuale përcillen përmes marrëdhënieve të pambrojtura seksuale (pa prezervativ), nga personi i infektuar në personin e shëndoshë, kjo përmes marrëdhënieve vagjinale, anale dhe orale.	SAKTË
6.	Marrëdhënia e ndërprerë është metodë e sigurt e kontracepsionit.	SAKTË
7.	Prezervativi është pajisja e vetme kontraceptuese që mbron në mënyrë efikase nga sëmundjet infektive seksuale, përfshirë edhe HIV/SIDA	SAKTË
8.	Nëse keni seks vetëm me njerëz që i njihni, nuk mund të infektoheni me virus HIV.	GABIM
9.	Në shtatzëni mund të arrihet edhe nëse femra nuk përjeton orgazëm.	SAKTË
10.	Marrëdhënia seksuale është marrëdhënie ndërmjet dy njerëzve të gjinive të kundërta.	GABIM

² Aktiviteti është marrë nga „Spol i Rod pod povećalom-Priručnik o identitetima, seksualnosti i procesu socijalizacije“ CESI, Zagreb, 2000

PUNËTORIA IV-4.6: PYETJE JOADEKUATE – PËRGJIGJE ADEKUATE

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Pyetje joadekuate – përgjigje adekuate
- Fletë pune për nxënësit: Përgjigje adekuate
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë lëvizin në rreth. Secili duhet ta mendojë një pyetje të cilën do t'ua parashtrojë pesë fëmijëve derisa të gjithë lëvizin në rreth. Pyetjet parashtrohen në mënyrë spontane. Kur fëmijët janë në rolin e atyre që përgjigjen në pyetje, ata duhet të përgjigjen me ndonjë përgjigje të çuditshme dhe joadekuate.

AKTIVITET KRYESOR 1

Nxënësit ndahen në 5-6 grupe. Secilit grup i jepet nga një fletë e punës për nxënësit “Pyetje joadekuate – përgjigje adekuate”, i cili duhet t'i lexojë pyetjet në të e pastaj i lidhë me ato përgjigje të fletës së punës “Përgjigje joadekuate” të cilat i konsideron për adekuate, përkatësisht pranë numrit rendor të pyetjes e shënon numrin rendor të përgjigjes të cilën e konsideron për adekuate. Në fund përgjigjet verifikohen në tabelë duke e zhvilluar një diskutim të përbashkët.

AKTIVITET KRYESOR 2

Arsimtarja ua shpërndan nga një situatë prej atyre që janë ofruar (pyetje dhe përgjigje) për çka duhet të merren vesh t'i aktojnë para nxënësve të tjerë. Secilit grup i jepet nga një situatë për aktrim. Në grup zgjidhen nga dy fëmijë të cilët vullnetarisht do t'i aktojnë situatat. Rekomandohet që gjatë kësaj të përdoret teksti i shpërndarë/i shkruar për pyetje ose përgjigje.

DISKUTIM

1. Si ndjeheshit kur aktronit?
2. A ndjeheshit keq?
3. A ka qenë dikush ndonjëherë në situatë që të përpiqet në ndonjë mënyrë të ushtrisë shtypje?
4. Pse këto kërkesa janë joadekuate? Pse këto pyetje janë quajtur “joadekuate”?
5. A mund të kujtohet dikush në shtypje të tjera të ngjashme?
6. Kush e bën zakonisht këtë? A e bëjnë vetëm meshkujt?
7. Si duhet të reagohet?
8. A ju duken reale dhe të mundshme reagimet e ofruara? Pse?
9. Çka mendoni, pse dikush do të përpiquej të ushtrisë këso trsynie?
10. Çka do të thotë marrëdhënia e padëshiruar? Çka nënkupton dhunimi? A është e lejuar apo e arsyeshme marrëdhënia me imponim?
11. Çka mendoni, çka do të nënkuptonte shprehja “sulm seksual ndaj fëmijës”?

PËRFUNDIM

Veçanërisht gjatë pubertetit dhe veçanërisht te personat e rritur shumë shpesh vajzat janë viktima të këtyre trsynive ndaj të cilave shumë shpesh nënshtrohen, për shkak të paditurisë, për shkak të shqetësimit, për shkak se mendojnë se ajo pritet prej tyre, për shkak se i kanë pranuar rolet patriarkale gjinore që i vënë në pozitë të nënshtuar. Shumë shpesh kjo rezulton

me çrregullim të zhvillimit të seksualitetit të viktimat. Por, nuk janë vetëm vajzat viktimat. Këto kërkesa janë quajtur më butë “joadekuate” – ndonëse në fakt bëhet fjalë për trysni/shtypje – sepse aty nuk respektohet qëndrimi/nevoja e personalitetit, ka orvatje për trysni, ka nënçmim emocional, me diçka që nuk ka lidhje me tjetrin. Në vend se të respektohet qëndrimi i personalitetit, manipulohet me atë që bëhet përpjekje që personi të ndjehet fajtor, borxhli, të ketë brejtje të ndërgjegjes për gjëra që janë krejt normale dhe natyrore. Nga ana tjetër djemtë janë viktimat të të priturve joreale ose të priturve të imagjinuara që i ka mjedisi për ata: se dinë gjithçka dhe nuk duhet të jenë të shqetësuar, të butë dhe tolerantë. Për të dyja gjinitë kjo situatë mund të sjellë frustracione dhe zhvillim jo të natyrshëm të seksualitetit. Që të mund të ndodhin këto gjëra, me rëndësi është që të bisedohet haptazi. Dhunimi është imponim me forcë i marrëdhënieve seksuale. Dhunimet mund të ndodhin edhe në lidhje, mes partnerëve ose mes bashkëshortëve, ndonëse mbisundon bindja se ato ndodhin ndërmjet personave të panjohur. Nëse personi i rritur e e keqpërdor seksualisht një fëmijë të mitur, kjo konsiderohet sulm seksual ndaj fëmijës. Sipas ligjeve të R. së Maqedonisë, “sulm seksual ndaj fëmijës mund të bëhet edhe pa forcë – nëse veprimi i kapjes për flokë dhe qafë të fëmijës bëhet me paramendim, me qëllim të kënaqjes së epshit seksual.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë lëvizin lirshëm nëpër rreth. Secili fëmijë duhet t’i gjejë tre fëmijë të tjerë të cilëve do t’ua parashtrijë nga një pyetje për të cilën mendon se do të marrë përgjigje “JO”. Pyetjet nuk duhet të jenë të pacipa, vulgare dhe joshembullore. Ato duhet të jenë të menduara mirë që të kenë lidhje me fëmijën konkret të cilit i parashtrijet pyetja.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA IV-4.7: FJALËKRYQI

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Fjalëkryqi
- Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Fjalëkryqi
- Tabelë dhe shkumës



AKTIVITETI HYRËS

Nxënësit ndahen në çifte dhe pastaj përpiqen të gjejnë ndonjë fëmijë në të cilin kanë më shumë besim. Arsimtari u thotë se do të flasim për pubertetin dhe se gjërat që do t'i bisedojnë në çift duhet të mbeten fshehtësi. Duke qenë në çift ata një pas një duhet të këmbëjnë nga diçka që u pëlqen shumë në lidhje me rritjen dhe zhvillimin e tyre, përkatësisht me pubertetin.

AKTIVITET KRYESOR

Nxënësit ndahen në grupe me nga katër-pesë fëmijë. Atyre u jepet nga një kopje e fletës së punë për nxënësit “Fjalëkryqi”, të cilin duhet ta zgjidhin në mënyrë adekuate. Para përfundimit të aktivitetit, arsimtari i shkruan në tabelë zgjidhjet, por jo sipas radhitjes dhe jo në formë të fjalëkryqit, por thjesht njëra pas tjetrës. Nëse në ndonjë grup nuk gjenden të gjitha zgjidhjet, mund të përdoren sugjerime nga tabela. Pastaj edhe një herë duhet t'i lexojnë shpjegimet dhe zgjidhjet.

DISKUTIM

1. A kishte disa terma që nuk i njihnit?
 2. Pas leximit të fjalëkryqit a i keni më të qarta disa fjalë?
 3. A ekzistojnë edhe më fjalë që nuk i njihni?
 4. A janë këto fjalë vulgare, të turpshme?
 5. A është e turpshme të përdoren ato në jetën e përditshme? Pse?
 6. A janë dhënë në fjalëkryq disa gjëra jo të natyrshme?
 7. Me kë mund të bisedohet për zhvillimin, rritjen dhe seksualitetin?
 8. A mund të bisedohet në shtëpi në lidhje me këto tema?
 9. E në shkollë? Me kë?
 10. A mund të bisedohet me moshatarët/fëmijët e tjerë? Si e dimë se përgjigjet që do t'i fitojmë janë të sakta?
 11. Nëse kemi pyetje pa lidhje” ose “naive” a duhet t'i mbajmë për vete? Pse jo?
 12. A mund ta paramendojmë ndonjë mënyrë në të cilën nxënësit që e kanë vështirë të pyesin, të parashtrajnë pyetje publikisht, që ashtu prej fillimit të mund të informohen për gjërat?
- (nxitet njëfarë formë anonime me shkrim e parashtrimin të pyetjeve, e pastaj arsimtar, pasi të sigurojë përgjigje relevante, në një kohë të caktuar, mund t'i lexojë para gjithë klasës pyetjet dhe të japë përgjigje ose t'u japë përgjigje me shkrim).



PËRFUNDIM

Puberteti, zhvillimi dhe seksualiteti nuk janë gjëra jo të natyrshme, andaj duhet të jenë tema të bisedave të lira. Në disa mjedise vërtet llogaritet e turpshme nëse flitet për këto tema, por megjithatë kjo nuk do të thotë se nuk duhet të flitet. Ajo që duhet të bëhet është të përshtatet fjalori që përdoret. Është normale që fëmijët të piquen më lehtë nëse lirisht parashtrojnë pyetje për çfarëdo temash.

Në formimin e personalitetit të shëndoshë me rëndësi janë përkrahja dhe informacionet adekuate nga shtëpia dhe nga shkolla, si dhe mbështetja e moshatarëve. Thuhet secili fëmijë ka botëkuptime të çuditshme” dhe të paqarta për seksualitetin dhe kjo është normale gjatë kohës së pubertetit, aq më tepër është e pranishme sepse seksualiteti në kulturat tona është tabu.

Të gjitha pyetjet, sado që na duken se janë “pa lidhje”, duhet të parashtrohen nëse na duken të rëndësishme.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Nëse në fund të diskutimit bëhet ndonjë marrëveshje për procedurën e parashtrimit të pyetjeve, mund të provohet procesi i parashtrimit të pyetjeve. Nëse nuk arrihet një marrëveshje e tillë, nxënësit përsëri ndahen në çifte. Nëse ka fëmijë që nuk duan të jenë përsëri në çiftin e njëjtë, bëhet një ndarje e re në çifte. Kështu ata në çifte duhet të parashtrojnë pyetje në lidhje me seksualitetin duke menduar se mund të marrin përgjigje nga moshatarët e tyre.

REFLEKTIM


1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja IV-4.7: Fjalëkryqi

Fletë pune për arsimtarin/arsimtares:

FJALËKRYQI



1. Abort spontan 3. Ereksion 5. Testise 6. Farë 7. Mitër 10. Qeliza vezë
12. Sperma 13. Pubertet

2. Skrotum 4. Ejakulim 8. Vezorë 9. Rrethprerje 11. Vepërçues

Përmbajtja IV-5:**PREVENTIVA E KEQPËRDORIMIT TË
SUBSTANCAVE PSIKOTROPIKE****Pritet që nxënësi/nxënësja**

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • T'i dijë normat ligjore që e rregullojnë konsumimin e duhanit, pirjen e alkoolit dhe përdorimin e drogave në vend dhe në botë • T'i dijë se cilat janë substancat psikotropine • T'i dijë pasojat e konsumimit të drogave dhe substancave të tjera psikotropine ndaj vetvetes dhe ndaj të tjerëve
Shkathësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mund t'i vlerësoj rreziqet ndaj shëndetit në rast të përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogave të tjera • Të mund t'i njohë rrethanat dhe faktorët që nxisin pirjen e duhanit, të alkoolit dhe të substancave të tjera psikotropine
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Ta kuptojë nevojën e kundërshtimit aktiv (personal dhe kolektiv të konsumimit të substancave psikotropine (pjesëmarrja në fushata, projekte) • Ta pranojë se alkoolizmi dhe narkomania janë sëmundje të varësisë • Ta kuptojë dëmin ndaj shëndetit nga përdorimi i drogave • Ta pranojë se ka përgjegjësi personale në marrjen e vendimit për konsumimin e substancave psikotropine • Ta kuptojë se është mirë t'i kundërvihet trysnisë së të tjerëve që promovojnë dhe/ose konsumojnë substanca psikotropine.

PUNËTORIA IV-5.1: ASOCIACIONET³

MATERIALET

- Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Asociacionet
- Sellotej
- Fletë e madhe e letrës
- Pajisje për të shkruar
- Gërshërë
- Letër për të vizatuar



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Arsimtarja u thotë të gjithëve se janë në kuiz dhe se ajo është udhëheqëse e kuizit. Fëmijët të gjithë një nga një, ashtu si qëndrojnë në rreth, e bëjnë një hap përpara dhe prezantohen vetëm me emër dhe tregojnë se çfarë kualitetesh kanë që të jenë të suksesshëm në ndonjë kuiz. (p.sh.: “Unë kam shumë dituri nga fusha e kompjuterëve”, “Unë nuk kam frikë”, “Unë kam përqendrim të mirë” etj.). Pas secilit prezantim fitohet një duartrokitje. Në fund të gjithë ulen dhe arsimtarja u tregon se kuizi tash fillon.

AKTIVITET KRYESOR

Arsimtarja e vendos fletën e përgatitur qysh më parë sipas fletës së punës për arsimtarin/ arsimtaren “Asociacionet” dhe ua tregon këto rregulla:

Fjala i jepet atij fëmijë që do të paraqitet. Secili fëmijë derisa ka fusha (A1, A2, C3, Ç4...) për t’u hapur duhet ta hapë një fushë dhe pastaj të thotë se çka mendon se është zgjidhja e kolonës (A, B, C, Ç). Një fëmijë mund të paraqitet vetëm një herë për ta gjetur zgjidhjen e një kolone. Nëse klasa është e madhe, fëmijët mund të ndahen në grupe dhe grupet të marrin fjalë një nga një. Derisa të hapen të gjitha zgjidhjet e kolonave, nuk kalohet në zgjidhjen përfundimtare. Për secilën përgjigje të saktë merret duartrokitje.

DISKUTIM

1. Çka kishim në kolonën A? Pse ato fjalë ju dërguan te fjala “duhan”?
2. Çka kishim në kolonën B? Pse ato fjalë ju dërguan te fjala “kafe”?
3. A mund të flasim edhe për kafënë si për varësi?
4. Çka kishim në kolonën C? Pse ato fjalë ju dërguan te fjala “alkool”?
5. Çka kishim në kolonën Ç? Pse ato fjalë ju dërguan te fjala “drogë”?
6. Ndërsa zgjidhja përfundimtare? Pse i quajmë varësi?
7. A është varësia sëmundje?
8. Pse disa fëmijë fillojnë të pinë duhan/të pinë alkool dhe të marrin drogë apo kafe?
9. A ka rrezik nëse “provohet një herë” (cigarja, marihuana ose ndonjë drogë e ngjashme)?
10. A ka rrezik shëndeti në atë rast?
11. Çka mund të bëjmë që mos të sëmuremi nga këto sëmundje? Si?
12. Duke menduar në plan afatgjatë, cili/cila është çapkën/çapkëne më i/e madh/madhe: ai/ajo që pi duhan, alkool dhe drogë apo ai/ajo që arrin më shumë sukses në shkollë ose në sport? Pse?



³ Ideja është përpunuar nga ideja e grupit të arsimtarëve, pedagogëve dhe psikologëve-stërvitës për shkathtësi jetësore, në takimin e punës në Ohër, shkurt 2009.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA IV-5.3: VARËSITË

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Leksikoni i varësive
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITET KRYESOR

Nxënësit ndahen në katër grupe. Secili grup i jepet fleta e punës “Leksikoni i varësive” dhe mjaft kohë sa ta lexojë tekstin. Pastaj grupeve u jepet nga një temë për punë (droga, alkooli, duhani, kafeina). Secili grup duhet ta ndajë një pjesë, një paragraf ose diçka që u ka bërë përshtypje për arsye të ndryshme, diçka që dëshirojnë ta veçojnë për diskutim ose për pyetje. Grupet i prezantojnë zgjedhjet e tyre. Nëse ka pyetje, arsimtari jep shpjegime plotësuese. Rekomandohet të sigurohet një kopje për secilin fëmijë, që nxënësit të mund ta mbajnë atë me vete.

DISKUTIM

1. A kishte gjëra që ishin të reja në tekst? E të panjohura? Cilat?
2. Cilat tipare të dëmshme të drogave ju bënë përshtypje? Pse?
3. Cilat tipare të dëmshme të alkoolit ju bënë përshtypje? Pse?
4. Cilat tipare të dëmshme të duhanit ju bënë përshtypje? Pse?
5. Cilat tipare të dëmshme të kafesë ju bënë përshtypje? Pse?
6. Pse të gjithë këto gjëra quhen sëmundje të varësisë?
7. Çka nënkupton varësia?
8. Çka nënkupton varësia fizike e çka varësia psikike? A janë çapkën/çapkëne më të mëdha ata që pinë kafe e që pinë cigare? Pse?
9. Çka mund të bëhet nëse të gjithë përreth teje pinë duhan ose pinë kafe e ti nuk pi dhe kjo mbase nuk të duket “kull” dhe diçka që të bën çapkën/çapkëne?
10. A e dini dikë që pi duhan një kohë më të gjatë dhe që dëshiron të heqë dorë prej tij, por që nuk i shkon lehtë? Çka mendoni, pse?



PËRFUNDIM

Me varësi nënkuptohet gjendja në të cilën personi konsumator i substancës nga e cila është i varur është i vetëdijshëm për dëmin e saj, por nuk mund të heqë dorë nga konsumimi.

Aktiviteti fizik: organizmi është mësuar me “doza” të rregullta të substancës nga e cila është i varur (kafeinë, nikotinë, alkool, droga) dhe nëse nuk i merr ato një kohë të caktuar, te ai manifestohen ndryshime trupore/fizike, siç janë lodhja, molisja, hipertensioni, djersitja, e deri te shtrëngimet serioze si te varësia nga disa droga.

Aktiviteti psikik është varësi nga shprehia për të bërë “rituale” të caktuara. Shumë shpesh këto aktivitete janë të lidhura mes vete dhe më së shpeshti varësia psikike zgjat më shumë se ajo fizike.

Kufiri i të varurve nga varësitë e pranuar sociale, siç është për shembull duhani dhe kafeina, shtyhen gjithnjë e më shumë në moshë më të re, njësoj si konsumimi i drogave/ fëmijët e kësaj moshe janë shumë të rrezikuar të kenë kontakt me këto substanca kur duhet të bëjnë zgjedhje. Mundësia që ata të mos e bëjnë zgjedhjen e gabuar është më e madhe nëse qysh më parë kanë informacione adekuate. Është më rëndësi të dihet se edhe ato varësi që janë të pranuar nga aspekti social, siç janë varësia nga kafeina, janë varësi dhe se secila prej tyre janë të dëmshme.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Nxënësit një nga një dalin një hap para në rreth dhe e përfundojnë këtë fjali “Unë mund t’i them “Jo” drogës/alkoolit/duhanit, sepse...”. Secili fëmijë duhet ta japë plotësimin e tij, që do të jetë i ndryshëm nga të tjerët. Pas secilës fjali jepet një duartrokitje.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



TEMA V:

UNË DHE MJEDISI RAPORTI ME MJEDISIN E JASHTËM

Përmbajtja V-1:

SJELLJA E SIGURT NË MJEDIS

Pritet që nxënësi/nxënësja

Dituri	<ul style="list-style-type: none">• Të dijë për rrezikun e armës ndaj vetes dhe mjedisit• Të dijë për veprimet dhe situatat e rrezikshme me të cilat mund të ballafaqohet në vende të caktuara (kafene, diskoteka, stadium, koncert, fushë sporti) si dhe në kohë të caktuar (vonë në mbrëmje)• Të dijë për rregullat e sjelljes në situata dhe në vende konkrete (në ahengje, në diskoteka, në ekskursionet)• T'i dijë pasojat e sjelljes personale ndaj sigurisë së të tjerëve
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none">• Të mund t'i respektojë dhe përdorë mjetet për alarmim dhe mbrojtje• Të mund ta përshtatë sjelljen e tij në vend/situatë konkrete• Të mund të kërkojë respektim të rregullave për sigurinë e të tjerëve
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none">• Të pranojë që sjellje të caktuara në vende dhe në situata konkrete mund të jenë të rrezikshme• Ta kuptojë nevojën e ekzistimit të rregullave dhe ndalesave të sigurisë• Ta pranojë nevojën për përshtatjen e sjelljes personale për shkak të sigurisë personale dhe sigurisë së të tjerëve

PUNËTORIA V-1.1: TA DEFINOJMË ARMËN

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Definicione për armën/pyetje
- Fletë për shkrim
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë lëvizin lirshëm në rreth. Secili fëmijë e paramendon nga një fëmijë i cili gjatë aktivitetit do të jetë bombë, ndërsa fëmija tjetër do të jetë mburoja e tij. Pas shenjës së dhënë të gjithë do të duhet të sillen nëpër hapësirë, ashtu që gjithnjë do të orvaten që mes tyre dhe fëmijës bombë të gjendet fëmija të cilin e kanë paramenduar si mburojë të tyre.

AKTIVITETI KRYESOR

Nxënësit ndahen në grupe me nga tre deri në pesë fëmijë. Ata në grupe duhet të merren vesh dhe të formulojnë definicion të tyre, gjegjësisht përgjigje të pyetjes “Çka është arma?”, Pastaj atë duhet ta shënojnë në letër. Pasi ta bëjnë definicionin e tyre, secilit grup i jepet nga një ekzemplar i fletës së punës “Definicionet për armën/pyetje”. Fëmijët do të duhet t’i krahasojnë definicionet e tyre të cilat duhet të krahasohen me definicionet e enciklopedive të njohura botërore, e pastaj të përgjigjen në pyetjet e mëposhtme të fletës së punës.

DISKUTIM

1. Çka është arma?
2. për çka shërben ajo?
3. Çka konsiderohet armë?
4. A mund të flitet për ndonjë situatë në të cilën arsyetohet përdorimi i armës?
5. Pse disa njerëz e kanë pasion armën? A është kjo e arsyeshme? Pse?
6. Cilat janë rreziqet bartjes së armës?
7. A lejohet që personat e mitur të mbajnë, posedojnë ose të manipulojnë me armë?
8. Kush mund të mbajë armë? Pse?



PËRFUNDIM

Arma është një lloj vegje e posaçme me të cilën shkaktohet lëndim dhe/ose vrasje të ndonjë qenie tjetër të gjallë. Armë konsiderohen edhe thikat me pjesë të mprehtë më të gjatë se 10 cm, hekurat e grushtimit e të ngjashme. Përdorimi i armës assesi nuk arsyetohet. Organe të caktuara të shtetit, siç janë policia dhe ushtria kanë të drejtë të mbajnë armë, por mund ta përdorin vetëm në rrethana tepër të jashtëzakonshme. Arma ka për qëllim të shkaktojë lëndim (plagosje) ose vrasje, andaj është shumë e rrezikshme nëse me të manipulon ndonjë person që nuk ka leje...

Disa fëmijë kanë botëkuptim të gabuar se nëse shëtisin përreth me armë do të afirmohen, mirëpo kjo vetëm e rrezikon sigurinë e tyre dhe sigurinë e të tjerëve për shkak se zakonisht ata nuk dinë të manipulojnë me të në mënyrë të duhur.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Secili fëmijë e imagjinojnë vendin e tij ideal/hapësirën për relaksim. Pas shenjës së dhënë, secili prej tyre duhet ta imagjinojë se gjendet në atë vend dhe të sillet sikur të jetë aty. Për shembull, nëse e paramendon veten si të jetë në plazh, le të shtrihet në ndonjë bankë, nëse është në mal, le të bëjë lëvizje gjoja se ngjitet përpjetë etj.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA V-1.2: SHUMË NJERËZ – PAK HAPËSIRË

AKTIVITETI HYRËS

Ndonjë aktivitet në të cilin krijohet turmë, e pastaj ka diskutim të shkurtër për atë sesi janë ndjerë dhe a kanë pasur ndonjë vështirësi.

AKTIVITETI KRYESOR

Nxënësit ndahen në shtatë grupe të vogla. Arsimtari ua ndan pesë situata të rreziqeve të mundshme në vende të ndryshme të cilat duhet të paramendohen dhe të aktrohen para nxënësve të tjerë. Situatat e rreziqeve të mundshme janë në lokacionet vijuese:

- në stadium
- në diskotekë
- në kafene
- në koncert të madh
- në ekskursion
- në fushë sporti
- vonë në mbrëmje gjatë kthimit në shtëpi



DISKUTIM

Në fillim, çështjet për diskutim kanë të bëjnë me situatat në të cilat nxënësit kanë luajtur role, me theks të veçantë të rreziqeve të cilat paraqiten në situatat e tyre.

1. Cilën situatë e prezantuat në lokacionin tuaj?
2. Për cilat rreziqe bëhej fjalë në atë situatë?

Nëse ka nevojë për shpjegim, nxënësit e të dyja grupeve po ashtu mund të parashtrojnë pyetje. Pastaj vijojnë pyetjet vijuese:

1. Cilat situata të tjera mund t'i përmendim në të cilat grumbullohen shumë njerëz në një vend? Çka duhet ditur lidhur me rreziqet e mundshme në situatat e tilla? Çka ndryshon nëse jeni vetëm ose në grup?
2. A ekzistojnë vende të rrezikshme në rrugën tuaj për në shtëpi, kur ktheheni vonë në mbrëmje? Çfarë janë ato vende? Me çka karakterizohen? Pse janë të rrezikshme?
3. Çka është burimi konkret i rrezikut?
4. Si duhet të sillemi në situata të tilla? Kujt duhet t'i drejtohem për ndihmë?
5. Si duhet reaguuar kur ndonjë i panjohur ju flet diçka vonë në mbrëmje? Çka do të duhej të bëni kur ju flet ndokush që duket se është i dehur?

PËRFUNDIM

Rreziqe potenciale mund të jenë situata të ndryshme në të cilat grumbullohen shumë njerëz në hapësira relativisht të vogla ose situata të cilat janë të reja për fëmijët. Për shkak të sigurisë personale, me rëndësi është të njihen rreziqet e mundshme. Për shembull, mund të shkaktohet panik në mes të publikut në rast se ndokush mund të hedhë bombë që shkakton tym ose nëse shkaktohet rrahje; në situata të tilla është shumë e rrezikshme të qëndrohet në turmën e cila lëvizë në mënyrë të pakontrolluar. Kur je vetëm, rreziku që të ndodhë diçka është më i madh, andaj është më mirë që fëmijët të mbahen në grupe dhe paraprakisht të merren vesh se çka duhet bërë nëse ndahen.

Vendet të cilat gjatë ditës janë të sigurta, vonë në mbrëmje mund të jenë të rrezikshme. Më së miri është nëse i njohim vendet e rrezikshme, të kërkojmë nga ndonjë i moshërritur të na dërgojë deri në shtëpi. Është mirë t'u ndihmojmë njerëzve deri në atë masë sa neve nuk ka rrezikohet siguria.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë lirshëm në hapësirë. Arsimtari ua bën me dije se gjenden në diskotekë me muzikë të ngadalshme. Ajo është diskoteka e vetme në botë e atij lloji. Muzika e cila lëshohet aty ka ritëm aq të ngadalshëm, saqë edhe breshka do të mund të luajë me rehati. Detyra e secilit fëmijë është të orvatet të luajë në ritëm shumë të ngadalshëm të cilin çdo fëmijë e imagjionon për vete.

REFLEKTIM


1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA V-1.3: INTERVENIME PËR TË MIRËN E TË GJITHËVE

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Skenar



AKTIVITETI KRYESOR

Nxënësit ndahen në pesë grupe. Secilit grup i jepet nga një pjesë e fletës së punës për nxënës "Skenar". Ata duhet të merren vesh dhe përpara fëmijëve tjerë, të cilët janë në rolin e publikut, t'i luajnë rolet e situatave të dhëna në fletat e punës. Para se të fillohet me aktrimin e secilës situatë, duhet të lexohet ajo që është shkruar në skenarin konkret. Skenari përmban situatë e cila është potencialisht e rrezikshme për disa ose për të gjithë fëmijët e përfshirë në të. Pasi njëri grup ta luajë situatën, nga publiku duhet të paraqitet ndonjë fëmijë (vullnetar) i cili do të dalë në skenë dhe do të intervenojë në mënyrën të cilën e konsideron si adekuate që të pengohet rreziku për fëmijët e përfshirë në skenë dhe/ose të mundësohet siguria e personave tjerë. Fëmijëve u bëhet me dije se nga vullnetarët, si dhe nga fëmijët tjerë, nuk pritët performans i përkryer artistik, por vetëm një orvatje që të prezantohen situata të caktuara nga jeta e përditshme.

DISKUTIM

Për secilën situatë

1. Cila sjellje ishte e rrezikshme në situatën ... (emërtohet ndonjëra nga situatat)? Pse? Siguria e kujt ishte vënë në rrezik? A mund të shtohet diçka tjetër në sjelljen e fëmijës i cili u orvat ta zvogëlojë rrezikun në atë situatë?

Pas të gjitha situatave.

2. A janë të mundshme në jetën e përditshme situata të tilla të cilat i aktruat?
3. Kush mban përgjegjësi në rast se jemi në shoqëri, e cila është e nxitur nga atmosfera e shoqërimit dhe fëmijët propozojnë gjëra të rrezikshme? A është përgjegjës vetëm ai i cili propozon ose edhe te ata të cilët nuk e kundërshtojnë propozimin ose pranojnë atë?
4. Ndaj kujt kemi përgjegjësi që ta mbrojmë nga rreziku? A kemi përgjegjësi vetëm ndaj atyre të cilët i njohim ose edhe ndaj personave të panjohur? Pse?
5. Cila është sjellja më e urtë e cila është mirë të zbatohet në situata të këtilla?

PËRFUNDIM

Shpeshherë njerëzit shtyhen nga atmosfera dhe ka gjasa të jepen propozime shumë të rrezikshme për vazhdimin e zbatimjes.

Secili fëmijë i përfshirë në atë situatë ka përgjegjësi për atë se a do të pranohen sjelljet e rrezikshme. Kemi përgjegjësi për njerëzit të cilët i njohim dhe për ata që nuk i njohim.

Gjithnjë është e dobishme t'u referohemi rreziqeve për siguri dhe zëshëm t'i kundërshtojmë propozimet ose situatat e pasigurta.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Fëmijët ndahen në treshe. Secili tresh përbëhet nga dy fëmijë të cilët mbahen për duar, ndërsa në mes të rrethit i cili formohen nga duart e tyre qëndron një fëmijë i tretë. Fëmija, i cili qëndron në mes, jep udhëzime për drejtimin dhe shpejtësinë e lëvizjes, ndërsa dy fëmijët tjerë duhet t'i ndjekin udhëzimet e tij, duke u përkujdesur për sigurinë dhe e vet dhe duke u ruajtur të mos ndeshet me treshet e tjera. Të gjitha treshet përnjëherë do të duhet të lëvizin lirshëm në

hapësirë, ndërsa në se fëmija në mes jep udhëzime të cilat nuk tingëllojnë si të sigurta, ato udhëzime duhet injoruar. Pas një kohe jepet shenjë dhe të gjitha treshet shpërndahen.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Përmbajtja V-2:

KUJDESI PËR HIGJIENËN E MJEDISIT

Pritet që nxënësi/nxënësja

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • T'i dijë mënyrat e ndryshme të riciklimit • T'i dijë qëllimet, aktivitetet dhe rezultatet e klubeve dhe organizatave ekologjike
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mund ta riciklojë letrën • Të mund të ndikojë ndaj të tjerëve që mos ta dëmtojnë mjedisin
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Të pranojë pjesëmarrjen aktive në aktivitetet e klubeve shkollore dhe ekologjike

PUNËTORIA V-2.1: RICIKLOJMË

MATERIALET

- Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Riciklimi dhe përdorimi racional
- Fletë pune për nxënësit: Fletët për frymëmarrje dhe fletët për të shkruar
- Pajisje për të shkruar
- Fleta të mëdha letre për të vizatuar
- Pajisje për të vizatuar
- Sellotej



AKTIVITETI KRYESOR 1

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Secili fëmijë duhet të nxjerrë na çanta e tij shkollore tre gjëra dhe ato t'i prezantojë në rreth, duke thënë:

- Nga çfarë materialesh është bërë ky send
- Nga vijtë ato materiale (me se bëhen) dhe
- Çka do të ndodhë me sendin kur nuk mund të përdoret më.

DISKUTIM

1. A është e mundur që disa nga ato sende të përdoren për diçka tjetër? Për çka, për shembull? A na ndodhë shpesh të zbulojmë ndonjë dedikim tjetër për gjërat që e kanë humbur funksionin e tyre parësor?
2. Çka ndodhë më shpesh me ato sende që nuk na duhen më shumë? Ku përfundojnë ato?
3. Çka mendoni se do të ndodhë pas qindra viteve, a do të mbeten të pazbërthyera ato gjëra edhe atëherë? Cilat?
4. Çka do të thotë riciklimi? Pse njerëzit riciklojnë?

PËRFUNDIM

Shumë shpesh në kohën tonë sendet që i përdorim çdo ditë nuk ridedikohen, por përfundojnë si mbeturina. Një pjesë e madhe e sendeve që kanë përfunduar si mbeturina që para tridhjetë vitesh ende mund të gjenden të pazbërthyera. Njerëzit e kohës sonë nuk i kushtojnë shumë kujdes asaj se prej çka janë bërë gjërat e ndryshme dhe çka ndodhë me ato pasi t'u përfundojë vlera e përdorimit.

Qytetërimi jonë bashkëkohor është një qytetërim me sasi marramendëse të mbeturinave. Që mos të na mbulohet gjithë planeti me shtresë mbeturinash, me rëndësi është të kemi kujdes për llojin e materialit dhe në çfarë sasive mund të përdoret ai.

Riciklim do të thotë ripërdorim i materialit (letrës, metalit, plastikës, qelqit), prej të cilit është krijuar një send.

AKTIVITETI KRYESOR 2

Nxënësvë u lexohen tekstet e fletës së punës për arsimtarin/arsimtare "Riciklimi dhe përdorimi racional".

DISKUTIM

1. Çfarë mesazhi në jep teksti që e lexova? Pse është me rëndësi të pakësohet përdorimi i plastikës? A zbërthehet (shkatërrohet) plastika me kalimin e kohës?

2. A ka mundësi të riciklohet letra? A është kjo e nevojshme? Si? Cilat janë përparësitë e riciklimit të letrës?



PËRFUNDIM

Qeveria britanike dëshiron t'i ndërgjegjësojë njerëzit se sa mbeturina i prodhojnë ata për kënaqësi “të imëta” pa qenë farë të vetëdijshëm për atë.

Sendet e plastikës praktikisht janë të pazbërthyeshme – nëse nuk ekspozohen në rreze ultra vjollce, kurrë nuk zbërthehen. Letrat edhe në aspektin teknologjik, po edhe në aspektin teknik, janë më të lehta për riciklim. Sa më shumë letër riciklohet, aq më shumë pyje ruhen.

Ridedikimi dhe ripërdorimi (riciklimi) i materialeve është me rëndësi marramendëse. Përveç asaj që kursen energji (e cila zakonisht për t'u prodhuar përsëri duhet ta ndotë mjedisin), riciklimi është i dobishëm që të mos shteren resurset natyrore.

AKTIVITETI KRYESOR 3

Nxënësit ndahen në grupe me nga 4-6 fëmijë. Grupeve u jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënës “Fletët për frymëmarrje dhe fletët për të shkruar” nga e cila duhet të bëjnë pllakate që përcjellin mesazhin e rëndësisë së riciklimit të letrës, të cilat nëse duan mund t'i përdorin për informacione.

Pllakatet mund të ngjiten në klasë, në korridor ose në ndonjë pjesë tjetër të shkollës.

DISKUTIM 3

Për secilin grup diskutohen veçmas pllakatet e krijuara me nënpyetje për shpjegimet e qëllimeve dhe metodave që përdoren në pllakate.

1. Çka paraqitët në pllakatin tuaj?
2. Çfarë mesazhi deshët të përcillni me të?

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Secili fëmijë e thotë një ide për ridedikim të ndonjë sendi, i i cili nëse nuk do të ridedikohej, do të ishte ndotës. Idetë mund të thuhën vetëm një herë.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja V-2.1: Riciklojmë

Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: RICIKLIMI DHE PËRDORIMI RACIONAL

Apel nga Qeveria britanike për qytetarët:

Përdorni disa herë qeset e njëjta të plastikës!

Një blerës mesatar gjatë jetës së tij harxhon rreth 13.000 qese.

Qeveria britanike të martën do të ngrejë fushatë me të cilën dëshiron t'i nxisë blerësit që t'i përdorin qeset e plastikës më shumë herë gjatë blerjes, përkatësisht paralajmëron se secili blerës mesatar gjatë jetës së tij përdor 13.000 qese.

„Nuk mund të vazhdojmë që secilin vit të përdorim miliarda qese të reja të plastikës; kjo është një humbje shumë e madhe dhe shenjë e dukshme e shoqërisë sonë për t'i përdorë gjërat më shumë se një herë” – tha ministrja e Mjedisit.

Gjurmimi britanik ka treguar se një blerës mesatar çdo vit përdor më shumë se 160 qese të reja, ndërsa vetëm vitin e ardhshëm janë shpërndarë 9,9 miliardë prej tyre, informon Qeveria.

Vitin e kaluar kryeministri Braun kërkoi nga të gjithë shitësit që të ndër marrin aksion në këtë aspekt, se në të kundërtën Qeveria britanike do të reagojë dhe do të kërkojë prej tyre që t'ua shesin qeset blerësve.


Qëllimi i fushatës së re është që të nxiten njerëzit që disa herë t'i përdorin qeset e plastikës, ndërsa para fillimit të fushatës shtatë marketet më të mëdha kanë marrë përsipër ta pakësojnë numrin e qeseve të dhëna për 50%.

Me riciklimin e dy shisheve të plastikës kursehet aq energji sa të vlojë uji për pesë filxhanë çaji.

PUNËTORIA V-2.2: MBROJTJA E KRIMBAVE NGJYRË VJOLLCE

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Metodën e veprimit
- Pajisje për të vizatuar/shkruar
- Fleta letre



AKTIVITETI KRYESOR

Nxënësit ndahen në katër grupe. Atyre u thuhet se do të duhet të punojnë në një temë me katër qasje të ndryshme. Tema është kjo: “T’i mbrojmë krimbat ngjyrë vjollce me pika të portokallta”. Secilit grup i jepet nga një prerje e ndryshme (1, 2, 3 ose 4) nga fleta e punës “Metodat e veprimit”. Pasi të përfundojnë, grupet e prezantojnë punën e tyre.

DISKUTIM

1. Si ndjeheshit gjatë realizimit të aktivitetëve?
2. Nëse dëshirojmë të tërheqim sa më shumë vëmendje dhe të fitojmë më shumë përkrahje, cilat janë anët e mira e cilat anët e këqija të këtyre qasjeve që i morët si detyra në grupet e vogla? A mund të zgjidhet vetëm një qasje si më e mirë? Pse?
3. A është me rëndësi të reagohet për mbrojtjen e llojeve të caktuara shtazore ose bimore? Pse?
4. Në çfarë mënyre njerëzit organizohen më shpesh për këso gjërash?
5. A dini për ndonjë organizatë që vepron në mbrojtjen e mjedisit? Pse ekzistojnë ato organizata? Cilat janë qëllimet e tyre? Kush mund të marrë pjesë në ato? A mund të inkuadrohen aty edhe nxënësit?
6. A mund të bëhet në kuadër të shkollës diçka e ngjashme? Çka?
7. Çka mund të bëjmë në atë seksion?
8. Çka mund të bëjmë nëse e vërejmë se në ndonjë lum derdhet ujë me ngjyrë dhe aromë të çuditshme? Ose kur ndonjë oxhak industrial lëshon tym? Ose kur ndonjë njeri ndez zjarr në vend joadekuat?



PËRFUNDIM

Ekzistojnë shumë mënyra që të tërhiqet vëmendja e opinionit për tema të ndryshme për mbrojtjen e mjedisit.

Është shumë me rëndësi të reagohet për mbrojtjen e llojeve të caktuara bimore dhe shtazore, sepse ato paraqesin pasuri natyrore dhe mundësojnë ruajtjen e baraspeshës në ekosisteme.

Njerëzit zakonisht bashkohet në shoqata/organizata qytetare për mbrojtjen e mjedisit. Ato organizata zakonisht kanë për qëllim të bëjnë fushata që do t’i ndërgjegjësojnë ose alarmojnë të tjerët për rëndësinë e ndonjë aspekti të mbrojtjes së mjedisit jetësor, të zbatojnë aksione konkrete, të reagojnë ndaj situatave të ndotjes ekstreme ose të zhdukjes së mjedisit ose që t’i edukojnë njerëzit për rëndësinë e ruajtjes së baraspeshës së mjedisit natyror. Në ato organizata në ndonjë formë të caktuara sigurisht mund të anëtarësohen edhe fëmijë.

Shkolla mundëson formimin e seksioneve për mbrojtjen e mjedisit.

Në situatat që seriozisht e rrezikojnë mjedisin përgjegjësia bie mbi secilin që mund të reagojë për pengimin e rrezikut.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë fëmijët në të njëjtën kohë e bëjnë aktivitetin që e kanë menduar gjatë kohës së punës në grupe. Arsimtari nxit “kaos kreativ”, përkatësisht atmosferë ku mund të ndjehet energjia e fushave të ndryshme të veprimit.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



VËREJTJE

Nëse arsimtari/arsimtarja di dhe ka mundësi të vë kontakt me ndonjë organizatë për mbrojtjen e mjedisit, rekomandohet që me kohë të vë kontakt me përfaqësues të asaj organizate dhe ta ftojë dikë nga organizata që të bëjë një prezantim të vogël të organizatës dhe t'i shpjegojë fushat e veprimit, qëllimet dhe aktivitetet. Rekomandohet të lihet kohë që nxënësit të mund të parashtrojnë pyetje.

PUNËTORIA V-2.3: “VJOLLCA”

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Fletë aderimi
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë qëndrojnë në dorë. Arsimitari u thotë nxënësve se në këtë aktivitet nuk lejohet të flitet ose të jepet shenjë/të komunikohet në ndonjë mënyrë tjetër me nxënësit e tjerë. Po ashtu u thuhet se ai do t'i përmendë disa gjëra sipas të cilave ata do të duhet të grupohen në pjesë të ndryshme të klasës, por pa bërë zë ose gjeste. Secili fëmijë duhet të veprojë ashtu si do të kuptojë. Këtu nuk ka interpretime “të sakta” ose “të gabuara”. “Kriteret” e grupimit janë këto:

- Grupohuni sipas ndonjë gjëje karakteristike të veshjes suaj
- Grupohuni sipas ndonjë tipari personal
- Grupohuni sipas temperamentit
- Grupohuni sipas aktivitetit të dëshiruar në kohën e lirë

DISKUTIM

1. Si ndjeheshit kur bashkoheshit në grupe? A e kishit vështirë apo lehtë?
2. Si ndjeheshit kur nuk e dinit se ku e keni vendin? E kur ishit pjesë e ndonjë grupi? Pse?
3. Pse njerëzit bashkohen?
4. A mund të numërojmë lloje të ndryshme të shoqatave të qytetarëve?

PËRFUNDIM

Shumë shpesh bashkimi me ndonjë grup do të thotë siguri. Njerëzit shpesh bashkohen që më lehtë ta realizojnë ndonjë qëllim të tyre. Ekzistojnë shoqata të ndryshme të qytetarëve sipas interesave të tyre të ndryshme. Ka shoqata shkencore, sportive, ideologjike, ekologjike, kulturore ose shoqata të njerëzve që kanë ndonjë hobi të njëjtë etj.

AKTIVITETI KRYESOR

Nxënësit ndahen në grupe me nga katër fëmijë. Atyre u thuhet të mendojnë se dëshirojnë t'i bashkohen ndonjë shoqateje të qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit – “Vjollca”. Secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënës “Fletë aderimi”, e cila duhet të plotësohet me të dhënat e ndonjë fëmije të imagjinuar. Gjatë kësaj duhet të kihet kujdes që të dhënat që shkruhen të jenë reale dhe të bashkëveprojnë me fëmijën e asaj moshe. Nëse e kanë më lehtë, mund të shkruajnë edhe të dhëna të ndryshme të anëtarëve të grupit. Për shembull, nga njëri fëmijë shkruhet numri amëz, nga tjetri shkruhet rruga, nga i treti numri i derës etj. Pastaj grupet prezantohen.

DISKUTIM

1. Si ndjeheshit derisa e plotësonit fletë aderimin? A kishte gjëra që i kishit më të vështira ose më të lehta për t'i plotësuar?
2. Çka do të thotë shtetësia? E çka përkatësia etnike?
3. Cili është numri i vetëm amëz? Pse quhet ashtu? Pse ekziston një numër i tillë? A mund të ekzistojnë dy persona me numër të njëjtë të amzës? A e di dikush se çka paraqesin shifrat në NVAQ?

4. Çka kërkohet të shkruhet në fushën shkathtësi? Pse kjo duhet për një organizatë siç është “Vjollca”?
5. Çka është letra motivuese? Pse shërben?
6. Pse dikush do të kërkonte që ta plotësojmë këtë dokument? Për çka do të shërbente ai?

PËRFUNDIM

Me shtetësi nënkuptohet ajo se në çfarë shteti është regjistruar personi si qytetar i atij vendi, ndërsa me përkatësi etnike nënkuptohet ndjenja personale e identitetit nacional. Numri i vetëm amëz, ashtu si emri nënkupton se nuk ka mundësi të ekzistojnë dy persona me numër të njëjtë. Shtatë shifrat e para e tregojnë datëlindjen, ndërsa shifrat e tjera tregojnë se a është personi gjinisë mashkullore ose femërore, në cilin vend ka lindur etj.

Një organizatës si “Vjollca” do t’i shërbenin këto dokumente nëse ka shumë persona që dëshirojnë t’i bashkohen, por edhe që të ketë evidencë për anëtarët e saj, për shkathtësitë dhe aftësitë e tyre. Gjatë zgjedhjes së shumë kandidatëve shpesh prej tyre kërkohet të shkruajnë letër motivuese, përkatësisht të shkruajnë se cilat janë motivet e tyre për shkak të të cilave ata persona dëshirojnë t’i bashkohen ndonjë aktiviteti ose të marrin pjesë në ndonjë aktivitet të shoqatës etj.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Fëmijët një nga një e bëjnë një hap para në rreth dhe tregojnë se në çfarë shoqate do të dëshironte secili prej tyre të anëtarësohet dhe pse. Secilit fëmijë i jepet duartrokitje.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Përmbajtja V-3:

**KRIJIMI I RAPORTIT POZITIV NDAJ
BIMËVE DHE KAFSHËVE**

Pritet që nxënësi/nxënësja

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • Të dijë vendin e bimëve dhe kafshëve në ciklin e botës së gjallë • Të dijë për ekzistimin e llojeve të rrezikuara të bimëve dhe shtazëve • Ta dijë se cilat lloje të bimëve dhe kafshëve janë të rrezikuara në Maqedoni • T'i dijë pasojat e zhdukjes së drurëve dhe pyjeve • Ta dijë se si mund t'u ndihmojë kafshëve të lënduara dhe të braktisura • Ta dijë se ekzistojnë shoqata për mbrojtjen e bimëve dhe kafshëve në nivel lokal dhe ndërkombëtar
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mund ta kundërshtojë sjelljen joadekuate të të tjerëve ndaj bimëve • Të mund t'i kundërshtojë trysnitë e moshatarëve për maltretimin e kafshëve
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Ta kuptojë se bimët dhe kafshët duhet të mbrohen • Ta pranojë se nevojitet sjellje adekuate ndaj bimëve • Ta pranojë se ndaj bimëve duhet të sillemi në mënyrë humane, ashtu si ndaj gjithë qenieve të tjera të gjalla • Ta pranojë se duhet të përkrahet puna e shoqatave për mbrojtjen e bimëve dhe kafshëve (aktivisht dhe/ose në mënyrë materiale)

PUNËTORIA V-3.1: NJERIU QË MBILLTE SHPRESË¹

MATERIALET

- Pajisje pune për arsimtarin/arsimtare: Njeriu që mbillte shpresë



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Një nxënës qëndron në mes (në fillim këtë e bën arsimtarja) dhe ai duhet të rrotullohet përreth boshtit të vet me sy të mbyllur dhe me dorë të shtrirë, duke bërë me gisht shpejt drejt një fëmije dhe me këtë rast ta thotë emrin e njerës prej tre figurave: PLEP, LULE ose KAÇUBË. Fëmija i shënjuar bashkë me fëmijët që janë majtas dhe djathtas tij duhet ta krijojë figurën e kërkuar, por këtë duhet ta bëjnë më shpejt se që mund të thonë shpejt dhe me zë nxënësit e tjerë PLEP, LULE, KAÇUBË!!! Nëse ata nuk arrijnë ta krijojë figurën për aq kohë ose po të gabojë njëri nga fëmijët-figura, fëmija që ka qenë i shënjuar shkon në mes të rrethit dhe i bën me shenjë ndonjë fëmijës tjetër derisa nuk bëhet që ndonjë fëmijë tjetër ta zëvendësojë atë sipas këtij parimi.

- Plepi bëhet ashtu që të gjithë fëmijët drejtohen përpjetë në gishta me duart të shtrira vertikalisht.
- Lulja bëhet ashtu që fëmija që është në mes qëndron i përkulur dhe i vë pëllëmbët e duarve në anët e fytyrës, duke e prekur mjekrën me gishtat e mëdhenj, ndërsa ballin e prek me gishtat tregues sikur të jenë fleta të lules.
- Kaçuba bëhet ashtu që fëmija që është në mes qëndron i drejtuar me duar të lëshuara pranë trupit, ndërsa fëmijët në anën e tij të majtë dhe të djathtë bëjnë një qark horizontal përreth tij.

Në fillim grupit nuk i jepet temp shumë i shpejtë për të thënë PLEP, LULE, KAÇUBË!!!, por ashtu si kalon koha, edhe fëmijët ushtrojnë, tempi shpejtohet më shumë, që kështu të jetë çdoherë në kufi për t'u realizuar/gabuar.

AKTIVITETI KRYESOR

Nxënësve u lexohet teksti nga pajisja e punës për arsimtarin/arsimtare "Njeriu që mbillte shpresë".

DISKUTIM

1. Cilat ndryshime të mjedisit jetësor ndodhin në përrallë?
2. Si ndikon ajo mbi jetën e njerëzve? (kërkohet të numërohen sa më shumë gjëra)
3. Pse kanë ndodhur vërshimet?
4. Pse ka ndodhur rrëshqitja e tokës?
5. A mund të lidhet prerja e pyjeve me tharjen e burimeve? Si?
6. E ajo që shirat janë pakësuar?
7. Në çfarë mënyre kjo ka ndikuar ndaj jetës së njerëzve të fshatit?
8. Çka ka bërë heroi i përrallës sonë?
9. Si arriti ai ta kthejë gëzimin dhe qeshjen te njerëzit e fshatit?
10. A është e mundur kjo në të vërtetë?
11. Cilat janë gjërat e dobishme që i ka pylli?

1 Ideja themelore është marrë nga tregimi „L'homme qui plantait des arbres“ од Jean Giono, 1953.

12. Çka ndodhë nëse i shkatërrojmë pyjet?
13. Çka ndodhë nëse e shkatërrojmë mjedisin tonë?
14. A mund të gjejmë shembuj nga jeta e përditshme që kanë të bëjnë e shkatërrimin e pyjeve?
15. Çka mund të bëhet në ato raste?
16. A mund ta rrezikojmë ose ta ripërtërijmë ne mjedisin? Si?
17. Çka mund të bëjë secili prej nesh?
18. Çka mund të bëjë secili prej nesh për ruajtjen e pyjeve dhe të mjedisit në përgjithësi?
19. Si e përjetuat heroin kryesor? Çfarë njeriu është ai?



PËRFUNDIM

Bimët dhe pyjet, përveç që janë prodhuesit më të rëndësishëm të oksigjenit, ato kanë rëndësi të madhe edhe për mikroklimën dhe tokën përreth pyjeve. Përveç që prodhojnë oksigjen dhe e pastrojnë ajrin, pyjet e mbrojnë edhe truallin, e rrisin lagështinë e ajrit, i pengojnë erërat dhe ofrojnë banim për shumë qenie të gjalla.

Ekzistenca jonë në planet varet nga ekzistenca e të gjitha llojeve bimore dhe shtazore, e me këtë edhe ekzistenca e pyjeve. Njeriu e ka humbur ndjenjën e rëndësisë së jashtëzakonshme të secilës qenie të gjallë në botë.

Prandaj është e dobishme të mbillen dru në secilën situatë të mundshme. Kjo mund të bëhet në mënyrë individuale, por edhe nëpër organizata të ndryshme për mbrojtjen e mjedisit.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Pastaj ftohet një fëmijë i cili do të përpiqet të shpjegojë se si mbillet një dru. Ai e shpjegon ngadalë procesin, me lëvizje, ndërsa fëmijët e tjerë i përsërisin lëvizjet e tij.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?

Punëtorja V-3.1: Njeriu që mbilte shpresë

Fletë pune për arsimtarin/arsimtaren:

NJERIU QË MBILLTE SHPRESË

Një vjeshtë, kur një pjesë e madhe e pyllit ishte prerë, pas një shiu të rrëmbyeshëm vjeshte, uji që nuk mund të ndalej në male, së pari u derdh në kroje e lumenj që u rritën shumë dhe i rrënuan urat, e pastaj pjesë të mëdha të kodrave rrëshqitën mbi fshat dhe kështu një numër i madh i shtëpive u mbuluan me tokë nga kjo rrëshqitje e tokës. Kishte edhe viktima. Pastaj në vitet e ardhshme kjo ndodhte gjithnjë e më shpesh. Edhe shiu më i vogël shkaktonte vërshime, rrëshqitje të tokës dhe fatkeqësi. Nuk kishte më drurë që ta mbajë tokën e cila do ta thithte ujin. Shumë shpejt mbetëm vetëm kodrat e zhveshura dhe bari i fortë. Kështu ishte derisa binte shi. Tash edhe shirat janë të rrallë. Nuk ka më asnjë lumë, asnjë krua. Tash të gjithë pimë ujë nga një pus i thellë, i largët dhe me erë të keqe. Shumica e njerëzve u shpërngulën prej këtu. Ata që mbetën nuk kanë ku të shkojnë, se edhe ata do të shpërnguleshin. Në fshat thuajse askush nuk flet me askënd. Njerëzit janë të përvuajtur, të vrenjtur dhe të ligë. Sikur të isha në vendin tuaj, unë do ta vazhdoja rrugën – ishte këshilla e plakut.

Por, ai nuk kishte ku të shkojë, andaj vendosi të mbetet aty. U shëtiti gjatë kohë nëpër shpatet e shkreta. Duhej të ecte shumë që të arrijë në një pyll të vogël dushku. Duke qëndruar njëherë nën një hije dushku, diçka e tërhoqi. Filloi të mbledhë lende dushku të rëna. Mblodhi derisa e mbushi strajcën e tij të madhe. Këtë e përsëriti disa ditë me radhë. Në shtëpinë që u shpërngul një dhomë të tërë e mbushi me lende. Madje e bëri edhe një numërim të përgjithshëm. Kishte më shumë se dhjetëra mijë lende. Pasi kaluan ditët e vjeshtës kur mund të pritej shi, ai para agimit u nis me bastunin e tij në dorë dhe me strajcën plot lende drejt kodrës që ishte më afër fshatit. Dhe, ia filloi. Me bastunin tij e bëri një vrimë në tokë, e vendosi aty një lende dhe e mbuloi me dhe. Pas 2-3 hapave përsëri edhe një vrimë dhe përsëri një lende e mbuloi me dhe. Edhe një, edhe një...

Ditën e parë e harxhoi gjithë strajcën. I bëri njëzet radhë.

Kështu atë dimër çdo mëngjes shkante në kodrat përreth fshatit dhe me plot durim e qetësi mbillte lende pas lende, derisa nuk e mbolli edhe lenden e fundit.

Në maj e pa se një numër i madh i lendeve kishin mbirë dhe po i gëzoheshin diellit.

Në shtator mblodhi edhe më shumë lende.

Ato arriti t'i mbjellë deri në mars.

Në maj përsëri e pa se ato po mbinin.

Në shtator mblodhi edhe më shumë lende.

Ato arriti t'i mbjellë deri në mars.

Në maj përsëri e pa se ato po mbinin. Këtë e bënte me vite të tëra. Njerëzit e fshatit mendonin se është ndonjë njeri i çmendur ose ndonjë njeri i çuditshëm, por nuk i pengonin. Kur e mbolli edhe pjesën e fundi të maleve të zhveshura, tashmë ishte shumë plak dhe kishte mbjellë më shumë se njëqindmijë lende. Lendet e para që i kishte mbjellë tashmë kishin fi

tor o arritirë sel1GuePtuëpijcën. I bkt045 -1.3P 1Tyreshte më a shj.rë selijcën. 467Di1n. ë tae uq
tdush pende. ahumëçuditshëm,thktë ë nb 3e-41të zhfëa, tatr i kdishiToatozdolnjë hilulen,2këkjë zh
të rë dimJ ishtkë. Gë, emo.lendteökn Atm meJudusëhura, ë ee.

PUNËTORIA V-3.2: RRJETA E JETËS

MATERIALET

- Kjo është pasojë e gjuetisë së pakontrolluar të disa llojeve të caktuara të kafshëve.
- Kjo është pasojë e punës së një fabrike të plumbit.

DISKUTIM

1. Si ndjeheshit derisa e realizoni aktivitetin (para se të priten penjtë)? Pse?
2. Çka bëmë ne në fakt në këtë aktivitet?
3. A arriti dikush ta përjetojë rolin dhe vendin e tij në rrjetin e bërë?
4. Si ndjeheshit kur i preva penjtë? Pse?
5. Çka ndodhi në fakt kur i preva penjtë? Çka nënkuptonte ajo?
6. A ndodhin këso gjëra me të vërtetë? A ndodhin gjëra të tilla edhe në mjedisin tonë/në mjedisin tonë më të afërt?
7. Çka do të ndodhë nëse ndërpriten lidhjet ndërmjet qenieve të gjalla?
8. Çka mund të bëhet në lidhje me këtë? Çfarë mund të ndërmarrim që mos të na ndodhë kjo?



PËRFUNDIM

Gjithë jeta e gjallë në planetin tonë është në varësi të ndërsjellë. Nga jeta dhe ekzistenca e qenieve që në shikim të parë na duken të parëndësishme varet ekzistenca e të gjitha qenieve të tjera të gjalla.

Nëse ndërpritet zinxhiri i lidhjeve, me zhdukjen e një ose të disa llojeve, kështu rrezikohet edhe ekzistenca e të tjerëve. Në fund të fundit edhe jeta e njerëzve.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë në rreth, fëmijët e përmendin nga një shtazë nga e cila “gërditen” ose nga e cila frikësohen dhe përpiqen të gjejnë një shkak se pse është e rëndësishme ajo kafshë të ekzistojë dhe mos të vritet. Kafshët “e gërditshme” mund të përmenden vetëm një herë nga një fëmijë.

REFLEKTIM


1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja V-3.2: Rrjeta e jetës

Fletë pune për arsimtarin/arsimtarene: KARTELA – RRJETA E JETËS


1. Algat



Përdorin – materie minerale


Ushqehen me to – pleshti i ujit, **kërmilli**, peshku, bakteret

2. Kërmilli



Ushqehet me – bar, alga, boronica, dru
Ushqehen me të – **bretkosa**, peshku, zogu, bakteret

3. Bretkosa



Ushqehet me – krimba, gjinkalla, kalë shtrigash, thnegla, kërmij

Ushqehen me të – **dhelpra**, bufi, sokoli, bakteret

4. Dhelpra



Ushqehet me – boronica, zogj, urith, ketra, iriq, mi, gjinkallë, pëllumb, bretkosë, peshk, bar

Ushqehen me të – **sokoli**, bufi, rrëqebulli, bakteret


5. Sokoli



Ushqehet me – dhelpër, zog, urith, ketër, mi, bretkosë, pëllumb, krimb, peshk

Ushqehen me të – **bakteret (1)**

6. Bakteret (1)



Ushqehen me – gjithçka

Ushqehen me to – **pleshti i ujit**

Prodhojnë – materie minerale

7. Pleshti i ujit



Ushqehet me – alga, baktere
 Ushqehen me të – **kali i shtrigave**,
 peshku, bakteret

9. Zogu

Ushqehet me – thnegla, krimba, boronica,
 kalë shtrigash, kërmill
 Ushqehen me të - dhelpra, sokoli, **bufi**,
 bakteret

11. Bakteret (1)

Ushqehen me – gjithçka
 Ushqehen me to - pleshti i ujit
 Prodhjnë – **materie minerale (1)**

8. Kali i shtrigave



Ushqehet me – thnegla, dafnia
 Ushqehen me të – **zogu**, bretkosa, bufi,
 peshku, bakteret

10. Bufi

Ushqehet me – mi, zog, bretkosë, kalë
 shtrigash, gjinkallë, dhelpër, urith, ketër,
 iriq
 Ushqehen me të – **bakteret (2)**

12. Materiet minerale (1)

Prodhohen – nga bakteret
 Përdoren – nga drunjtë, bari, lulet, algat,
boronicat


13. Boronicat



Shfrytëzojnë – materie minerale

Ushqehen me to – **thnegla, qukapiku**, dhelpra, zogu, ketri, iriqi, miu, gjinkalla, pëllumbi, **drenusha**, ariu, kërmilli, bakteret

14. Thnegla



Ushqehet me – lule, boronica, dru,
Ushqehen me të – qukapiku, urithi, **gjinkalla**, bretkosa, kali i shtrigave, zogu, ariu, bakteret

15. Gjinkalla

Ushqehet me – thnegla, boronica, dru, lule

Ushqehen me të – dhelpra, zogu, **urithi**, ketri, bufi, ariu, bakteret

16. Urithi

Ushqehet me – thnegla, krimba, gjinkallë

Ushqehen me të – dhelpra, bufi, sokoli, **rrëqebulli**, ariu, bakteret

17. Rrëqebulli

Ushqehet me – zog, urith, iriq, dhelpra, drenushë, pëllumb

Ushqehen me të – **bakteret (3)**


18. Bakteret (3)

Ushqehen me – gjithçka

Ushqehen me to - pleshti i ujit

Prodhojnë – **materie minerale (2)**


19. Materie minerale (2)



Prodhohen – nga bakteret

Përdoren – nga **drunjte**, bari, lulet, algat, boronicat

20. Drutë



Shfrytëzojnë – materie minerale

Ushqehen me to – thnegla, **krimbi**, ketri, iriqi, miu, drenusha, kërmilli, pëllumbi, bakteret

21. Krimbi

Ushqehet me – bar, boronica, dru

Ushqehen me të – zogua, bretkosa, urithi, peshku, sokoli, bakteret

22. Peshku

Ushqehet me – kalë shtrigash, plesht të ujit, krimba, algat, kërmij

Ushqehen me të – dhelpira, sokoli, **ariu**, bakteret

23. Ariu

Ushqehet me – boronica, thnegla, urith, iriq, gjinkalla, peshk, drenusha

Ushqehen me të – **bakteret (4)**


24. Bakteret (4)

Ushqehen me – gjithçka

Ushqehen me to - pleshti i ujit

Prodhojnë – **materie minerale (3)**

25. Materie minerale (3)



Prodhohen – nga bakteret
Përdoren – nga drunjtë, bari, **lulet**, algat, boronicat


27. Drenusha

Ushqehet me – dru, lule, bar, boronica
Ushqehen me të – ariu, rrëqebulli, ujku, bakteret

29. Bakteret (5)

Ushqehen me – gjithçka
Ushqehen me to - **pleshti i ujit**
Prodhojnë – materie minerale

26. Lulet



Shfrytëzojnë – materie minerale
Ushqehen me to – thnegla, ketri, iriqi, miu, ariu, **drenusha**, bakteret

28. Ujku

Ushqehet me – drenushë, urith, iriq, ketër
Ushqehen me të – **bakteret (5)**

30. Pleshti i ujit

Ushqehet me – alga, baktere
Ushqehen me të – **kali i shtrigave**, peshku, bakteret

PUNËTORIA V-3.3: ZINXHIRI USHQIMOR

MATERIALET

- Fletë pune për nxënësit: Zinxhiri ushqimor
- Fletë pune për nxënësit: Pyetje
- Një lugë supe
- Disa vezë

AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë lëvizin lirisht nëpër klasë. Kur jepet shenjë, të gjithë fëmijët ndalen. Arsimitarja u thotë se tash të gjithë janë bërë në bimë dhe se nuk mund të lëvizin. Prandaj duhet të qëndrojnë aty ku janë dhe të shikojnë drejt para vetes në lartësi të syve. Pastaj e përcakton një fëmijë i cili do të bëhet vemje. Ajo po ashtu nuk mund të lëviz, përveç gojës, por ashtu duhet të bëjë lëvizje sikur të përtypë çam-çakëz. Vemja mund ta hajë cilën bimë të dojë në atë mënyrë që do ta shikojë në sy dhe prej atij çasti ai fëmijë bëhet vemje dhe po ashtu mund “të hajë/shndërrojë” edhe fëmijë të tjerë në vemje. Loja përfundon pasi të bëhen të gjithë fëmijët vemje.

AKTIVITETI KRYESOR

Nxënësit ndahen në tre-katër grupe të vogla. Secilit grup i jepet nga një komplet i fl

Po ashtu konsumatorët kontribuojnë për ato lloje me të cilat ushqehen, ashtu që i hanë ato që janë të sëmura, të dobëta dhe kështu ndihmojnë në shpejtimin përparimit të evolucionit të atyre llojeve.

Çrregullimi i baraspeshës së ndjeshme mund të shkaktojë kolaps të gjithë ekosistemit. Baraspesha është vendosur qysh para ekzistimit të njeriut dhe, nëse njeriu nuk e çrregullon atë, duke i shkatërruar vendbanimet natyrore ose me ndotje, gjueti, helmim, spërkatje, popullim me lloje joautoktone etj., kjo baraspeshë mbetet shumë stabile.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Nxënësit ndahen në dy grupe me numër të njëjtë të nxënësve dhe ata ndalen në dy skaje të kundërta të klasës. Zgjidhet një fëmijë që do të dëshirojë ta fillojë aktivitetin. Detyra e tij është që ta bartë një vezë me lugë nga skaji i kundërt i klasës. Prej aty e merr një fëmijë tjetër i cili po ashtu e ka atë detyrë. Procedura përsëritet derisa të gjithë fëmijët të mos e bartin vezën.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA V-3.4: LLOJET E RREZIKUARA

MATERIALET

- Monedha prej 2 dhe 5 denarësh, përafërsisht me numër të njëjtë për secilin fëmijë nga një
- Fletë pune për nxënësit: Prerje nga gazetata – llojet dhe ekosistemet e rrezikuara
- Fletë pune për arsimtarin/arsimtares: Udhëzime
- Pajisje për të shkruar
- Copa të letrës së mbledhur, nga një për secilin fëmijë



AKTIVITETI HYRËS

Arsimtari ia jep secilit fëmijë nga një monedhë prej 2 ose 5 denarësh në pëllëmbë, të cilën ai menjëherë e mbyll që mos t'ia shohin fëmijët e tjerë. Fëmijët duhet të shëtisin lirshëm nëpër klasë dhe, nëse duan, mund të luajnë tregtim ose qëlluarje. Kjo luhet ashtu që kur të takohen dy fëmijë dhe të shikohen në sy, ata do të duhet të bërtasin “TREGTIM” ose “QËLLUARJE”, varësisht nga ajo se çka dëshiron secili prej tyre. Fëmija që do ta thotë i pari dëshirën e tij, ai vendos se a do të tregtohet apo do të qëllohet.

Tregtimi bëhet duke ia treguar monedhat njëri-tjetrit, ashtu që ai që ka monedhë më të vogël mund ta ndërrojë me monedhë më të madhe. Nëse të dy fëmijët kanë vlerë të njëjtë të monedhave, vazhdohet më tej.

Qëllimi bëhet ashtu që fëmija që i pari e ka thënë dëshirën e tij, ai të mund të qëllojë se në cilën dorë është monedha e fëmijës tjetër. Nëse ia qëllon, ai mund ta ndërrojë monedhën me fëmijën tjetër – nëse do, e nëse nuk ia qëllon, atëherë fëmija tjetër mund të kërkojë t'i ndërrojë monedhat.

Në fund monedhat kthehen te arsimtari.

AKTIVITETI KRYESOR

Nxënësit ndahen në katër grupe. Secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënësit “Prerje nga gazetata – llojet dhe ekosistemet e rrezikuara”. Secilit grup i jepet nga një udhëzim prej fletës së punës së arsimtarit/arsimtares „Udhëzime“. Pastaj grupet e tregojnë atë që e kanë punuar.

IDEJA PËR AKTIVITET KRYESOR

Nxënësit ndahen në gjuetarë (3-4), ndërsa të gjithë të tjerët janë shtazë. Atyre u jepet nga një fotografi e kafshës që do t'u bie (mund të jetë nga kafshët më të rrezikuara në vend). Gjuetarët krijojnë municion – topa të letrës se vjetër të mbledhur dhe me ato i gjuajnë kafshët që përpiqen të kalojnë nga një pikë te tjetra. Qëllimi i tyre është të gjuajnë sa më shumë kafshë.

Pastaj zhvillohet diskutim.

DISKUTIM

1. Çka do të thotë fraza “lloj i rrezikuar”? E çka “lloj i zhdukur”?
2. Cilat janë llojet e shtazëve më të rrezikuara në Republikën e Maqedonisë?
3. A dini për ndonjë lloj bimësh që janë të rrezikuara apo të zhdukura?
4. Cilat janë pasojat afatshkurtra dhe afatgjata nga zhdukja e llojeve bimore dhe shtazore në një ekosistem?



5. Cilët janë faktorët më të rëndësishëm që e rrezikojnë ekzistencën e llojeve bimore dhe shtazore te ne?
6. A ka mundësi që ndonjë qenie e gjallë të quhet “e dëmshme”? Pse? A janë, për shembull, ujëqit të dëmshëm? Prej nga vjen kjo etiketë?
7. Kush është dëmtues më i madh: njeriu apo kafshët?
8. A keni ide se si mund të pengohet me efikasitet zhdukja e disa llojeve të caktuara?
9. Kush është përgjegjës për zhdukjen e qenieve të gjalla në një ekosistem?
10. Si mund të duket një fushatë për mbrojtjen e botës së gjallë? Kujt duhet t’i dedikohet ajo? Çka duhet të përmbajë ajo? Çfarë mjetesh mund të përdoren në atë fushatë?

PËRFUNDIM

Lloje të zhdukura llogariten ato lloje të kafshëve dhe bimëve që tashmë nuk ekzistojnë në një territor të caktuar ose në një ekosistem. Të rrezikuara konsiderohen ato kafshë dhe bimë, numri i të cilave është zvogëluar ndjeshëm, popullata e të cilave është shpërndarë ashtu që ato që kanë mbetur të vetme nuk arrijnë të kenë kontakt me llojet e tjera të njëjta që të mund të shumohen. Vendbanimet dhe resurset e tyre natyrore shkatërrohen ose ato kafshë vriten në mënyrë aktive, shpesh si “të dëmshme”. Fatkeqësisht te ne ende ka kafshë që konsiderohen “të dëmshme” për mjedisin, edhe pse njerëzit janë ata që e uzurpojnë vendbanimin e ujëve ose të disa kafshëve të tjera, i gjuajnë kafshët dhe i shkatërrojnë bimët me të cilat ushqehen ato. Prandaj atyre kafshëve nuk u mbetet asgjë tjetër, pos që ta sulmojnë mallin ose pronën e njerëzve. Fushat efikase duhet të orientohet drejt ndryshimit të vetëdijes te secili njeri se ndjekja e llojeve të caktuara në fund të fundit e rrezikon ekzistencën e vetë njeriut. Në faqen e internetit <http://www.arkive.org/> është dhënë lista e llojeve të rrezikuara nga gjithë bota.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë lëvizin lirshëm në rreth. Secili fëmijë e ka të fshehur në pëllëmbë të dorës një letër të mbledhur. Secili fëmijë ka për qëllim që të takohet me sa më shumë fëmijë dhe ta luajë lojën “qëlloje në cilën dorë”. Kur të takohen dy fëmijë, secili prej tyre duhet t’i shtrijë duart, duke i mbajtur grushtet të shtrënguara. Pasi t’i shtrijë, ai duhet të përpiqet t’ia qëllojë se në cilën dorë e ka letrën fëmija dhe ta hapë dorën që fëmija tjetër e përcakton si dorë me letër. Nëse ia qëllon, ai e fiton letrën e fëmijës tjetër. Nëse nuk ia qëllon, ai e dorëzon letrën e vet. Nëse të dy fëmijët ia qëllojnë dhe nuk ia qëllojnë, ata mbeten në situatën e njëjtë siç kanë qenë para se t’ia qëllojnë në atë çift. Meqë shumë shpejt disa fëmijë do të mbeten pa letër në dorë (nuk mund të merret tjetër), secili fëmijë që qëllon mund të thotë edhe se ai mendon se në asnjërën dorë nuk ka letër. Në secilin raund të qëllimeve secili fëmijë mund ta ketë vetëm një fletë letre dhe vetëm në një dorë. Nëse “ka fituar” më shumë, ato i fut në xhep dhe i përdor nëse e humb fletën që e ka pasur.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja V-3.4: Llojet e rrezikuara

Fletë pune për arsimtarin/arsimtarene:

„UDHËZIME“

Sipas asaj që e lexuat nga fleta e punës, shkruani cilat janë llojet e rrezikuara në vendin tonë.

Nëse dini për ndonjë lloj që është i rrezikuar, e që nuk është përmendur në fletën e punës – shtojeni.

Sipas asaj që e lexuat në fletën e punës, shkruani cilat janë pasojat e drejtpërdrejta nga ato gjëra.

Sipas asaj që e lexuat në fletën e punës, shkruani pasojat afatgjata nga ato gjëra.

Sipas asaj që e lexuat në fletën e punës, shkruani se cilët janë faktorët më të rëndësishëm për zhdukjen e llojeve bimore dhe shtazore te ne.

Sipas asaj që e lexuat në fletën e punës, shkruani idetë tuaja si mund të pengohen ato në mënyrë efikase.

Sipas asaj që e lexuat në fletën e punës, mendoni fushatë për vetëdijesimin e popullatës për rëndësinë e ruajtjes së llojeve bimore dhe shtazore në Republikën e Maqedonisë.

Shkruani si duket ajo fushatë, çka do të përmbajë dhe kujt do t'i dedikohet.

Përmbajtja V-4:

MBROJTJA E PLANETIT TOKË

Pritet që nxënësi/nxënësja

Dituri	<ul style="list-style-type: none"> • Ta dijë dallimin ndërmjet burimeve të ripërtëritshme dhe të paripërtëritshme të energjisë • T'i dijë shkaqet dhe pasojat e ngrohjes globale, sindromit të kopshtit të qelqit dhe çrregullimit të mbështjellësit të ozonit • Të dijë se çka duhet të bëjë që të zvogëlohet ndotja e tokës, ajrit dhe ujërave (përdorimi i burimeve alternative të energjisë dhe teknologjitë e reja, filtrat e fabrikave...) • Të dijë për ekzistimin e lëvizjeve për mbrojtjen ekologjike të planetit
Shkathtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Të mund të tërheqë vërejtjen ndaj përdorimit të resurseve natyrore • Të mund të nxisë përdorim të burimeve alternative të energjisë
Qëndrime/ vlera	<ul style="list-style-type: none"> • Ta kuptojë përgjegjësinë personale për mbrojtjen e mjedisit jetësor • Ta kuptojë se ekzistenca e llojit njerëzor dhe e të gjitha qenieve të tjera të gjalla varet nga ballafaqimi me ekosistemet globale • Ta kuptojë se duhet të kufizohet përdorimi i teknologjive ndotëse spreje, freone ...) • Ta kuptojë nevojën e inkuadrimin aktiv në mbrojtjen ekologjike

PUNËTORIA V-4.1: (D)EVOLUCIONI

AKTIVITETI KRYESOR

Kërkohen 3-4 vullnetarë që do të jenë njerëz, ndërsa të tjerët ndahen në grupe të vogla me nga katër anëtarë. Secili grup i vogël është një ekosistem ndryshe, tre bimë dhe një kafshë. Për shembull: tre fëmijë janë pylli dhe ndërmjet tyre ndalet një fëmijë që është rrëqebull; tre fëmijë janë kallam, ndërsa një është xhufkë; tre fëmijë janë korale, ndërsa një është peshk; tre fëmijë janë livadh, ndërsa një është lepur, tre fëmijë janë lule, ndërsa një është bletë, tre fëmijë janë barnishte, ndërsa një është mollëkuqe. Në njërin nga grupet vendoset ai që e luan rolin e njerëzve. Përveç dy grupeve të tjera të ekosistemit, që janë radhitur me rastësi, në klasë vendosen edhe njerëzit e tjerë. Fëmijët që janë bimë/kafshë shikojnë drejt vetvetes dhe as nuk e ngrenë e as nuk e lëshojnë shikimin e tyre, por kohë pas kohe i mbyllin sytë përkohësisht. Njerëzit lëvizin lirisht nëpër hapësirë dhe, nëse duan, mund t'i shndërrojnë të tjerët në njerëz që "do t'ua kapin" shikimin. Kur "të kapet" shikimi, ai fëmijë po ashtu bëhet njeri dhe mund të vazhdojë të luajë sipas atyre rregullave. Kështu vazhdohet derisa të bëhen të gjithë njerëz.

DISKUTIM

1. Çka ndodhi?
2. Si ndjeheshit kur ishit bimë, kafshë, njeri?
3. A ju pëlqente kur pa ju pyetur ju shndërronin në njerëz?
4. A mund të bëhet paralele me jetën reale? A i "pyesin" njerëzit qeniet e tjera kur marrin aksione, a mbajnë çdoherë llogari për atë sesi do të reflektohen ndryshimet ndaj qenieve të tjera?
5. Kur u bërë të gjithë njerëz, çka ndodhi përreth jush?
6. Nëse kjo ndodhë në të vërtetë – a do t'ju pëlqente ajo botë? Si do të dukej jeta në atë botë?
7. Si do të ushqeheshin njerëzit?
8. Si do të merrnin njerëzit frymë? Prej ku vjen ajri i pastër? Kush e prodhon oksigjenin? A mund të ekzistojnë njeriu dhe planeti Tokë nëse zhduken pjesa më e madhe e llojeve bimore dhe shtazore? Pse?
9. Çka mund të bëjmë që të ndalet ndotja e paplanifikuar dhe zhdukja e llojeve bimore dhe shtazore?
10. Çka mund ta zhdukë natyrën Çka mund ta zhdukë planetin?
11. Si mund ta ndotë njeriu mjedisin? Si e ndot ujin? Si e ndot ajrin?
12. Çka mund të bëjmë që kjo të ndryshojë?

PËRFUNDIM

Njerëzit shpesh ndërmarrin aksione dhe e ndryshojnë mjedisin dhe natyrën pa i ditur dhe pa pasur mundësi t'i vërejnë pasojat e atyre aksioneve. Njerëzit e ndryshojnë mjedisin e tyre në të cilin jetojnë bashkë me qindra qenie të tjera të gjalla pa mbajtur fare llogari se çfarë efektesh do të ketë ai ndryshim ndaj atyre. Njerëzit në mënyrë shumë jointeligjente mendojnë se ata kanë të drejtë të bëjnë çka të duan. Por, edhe njerëzit po ashtu janë të varur nga natyra.

Pa të mirat natyrore ne nuk mund të jetojmë. Ajri dhe uji i ndotur janë po ashtu shkatërrues edhe për njeriun edhe për bimët edhe për kafshët.

Secili mund të kontribuojë për ruajtjen e mjedisit duke e ndryshuar sjelljen e tij.

REFLEKTIM


1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



PUNËTORIA V-4.2: ÇKA ËSHTË NDRYSHE?

MATERIALET

- Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Çka është ndryshe? (ose fotografi të revistave nga Hëna në makroplan dhe disa peizazhe nga Toka ku shihen drunjtë, liqenet, detet, lumenjtë, pyjet etj.)
- Disa topa të letrës së mbledhur, me madhësi të topit të tenisit
- Sellotej
- Lugë kafeje
- Gogël
- Tabelë dhe shkumës



AKTIVITETI HYRËS

Fëmijët qëndrojnë në një pjesë të klasës. Të gjithë ata një nga një ose, po të lejojë hapësira, dy nga dy, shkojnë nga njëri skaj i klasës në skajin tjetër, duke mbajtur në duar fletore në të cilën gjendet nga një top i letrës së mbledhur. Fletorja duhet të qëndrojë në pozitë horizontale, me qëllim që nxënësit të përpiqen ta baraspeshojnë me fletore, që topi mos t'u bie.

AKTIVITETI KRYESOR

Fotografitë e Hënës ngjiten në njërin anë të tabelës, ndërsa fotografitë e Tokës (nga fleta e punës dhe prej atyre që i ka sjellë arsimtari) ngjiten në anën tjetër. Arsimtari i pyet nxënësit se a dinë se çka janë fotografitë. Nëse nuk jepet përgjigje e saktë, thuhet se në njërin anë të fotografisë është sipërfaqja e Tokës, ndërsa në tjetrën është sipërfaqja e Hënës. Pastaj arsimtari përmes stuhisë së ideve kërkon të jepet përgjigje në pyetjen: “Çka është ndryshme në fotografitë e Tokës dhe të Hënës?”. Të gjitha idetë i shkruan në tabelë...

DISKUTIM

1. Pse në Tokë ka dhe, e jo shkëmbinj pa vegetacion? Si qëndron dheu në sipërfaqen e Tokës?
2. Kush e bën atmosferën e Tokës?
3. Për çka tjetër janë të rëndësishme bimët?
4. Çka do të ndodhë nëse zvogëlohet numri i bimëve në Tokë?
5. E i llojeve të kafshëve?
6. A mund t'i ngajë sipërfaqja e Tokës sipërfaqes së Hënës? Si?
7. Çka mund të bëhet për ruajtjen e atmosferës natyrore të Tokës dhe për ruajtjen e jetës së gjallë?
8. Çka mund të bëjë secili prej nesh me pak rezistencë?



PËRFUNDIM

Lidhjet ndërmjet botës së gjallë në Tokë janë shumë komplekse, shumështrësore, por edhe shumë të ndjeshme dhe që çrregullohen lehtë. Atmosferën në Tokë e krijojnë bimët, ndërsa deri te paraqitja e bimëve, ashtu siç i shohim sot, atmosfera e Tokës ka pasur një përqindje të vogël të oksigjenit. Bimët janë prodhuesit e vetëm të ushqimit dhe vetëm bimët mund t'i shndërrojnë mineralet e forta të Tokës në diçka të dobishme/ushqim. Jeta e gjallë komplekse mundëson që në Tokë të ketë atmosferë, klimë dhe ajër. Lidhjet ndërmjet botës së gjallë dhe të vdekur për nga përkufizimi janë reciproke. Nëse çrregullohet baraspesha e botës së gjallë ose

po të harxhohen resurset natyrore, kjo do të ketë efekt mbi gjithë jetën dhe pamjen e planetit. Nëse e shprehim me përshkrim, Toka funksionon si një organizëm i madh i gjallë. Këtu edhe shumë aksione që në shikim të parë na duken të parëndësishme, mund të bëjnë ndryshime. Nëse çrregullohet baraspesha natyrore e planetit, edhe Toka jonë mund t'i ngjajë shumë shpejt Hënës, pa gjelbërim dhe pa ujë. Mund të mbeten vetëm shkëmbinj të thatë.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Fëmijët qëndrojnë në një pjesë të klasës. Atyre u thuhet se në këtë lojë baraspesha është shumë e rëndësishme. Secili fëmijë duhet të kalojë në skaj tjetër të klasës, duke e mbajtur në dorë një lugë në të cilën gjendet një gogël që gjatë rrugës nuk duhet t'i bie.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja V-4.2: Çka është ndryshe?

Fletë pune për arsimtarin/arsimtares:

ÇKA ËSHTË NDRYSHE?



Punëtorja V-4.2: Çka është ndryshe?


Fletë pune për arsimtarin/arsimtarene:

ÇKA ËSHTË NDRYSHE?

PUNËTORIA V-4.3: VILENA - PLANETI I RI

MATERIALET

- Fletë pune për arsimtarin/arsimtare: Vilena – planeti i ri
- Fletë pune për nxënësit: Organizimi i jetës së planetit të ri 1, 2, 3 dhe 4
- Fletë pune për nxënësit: Informacionet e shkencës për Tokën
- Pajisje për të shkruar



AKTIVITETI HYRËS

Të gjithë lëvizin lirshëm në rreth. Udhëzimi është që ata të lëvizin ngadalë në mënyrë që vetë ata do ta zgjedhin: vallëzim, ecje, kërcim, duke e menduar veten se janë skafanderë dhe janë të gjendje të papeshë. Me rëndësi është të mos preken, sepse ashtu do t'u thyhen skafanderët do t'i gëlltitë vakumi kozmik.

AKTIVITETI KRYESOR

Nxënësve u lexohet teksti i fletës së punës për arsimtarin/arsimtare “Vilena – planeti i ri”. Nxënësit ndahen në katër grupe dhe secilit grup i jepet nga një kopje e ndryshme e fletave të punës për nxënës “Organizimi i jetës së planetit të ri 1, 2, 3 dhe 4”. Secilit grup i jepet nga një kopje e fletës së punës për nxënës “Informacionet e shkencës për Tokën” që mund të përdoren në punën e tyre. Puna grupore do të dëshmohet gjatë diskutimit.

DISKUTIM

1. Si do të prodhoni ushqim? Çka do të përdorni për përpunimin e tokës? A do të prodhoni pleh artificial? Pse? Cilat janë pasojat e përdorimit të teknologjive të Tokës për mjedisin e planetit të ri?
2. Si do të prodhoni energji? A do të keni kujdes që të prodhoni energji të pastër (prodhim që nuk ndot) ose energji të papastër (proces i prodhimit të energjisë ndot)? Cilat zgjedhje të mundshme për prodhimin e energjisë mund t'i bëni?
3. Si do të furnizoheni me ujë? A do të përdorni pajisje kimike për pastrim dhe higjienë personale? Çfarë? A do të mbani llogari për atë se kush ndot më shumë e kush më pak. Pse? Cilat janë pasojat?
4. A do të përdorni plastikë? Pse? Cilat janë pasojat e përdorimit të plastikës? A do të prodhojë shoqëria juaj mbeturina/plehra? Si do të ballafaqoheni me këtë? Çfarë plehu do të bëni: të zbërthyeshëm apo të pazbërthyeshëm? A do të ricikloni? Pse? A janë këto gjëra të rëndësishme për jetën në Tokë? Pse?
Si prisni të jetë ardhmëria e planetit të ri?
5. **A mbahet atje llogari për zvogëlimin e ndotjes me çka mund të shmangen problemet që janë shkaktuar nga ndotja e Tokës?**
6. **Cilat janë pasojat e ngrohjes globale ndaj planetit Tokë?**
7. Çka është vrima e ozonit? Si bëhet?
8. A e dini se çka do të thotë sindrom “i kopshtit të qelqtë”? Si është arritur ai?
9. Çka mund të bëjmë që ta mbajmë planetin të shëndoshë apo së paku mos ta zhdukim?
10. A mund të kontribuojë dikush nga ne për përmirësimin e këtyre gjërave? Si?



PËRFUNDIM

Mënyra e jetës bashkëkohore shpenzuese është shumë destruktive për gjithë jetën e Tokës. Njerëzit shndërrohen në konsumatorë të ledhatuar e të papërgjegjshëm, prodhues të mbeturinave dhe helmeve, thjesht shkatërrues. Që të ruhet ajo që ka mbetur nga jeta e planetit, duhet të mendohet seriozisht për atë se sa, çka dhe si konsumojmë. Me ndotjen e ajrit ka gjithnjë e më pak ozon në atmosferë. Meqë është dëmtuar mbështjellësi i ozonit, pjesa më e madhe e rrezeve ultra vjollce nga dielli bien në tokë, ndërsa refuzohen nga toka për shkak të reve të tymit, por nuk kthehen prapa në kozmos, por mbeten në atmosferë dhe e ngrohin tokën duke e bërë si një mjedis të qelqtë. Njësoj si kur prodhojmë energji, ushqim dhe resurse të tjera. Si do të sillemi ndaj ujit dhe botës së gjallë. Secili ka përgjegjësi personale për këto gjëra.

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR

Të gjithë qëndrojnë në rreth. Fëmijët një nga një e bëjnë një hap para dhe thonë: “Ky është një hap i vogël për mua, por i madh për planetin, sepse prej sot unë...”. Fjalia duhet të përfundohet me ndonjë vendim ose aksion që nuk duhet të jetë grandioz, por realisht i mundshëm dhe të ketë efekt minimal pozitiv ndaj mbrojtjes së planetit Tokë.

REFLEKTIM

1. Çka bëmë sot?
2. Si ndjeheshit?
3. Çka mësuam?
4. Si mund ta përdorim atë që e mësuam në jetën e përditshme?



Punëtorja V-4.3: Vilena - planeti i ri**Fletë pune për arsimtarin/arsimtaren:****VILENA – PLANETI I RI**

Nxënës të dashur!

Kam një risi shumë interesante për ju. Ju lutem dëgjoni me kujdes.

Sot e morëm një faks nga kryetari i Komunës, të cilin ai e ka pranuar nga kryetari Kuvendit të Republikës, i cili e ka pranuar atë nga Sekretari Gjeneral i Asamblesë Qendrore të Kombeve të Bashkuar, i cili e ka pranuar atë faks nga planeti VILENA, që është i barabartë me të barabartit e tubimit të galaktikës, se tash është zbuluar një sistem i ri që ka rreth dyzet planetë, që janë ideale për jetë, ndërsa janë të papopulluara. Në kuadër të galaktikës ka pikërisht aq qytetërime. Në tubimin ndërgalaktik është vendosur që në secilin planet të dërgohen nga (përmendet numri i nxënësve të klasës konkrete) përfaqësues të rinj të secilës racë të galaktikës. Në faksin të cilin kryetari i Kuvendit të Republikës e kanë lexuar tri herë para se t'ia dërgojë kryetarit të Komunës, i cili së paku dy herë piu ujë dhe tri herë i fshiu syzet para se të na e dërgojë neve, shkollës sonë, ku gjithë Këshilli i Arsimtarëve u djersit para se të marrë vendim se nuk ka kurrfarë baze për dyshim pasi që dy arsimtarë të gjuhës dhe një i informatikës e lexuan dhe e mësuan tekstin, ndërsa njëri madje i mori erë edhe ngjyrës së lapsit, se pikërisht klasa jonë është zgjedhur si potenciale që të shpërngulet në planetin e ri. Janë edhe dy shkolla që janë në konkurrencë. Njëra është nga Japonia veriore dhe një tjetër nga Sibiri.

Para se të fillojnë përgatitjet për udhëtim, ju duhet të merreni vesh për disa gjëra. Prej kësaj do të varet se a do ta fitoni pikërisht ju mundësinë që askush deri tash nuk e ka pasur në civilizimin tonë. Ju këshilloj që maksimalisht të përkushtoheni në detyrat që do t'i merrni.

Ata që nuk duan të udhëtojnë, i kanë 3 javë që të gjejnë zëvendësim, por për këtë do të flasim më vonë.

Tash duhet të punohet në këtë hartim.

